
PRURJE TE VARIANTEVE GJUHËSORE

HELENA GRILLO

Universiteti "Aleksandër Mojsiu", Durrës, SHQIPËRI

Email: helenagrillo@yahoo.com

AKTET VII, 4: 261-265, 2014

PËRMBLEDHJE

Një gjuhë standarde zhvillohet e larmohet: ajo merr prurje vazhdimisht nga rrethina dialektore, por ka edhe rrugën e saj të zhvillimit. Prurjet gjuhësore lidhen me nevojat që i lindin bashkësisë gjuhësore në faza të ndryshme të zhvillimit të saj. Në këtë fazë të zhvillimit të shqipes sot problem më i diskutueshëm është problemi i funksionimit e vlefshmërisë së standardit të shqipes, si dhe hulumtimet mbi prurjet nga varietete të ndryshme në standard. Zhvillimet në zbatimin e standardit janë trajtuar shkencërisht në *Atlasin Dialektologjik të Gjuhës Shqipe*. Vepra sjell prurje interesante të varianteve gjuhësore. Mbështetur në të dhënat e kësaj vepre, si dhe në *Përshkrimin e së folmes së Himarës, si pjesë e Labërishtes* nga Rahmi Memushaj do të analizojmë prurjet në standard nga e folmja e Himarës, si pjesë e varietetit të gjuhës së folur. Nga varieteti i gjuhës së shkruar do të hulumtojmë prurje nga vepra e Petro Markos.

Fjalë çelës: gjuhë standard, varietet gjuhësor, prurje

SUMMARY

A standard language develops by diversity and it takes always linguistic feeds from all the dialects but the standard language has its own development. All the linguistic flows is related to the needs of language community, in various stage of its development. In this phase of Albanian language, the main controversial problem today is the operation validity of standard language and the research regarding the linguistic flows from the dialects into the standard language. Developments of standard language applications are treated in the work *Dialectology atlas of Albanian language*. This work brings interesting linguistic flows from all the dialects. Based in data of this work and the *Description of oral dialect of Himara-as part of labërishte* from Memushaj, will analyze all the linguistic feeds that comes from the oral dialect of Himara into the standard language -as a part of, of spoken language. From the variety of written language, I am going to analyze the linguistic feeds tha comes from Petro Marko's work.

Key words: standard language , linguistic flows, variety.

Hyrje

Tabloja e gjuhës shqipe që po ravijëzohet paraqitet mjaft interesante: gjuha standarde në qendër që merr frymë me dy mushkëri njëkohësisht, toske e gege, pa harruar edhe degën tjetër ushqyese, variantin e diasporës arbëreshe. Shqipja e sotme po pasurohet vazhdimisht me prurje leksikore. Në punim do të hulumtojmë dukuri të varieteteve duke shqyrtuar si nga pikëpamja diakronike, ashtu edhe sinkronike. Punimi thellohet në prurjet nga varietetet e marra në shqyrtim dhe synon të identifikojë kë-

to prurje dhe kontributin e tyre në standard, rrugët e hyrjes në standard, evolucionin dhe zhvillimin e tyre në gjuhën shqipe. Përveç tyre një vend të rëndësishëm zënë letërsia e shkrimtarëve, lëvruet të fjalës shqipe dhe masmedia në tërësi (Rrokaj 2008: 34).

R. Hudson vëren: «njëri nga tiparet më të qenësishme të gjuhës është se ajo përbëhet nga shumë varietete, të cilat ndahen më tej në një numër ende më të madh entitetesh të veçanta. Me fjalë të tjera gjuha është pluridimensionale. Për t'i shqyrtuar varietetet gjuhësore në

raport me kontekstet social-kulturore prej nga lindin, nuk është aspak e nevojshme dhe as e dobishme të përdoren konstrukte me format të madh si “gjuha” dhe “dialektet”. Në të vërtetë të dhënat që ofrojnë studimet mbi gjuhën dëshmojnë se të bazuarit mbi konstrukte të tilla të mëdha shpie në përfundime fare pak (ose aspak) objektive» (Hudson 1980). Duke analizuar varietetet vendore gjuhëtarët i afrohen më objektivisht studimit të gjuhës së këtyre varieteteve dhe duke u njohur më parë me konstrukte të vogla e kanë më të lehtë të përcaktojnë rrugën e zhvillimit gjuhësor e prurjet nga këto varietete në strukturën tërësore të gjuhës.

Marrëdhëniet e ndërsjella me variantet jostandarde të gjuhës kanë qenë dhe mbeten rrugët kryesore për pasurimin e zhvillimin e gjuhës. Këto vitet e fundit janë shtuar ndjeshëm kontaktet e gjuhës standarde me variantet dialektore. Këto kontakte kanë vijuar diskutimet e dy pikëpamjeve, apo filosofive të ndryshme, të papajtueshme me njëra - tjetrën: filozofia e përfshirjes në standard e të gjitha vlerave gjuhësore kombëtare nga njëra anë dhe teoria e mospërzijes së sistemeve nga ana tjetër.

1. Prurje të Labërishtes në shqipen standarde

Do të shqyrtojmë prurjet nga labërishtja në shqipen standarde, fjalë e trajta fjalësh që kanë zënë vend në standard nga kjo e folme.

1.1 Shtresëzim të leksikut

1. Kemi fjalë të ngjashme me ato të gjuhës standarde, pa dallime leksikore dhe kuptimore, por që padyshim kanë pësuar ndryshime fonetike. Këto, sipas Gjovalin Shkurtajt i quajmë dialektizma fonetikë: *mbill-mbyll, si-sy, i verdhur- i zverdhur, çit-shqit, bë'rë-bërë, ki-ky, zëmër-zemër, të vogjij – të vegjël, xharape-çorape, ndrishoje-ndryshoje, e ndrejtë-e drejtë*, etj.

2. Fjalë të përbashkëta me ato të gjuhës standarde, të cilat paraqesin dallime në eptim dialektizma morfologjikë.

Këtu hyjnë dallimet në paradigma të foljeve, të lakimit të emrave, përemrave, p.sh: trajtat e së pakryerës, e të së kryerës së thjeshtë që nuk

dalin me mbasesat e gjuhës standarde, por na shfaqen me format e vjetra të shqipes.

3. Fjalë që lidhen me koncepte të reja. Këto fjalë ose mund të futen në të folmen nga gjuha standarde, ose mund të huazohen nga greqishtja, si rezultat i lëvizjeve të fuqishme demografike. Sipas Uilliam Mekit “në të folmen e dygjuhësit gjenden disa ndërndikime, të cilat shkaktohen jo nga gjuha tjetër, po nga kultura, pasqyrim i së cilës është kjo gjuhë. Elementi i huaj shpesh është rezultat i përpjekjes së bërë me qëllim që të shprehen fenomene të reja apo përvoja të reja në një gjuhë, e cila nuk i kish shënuar më parë. Fenomenet përbëhen nga futja e objekteve të reja gjë që e detyron dygjuhësin t’i përdorë të gjitha mundësitë që dy gjuhët e tij ia vënë në dispozicion”.

2. Prurje nga varieteti i gjuhës së shkruar

Një tjetër varietet që ndikon e sjell prurje në standard është varieteti i gjuhës së shkruar, të cilin për qëllime studimore, ne po e kufizojmë në gjuhën e letërsisë artistike. Mes entiteteve “Kod Standard” dhe “Gjuhë Letrare”, qysh në zanafillën e dokumentuar të tyre ka përcaktime të ndryshme e kontradiktore. Përcaktimet që jep FGjSSH (1980) për këto entitete të shqipes, janë si më poshtë:

- Gjuha letrare: Forma më e përpunuar e gjuhës së një populli, e cila ka norma të caktuara, të ngulitura në të shkruar e në të folur dhe arrin njësimin më të lartë në kohën e krijimit të kombeve e të shteteve kombëtare.

- Normë: Tërësia e mjeteve që përcaktojnë përdorimin e mjeteve të gjuhës letrare në mënyrë të njëlojtë për të gjithë pjesëtarët e një kombi.

Kemi përzgjedhur letërsinë artistike, pasi ajo e lëvruar gjerësisht në gjini e lloje të ndryshme, jep mundësi të shohim shkallën e përpunimit e zotërimit të mjeteve shprehëse dhe kulturës gjuhësore të shkrimtarëve tanë dhe për rëndësinë e jashtëzakonshme që kanë në procesin e standardizimit breza të tërë lëvruesh të saj, ndër të cilët rolin parësor e kanë luajtur shkrimtarët. Duke pasur parasysh interesat e përbashkëta të shkrimtarëve për gjuhën, do të anali-

zojmë prirjet gjuhësore në gjuhën e shkrimtarëve vlonjatë, për t'i krahasuar me varietetin e gjuhës së folur nga ata vijnë. Si autor bregas analizojmë prurjet e Petro Markos, gjuha e vepërave të tij është pjesë e gjuhës së letërsisë artistike, kapërthyer me ndikime të së folmes nga vjen autori.

Shembull: "E shoqja s'tha asnjë fjalë. Çoku më hidhte ndonjë *shikim të lodhur*. Sikur të ishte mësuar me të tilla vizita." (*Nata e Ustikës*, f. 111). Përdorimi i përemrit *çoku* vjen si prurje nga e folmja e Himarës në veprat e Markos, e kalon drejt standardit mes gjuhës së letërsisë artistike.

Shembull: "Litari është shpëtim, Andrea Bora. O vra nuk përdor litarë dhe plumb. Ato *vdekje humanitare* i përdor kuestura, karabineria dhe SIM-i."

Mendojmë se sintagma *vdekje humanitare* është prurje nga gjuha e Markos, mes metaforës.

Shembull: "Edhe në shtëpinë tënde të jesh, e po të mbyllësh derën nga jashtë, të duket sikur s'ngopesh me frymë. Pale në burg, në qeli! Dhe, ngaqë trupi mbetet në vend brenda katër mureve dhe *shpirti arratiset* duke kërkuar gjurmët e djeshme të këmbëve..." (*Nata e Ustikës*, f. 37).

Si njohës i mirë i gjuhës dhe i vlerave të saj, Petro Marko është nga ata autorë që si rrallë-kush tjetër skaliti një gjuhë të bukur, duke e lëmuar dhe ngjeshur me kujdes dhe figuracion dhe ide. Nga strukturat minimale si vatra të ngjizjes kuptimore ka përdorur më tepër ndërtimet animizuese të tipit *emër + mbiemër* dhe *folje + emër*. Kjo lëvizje kuptimore i ka shërbyer autorit për t'i dhënë më shumë gjallëri, jetë e frymëmarrje të gjerë veprës së tij.

Fjalë kompozita me prirje drejt standardit, madje tashmë të standardizuara që i japin bukur e hijeshi gjuhës (kemi parasysh kohën e shkrimit të veprës dhe paralelizmat me Fjalorët e gjuhës shqipe) – (hallemadhi, derëzi, kokëshkretë, derëshuari, vulëhumbur, flokëverdhë, fytyrëvogël, fatzi, derëbardhë, ogurzi, gjethetharë, tirqbardhë, këmbëkryq, leshverdhë).

E hollë, flokëverdhë, fytyrëvogël, me dy sy të mëdhenj bojëdeti, e veshur hollë, e zbatthur dhe me gjoks të madh gati përjashta (*Nata e Ustikës*, f. 38); *Fytyrë të mbushur, të rruar, me ato palë mustaqe të zeza të holla gjer te veshët dhe me një kape të gjatë si nëndetëse, të vënë përmbi sytë e mëdhenj bojë gështenjë. Kokën e kishte qethur krejt* (*Nata e Ustikës*); *Ipaemri, ashtu i gjatë edhe i thatë, me flokë të zinj dhe sy bojë hiri, dukej si ndonjë shtyllë fari.* (*Qyteti i fundit*, f. 3).

Në sintaksë parapëlqen sipas modelit të standardit kallëzuesin e shprehur me formën e përsëritur të së pakryerës, të së tashmes e të së ardhmes, i cili tregon një veprim me zgjatje të pakufizuar.

Nga fusha e sintaksës prurje e thellim në standard është përdorimi i pranëvënies së dy emrave pa lidhje morfologjike si përcaktor midis të cilëve ka vetëm një ngjashmëri e krahasim kontekstual të pashprehur morfologjikisht. Kjo është një prirje e gjithë poetëve vlonjatë (Merkuri 2001: 232): *bllok shkëmbi; pllakë shkëmb; gërmadhë - moli; dallgë - oshëtime; çimentoje - gur; tym - jetë; hije - ferri; jetë - ferri; shtëpitë - burg; banesat - burg*.

Dialektet kanë shërbyer e vlejné kurdoherë si gurra të pasurimit e të larmisë shprehëse të gjuhëve të njësuar. Vënia e njërit nga dialektet në bazën e gjuhës së njësuar zyrtare, pikërisht për arsye njësuese ka të bëjë në radhë të parë me zgjedhjen e trajtave fonetike e morfologjike, porse kjo nuk ua pret udhën aspak prurjeve të fjalëve, shprehjeve dhe mënyrave të të thënit nga krahinat e dialektit tjetër (Shkurtaj 2006). Ndonëse citojmë prof. Gjovalin Shkurtaj zbrisim nga niveli i dialektit në struktura më të vogla sipas Hudsonit. P.sh.: në gjuhën e njësuar shqipe normë është fjala grindje. U bëjnë vend me kënaqësi fjalëformimeve me prurje nga e folmja gërnj~ë (formë fonetike dialektore) me mjetet fonetike të shqipes, gërnj-ar (prapashtesa -ar) fjala gërnjar - grindavec. Formim i Markos, *mjegull gërnjare* realizohet duke kaluar kuptimisht. Përdoren dysorë të trajtave: sinorë - kufij. Trajta dialektore sinor~i (sinore të reja) po

hyn në standard për efekte shprehësie. Vetëm në të folmen e Himarës kjo fjalë haset me formim të ri në fjalën: sinorit – i (pronari i tokës a arës kufitare) (Qirjazi 2008: 170). Kjo prurje i përket të folmes. Paralelisht me standardin përdoren edhe fjalët: e djathta-e mëngjra.

“Nuk shkuam nga e djathta, po u kthjem nga e mëngjra” (Nata e Ustikës, f. 175) “U kthjem nga e mëngjra” (Nata e Ustikës, f. 183). Standardi nuk e pengon shkrimtarin të krijojë fjalë të reja e të përdorë paralelisht të dy trajtat (krahinore dhe standarde).

Rexhep Qosja shkruan: «Shkrimtar i mirë, që e ka të siguar ardhshmërinë gjuhësore, nuk mund të quhet ai që vetëm sa u përmbahet rregullave të drejtshkrimit, duke i respektuar si besimtarët fjalitë e librave të shenjtë. Shkrimtarët, më parë se gjuhëtarët janë ata që e zhvillojnë e pasurojnë gjuhën, që e zgjerojnë dhe i thellojnë mundësitë e saj shprehëse. Për më tepër, mund të thuhet, këtë detyrë ata nuk do të mund ta kryenin me sukses në qoftë se do t'i respektonin kërkesat e gjuhëtarëve që shpesh janë në kundërshtim me “lirinë” gjuhësore të krijuesve» (Qosja 1988).

Si ndajfolje vendi parapëlqehet trajta dialektore *përposh*, e cila po hyn në standard: *hidhnim gurë përposh (Ultimatumi, f. 187); përposh, në shkëmbinjtë e nxirë, vala e detit mezi nxirrte pëshpërimat e saj (Nata e Ustikës f. 201); përposh nesh gremina (Nata e Ustikës, f. 183); përposh dëgjohej në gramafon (Nata e Ustikës, f. 117).*

3. Kompozimi - prurje në gjuhën e Petro Markos

Prejardhja mbetet mënyra më prodhimtare dhe më e larmishme në sistemin e fjalëformimit. Një shtrirje e gjerë e saj, kryesisht e nënndarjeve, qofshin këto të fundit, parashtesore, prapashtesore etj., evidentohet në veprën e Petro Markos. Gjallërimi i madh i fjalëformimit me anë të kompozimit, duke krijuar njësi të mbyllura e kompakte, sjell edhe forcimin e sintetizimit gramatikor. Prurja vjen si sintetizëm gramatikor, kryesisht në fushën e kompozitave, lind domosdoshmërisht nevojën e

analizës së tyre mbi bazën e kriterit strukturor - formal. Sipas vlerës leksiko – gramatikore të komponentëve përbërës të këtyre kompozitave, gjithmonë, duke iu referuar materialit të vjelë, dallojmë këta tipa të veçantë strukturorë:

1. emërorë
2. mbiemërorë
3. ndajfoljorë
4. numërorë, deri diku edhe foljorë.

Emër + emër çfarëdo. Ky tip përbëhet nga nëntipa të ndryshëm. Gjymtyra e dytë përcakton të parën. Këtu përfshihen fjalë të tilla si: *bregdeti, magnetotruri, dorëshkrim, mesdheu, mesnatë, bukëfiqe, bukëvale* etj. *“...dhe njeriu i veçuar nga jeta, ose më mirë i vdekur, se i vdekur është ai që jeton me kujtimet, kurdis magnetotrurin e tij dhe kalon kohën i qetë, duke numëruar hapat e këmbëve e të mendimit... (Retë dhe gurët, f. 11); “dhe vejusha priftëreshë i shpuri dy bukëfiqe, një çepele, pak duhan dhe një shishe verë të vjetër për priftin e saj të ndjerë” (Nata e Ustikës, f. 67).*

Prurja e kompozitave, një pjesë e mirë e të cilave, po shkojnë drejt standardit, është një vlerë e padiskutueshme gjuhësore.

Rezultatet dhe diskutimi

Rezultatet e nxjerra do t'i përdorim për t'u thelluar në njohje e analiza të gjuhës së letërsisë artistike. Theksojmë se një faktor i rëndësishëm që duhet pasur parasysh në studim është faza e zhvillimit të shqipes standarde. Punimi hap dhe analizon polemika mbi prurjet në standard, e konkretisht prurjet nga Labërishtja, autorët vlonjatë, si dhe Petro Marko. Nga diskutimet e shumta mbi hapjen e standardit jemi mbështetës të mendimit të argumentuar se vetëm sistemi leksikor është i hapur nga prurjet e të folmeve e varieteteve të ndryshme gjuhësore.

Bibliografia

RROKAJ, Sh. (2008), Shqipja standarde në pragun e shekullit të ri: *Gjuha shqipe*, 3, Tiranë.
HUDSON, R. A. (1980), *Sociolinguistika*, Bologna.

MERKURI, N. (2001), *Vlora në rrjedhat e kohës*, Vlorë.

SHKURTAJ, Gj. (2006), *Kundrime gjuhësore*, Tiranë.

QIRJAZI, Dh. (2008), Recension- E folmja dhe toponimia e Qeparoit N. Sotiri: *Albanohellenica*, 3, Selanik.

QOSJA, R. (1988), Përgjegjësia gjuhësore e shkrimtarit: *Panteoni i rralluar*. Prishtinë.

FREQUENCY ANALYSIS OF THE ALBANIAN LANGUAGE, CHALLENGES AND BENEFITS ANALIZIMI FREKUENCOR I GJUHËS SHQIPE, SFIDAT DHE PËRFITIMET

Qani MUKA¹ & Edlira ÇERKEZI²

¹Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit, Universiteti Politeknik i Tiranës, Tiranë, SHQIPËRI

²Departamenti i Gjuhës dhe i Letërsisë, Fakulteti i Edukimit, Universiteti "Ismail Qemali",

Vlorë, SHQIPËRI

E-mail: qani.muka@fti.edu.al; edlira_cerk@yahoo.com

AKTET VI, 4: 266-271, 2013

PËRMBLEDHJE

Në ditët e sotme kur teknologjia po përparon me hapa të shpejtë, duket se edhe sasia e komunikimit njerëzor po rritet, njëkohësisht duke marrë forma të ndryshme. Në këtë kuadër, disiplina e gjuhësisë kompjuterike po merr një rol tejet të veçantë. Ajo gjen përdorim në kriptografi, analizë frekuencore e teksteve të koduar, autorësi të veprave bazuar në stilin e autorit sipas një vlerësimi statistikor të kryer. Në këtë rrjedhë, ajo ç'ka synohet të sillet në këtë artikull është krijimi i një baze për vlerësimin sasior të gjuhës shqipe duke kryer një analizë statistikore të gjuhës shqipe nëpërmjet algoritmave të zhvilluar prej nesh. Në dallim nga studimet analoge që janë kryer për gjuhët e tjera, gjuha shqipe paraqet sfida të veçanta, si: krijimi i një korpusi fjalësh të dixhitalizuara, modifikimi i algoritmave të cilët duhet të trajtojnë gërmat bigrame "dh, gj, ll, th, nj, rr, sh, xh, zh" si dhe gërmat me shenja diakritike "ë, ç". Për të marrë rezultate me një saktësi të madhe dhe të besueshme si tekst përfaqësues (korpusi i fjalëve) është marrë fjalori Shqip me 48000 fjalë të cilin e kemi dixhitalizuar në mënyrë që të jetë i trajtueshëm lehtësisht prej algoritmave. Si rezultat do të marrim frekuencën relative të secilës germë të përdorur në korpus i cili është një tekst përfaqësues i gjuhës shqipe për të dhënë një referencë për vlerësimet frekuencore të mëtejshme. Si vlerë të shtuar, me algoritmin e zhvilluar prej nesh pretendojmë të hedhim një bazë për vlerësimin e autorësisë së veprave duke u nisur nga veçoritë e analizës statistikore që u bëhet autorëve të veçantë.

Fjalët çelës: analizë frekuencore, gjuhësi kompjuterike, identifikim i autorësisë, korpusi i fjalëve.

SUMMARY

Nowadays where technology is progressing rapidly, it appears that the amount of human communication is growing, simultaneously taking different forms. In this context, the discipline of Computer Linguistics is taking a very special role. It finds use in cryptography, frequency analysis of the encoded texts, authorship identification based on the author's style as a statistical evaluation performed. In this flow, what we aim in this article is to create a basis for quantitative evaluation of the Albanian language by performing a statistical analysis of the Albanian language through algorithms developed by us. In contrast to analogous studies that have been conducted for other languages, Albanian presents special challenges such as: creation of a digitized corpus of words, modification of algorithms which have to deal with bigram letters "dh, gj, ll th, nj, rr, sh, xh, zh" and special letters "ë, ç". To obtain results with great precision and reliability, as representative text (corpus of words) is taken Albanian dictionary with 48000 words which we have digitized in order to be easily treated by algorithms. As a result we will take the relative frequency of each letter used in the corpus, which is a representative text of the Albanian language giving a frequency reference for further evaluations. As an added value, the algorithm developed by us pretend to throw a basis for assessing the authorship of manuscripts ranging from statistical analysis features that were made for particular authors.

1. Hyrje

Komunikimi dhe gjuha kanë qenë dhe do të mbeten një simbol i vyer që një popull kultivon dhe ruan në kulturën dhe traditën e vet. Sot po merr një rol të veçantë edhe komunikimi ndërkulturore mes kulturave të ndryshme. Në këtë aspekt kanë ndikuar së fundmi edhe zhvillimet e fundit në fushën e teknologjisë, të cilat i kanë shkurtuar shumë distancat midis popujve dhe kulturave të ndryshme, pikërisht prej risive që kanë sjellë në çdo fushë dhe kryesisht në shkëmbimin ndërkulturore [1] [2] [3] [4].

Në këtë kontekst, gjuhësia kompjuterike po merr një rol të veçantë në studimet sasore lidhur me gjuhë të ndryshme, si: anglishtja, italishtja, frëngjishtja etj. Ndërkohë që për gjuhët e tjera gjejmë një bazë të vlerësimit sasior apo statistikor të tyre, pra një vlerësim numerik rreth përdorimit të secilës germë, të secilës fjalë apo tog-fjalësh që përdoret brenda një gjuhe, për gjuhën shqipe kjo gjë mungon.

Ajo çfarë ne na nxit për të ndërmarrë këtë studim është realizimi i një vlerësimi statistikor, sasior të gjuhës shqipe. Në thelb ne duam të arrijmë të njohim se cilat janë germat më të përdorura në gjuhën shqipe, cilat janë fjalët apo tog-fjalëshat (n-gramat) më të përdorura në gjuhën shqipe. Detyra e një vlerësimi statistikor të një gjuhe nuk mbaron thjesht në faktin që njihemi me përdorshmërinë apo frekuencën e një geërme/fjalë, pasi ajo gjen dhe përdorime të tilla si në kriptografi, e cila në ditët e sotme është një çështje e rëndësishme e teknologjisë së informacionit [5] [6].

Një përdorim të gjërë gjen[edhe në vlerësimin e autorësisë së veprave duke vlerësuar stilin (këtu bëhet fjalë për një vlerësim sasior) të një autori [7] [8] [9]. Në këtë kontekst me stil të një autori do të kuptojmë frekuencën relative të germave/ fjalëve/ n-gramave që një autor përdor më së shumti në shkrimet e tij. Gjithashtu në stil të një autori do të përfshihet edhe vlerësimi rreth gjatësisë së zanoreve. Duke bërë një vlerësim sasior mbi stilin e një autori, ne krijojmë një model apo më mirë një profil sasior të një autori të cilin mund ta përdorim më pas për krahasime të ndryshme ndërmjet autorëve të tjerë apo ç'ka është më e rëndësishme duke vërtetuar nëse një

dorëshkrim është origjinali i një autori apo është imitim i kohës [10] [11] [12].

Po t'i referohemi studimeve të ndryshme që janë bërë, kryesisht ato për gjuhën angleze [13] dhe italiane [14], që u bënë nxitje edhe e studimit tonë, do përpiqemi që të hedhim një bazë reale për vlerësimin statistikor, sasior, të gjuhës shqipe. Lidhur kjo edhe me faktin e mungesës së një studimi të tillë, rëndësia dhe roli që merr nxjerrja e rezultateve për shpërndarjen statistikore të germave/ fjalëve/ n-gramave, është me pritshmëri të madhe.

Ajo çfarë ne duam që të arrijmë është hedhja e një baze për vlerësime të mëtejshme sasore të gjuhës shqipe, duke e lidhur edhe me vlerësimin e autorësisë së veprave duke krijuar njëkohësisht një profil sasior për shkrimtarët tanë. Në studimin tonë jepet një model sasior korrekt për shpërndarjen statistikore të secilës germë/fjalë, e cila mund të përdoret si etalon dhe të luajë rolin e një modeli krahasues lidhur me modele që kanë gjuhët e tjera, apo dhe modele të dorëshkrimeve të tjera brenda gjuhës shqipe.

2. Materialet dhe metodat

Megjithatë, secila gjuhë ka strukturën e vet dhe veçantitë e saj dhe sfidat për të arritur deri tek rezultatet që ne synojmë janë të shumta.

Si fillim për të kryer një studim apo një vlerësim sasior të gjuhës shqipe të duhet një korpus i dixhitalizuar, i cili për gjuhën shqipe mungon. Ashtu si edhe në studimet analoge për gjuhë të tjera, si korpus apo si tekst përfaqësues merret fjalori gjuhësor. Për studimin sasior të gjuhës angleze është marrë si korpus *Fjalori Anglisht i Oxfordit* [15]. Fjalori gjuhësor paraqet një korpus të plotë, i cili bën vlerësimin sasior sa më të saktë. Kjo lidhet dhe me faktin që fjalët e paraqitura aty janë të gjuhës standarde dhe të redaktuar deri në detaje. Kështu që ndikimet krahinore në gjuhë eliminohen nga një vlerësim sasior jo korrekt që mund t'i bëhet një gjuhe, vlerësim i cili më pas do të merret si referencë për t'u krahasuar me dorëshkrime të tjera brenda të njëjtës gjuhë apo ndërmjet gjuhëve të ndryshme.

Sfida jonë e parë lidhet me krijimin e këtij korpusi, i cili duhet në formë të dixhitalizuar, për

të krijuar lehtësira në analizën sasiore që do të bëhet. Në këtë studim është zgjedhur si korpus *Fjalori i Gjuhës Shqipe* me 48'000 fjalë (FGJSH, Tirane, 2006) [16]. Ky fjalor është përpunuar dhe është kthyer në formë dixhitale, ku gjithsej përbëhet nga 1.9 milion fjalë (në total) dhe 9 milion karaktere.

Sfida e dytë me të cilën përballemi është ndërtimi i një algoritmi, programi kompjuterik, i cili të marrë parasysh gerrat dyshe: dh, gj, ll, nj, rr, sh, th, xh, zh; si edhe gerrat e veçanta: ç, ë. Dihet që programet kompjuterike kanë një formë të standardizuar komunikimi apo gjuhe, të cilën ata e përdorin dhe kjo është sipas kodit ASCII, i cili nuk i përmban gerrat e veçanta dhe dyshe që përdoren në gjuhën shqipe. Si rrjedhim, ndërtimi i algoritmit është shumë delikat dhe nuk mund të gjejë mbështetje në studimet analoge që janë kryer për faktin që gjuha shqipe dallon krejtësisht nga gjuhët e tjera. Prandaj, algoritmi i përdorur për vlerësimin e gjuhës shqipe është zhvilluar krejtësisht prej nesh, është origjinal dhe i personalizuar për t'u përballur plotësisht me sfidat e germave të veçanta dhe germave dyshe. Ndërtimi i një algoritmi të mirë, i cili merr parasysh të gjitha rrethanat apo variantet e përdorimit të germave brenda një gjuhe, rrjedhimisht na çon drejt një vlerësimi sasior, statistikor, korrekt. Pas kryerjes së simulimeve të para me anë të programit tonë u vu re një fenomen, i cili na bënte që rezultatet të mos ishin krejtësisht korrekte dhe të lidhura me realitetin e përdorimit të gjuhës. Kjo lidhet me faktin që duke qenë se si korpus përdorej *Fjalori i Gjuhës Shqipe*, disa germave u bëhej një mbivlerësim, apo disa të tjerave një nënvlerësim për shkakun se në fjalor përdoren shkurtesat që vendosen përbri çdo fjale dhe shpjegojnë përdorimin e saj. Si shembull mund të japim disa shkurtesa: e. – emërore (rasa); m. – emër i gjinisë mashkullore; f. – emër i gjinisë femërore; sh. – numri shumës etj. Në këtë kontekst u pa e udhës që shkurtesat të eliminoheshin dhe mos të ishin pjesë e korpusit

që do të merrej për të kryer vlerësimin sasior. Kjo sepse ne duam të kryejmë një vlerësim sasior të një gjuhe të shkruar me korrektesë nga ana drejtshkrimore dhe në mënyrë të balancuar. Duke shpjeguar më tej idenë e balancimit në shkrim; ne nuk mund të pretendojmë që të kryejmë një vlerësim sasior korrekt kur teksti i marrë në shqyrtim përsëritë për arsye specifike një fjalë apo disa fjalë. Ne nuk mund të marrim një tekst që lidhet rreth përdorimit të rrezeve X dhe më pas të pretendojmë që vlerësimi sasior është kryer korrekt dhe modeli që ne marrim për një gjuhë të tërë është më korrekti i mundshëm, kjo pasi ky lloj teksti që flet rreth rrezeve X do të na japë një mbivlerësim të gërmës "x" apo dhe fjalës "rreze".

Duke përdorur këtë mënyrë analizimi, edhe shkurtesat që vendosen në fjalor përbri çdo fjale, paraqesin një pasaktësi ku mbivendoset vlerësimi statistikor korrekt që i bëhet gjuhës shqipe.

3. Rezultate dhe diskutime

Në përfundim mund të themi se i gjithë korpusi përbëhej nga 1.9 milion fjalë (të përdorura në totale) dhe 7.7 milion germa. Shpërndarja statistiore e germave jepet në Tabelën 1 (renditja sipas alfabetit) dhe në Figurën 1 (renditja sipas frekuencës më të madhe të përdorimit). Siç shihet, gërmat "ë" dhe "e" janë më të përdorurat në gjuhën shqipe. Për të krijuar një kuptim dhe për të mos lënë në shumë pikëpyetje sesi këto rezultate janë marrë, është kryer edhe vlerësimi sasior sipas përdorueshmërisë më të madhe të fjalëve dhe n-gramave. Kështu, në Tabelën 2 janë paraqitur frekuencat relative të 30 fjalëve më të përdorura në gjuhën shqipe dhe 30 togfjalëshave (për saktësi: 2-grama dhe 3-grama). Kjo na jep një pasqyrë më të mirë të rezultave, edhe përmes një analize të shpejtë mund të shikojmë që rezultatet e shpërndarjes statistikore të germave nuk janë surprizë. Ato kanë një lidhshmëri me fjalët më të përdorura dhe me tog-fjalët më të përdorura në gjuhën shqipe.

Tabela 1: Shpërndarja statistikore (frekuenca relative) e germave të alfabetit të gjuhës shqipe

gërma	A	B	C	Ç	D	DH	E	Ë	F	G	GJ	H	I	J	K	L	LL	M
$f_{rel}(\%)$	7.4	1.8	0.4	0.4	2.4	0.7	9.9	10.3	1.3	1.2	0.6	1.1	7.8	2.6	3.6	2	0.7	4.4
gërma	N	NJ	O	P	Q	R	RR	S	SH	T	TH	U	V	X	XH	Y	Z	ZH
$f_{rel}(\%)$	4.7	0.8	3.4	3.2	1.3	6.9	0.6	2.9	2.7	7.4	0.4	3.9	1.5	0.1	0	0.7	0.8	0.1



**Fig. 2: Renditja e germave sipas shpërndarjes statistikore (frek. më lartë→më e vogël)****Fig. 3: Krahasimi i shpërndarjes statistikore të germave për gjuhën shqipe, angleze dhe italiane**

Tabela 2: Shpërndarja statistikore e 30 fjalëve më të përdorura në gjuhën shqipe

Nr.	f _{rel} (%)	Fjala	f _{rel} (%)	2-Grama
1	6.72	e	0.5	shih te
2	5.08	të	0.49	për të
3	4.39	i	0.32	në një
4	2.84	që	0.22	e të
5	2.5	me	0.21	që është
6	2.37	në	0.18	e një
7	2.07	një	0.17	që ka
8	1.52	për	0.16	ë a
9	1.26	a	0.15	me një
10	0.88	nga	0.15	që nuk
11	0.85	ka	0.14	që ka
12	0.73	është	0.14	që është
13	0.68	u	0.14	sipas kuptimeve
14	0.64	dhe	0.14	kuptimeve të
15	0.62	shih	0.14	me të
16	0.59	nuk	0.13	të një
17	0.57	ose	0.13	që i
18	0.56	më	0.12	veta
19	0.54	diçka	0.12	e me
20	0.53	te	0.12	nga një
21	0.51	si	0.11	dhe e
22	0.43	etj	0.11	për një
23	0.43	shumë	0.11	a të
24	0.32	pa	0.11	të foljeve
25	0.28	sipas	0.11	e ka
26	0.26	s	0.1	që të
27	0.24	dikujt	0.1	veprimi sipas
28	0.23	së	0.1	për të
29	0.22	ia	0.1	në të
30	0.21	dikë	0.09	ai që

Nëse duam të kryejmë studime më të thelluara, fare mirë mund të kryejmë një analizë konkordancash për secilën fjalë. Kështu mund të shikohen mënyrat e ndryshme të përdorimit brenda fjalisë për secilën fjalë. Kjo jepet si një shembull që do të shërbejë për analiza studimore të mëtejshme, pasi në këtë punim nuk është objekt studimi. Lidhur me faktin se sasia e temave që do të hapeshin dhe do të trajtoheshin do t'i tejkalonte kufijtë dhe kornizat si dhe idenë kryesore për të cilën ky studim u nxit dhe mori jetë.

Një trajtim interesant është dhe krahasimi i shpërndarjes statistikore për gjuhën shqipe, angleze dhe italiane, treguar në Figurën 3. Siç vërehet dhe në grafik, diferencat ndërmjet gjuhëve janë të ndryshme. Gjetja e pikave të për-bashkëta dhe e pikave të diferencës del si një detyrë për studimet në vazhdim që mund të

kryhen lidhur me faktet e përdorimit të secilës germë për secilën gjuhë. Kjo çështje duhet të shihet në tërësi, pasi nëse e trajtojmë vetëm në këndvështrimin e një shpërndarjeje statistikore të germave, në fushën e gjuhësisë nuk na thotë asgjë të re.

Nëse trajtohet e plotë bashkë me shpërndarjen statistikore të fjalëve apo tog-fjalëve, kemi një pamje më të plotë studimore ku mund të ndërpusim dhe komunikimin ndërkulturor, si dhe të vëzhgohet me kujdes lidhshmëria e shpërndarjes statistikore, kur bëjmë dhe përkthime nga njëra-gjuhë në tjetrën. Të gjitha këto janë detyra të cilat do të jenë objekte të studimeve të mëtejshme në fushën e vlerësimeve sasiore që u bëhet gjuhëve. Këto lloj studimesh do të ndihmonin shumë jo vetëm në të kuptuarit e diferencave dhe pikave të kontaktit ndërmjet gjuhëve apo kulturave të ndryshme, por duke luajtur dhe rolin e re kordeve që bëhen objekte studimore për brezat në vazhdim duke kuptuar evoluimin dhe ndikimet që kulturat e ndryshme kanë pasur dhe kanë tek njëra-tjetra.

Si përfundim, mund të themi se në këtë artikull është hedhur baza për krijimin e një modeli të shpërndarjes statistikore të germave/fjalëve në gjuhën shqipe. Ky model do të luajë rolin e një etaloni i cili merret si referencë për krahasime sasiore ndërmjet rezulateve të ndryshme statistikore që merren për dorëshkrimet në gjuhën shqipe. Gjithashtu mund të merret dhe si model referues për t'u përdorur për krahasimet sasiore që bëhen ndërmjet gjuhëve të ndryshme. Këtë mund ta themi me siguri, pasi ky studim i paraqitur në këtë punim është punuar mbi të njëjtat baza që janë punuar edhe studimet analoge të gjuhëve të ndryshme.

Bibliografia

- [1] E. Çerkezi, Q. Muka, E. Çelo, A. Dumi, Impact of new entry strategic technology on frequency words analysis in translation, literature and intercultural communication: *Proceedings of 9-th International Strategic Management Conference*, Latvia, 2013.
- [2] Translation and Cultural Identity: Selected Essays on Translation and Transcultural Communication Edited by Micaela Muñoz-Calvo

and Carmen Buesa-Gómez Newcastle upon Tyne: Cambridge Scholars Publishing, 2010.

[3] N. Castro, Translation: A Meeting Point for Interdisciplinary Enquiry, *Global Media Journal - Canadian Edition*, Vol. 5, 2012.

[4] A. Glodjović, Translation as a means of cross-cultural communication: some problems in literary text translations, *Proceedings of the Second International Conference on Linguistic and Intercultural Education (CLIE2)*, 2010.

[5] R. Lewand, *Cryptological Mathematics*, Mathematical Association of America, Washington DC 2000.

[6] Lee, E. Stewart. "Essays about Computer Security" (PDF). University of Cambridge Computer Laboratory. p. 181.

[7] O. V. Kukushkina, A. A. Polikarpov, and D. V. Khmelev, Using Literal and Grammatical Statistics for Authorship Attribution, *Problems of Information Transmission*, Vol. 37, No. 2, 2001.

[8] D. V. Khmelev, F. J. Tweedie, Using Markov chains for identification of writers, *Literary and Linguistic Computing*, Vol. 16, No. 4, 2001.

[9] M. Rosen-Zvi, T. Griffiths, P. Smyth, M. Steyvers, Learning Author Topic Models from Text Corpora, *ACM SIGKDD Conference*, 2004.

[10] J. Diederich, Computational methods to detect plagiarism in assessment, 7th Information Technology Based Higher Education and Training (ITHET), 2006.

[11] P. Sallis, S. Shanmuganathan, A Blended Text Mining Method for Authorship Authentication Analysis, *Proceedings of the Second Asia International Conference on Modelling & Simulation (AMS)*, 2008.

[12] Y. Hosoda, Repair and relevance of differential language expertise in second language conversations. *Applied Linguistics*, 27(1), 2006.

[13] "What is the frequency of the letters of the alphabet in English?". *Oxford Dictionary*. Oxford University Press. Retrieved 29 December 2012.

[14] S. Singh and S. Galli, *Codici e Segreti* (in Italian), Rizzoli, Milan 1999.

[15] *Concise Oxford Dictionary* (11th edition revised, 2004)

[16] Fjalori i Gjuhës Shqipe, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2006.

PUNA ME NORMIMIN E SHPREHJEVE DHE STANDARDIZIMIN E TERMEVE TË REJA REGARDING SYSTEMATIZATION OF EXPRESSIONS AND STANDARDIZATION AND AS AN EXPRESSION

MUSTAFA IBRAHIMI

Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit, Universiteti i Evropës Juglindore, Tetovë, MAQEDONI
Email: m.ibrahimi@seeu.edu.mk

AKTET VII, 4: 272 - 277, 2014

PËRMBLEDHJE

Në këtë artikull bëjmë fjalë për rrugën deri te standardizimi i termave të ndryshëm, sidomos natyrën, formimin dhe përdorimin e tyre. Me zhvillimin e shkencës në të gjitha fushat e veprimit shoqëror të njeriut, paraqitet një dukuri e vërshimit të termave të reja dhe të llojllojshme që kërkojnë normim të shpejtë dhe profesional, si në planin e shprehjeve, ashtu edhe të përmbajtjes. Në këtë mënyrë këta terma kërkojnë një terminologji të unifikuar dhe të standardizuar, por edhe botimin e një fjalori që do t'i përmbledhte vetëm fjalët e reja në 20 vjetët e fundit, por të normuara dhe si terma të standardizuar. Objekt yni është të bëjmë një studim mbi disa nga problemet që dalin gjatë normimit të tyre. Nuk mund të lejojmë që këta terma t'i marrim ashtu si janë pa ndonjë kriter, qoftë nga nomenklatura popullore, qoftë nga repertori i fjalorit të gjuhëve klasike, ose thjesht t'i marrim nga literatura e huaj dhe ashtu t'i përdorim në gjuhën tonë letrare dhe në sistemin tonë terminologjik.

Fjalët çelës: normim, shprehje, standardizim, terme, terminologji

SUMMARY

In particular, in this item, we will discuss the process of standardizing various terms, with a special on emphasis on the nature, the formation, and their usage. As science advances in many other realms of mankind's social interaction, a phenomenon of a surge of new and diverse terms emerges. These terms require a speedy and professional systematization of both expressions and content. Hence, it is necessary that these terms be comprised in a unified and standardized terminology. Our goal is to conduct a study on some of those problems regarding certain relationships of words and expressions that we will touch on in this keynote speech. We cannot afford to simply acquire those terms, either from the popular nomenclature, the repertoire of classic languages dictionary, or get them from foreign literature and incorporate them in our standard language and our terminological system. These terms require a speedy and professional systematization of both expressions and content.

Key words: systematization, expressions, standardization, terminology.

Hyrje

Nga dita në ditë në korpusin e çdo gjuhe, po edhe të asaj shqipe, hyjnë shumë fjalë të reja, në të gjitha fushat e shoqërisë moderne. Kjo dukuri, mori hov më të madh në botën e sotme të globalizimit, të dinamizmit dhe të shpejtësisë, sidomos me ardhjen e teknologjisë së re dhe zhvillimin e shkencave kompjuterike, kryesisht në mesin e

shekullit XX, kur ndodhën shumë ndryshime. Në këtë mënyrë puna me terminologjinë merr një rëndësi të dorës së parë, e cila duhet pranuar dhe për të cilën duhet punuar me përkushtim dhe me profesionalizëm. Në këtë kuptim, lufta për terminologjinë është luftë për afirmimin e identitetit kulturor të një kombi. Roli i terminologjisë është në të njëjtën kohë kapital për të gjitha mjeshtritë

dhe dijet, të cilat i huazojmë përmes përkthimit: gjuhësi, filozofi, mjekësi, inxhinieri, shkenca të mjedisit, arte...

1. Tipologjia dhe ritmi i ndryshimeve në fjalorë

Renovimi i fjalorit të gjuhës është një proces i natyrshëm dhe i vazhdueshëm. Ajo që më tepër i nevojitet shqipes është intervenimi në domenin leksikor. Në fakt leksiku është sfera më dinamike dhe më e ndryshueshme në një gjuhë, për dallim nga fonetika dhe morfologjia, të cilat janë më konservatore. Ekzistojnë dy lloje arsyesimesh për intervenimin në domenin leksikor:

(a) arsyetimi i parë është kur mendohet se në gjuhë kanë vërshuar fjalë të huaja, të cilat duhet mënjanuar dhe zëvendësuar me fjalë autoktone; ndërkaq

(b) në rastet e tjera ky veprim ndaj leksikut i përgjigjet dëshirës që gjuha të pasurohet: mendohet se gjuha për t'iu përshtatur nevojave të reja të kohës moderne, dhe për t'i përcjellur përmbajtjet e reja (në arsim, politikë, shkencë etj) duhet të fitojë fjalor i ri.

Në historinë tonë të re ka dy periudha të tilla të depërtimit të termave të rinj. Njëra është menjëherë pas datës 9 shtator 1944, kur u ndryshua sistemi shoqëror, përkatësisht qëndrimet e njerëzve. Në atë kohë në gjuhën shqipe hynë shumë fjalë, të cilat i pasqyruan këto ndryshime. Hynë shumë fjalë të reja nga rusishtja, si dhe të tilla, të cilat sot janë arkaizma dhe nuk përdoren në fjalorin tonë (si për shembull zbor, por edhe nga kinezishtja, si fletërufe, e përkthyer në shqip; ose dezurni nga frengjishtja nëpërmjet rusishtes etj.) Periudha tjetër e hyrjes së shumë fjalëve të reja në gjuhën tonë është pas vitit 1989, kur krejt rajoni nisi rrugën e ekonomisë së tregut. Pikërisht gjatë 20 vjetëve të fundit në gjuhën tonë hynë kaq shumë neologjizma!"

Një pjesë e neologjizmave janë fjalë të huaja, të cilat përhapen në "territore të mëdha leksikale", të lidhura me zhvillimin e teknologjive informative, me sferën bankare, ruajtjen e mjedisit etj. Më të shumta janë fjalët e marra nga anglishtja.

2. Faktorët që përcaktuan ndryshimet leksikore në periudhën pas vitit 1989

Në vitet e fundit, në gjuhën shqipe kanë depërtuar me mijëra fjalë e shprehje të reja leksikore. Paraqitja e tillë, shpesh nga gjuhëtarët përcaktohet si një ortek ose si një vërshim i nominimit të sendeve. Ky vërshim i fjalëve të reja, është diktuar nga nevoja për tu dhënë emra objekteve të reja, fenomeneve, ngjarjeve etj. Krejt kjo ka rezultuar me ndryshimet e mëdha që ndodhën gjatë kësaj periudhe, si në vendet tona, ashtu edhe në botë.

Faktorët që mundësuan këto ndryshime të thella në shoqërinë tonë dhe në shumicën e vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore ishin lëvizjet drejt demokracisë dhe ekonomisë së tregut, lirisë së fjalës, hapjes ndaj botës, intensifikimi i aktiviteteve politike dhe parlamentare etj. Krejt këto ndikuan në lindjen dhe konsolidimin e fjalëve dhe frazave të reja, të tilla si: *postkomunizmi, postotalitare, antitotalitar, depolitizim, lustrimi, shoqëria civile, shoqëria e hapur, rruga drejt Evropës, rruga drejt NATO-s, erërat e ndryshimit* etj.

Zhvillimet shoqërore dhe politike në botë, proceset e globalizimit dhe përpjekjet për integrimet evropiane, tensionet sociale në shumë vende, shfaqja apo ringjallja e lëvizjeve të ndryshme shoqërore, filozofike, fetare dhe dukuri të tjera, gjithashtu ndikuan në shfaqjen e vazhdueshme të fjalëve të reja, që normalisht hynë edhe në gjuhën tonë nga gjuhët e tjera (kryesisht nga anglishtja ose nëpërmjet anglishtes). Të tilla janë fjalët: *globalizimi, antiglobalizimi, eurooptimizëm, euroskepticizëm, dollarizim, ballkanizim, kosovizimi, intifada, muxhahedin, taliban, fundamentalizëm, islamizëm, vehabizëm, satanizëm* etj.

3. Shpërndarja e neologjizmave sipas fushave tematike

Numri i fjalëve të reja që kanë hyrë në gjuhën shqipe, që nga viti 1989 është shumë i madh edhe atë në terminologjinë e të gjitha fushave publike, por më së shumti janë të lidhura me kompjuterët.

3.1. I madh është numri i i fjalëve të reja nga fusha e politikës, rregullimit social dhe e ideologjisë. Të tillë janë: *pluralizëm, konsensus, elektorat, partizim, marginalizim, lustrim, impigment, lobim, lobues, antikorrupsion, kundër-*

miting, klientizëm, klasa politike, diplomacia e heshtur, partneriteti për paqe, fshisa politike, taliban, rejting, bilbord. Dinamika në jetën tonë solli edhe paraqitjen e partive të reja, lëvizje dhe shoqata, prej këtu edhe emërtimet si : PPD, BDI, PDSH, RDK (Maqedoni), PD, PS, PR, (Shqipëri), LDK (Kosovë), *bëdëist, pëdë shëist, Saliada, Berishation, Salistan, Saligërdeci* (Metani 2010: 471); *Rama : Ramistë, Rameskë, Ramoid, ramëkriza; Enverizëm; Kemalismi.* (Ibrahimi 2012: 711).

3.2. Grupin e dytë tematik më të madh e formojnë neologjizmat që lidhen me **ekonominë, punën bankiere, tregtinë** etj. Këtu mund të përfshihen: *makroekonomia, mikroekonomia, menaxhues, menaxhment, diler, broker, bankomat, privatizim, diskaunt, monitoring, kesh, bonus, biznesklima, biznesinkubatori, transha, fiskalizim, liberalizim i çmimeve, depozitues, governor, lizing, privatizim, bordi valutor, biznesi i vogël (i mesëm), kredi.*

3.3. Fusha tjetër tematike, e cila konsiderohet si një nga fushat më pjellore të depërtimit të fjalëve të reja, është ajo e **terminologjisë kompjuterike**, duke krijuar kështu të ashtuquajturën nëngjuhë të re. Që nga fillimi i krijimit të fjalorit kompjuterik shqip deri më tani ka pasur shumë ndryshime. Në këta fjalorë informativë hasim terma që kanë mbetur të pandryshuar, pra që janë përdorur në formën origjinale në anglisht, që janë përkthyer fjalë për fjalë nga anglishtja në shqip, si edhe fjalë të reja që janë krijuar për të zëvendësuar konceptet e gjuhës angleze. Të tilla janë: *fajll, server, haker, kraker, soutuer, harduer, antivirus, baner, link, skrinseivër, noutbuk, provajder, uebdizajn, interaktiv, telefaks, bllog, posting, laptop, domen, displej, blutuut* etj. Na paraqiten edhe fjalë të reja shqipe, kryesisht të përkthyer: *miu, dritarja, ikona* etj.

3.4. Me fjalë të reja është e pasuruar edhe **mjekësia**: *mjekësia alternative, gripi i zogjve, hospis, muzikoterapia, mjeku amë, su-xhok, viagra, aurikullodiagnostika, konzorcium*

3.5. Neologjizmat e sferës së ushtrisë dhe veprimtarisë së sigurimit: *natovizimi, baretat e kuqe, baretat blu, bodigard*

3.6. Emërtimet e reja në fushën e arsimit dhe edukimit: *arsimi në distancë, modul, de pa-*

rtament, syllabus, draft, bord, master, pas-doktoraturë,

3.7. Shumë neologjizma paraqiten në fushën e kulturës dhe muzikës: *ëndërgraunt, popkultura, muzika alternative, kinemaja alternative, artkinemaja, artolimpiada, disxhej, raper, hardkor, hevimetal, rep, rejv, teh no, hip-hop, popfolk, etnomuzika, remiks, plejbek, performans, rimejk, hepening, kiberart, ekshën, triler, bestselër.*

3.8. Nga fusha tematike religjioze dhe fetare kemi fjalët: *vehabist, xhihad,*

3.9. Përfshihen edhe neologjizma, nga fusha e paranormales: *psikotronika, ekstrasens, psikokineza, sinestet*

3.10. Ka hyrë një numër shumë i madh fjalësh të reja sportive: *antidoping, akuaerobik, stepaerobik, akua-spining, kejturf, spa, fitnes, streqing, bodibord, bodibilding, plejmejker, plejof, snoubord, skeitbord, skuosh, ultras, ferplej, taekwondo, maebo, kikkoks, kaitsërfing, xhosing, sport ekstrem, gol i artë* etj.

3.11. Fjalë të reja në fushën e mediave: *ma s-media, media elektronike, printmedia, njusrum, piar, imidzhmejkër, pëblik rilejshëns.*

3.12. Nuk janë të pakta edhe fjalët që shënojnë sende e ngjarje nga fusha e modës dhe sfera të tjera: *suxhok – nga gjuha koreane për një masazh të posaçëm ekzotik, lifting, piling, depilim, bodi, pampers, likra, shopping, sudoku, karaoke, outlet;*

3.13. Neologjizma që lidhen me fushën e ushqimit: *llazanjë, fresh, sushi, frape, ajran, hamburger, qizburger, qips, pije energjike, suflaqe,*

4. Tipat e neologjizmave

4.1. Neologjizmat leksikore

4.1.1. Fjalë të reja, shpesh krijohen edhe me anë të ligjeve të fjalëformimit. duke përdorur sistemin ekzistues të fjalëformimit (parashtesat, prapashtesat etj.). Shumë rrallë, në formimin e fjalëve të reja, gjatë periudhës moderne të zhvillimit të një gjuhe kanë depërtuar edhe formante të reja. Zakonisht më prodhimtare janë formantet ekzistuese, që adaptohen me sfidat e reja. P.sh. *de-, anti-, mega-, mikro-, mini-, multi-, post-, super-, top-, ultra-, hiper-* etj.

Me parashtesa: **de-** (*deballkanizim, deideologjizim, departizim, depolitizim, desindikalizim*);

anti- (*antimafia, antimiting, anti doping, antidiskriminim*); **mega-** (*megadiskotekë, megayllë, megaideja, megaskandal*); **mikro-** (*mikrokredit, mikroreklamë, mikrofinancim*); **mini-** (*minibus, minimarket, minikompjutër*); **multi-** (*multikulturalizëm, multimiljarder, multifunksional*), **post-** (*postkomunizëm, postfeminizëm, postfestum*); **super-** (*supermodel, supermarket, superfuqi*); **top-** (*topmodel, toplistë, topalbum*); **ultra-** (*ultradjadhtist, ultramodern*); **hiper-** (*hiperinflacion, hiperaktiv, hiperaktualm hipermarket*).

Kohëve të fundit janë aktivizuar edhe parashtesa të reja, si p.sh. : **euro-** (*eurodeputet, eurointegrim, euroskepticizëm, eurofonde, eurobanknota, aurokup, euroligë, europolitikë*); **narko-** (*narkoafëra, narkobiznes, narkodiler, narkokanal, narkodollarë*); **porno-** (*pornobiznes, pornoindustri, pornoaktor/e, pornokompani, pornodisk*); **seks-** (*seksbiznes, seksmaniak, seksbombë, seks klub, seksindustri, sekspunëtore, seksskandal*); **tekno-** (*teknogrupë, teknoklub, teknoparti*).

Krijohen edhe një sërë fjalësh me një fjalë të dytë, si p.sh. **biznes-** (*aviobeznes, autobiznes, narkobiznes, seksbiznes, radiobiznes*), **-bos** (*narkobos, radiobos, telebos*)

4.1.2. Grupin e dytë të neologjizmave leksikore e përbëjnë huazimet e reja nga gjuhët tjera, më shpesh huazime nga gjuha angleze, sidomos në fushën e kompjuteristikës, financave, sportit etj., të cilat njihen edhe si ndërkombëtarizma, sepse kanë hyrë edhe në shumë gjuhë të familjeve të ndryshme të botës, si psh. *barkod, bexh, kompak-disk, menaxhues, monitoring, nonstop, noutbuk, onllain, ofllain, performans, hepening, faill* etj. Nga frengjishtja kanë hyrë, po ashtu huazime të reja, si: *butik, depozitues, detergjent, defile, ekskluziv, konfeksionist, likra, marzh, frankofon, hotelier* etj. Nga gjermanishtja – *puq, tender, mjusli*; nga italishtja – *kallço, kargo, kasko, llazanjë, paparac, pasta, ravioli, tifo*; nga spanjolishtja – *maço, paçanga*; nga rusishtja – *perestrojka, kompromat*; nga suedishtja – *ombudsman*; nga portugalishtja – *lambada*; nga japonishtja – *bonsai, kamikaze, kraoke, tamagoçi, shiacu, xhakuzi*; nga gjuhët afrikane – *zomba, jamakashi*; nga arabishtja – *vehabizëm, taliban*.

4.2. Neologjizma semantike

Ekzistojnë edhe përkufizime të çuditshme për njerëzit, të cilët kanë interesa dhe dëshira të çuditshme:

- Zurbonaut - një njeri i cili zbret në topin transparente inflatable në shpatet;
 - Numofob - person i cili ka frikë mos të ngelë pa telefonin e tij celular;
 - Bigoreksik - person i cili ka për qëllim vazhdimisht të zhvillojë muskuj trupore;
 - Makedonoid – maqedonas antik, që dallohet nga ata sllav.
 - Çapilling – ata që insistojnë për të drejtat e veta, kundërshtojnë shtypjen (nga tur. Capulcu = grabitës, haramxhi).
- Gjatë disa viteve të fundit në të folurit tonë kanë hyrë frazeologji të reja si “e ngre adrenalinën”, për shembull, dhe 600 terma specifikë si “sistem operativ”, “energjia e gjelbër” etj.

5. Botime leksikografike të neologjizmave

Fjalët e reja leksikore të një periudhe të caktuar, mbledhen dhe botohen në fjalorë specialë të neologjizmave. Vende të ndryshme çështjen e administrimit dhe të përditësimit të bazës së të dhënave terminologjike e kanë zgjidhur në mënyra e forma të ndryshme. Po përmend vetëm shembullin e Francës. Organizimi i bazës përbëhet nga një dhe grupe pune të terminologjisë, që funksionojnë si njësi më vete pranë çdo ministrie: që nga Ministria e Bujqësisë deri te Ministria e Jashtme. Këto komisione specialistësh e përkthyesish, terminologë hartojnë çdo muaj listën e termave të rinj dhe të neologjizmave gjuhësorë dhe ia përcjellin për miratim Komisionit të Përgjithshëm të Terminologjisë dhe Neologjizmave, si organi më i lartë me të drejtë vendimarrëse. Komisioni i Përgjithshëm funksionon nën varësinë e Kryeministrit të vendit, përbëhet nga 17 anëtarë dhe mbledhet çdo muaj për të miratuar listat e propozuara nga komisionet e specialistëve të ministrive. Termat e pranuar botohen rregullisht në Gazetën Zyrtare, si dhe janë lirishit të konsultueshëm në faqen zyrtare të internetit. Komisioni i Përgjithshëm boton çdo vit raportin vjetor të punës dhe aktet e tij zyrtare bëhen të detyrueshme për zbatim, jo vetëm nga administrata, por edhe nga

specialistët e fushave të ndryshme dhe nga media. Vendet e zhvilluara i kushtojnë një rëndësi të madhe botimit të informatizuar të terminologjisë së përditësuar, si dhe Fjalorëve të mëdhenj terminologjikë në shërbim të publikut. I këtillë konsiderohet, për shembull *Fjalori Terminologjik dygjuhësh* i Universitetit të Kebekut në Kanada, me një pasuri prej 3 milion termash nga rreth 200 fusha të ndryshme të dijes, shkencës dhe teknologjisë.

Nuk është e rastit se gjatë 20 viteve të fundit të tranzicionit demokratik, plot ngjarje të trazuara, gjuhët e Ballkanit, por në përgjithësi edhe gjuhët e tjera, janë pasuruar me fjalë të reja. Kështu, të themi gjuha bullgare është pasuruar me mbi 5 mijë fjalë të reja sipas *Fjalorit të fjalëve të reja në gjuhën bullgare*. Prej tyre 4300 janë fjalë të reja, kurse 700 fjalë të njohura, por me kuptime të reja. Gjuhëtari serb Ranko Bugarski (2010: 263) në hulumtimet e tij të bëra në vitin 2006 ka analizuar dhe klasifikuar rreth 3200 zhargone dhe 800 blende ose fjalë të përziera, duke hartuar një *Fjalor të fjalëve të reja në gjuhën serbe* me 4000 njësi leksikore. Këto dy raste mund të na shërbejnë si shembull, që edhe në gjuhën shqipe ndihet e nevojshme të botohet një fjalor i tillë.

5.1. Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe me fjalë të reja

Me botimin e *Fjalorit të ri drejtshkrimor të shqipes* nga autorët Ali Dhrima dhe Rami Memushaj, gjuha shqipe në 34 vjet ka shtuar 40 mijë fjalë të reja. *Fjalori* i parë *Drejtshkrimor i Gjuhës Shqipe* u botua në vitin 1976 dhe përmban rreth 38 mijë fjalë, ndërsa fjalori i dytë që vjen pas kaq vitesh është një vepër prej 925 faqesh dhe përmban gjithsej 75 mijë fjalë, nga të cilat 40 mijë fjalë janë të reja. Fjalori pasqyron në mënyrë sa më të plotë atë pasurim dhe shpërthim të gjuhës shqipe në të gjitha stilet, gjinitë, sidomos në këto 20 vjetët e fundit. Edhe pse shumë studiues të gjuhës fjalorin e cilësojnë si të nevojshëm në të gjitha fushat, por, sipas tyre, shumë fjalë dhe fraza të reja që janë përfshirë në të duhet të marrin më parë miratimin e standardit zyrtar. Edhe bullgarët kanë punuar në *Fjalorin e ri Drejtshkrimor*. Në vitin 2012 Akademia e Shkencave të Bullgarisë, botoi *Fjalorin* zyr-

tar drejtshkrimor i gjuhës bullgare me 10.000 fjalë të reja. Fjalori përfshinë 90.000 fjalë, 20.000 fjalë më shumë se fjalori i mëparshëm, dhe përfërsisht rreth 10.000 fjalë të reja kanë hyrë në këtë gjuhë në vitet e fundit.

Përfundime

Duhet të ndërgjegjësohemi dhe të shtrojmë pyetjen si ka hyrë shqipja në mijëvjeçarin e ri? Kjo shtron nevojën e krijimit të një politike të re gjuhësore. Sepse duhet të jemi të vetëdijshëm se pas nënshkrimit të rezolutës së vitit 1972, gjuha standarde ndodhet në një kontekst tjetër kulturor nga koha kur u nënshkrua. Kjo do të thotë se gjuha shqipe me mjetet e veta nuk ka mundësi t'i përbushë nevojat që i dalin në përballjen me kulturat e huaja. Ajo është në gjendje ta bëjë këtë vetëm pjesërisht. Andaj, gjatë përpilimit të fjalorëve me fjalë neologjizmesh, nevojitet që disa fjalë të terminologjisë së huaj, të përkthehen fjalë për fjalë nga anglishtja (mous - miu), disa fjalë të mos përkthehen fare, por në gjuhën shqipe të përdoren të njëjtët fjalë si dhe në gjuhën e origjinalit, me përshtatje të mundshme në gjuhën shqipe (software - softuer); dhe disa fjalë të përkthehen në shqip me një term të ri.

Ne do të bëhemi gjithnjë e më të hapur ndaj kulturave të tjera, të përgatitemi për shqipen në shoqëritë shumëkulturore. Detyra jonë në të ardhmen, do të jetë që shqipen standarde ta bëjmë të përshtatshme për nevojat dhe kërkesat e mijëvjeçarit të ri. Njëkohësisht nuk ka përse të heqim dorë nga kërkimet në gjuhën e popullit, por duhet të kemi parasysh se shqipja ka nevojë të jetë e hapur edhe për thesare të tjera. (Lloshi 2003: 89).

Bibliografi

- AJETI, Idriz (1989). Çështje të gjuhës letrare shqipe: *Studime gjuhësore në fushë të shqipes*. Prishtinë, Rilindja.
- BECI, Bahri (1995). Gjuha letrare shqipe dhe baza e saj dialektore: "*Albania*", 3 nëntor. Tiranë.
- BUGARSKI, Ranko (2002). *Lica jezika*. BIGZ: Beograd.
- BUGARSKI, Ranko (2005). *Jezik i kultura*. BIGZ: Beograd. (74-75)

- DOMI, M. – Ajeti I. (1992), Gjuha letrare shqipe në dritën e zhvillimeve të reja politike dhe kulturore në botën shqiptare: *Gjuha letrare kombëtare dhe bota shqiptare sot*. Prishtinë.
- IBRAHIMI, M. (2008). Vëzhgime mbi disa dukuri sociolinguistike tek shqiptarët e Maqedonisë e më gjerë: *Studime etnolinguistike, folklorike dhe sociolinguistike për kulturën shqiptare në Maqedoni* (koautorë V. Bexheti, H. Xhaferi) UEJL: Tetovë.
- IBRAHIMI, M. (2009). *Fjalor i zhargoneve dhe eufemizmeve shqiptare*. Interlingua:Shkup.
- IBRAHIMI, M. (2010). Perifrazat shqipe në kontakt me gjuhët e tjera: *Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare*. Nr. 29/1, Prishtinë. 235 - 247.
- IBRAHIMI, Mustafa (2012). Krijimi i neologjizmave në gjuhën shqipe gjatë tranzicionit demokratik: **AKTET** – Revistë e institutit Alb-Shkenca. Journal of Institute Alb-Shkenca. Tiranë_ Prishtinë_Shkup, Vëll.V, nr.4, fq 708-713.
- ISMAJLI, Rexhep (2005). *Gjuhë standarde dhe histori identitetesh*. Tiranë.
- KOSTALLARI, A. (1988). *Gjuha letrare shqipe dhe epoka jonë*. Tiranë.
- LLOSHI. Xhevat (2001). *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*. SHBLU:Tiranë.
- LLOSHI. Xhevat (2003). Shqipja – gjuhë e hapur dhe dinamike: *Konferenca Shkencore – shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot*. Tiranë.
- METANI, Idriz (2010), Gjurmë semantike dhe strukturore në shqipen e sotme nga kontaktet gjuhësore: *Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare*, Nr. 29/1, Prishtinë: 469-474.
- MULAKU, Latif. (1989). Disa çështje aktuale të standardizimit të shqipes letrare: "*Gjuha në shkollë*", Prishtinë. f. 3-11.
- MURATI, Qemal (2004). Gjuha shqipe sot- prirje të reja "evropianizuese: *50 vjet studime albanologjike*. Instituti Albanologjik i Prishtinës. Prishtinë.
- PARLLAKU, Matida (2010), Reklama si mishërim i kontakteve në gjuhë e mes gjuhë: *Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare*. Nr. 29/1, Prishtinë.492-503.
- SHAMKU-SHKRELI, Ledi. (2007). *Standard dhe substandard*. Çabej: Tiranë.
- SHKURTAJ, Gjovalin (2003). *Sociolinguistikë*. Tiranë.
- РЕЉИЋ, Митра (1995). О неологизмима са социолингвистичког становишта (на материјалу руског језика): *Зборник Филолошког факултета у Приштини* 5-6, 235-241..

QASJE MODERNE NË DRAMËN E REXHEP QOSJES

THE MODERN APPROACH TO THE DRAMA OF REXHEP QOSJA

ERENESTINA HALILI

Departamenti i Letërsisë, Fakulteti i Filologji Historisë, Universiteti i Tiranës, Tiranë, SHQIPËRI

Email: erenestina@gmail.com

AKTET VII, 4: 278 - 281, 2014

PËRMBLEDHJE

Në përmbledhjen me drama "*Mite të zhveshura*" (*Beselam, pse më flijojnë, Sfinga e gjallë dhe Vdekja e Mbretëreshës*), Rexhep Qosja udhëhiqet nga ideja rationale e kritike për ta bërë shoqërinë të kthjellët në mënyrën e të jetuarit, ta zhveshë nga iluzionet, utopitë. Sakaq mitologjia në dramën e R. Qosjes është këqyrur si një mjet dhe mënyrë e frutshme në mbërritjen e shpejtë dhe në udhë emocionale të disa të vërtetave të qenies dhe etnisë. Në të trija këto rrafshet dramën e Qosjes sjellin relieve tronditëse me praninë e kategorive estetike të madhërishmës, të tragjikës, të sublimes, të epikes, por edhe të satirikes e të sarkastikes, ku shfaqet një forcë e tillë shprehëse dhe një impakt i tillë me lexuesin, sa që rrallë mund të vërehet në dramën shqipe. Artikulli synon të sjellë ndihmesë në studimin e dramës si tekst letrar dhe në historinë e letërsisë shqipe.

Fjalët çelës: Drama, qasje moderne, miti, demitizimi, rimitizimi, destrukurimi i fabulës.

SUMMARY

As it is known, increasing the communicating power of literary works as it relates to readers of their time remains one of the major concerns and problems of drama and playwrights. It is for this reason that in the twentieth century, the process of resemantising and demythicising of ancient myths by the most prominent writers took a leading place. The desire to bring new meaning beyond what is already said in myth or by early dramatic writers - was justified by the ironic way how literature and society generally perceived them. In all of these planes, the dramas by R. Qosja bring shocking relief with the presence of phenomena such as the grandiose, the tragic, the sublime, the epic, and also of the satirical and sarcastic, which display such an expressive force and impact on readers, which rarely can be observed in Albanian drama.

Key words: drama, epic, greatness, myth, tragic, satirical, sublime.

Hyrje

Në librin me drama të Rexhep Qosjes "*Mite të zhveshura*", ku përfshihen dramat *Beselam, pse më flijojnë, Sfinga e gjallë dhe Vdekja e mbretëreshës* miti dhe historia kanë ardhur më së shumti si një pretekst a mbulesë për të risjellë në dijen e lexuesit një problematikë të mprehtë bashkëkohore.

Udha drejt mitit tek ky dramaturg, nuk identifikohet me kureshtjen për të zbuluar "fosilet" antropologjike të shoqërive të hershme shqiptare, tashmë të mbyllura si mënyrë jetese

dhe formacione socialpolitike. Tjetër gjë ka në brendi të mitit të sjellë si subjekt apo si element subjekti dhe tjetër gjë pohon shkrintari, i cili tashmë i kundërvihet mitit: herë në formë ironie e shpotie ndaj vetëdijes mitike, që ende vepron tek njerëzit e kohës së tij dhe herë si kritikë e hapur ndaj fuqisë mitologjizuese të ideologjive a politikave korente, që operojnë me fetishizime ideshë, raportesh historike, situatash e konjukturash sociale deri me keqpërdorimet politike të trashëgimisë kulturore dhe antropologjike.

Përveç shfrytëzimit të lëndës mitologjike, sidomos për krijimin e situatave, sikurse edhe theksimit të procesit demitizues për të zbuluar se çfarë pikërisht fshihet pas mekanizmit fetishizues që prodhon ndërgjegja mitike, nga ana tjetër, lënda mitike është shfrytëzuar edhe për të krijuar metafora letrare dramatike të mprehta. Të trija këto aspekte që ne përmendëm më sipër e kthejnë raportin e shkrimtarit me mitin në një raport veprues dhe krijues në kuptimin e asaj se çfarë ka dashur të nxjerrë në pah ai për lexuesin e vet.

1. Risemantizimi i mitit

Me *“Mite të zhveshura”*, sipas parathënies të Bajram Krasniqit, R. Qosja është nga dramaturgët e parë shqiptarë që i dha përmbajtjes së ardhur nga mitet frymën e kohës dhe të njeriut të sotëm, duke na e paraqitur të shkuarën dhe korpin etnopsikologjik shqiptar nën dritën e bashkëkohësisë (Krasniqi 1978: 7).

Sikurse dihet, rritja e forcës komunikuese të një veprë letrare në raport me lexuesin e kohës së vet, mbetet nga shqetësimet dhe problemet e mëdha të dramës dhe dramaturgëve. Është kjo arsyeja që në shekullin e XX procesi i demitizimeve dhe risemantizimit të mitit të lashtë nga ana e shkrimtarëve më në zë, zuri një vend kryesor. Dëshira për të sjellë kuptime të reja tej asaj çka është e thënë tashmë në mit, pra (1) në shoqëritë e hershme apo (2) nga shkrimtarë dramatikë të hershëm - ishte e përligjur nga vetë mënyra ironike se si letërsia dhe përgjithësisht shoqëria i perceptonte “përrallat e lashta”, se si këto “përralla” të mund të bëheshin të besueshme, tashmë jo në idetë e tyre (pasi ato vazhdojnë të mbeten universale dhe me ndikim të fortë në çdo kohë e në çdo vend), por në mënyrën e të thënit të këtyre ideve, ku përfshiheshin, medoemos, edhe destrukturimi i fabulës, rishikimi dhe rikonceptimi krej ndryshe i personazheve, këqyrja e subjektit si diçka jo e vërtetë, në të shumtën e herës si një “përrallë” a diçka e “sajuar”, e pranuar si e tillë për efekt komunikimi. Dhe kjo “përrallë”, ky “sajim”, prej shkrimtarit modern ka nevojë të rimodelohet e të ndryshohet, duke iu gjegjur kërkesave të një

trillimi, tashmë “letrar”, ku humbet, anashkalohet dhe bjerren njëkohësisht si efekti i besimit, ashtu edhe efekti hipnotik që buron prej këtij besimi. Rrjedhimisht, një mënyrë e tillë rrëfimi e konceptimi, bën që të tejkalohet mënyra e perceptimit të mitit nga shoqëritë e hershme që e prodhuan atë si pasojë e në funksion të besimit, të religjionit, përfshi gjithë elementet e njohura të kulteve, të bestytive, të proceseve ezoterike: magjitë, shtrigat dhe shtriganët, forcat e natës dhe të ditës etj., etj.

Në përmbledhjen me drama *“Mite të zhveshura”* (*Beslam, pse më flijojnë, Sfinga e gjallë dhe Vdekja një mbretëreshe*), Rexhep Qosja udhëhiqet nga ideja rationale e kritike për ta bërë shoqërinë të kthjellët në mënyrën e të jetuarit dhe të sjellurit të saj, ta zhveshë nga iluzionet, utopitë e rrejshme. Arsyeja kritike dhe vetë stadi i zhvillimit shoqëror kërkonte që gjithë mbivendosjet mitologjike në vetëdijen e shoqërisë të rishqyrtohen duke e larguar njeriun nga mashtrimi dhe vetëmashtrimi. Përpos kësaj ideje, sakaq mitologjia në dramën e R. Qosjes është këqyruar si një mjet dhe mënyrë e frutshme në mbërritjen e shpejtë dhe në udhë emocionale tek disa të vërteta të ngulura të qenies dhe etnisë. Sintezat që janë realizuar në drama përmes kësaj poetike kanë një ndikim tronditës mbi vetëdijen e lexuesit për vetë përmasën që ato shfaqin. Kjo bie në sy te *“Beslam pse më flijojnë”*, por edhe te *“Sfinga e gjallë”*.

2. Kirurgji në trup të mitit

Tek *“Vdekja e një mbretëreshe”* lexuesi dallon kirurgjinë e hollë që ka bërë autori në trupin e mitit historik duke na dhënë pamjen reale se si dhe pse shembet një mbretëri. Autori jo se nuk e respekton mitin e ngritur mbi historinë e lashtë të iliro-shqiptarëve, si dhe fuqinë përgjithësuese të tij, por rreket të operojë prej trupit të historisë pikërisht indet e kalbura, të vdekura, gjithçka që nga vetëdija e re kritike e moderne e kohës duken tanimë si të tejkaluara, anakronike, madje qesharake e që me zor funksionojnë. *“Vdekja e një mbretëreshe”* – vë në dukje Sabri Hamiti, - është një tekst parabolë mbi të sotmen. Këtu qëndron vlera më e madhe e tij. Të aktualizohen,

sërish të theksohen problemet, që në shoqërinë njerëzore të kohëve të ndryshme përsëriten” (Hamiti 2002: 130).

Një “matematikë” e tillë ka bërë që në dramën e R. Qosjes prej materies mitologjike të rivlerësohet fuqia sintetizuese e përvojave etnike që shprehet përmes saj, fuqi e cila kundrohet prej autorit në tri rrafshë: edhe si filozofi jetësorë ekzistenciale, edhe si energji psikike e akumuluar nëpër rrjedhën e shekujve, edhe si apel për proceset bashkëkohore. Në të dyja këto rrafshë dramën e Qosjes sjellin relieve tronditëse me praninë e fenomeneve të të madhërishtes, të tragjikes, të sublimes, të epikes, por edhe të satirikes e të sarkastikes, ku shfaqet një forcë e atillë shprehëse dhe një impakt i tillë me lexuesin, sa që rrallë mund të vërehet në dramën shqipe.

“Në arketipin e mitit të lashtë ilir të murimit, të ndërtimit të kështjellave apo të urave, të cilat ndërtohen ditën dhe në mënyrë misterioze rrënohen natën, - vë në dukje studiuesi Nebi Islami, ky autor ka marrë temën dhe frymëzimin, që më tutje, përmes risemantizimit dhe zhvendosjes së kuptimit parësor të këtij miti, ka krijuar njërën ndër dramën tona më të fuqishme, me rezatime polisemantike, me vështirimin shumëdimensional të ekzistencës” (Islami 2003: 30).

3. Absurditetit i flijimit

Drama “*Beselam, pse më flijojnë*” e Rexhep Qoses, burimin mitik të lëndës, ndonëse i rrumbullakësuar si materie letrare, e shfrytëzon në disa qasje e për disa qëllime:

- 1) Si shtresim antropologjik ku ngjizet, shprehet dhe jetësohet vetëdija e etnosit si njësi sociale e historike (prej shqiptarësh),
- 2) si zbulësë religjioze mistike, që në vepër vjen si një mbishtresim i trashëgueshëm dhe fillesë kompaktësimi në kryerë të krijimit të etnisë (fisit të shqiptarëve),
- 3) si paragjykim dhe mbetje ezoterike me fuqi magjike që çon rëndom në konceptime edhe fataliste të ekzistencës,
- 4) si rikapitullim i lëndës së moçme mitologjike në funksion të kuptimit të ri të saj,

5) si pranëvënie dhe paragoni midis thelbit të hershëm mitik me thelbin e sotëm social e politik të ekzistencës së kombit shqiptar të ndarë dysh (Shqipëri-Jugosllavi),

6) si situatë psikosociale e tipit kolektivist, totalitarist dhe si ideologji indoktrinuese,

7) si raport midis lirisë dhe varësisë, identitetit të shprehur dhe identitetit të manipuluar, individit dhe bashkësisë, shtetit shtypës dhe popullit të shtypur, diktaturës dhe demokracisë,

8) si shturje të zanafillës mitike dhe shfrytëzimin e saj për të realizuar vështirime kritike ndaj njeriut dhe shoqërisë bashkëkohore.

Drama *Beselam, pse më flijojnë* i qëndron besnike baladës shqiptare, domethënë variantit kur për ndërtimin e “Urës” na paraqiten tre vetë: Monumi si arkitekt, Molosi si projektues dhe Beselami si murator. Këtu nuk hasim ndërtimin e “Kështjellës”, e cila pranëvitet për synime ideore krahasuese nga autori. Skema është po ajo, si në baladë: çfarë ndërtohet ditën, prishet natën prej qenieve të mistershme, një mallkimi a diçkaje okulte. Kjo e shqetëson bashkësinë, fisin, andaj duhet flijuar dikush e shtrenjtë dhe e shenjtë, në pikëpamjen e “pastërtisë”. Flija njerëzore e “pandotur” mund të bëhet shpëtimtare e fisit, sipas porosisë së një plakut, që nënkupton urtësinë, pjekurinë, arsyen profecinë. Në baladën shqiptare kemi tri nuse vëllezërisht, tri kunata. Më e vogla prej tyre, ajo më e bukura dhe më e pamëkatnueshmja muroset. Kjo nuse në dramë është Hana, që të kujton, sakaq, edhe një përfytyrim folklorik e mitologjiko-poetik, hënën e argjendit, të bukur e të venitur si një nga figurat më të përdorshme të poezisë lirike folklorike ndër shqiptarët. Rrjedhimisht, në konotacionet e hënës vjen edhe personazhi i Hanës në strukturat e njohura të arketipit baladesk të nuses së vogël të shtëpisë: e bukur, besnike, fisnike, e dashur, e hirshme, e pafajshme, nënë e re me fëmijë të vogël në gji, e pastër, e brishtë, sintezë e virtyeteve të vashës shqiptare. Parafytyrimi i Hanës si simbol i të bukurës (fizike dhe shpirtërore) kryen disa funksione:

- 1) identifikimin e asaj çka do të flijohet, e cila është në përputhje me përfytyrimin mitologjik, pra dhe religjioz, të njeriut të pastër,

2) trauma shpirtërore e bashkësisë që lind nga ky sakrifikim i njeriut të “selektuar” dhe më të “mirë”,

3) flija si domosdoshmëri për të tejkaluar mallkimin dhe forcat shkatërrimtare,

4) situata tragjike që vjen me vdekjen e Hanës jo si anatemë, por si mundësi e reshtjes së saj dhe të mallkimit,

5) nevoja për të rindërtuar besimin e humbur dhe soliditetin e brejtur nga dyshimi.

Sakrifica duhet të jetë grua, sepse:

Dhembja për gruan është dhembje e madhe

Dhembje e shtëpisë, dhembje e gjinisë

Dhembje e vajit të fëmisë.

Dhembja e tamblit të djegur në sisë (Qosja 1978: 248).

Kurse Beselami thotë:

Atje ku ka më shumë dashuri,

Atje dhe dhimbja është më e madhe.

Atje ku ka më shumë dashuri,

Atje dhe fatkeqësia është më afër.

Përtej këtij konceptimi që është në përputhje me atë të mitit si të tillë, shkrimtari krijon me flijimin e pamerituar të Hanës një kontrapunkt të fuqishëm ideor: absurditetin e ndjekjes së praktikave mitologjike, ezoterike e paranojake, tashmë të tejkaluara e të dëmshme. Vetëdija e iluminuar është ajo që e kapërcen ritualin mortor të sakrifikimit. Kësisoj, thelbi i mitit zhbëhet, demotivohet, profanizohet. Ai zëvendësohet nga arsyeja kritike duke e kthyer flijimin zanafillor mitologjik në pakuptimësi në raport me shoqërinë moderne.

Përfundim

Në tërësinë e saj, është e ngarkuar me ide që shestohen në rrafshe ekzistencialiste, ku sintezat e sprovave historike të jetës, të gërshetuara me sintezat e ardhura nga perceptimet metafizike të mistereve, realizohen në linjën e flijimit, të therrorisë së paraparë, më së shumti në trajtën e

traditës, të trashëgimisë etnopsikologjike dhe të parashkrimit (fatalitetit), rrjedhimisht të martirizimeve tragjike. Konstatimi i mësipërm, risjell në vëmendjen tonë, se krejt lënda mitike e mistike që trashëgohet në mënyrën e të kuptuarit të qëndresës së shqiptarëve rrjedhve të kohës ndaj faktorëve dezintegruues, nuk ndjek parimin e një *mitizimi të dytë*, pra të një rimitizimi, ku fantazia dhe elementet artistikë e rritin ndjeshëm forcën sugjестive të subjektit. Përkundrazi, duke e studiuar me kujdes, lexuesi, nuk e ka të vështirë të dallojë, falë kontrapunkteve dhe kundërshtive, falë ironisë dhe tjetërsimeve, mekanizmin e perceptimit letrar artistik të autorit, se si pikërisht kjo lëndë demitizohet duke synuar *profanizimin* e saj.

Bibliografi

ÇAPALIKU, Stefan (2003), *Estetika moderne*, Ombre GVG, Biblioteka Estetike, Tiranë.

FRAJ, Northop (1990), *Anatomia e kritikës*, Prishtinë.

GROTOVSKI, Jerzhi (2010), *Për një teatër të varfër*, Teatri i Metropolit, AAB Rinvest, Tiranë.

HAMITI, Sabri (2002), *Letërsia bashkëkohore*, *Vepra letrare 9*, Faik Konica, Prishtinë.

ISLAMI, Nebi (2003). *Historia dhe poetika e dramës shqiptare 2 (1886-1996)*, ARTC Prishtinë.

KRASNIQI, Bajram (1978), Parathënie: *Mite të zhveshura; Semantika e miteve*, Rilindja, Prishtinë.

QOSJA, Rexhep (1978), *Mite të zhveshura*, Rilindja, Prishtinë.

TIRTA, Mark (2004), *Mitologjia ndër shqiptarë*, ASHSh, IKP, Dega e Etnologjisë, Tiranë.

UÇI, Alfred (1982), *Mitologjia, folklori, letërsia*, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë.

UÇI, Alfred (2008), *Estetika metateorike mbi artin. Klasika apo Nonklasika?*, vëllimi I, ASHSh, Tiranë..

DISA VEÇORI TË NJËSIVE FRAZELOGJIKE QË KANË SI GJYMTYRË EMRA ETNONIMESH

SOME PROPERTIES OF THE PHRASEOLOGICAL UNITS WHICH CONTAIN ETHNONYM NAMES

MUSTAFA IBRAHIMI

Universiteti i Evropës Juglindore, Tetovë, MAQEDONI

Email: m.ibrahimi@seeu.edu.mk

AKTET VII, 4: 282 - 286, 2014

PËRMBLEDHJE

Në një numër shumë të madh të të folmeve shqipe shqyrtohen edhe frazemat që si gjymtyrë kanë etnonimet. Dihet se çdo të folme, pak a shumë, është e pasur me njësi frazeologjike, kanë gjymtyrë etnonimike, lokale, regjionale dhe etnike. Të pakta nga këto janë sistemuar në fjalor. Njësi të tilla regjionale do ta pasuronin fjalorin. Shumë prej këtyre frazemave dialektore të cilat me emra e me shtrirje të përdorimit e kanë tejkaluar hapësirën rajonale dhe janë bërë prone kombëtare e më gjerë, pasqyrojnë mënyrën se si i emërtojnë të tjerët, por edhe të tjerët si na emërtojnë ne. Po kështu edhe frazeologjitë arbëreshe e kanë kaluar hapësirën rajonale, duke u përdorur edhe në hapësirat e të parëve të tyre. Krahasimi i këtyre frazemave me gjuhët tjera, kryesisht sllave do të gjejnë përputhje në disa fusha konceptuale, por edhe dallime si rezultat i rrethanave historike gjeografike specifike të çdo populli.

Fjalët çelës: frazema, toponime, dialekte, rajon, fjalor

SUMMARY

The large number of Albanian vernacular languages are also made up of idioms, whose adjacent parts are the ethnonyms. It is known that each and every local vernacular is more or less abundant in phraseological units, adjuncts of local, regional, and ethnic ethnonyms. However, only a small portion of them have been incorporated in dictionaries, although such local language units would enrich dictionaries a great deal. A number of these vernacular idioms, which in terms of their span of use, have gone beyond local areas and have become a national asset elsewhere. They reflect the way how we describe others, but also how others describe us. In the same manner, the phraseological terms of Arberesh people, too, have gone beyond local areas, thereby ensuring usage also in the areas where their ancestors once lived. In comparing these idioms with other languages, that is primarily Slavic languages, we find out that there are similarities in some conceptual aspects, but also differences as a result of historical and geographical circumstances that can be found in all nations.

Key words: idioms, toponym, dialects, dictionary.

HYRJE

Kontaktet përveç që përmbajnë shënime kognitive, përmbajnë edhe shënime emocionale. Këtë më së miri mund ta vërejmë edhe te njësitë frazeologjike që si gjymtyrë kanë etnonimet. Nëpërmjet këtyre frazemave, në shprehje vjen mënyra se si këta popuj e perceptojnë tjetrin dhe veten. Shumë frazema janë krijuar si rezultat i kategorizimit kognitiv të së vërtetës. Krahasimi i këtyre frazemave midis popujve të Ballkanit dhe, në

veçanti midis të folmeve shqipe tregon ngjashmëri në disa fusha konceptuale. Megjithatë, në shumë komponentë onimike ekzistojnë edhe dallime, si rezultat i dallimeve gjeografike, historike të një bashkësie gjuhësore. Qëllimi i këtij punimi është që me anë të krahasimit të frazemave me komponentë onimike, të shohim se në çfarë mënyre bëhet perceptimi ndaj tjetrit dhe vetes. Kjo mund të vërehet në inventarin frazeologjik të gjuhëve të Ballkanit, ku dalin

ngjashmëritë dhe ndryshimet midis tyre. Korpusi për këtë lloj hulumtimi u mbështet duke gjurmuar në fjalorët e përgjithshëm dhe në fjalorët frazeolo gjikë të këtyre gjuhëve.

Psikologjia sociale niset nga çështja se çdo bashkësi të tjera dhe anon kah pikëpamja se ajo përherë ka qëndrim pozitiv ndaj vetes (Quast-hoff 1988: 45). Stereotipet etnike rajonale, gjithmonë tregojnë njohuri ndaj një grupi të caktuar etnik, dhe ky stereotip social ndaj grupit përsëritet edhe te njësitë frazeologjike ose frazemat. Një dukuri të këtillë e vërejmë në frazemat *pi si turk, flet si maxhup* etj.

Frazema etnonimike ekzistojnë edhe te popujt e tjerë, ku gjithë popullit i përshkruajnë ndonjë karakteristikë. Frazemat si në ang. *take french leave*, frengj. *filer ala anglaise*, ital. *fillare all. Inglese*, ose gjerm. *sich polnisch/englisch/französisch verabschieden* («lamtumirë, ose të shkosh në mënyrë të fshehtë në gjuhën polake, angleze, frenge»), ose sëmundja e sifilisit në gjuhën kroate, gjermane, polake po edhe shqipe është sëmundje franceze, kurse për rusët sëmundje polake (Eismann 1994: 94), tregon se edhe të huajt perceptojnë në mënyrë të njëjtë dhe të ngjashme.

Distanca dhe qëndrimi ndaj të tjerëve tregon se edhe anëtarët e bashkësisë së vet dalin nga normat e sjelljes dhe me këtë stigmatizon: *punë maxhupi, rrenë si maxhup, pi si turk, polnisch heiraten* ("të fejojesh në mënyrë polake", të jetosh i pafejuar), *fluchen wie ein Russe* ("të shash si rus", shumë të shash).

Stereotipat luajnë rol të rëndësishëm edhe në gjuhësinë kognitive, e cila është karakteristike me qasjen enciklopedike ndaj kuptimit. Kjo qasje ka të bëjë me interpretimin e dukurive të ndryshme nga jeta e përditshme duke i interpretuar në mënyrë mendore, si prototipe. Të kësaj natyre janë frazemat *stolz wie ein Spanier* ("krenar si një spanjoll").

Shumë frazema lindin nga përvoja me kulturën e bashkësive të tjera etnike, gjegjësisht nga mënyra se si e perceptojnë kulturën e vet pëballë kulturës së tjetrit. Një model i tillë është i dukshëm te frazemat *punë maxhupi* ("i papastër/ punë; jo

e sinqertë"), *rren si xhyp; secili jevg e lavdon kalin e vet* ("secili anon ka vetvetja").

Zakonisht te frazemat dominon ose vlerësimi pozitiv ose ai negativ, gjegjësisht ose tregohet simpati ose antipati. Edhe pse në korpusin e frazemave, vlerësimi pozitiv është më i rrallë. Ja disa frezema të tilla: *Albioni krenar, punon si orë Zvicre*; ndërkaq frazema me vlerësim negative, përveç atyre që përmendëm janë edhe këto: *si greku në haps* (i pashpresë, i habitur, i humbur), *si greku në borxh, sillet si ballkanas*.

Frazemat dhe konceptualizimi i botës

Gjatë krijimit të stereotipave, zakonisht ndikojnë shumë faktorë – përvoja, kultura dhe emocionet. Kjo më së mirë shihet në disa frazema me onomitë e atyre popujve me të cilët ekzistojnë kontakte të afërta dhe të shumta, para së gjithash me popujt **sllavë** (që emërohen me termin *kaur*), **romët** (këtu dalin edhe variantet *cigan, maxhup, xhyp, jevg*), **vllahët, turqit, grekët, rumunët, latinët (italianët), hebrenjtë, tatarët dhe arabët**. Në mënyrë të veçantë shqyrtojmë edhe frazemat që si gjymtyrë kanë variantet që lidhen me shqiptarët, si: **shqiptar, arbëresh, arvanitas, arnaut, alban**.

Fqinjësia dhe lidhjet më komplekse janë me popujt **sllavë**, gjë që manifestohet edhe te frazemat. Te stereotipat frazemike për popujt sllavë, edhe sot paraqesin: *As hajri i turkut, as sherri i kaurit* – "paaftësi për diçka" (Reçani 2001: 379); të këqij, rrenacak: *Llaf i keq - llaf kauri* (Ibrahimi 2007: 236); si arsyetim për një punë të pakryer: *Ka cof kauri* (ka vdek duqanxhiu) etj.

Në mënyrë negative dominojnë edhe frazemat me komponentin **rom** (në të folmet kemi gjetur sinonimet *magjup, xhyp, cigan, jevgj, gabel*), si p.sh.: *Gjypi kaur gjen dhallt, kërkon en kos; Gjypi s'fryhet me pak* – "kur se ka mjaft" (Ibrahimi 2007: 225); *En xhypi i kataunit um shet pufka* – "kur e mbivlerëson veten" (Ibrahimi 2007: 261); *Ka vdekur xhupka që të lëvdonte* (Murati 2004: 137); *Çdo xhip e lavdron lodrën e vet; Secëlla xhyp kë lavdon setën e vete* (Murati 2003: 209) – "lavdohet vetë"; *Ene brekët e xhypkës falisin* – "i parregulluar, grumbulluar gjithçka" (Ibrahimi 2007: 205); *Punë magjupi* (i papastër/ punë jo e sinqer-

të); *Fëmija të bën mik edhe me xhypin* – “miqësi e papritur” (Murati 2004: 126); *Në jam i zi, xhyp nuk jam* – “nuk jam koprrac” (Murati 2004: 147); *Verë xhyphshish* – “koha me diell në nëntor” (Murati 2004: 167); *Xhyppit martoen* – “kur duken rrezet e diellit dhe njëkohësisht bie shi” (Ibrahimi 2007: 261); *Secili jevg e lavdon kalin e vet* – “secili anon ka vetvetja” (Gjuravçaj 2004: 96); *E gjeç nga ndonjë evgjit* – “e pësofsh nga frikacakët” (Mërkuri 2009: 379); *Si për Patoushin ene nji lodër e nji cigani jonë shoum* – “për atë që është i varfër edhe pak i duket se është shumë” (Murati 2008: 120).

Frazemat me komponentë **grekë**, po ashtu lidhen me sjellje negative, p.sh. *Si greku në haps* – “i pashpresë, i habitur, i humbur”; *Si greku në borxhe* – “gjendje të rëndë”, *Hupi si Gërçka* – “u zhduk, nuk e ka një kohë të gjatë”.

Në korpusin e gjuhës shqipe, bëjnë pjesë edhe frazemat që lidhen me **turqit** dhe **vllahët**. Qëndrimi shumë i gjatë i Perandorisë Osmane ka bërë që edhe sot e kësaj dite të jenë ruajtur shumë frazema që si komponentë kanë etnonime. *Bukë turku t’bafshin* – e pësofsh keq; *As hajri turkut, as sherri kaurrit* – “i paaftë për kurrjë” (Reçani 2001: 379); *E boni bukë turku* – “e rrahu mire” (Çe). *Koka e turkut dashi i kurbanit* (Spahiu 1980: 202).

Frazemat me komponentin **vllah**: *Ta qajsh me lla-hojnka / vllahinka* – “t’ia qash hallet” (Murati 2008: 121; 2003: 211); Interesant është edhe frazema *Si vallj’e rumunit* – “një punë që s’ka të mbaruar” (Murati 2008: 120; 2003: 210).

Negativisht shprehen edhe shumica e frazemave që si komponentë kanë **hebrejtë**, si p.sh.: *borxh çifoutit* – borxh i rëndë. *De hy borxh çifoutit* (Murati 2008: 116; 2003: 189), si dhe frazema që lidhet me **tatarët**, si p.sh.: *Tatari t’ardht hakut dhe Tatari t’mart vesh*.

Mjaft me interes paraqiten edhe frazemat me komponentët **arab** dhe **francez**. Komponenti **arab**, këtu më tepër luan rolin metaforik për ngjyrën, parregullsinë dhe paqartësinë ndaj një sendi, si p.sh.: *E zuri arapi* – “(dikë) u zemërua keq, e zuri inati” (Thomai 1999: 75); *Është bërë flokë arapi* – “(dikë) është bërë” (Thomai 1999: 306); *I ka punët liesh arapi* – “është përzier në shumë punë”

(Ibrahimi 2007: 247); *U bë liesh(flokë) arapi* “flokë të parregulluara” (Spahiu 1980: 5).

Në frazemën me komponentë **frëng**, *sa frëngu pulën* – “shumë shtrenjtë” (Thomai–Lloshi 109). P.sh.: *E bleu sa frëngu pulën dhe e shiti për një copë buke; do të na kushtojë sa pula frëngut, por ama do të na kenë zili të gjithë* (Thomai 1981: 160).

Për frazeologjinë shqiptare me interes janë frazemat që lidhen me **arbëreshët**. Një fjalë e urtë siciliane thoshte atëherë: “*Si vidhi llugjegu e vidhi lluglupu, spara allu gjegju e llasa lluglupu*” = **Ndë sheh një arbëresh e një ulk, shkrehu arbëreshit e le ulkun** (nëse ti ndesh në rrugë një ujk dhe një shqiptar atëherë qëllon në fillim shqiptarin). Në fshatin Falkunara, kryetari Erkole Konti përmendi shprehjen italiane ndaj arbëreshëve “*vrit arbëreshin e lë ujkun*” (Ibrahimi 2008: 138).

Frazemat arbëreshe që si gjymtyrë kanë etnonimin **l’tir (latin)**, kanë të bëjë me italianët. Arbëreshët e Italisë kanë patur shprehje, si: “*Derk e lti mos e klit ndë shpi se të mblon me bri*” ose “*L’tiri t’ha, t’pi e t’lidhen*”, *Derk e lëti mos e qell mb’shpi, se t’çan tigan e kusi (Plataci)*, *Derk e lëti mos e qas mb’shpi, se çan poçen me gjith kusi (Plataci)*. Një prift arbëresh, për ta shprehur urrejtjen e trashëguar, emrin **l’ti** ua shkruante fëmijëve të fshatit në thembrën e këpucës: “*shkileni, shkileni l’tirin tërë ditën, nesër prapë do t’jua shkruaj*” (Zlatku 1996: 52).

Krahasimi i frazemave

Çdo leksikalizim nënkupton edhe një perspektivë të caktuar të së vërtetës. Si bazë e perspektivizimit e përbën aftësia kognitive për ta tërhequr vëmendjen (Ungerer/Schmid 1996: 209). Në frazemat *borxh çifoutit* – borxh i rëndë; *si greku në haps* – “i pashpresë, i habitur, i humbur”; *si greku në borxhe* – “gjendje e rëndë”; *si vallj’e rumunit* – “një punë që s’ka të mbaruar”; *koka e turkut dashi i kurbanit* – “dikë me vlerë”; *sa frëngu pulën* – “shumë shtrenjtë”; *si punë magjupi* (i papastër/punë jo e sinqertë); *e boni bukë torku* – “e rrahu mire”, vëmendja përqendrohet në krahasimin e tyre, ndonjëherë krahasimi paraqet një nga mjetet më të rëndësishme të njohjes së botës.

Në disa raste të frazemave krahasuese, etnonimi paraqitet si *comparatum* që i përngjitet foljes ose mbiemrit (*terbium comporationis*) – kuptimi frazeologjik del nga krahasimi i cili tregon shkallën ose intensitetin, gjegjësisht gradacionin e ndonjë cilësie ose pune: *në jam i zi, xhyn nuk jam* – “nuk jam koprrac”; *pi si turk* – “pi shumë”; *e zuri arapi* – “(dikë) u zemërua keq, e zuri inati”; *është bërë flokë arapi* – “(diçka) është bërë”; *i ka punët liesh arapi* – “është përzier në shumë punë”; *u bë lesh (flokë) arapi* “flokë të parregulluara”; *si për Pato-ushin ene një lodër e një cigani jonë shoum* – “për atë që është i varfër edhe paka është shumë”.

Frazemat metaforike

Ashtu si frazemat krahasuese, edhe frazemat metaforike krijohen si reflektim i perceptimit të së vërtetës nga një perspektivë të caktuar. Metaforat, përveç që emërtojnë dukuritë, ato fokusojnë edhe perceptimin e vet, sepse bashkojnë elementet e dy fushave. Në këtë mënyrë një dukuri shihet dhe shqyrtohet me ndihmën e tjetrës. Pra në këtë domen të ri, metafora bart strukturën e vet, gjegjësisht raportet interne dhe logjikën e modelit kognitiv (Ungerer/Schmid 1996: 120), e cila domosdoshmërisht formon dhe drejton edhe mënyrën e të menduarit.

Kështu në frazemat *kifla kroate* ose *tenxherja bos-shnjake* kemi raste ku pasqyrohet domeni i gatimit në ngjarjet politike; te frazema *fshatra/lagje spanjolle* pasqyrohet largësia e një sendi abstrakt, diçka e panjohur; ndërkaq te frazemat *çizma italiane dhe kifla kroate* në mënyrë metaforike pasqyrohen format e shteteve të tyre. Në këtë mënyrë bashkohen objekte dhe fotografi të ndryshme/ asocime nga domenet e tyre dhe krijohen kuptime të reja, qoftë për shkak të rrethanave të ndërlikuara politike, formës gjeografike, qoftë nga gjerat krejtësisht të panjohura, ndërlikimeve politike, përlësisë / pendimit etj.

Frazemat me metonimi

Sipas Lakofit, frazemat me metonimi janë burimi kryesor i dukurive prototipike të metonimisë, si një nga format e pasqyrimin të së vërtetës (Lakoffu 1987: 79). Me këtë nuk ndërtohen raporte

midis koncepteve të ndryshme, si tek metafora, por raporte midis dy elementeve të një koncepti të njëjtë, nga të cilët njëri prej tyre është pjesë e tjetrit ose është afërsisht i lidhur me të. Në këtë mënyrë subkategoria shpesh në mënyrë prototipe barazohet me tërë kategorinë. P.sh.: *Për mua ajo është kinezisht/arabisht*, ku gjuha e panjohur qëndron për të treguar diçka që nuk është e njohur në përgjithësi. Një metonimi të njëjtë konceptuale, pjesa përfaqëson tërësinë, qëndron edhe te frazema *ku shkel këmba e turkut, nuk mbin bar*, ku etnonimi që asocion një shtet militar paraqet ushtrinë.

Ky perspektivizim, gjegjësisht konceptualizim i një të vërtete të njëjtë, mund të jetë e njëjtë në bashkësi të ndryshme. Këtë mund ta shohim në disa frazema *sëmundja franceze/angleze*- eufemizëm për sifilizin dhe rakitisin. Te frazemat *të flasësh gjermanisht sikur lopa latinisht (të flasësh frë ngjisht si lopa spanjolisht)* ose *kupton anglishten sa gomari muzikën* vendosen raporte të njëjta midis kafshëve që nuk kanë aftësi të flasin, me këtë edhe zotërimin e gjuhëve të huaja dhe njerëzve që e kanë atë aftësi. Pra në mënyrë qesharake konstatohet jokompetenca.

Përfundim

Numri i frazemave letrare dhe dialektore shqipe me gjymtyrë etnonimi, tregon se edhe këtu, ashtu si në fushat e tjera leksikore- ekzistojnë ngjashmëri dhe ndryshime. Ngjashmëri kemi më tepër në frazemat ndërkombëtare, por shpesh edhe në të folmet shqipe përdoren edhe frazema të përgjithshme, të njohura edhe te popujt e tjerë evropia në dhe botërorë. Dalin në sipërfaqe edhe lloje të ndryshme të frazemave lokale. Shpesh ndodh që kuptimi dhe struktura e frazemave të jetë e njëjtë në të folme të ndryshme, por edhe me shtete të tjera dhe zakonisht ndryshojnë etnonimet (p.sh. *të flasësh gjermanisht sikur lopa latinisht (të flasësh frëngjisht si lopa spanjolisht)* ose *kupton anglishten sa gomari muzikën*).

Nga materiali i përpunuar shohim se elementet onimike në frazema shumë shpesh janë të lidhura me perceptime stereotipe të shënuara me denotate të caktuara për ta. Stereotipet paraqiten si rezultat i mekanizmave socialë, kulturorë, psikologjikë e gjuhësorë dhe kanë tre funksione kognitive, sociale dhe afektive (Quasthoff 1988). Pra, ata si një mënyrë mentale të organizimit të botës kanë aspekte individuale dhe kolektive. Ashtu si shprehjet e tjera gjuhësore, edhe këto frazema me komponentë etnonimike dëshmojnë për konceptualizimin e botës, sepse në të shumtën e rasteve bazohen në modelet prototipe ose në projeksonin e tyre metaforik dhe metonimik. Potenciali i tyre pragmatik është shumë i madh, sidomos në krijimin e fotografisë për veten dhe të tjerët. Këto frazema që i kemi paraqitur, reflektojnë edhe bashkësitë gjuhësore që i kanë krijuar.

Bibliografia

- BELLUSCI, Antonio (1898). *Fraseologji arbëreshe dhe arbërore*.
- BELUSCI, A (1989), *Dizionario frazeologico degli albanesi d'Italia et Grecia*. Cosenca
- EISMANN, Wolfgang (1994). *Nationales Stereotyp und sprachliches Klischee. Deutsche und Slawen im Lichte ihrer Phraseologie und Parömiologie*. U Sandig, Barbara (Hg.). *Europhras 92. Tendenzen der Phraseologieforschung*. Bochum: Brockmeyer, 81.107
- GJEVORI, Mehmet (1968). *Frazeologjizma të gjuhës shqipe*. Prishtinë.
- GJOCAJ, Zenun (2009), *Trajtesa frazeo – stilistike të shqipes*. Prishtinë.
- GJURAVÇAJ, Gjergj (1994), *Proza popullore Malësisë së Mbishkodrës*. Shkup. (dorëshkrim)
- IBRAHIMI, Mustafa (2007), *Fjalë dhe shprehje popullore nga rrethi i Prilepit, Krushevs dhe Velesit*. Shkup.
- IBRAHIMI, Mustafa (2008). *Shënime udhëtimi mes arbëreshëve të Italisë*. Shkup: Interlingua.
- IVANETIĆ, Nada / BREMER, Ute Karlavaris. (1999). Onimijski frazemi i konceptualizacija sveta. *“Suvremena lingvistika”*, Vol. 47-48, No.1, May 1999.
- LAKOFF, Gordon (1987). *Women, Fire, and Dangerous Things*. Chicago: UP
- MËRKURI, Nexhip (2009). *E folmja e Përmetit*. Vlorë.
- MURATI, Qemal (2003). *Fjalor i fjalëve të rralla të përdorura në viset shqiptare të Maqedonisë*. Logos: Shkup.
- MURATI, Qemal (2008). *Kërçova. Hulumtime gjuhësore, etnografike dhe folklorike*. Shkup.
- MUSTAFA, Niko (1989), *Shprehje popullore nga rrethi i Korçës*.
- OSMANI, Zihni. (1997). Frazeologjizmat në të folmen e Prespës. *“Jehona”* nr.6/7.
- QUASTHOFF, Uta (1988). *Ethnozentrische Verarbeitung von Informationen: Zur Ambivalenz der Funktionen von Stereotypen in der interkulturellen Kommunikation*. U Matusche, Petra (Hg.). *Wie verstehen wir Fremdes*. München: Goethe Institut: 37.62.
- SHABANI, Haxhi (1989). Frazeologjizma nga Ana e Malit: *“Gjuha shqipe”*, nr.1, fq. 72-76. Prishtinë.
- SPAHIU, Agim (1980). *Frazeologjizmat në FGJSSH të vitit*.
- THOMAI, Jani – Lloshi, Xhevat (). Paralele frazeologjike të shqipes me gjuhë të tjera të Ballkanit: *“Studime filologjike”*, nr. 1. Tiranë.
- THOMAI, Jani (1999), *Fjalori frazeologjik i gjuhës shqipe*. Tiranë.
- UNGERER, Friedrich /SCHMID, Hans Jörg (1996). *An Introduction to Cognitive Linguistics*. London etc.: Longman
- XHAFERI, Haredin (2011), *Tomorica në vështrim gjuhësor*. Tiranë.
- ZENELI, Petrit (1999). *Fjalor me shprehje dhe fjalë të rralla nga Tropoja*. Tiranë.
- ZLLATKU, Rexhep (1996). *Me arbëreshët*. Shkup.
- .,

JUL CEZARI NË TROJET ILIRE (NGA PALASA NË DURRËS)

JULIUS CEASAR IN THE ILLYRIAN LAND (FROM PALASA TO DURRËS)

NERMIN BASHA

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Departamenti i Italishtes, Seksioni i Latinishtes, Tiranë, Shqipëri

Email: nerinabasha@yahoo.com

AKTET VII, 4: 287 - 291, 2014

PËRMBLEDHJE

Artikulli mbështet në librin III të veprës *Lufta civile*, ku, Cezari përshkruan luftërat me Pompeun në vitin 48 para e.s.. Duke marshuar nëpër territore ilire në ndjekje të Pompeut dhe luftimet me të, Cezari përmend 67 herë emra qytetesh, lumenjsh, fisesh ilire. Gjithashtu, libri III na njeh me prodhimin bujqësor e blegtoral, gjendjen e popullsisë, rrugët në bregdet e në thellësi të vendit. Përshkrimi i disa prej këtyre vendeve, sipas Cezarit dhe autorëve të tjerë para e pas tij, përbën thelbin e artikullit. Në kuadrin e ilirologjisë vepra e Cezarit plotëson dokumentacionin e historisë antike të vendit tonë, studimet e toponomastikës historike shqiptare, përforcon disa nga çështjet e kumtuara në burimet e shkruara. Në kuadrin e zhvillimit të turizmit, nëpër guidat turistike, në pjesën historike lidhur me shumë prej vendeve të përmendura në vepër, të shtohen episode të zhvilluara gjatë luftës mes Cezarit dhe Pompeut, sepse paraqesin lashtësi, interes, vlerë.

Fjalët çelës: lashtësia, Cezari, albanologjia, Orikumi, Apolonia, Durrësi.

SUMMARY

The article is based on the 3rd book of "The Civil War", where Julius Caesar describes the wars with Pompey, which took place in Illyria in year 48 b.c.. By marching through the territory in pursuit of Pompey, and engaging in battle with him, Caesar mentions names of cities, rivers, tribes. The 3rd book introduces us to the local agricultural products, the situation of the locals, roads. The description of some of these places, according to Caesar and other authors, comprises the core of the article. Within the framework of the Illyrology the 3rd book of Caesar's work enrich the documentation of the ancient history of Albania. We suggest that the tourist guide books discuss the war between Caesar and Pompey in the historical section related to the places mentioned in Caesar's work, because they are a testament to the antiquity of our country, and represent interest, value.

Key words: antiquity, Caesar, Albanology, Orikum, Durrës, Apolonia.

Hyrje

2000 e ca vjet vjet më parë, Jul Cezari zbarkoi ushtrinë në Epir, në ndjekje të Pompeut, i cili, konfliktin mes tyre, e barti në trojet ilire. Këtë përplasje Cezari e paraqiti në veprën *Lufta civile*, në librin III të të cilit përshkruhen ngjarjet në truallin ilir. Mes rreshtave cezarianë, gjendet një material i pasur dhe shumë i vlefshëm për historinë e Ilirisë. Emra vendesh, qytetesh, fisesh, lumenjsh përmenden drejtpërsëdrejti nga pena e

tij, që e bëjnë veprën me rëndësi për shkencën e albanologjisë.

Vendi i Germinëve

Në kreun VI autori shkruan se "*ditën tjetër ai preku tokën e Keraunëve /.../ zbarkoi tek ai vend që quhet Palestë*" (Caesar 2007: 19). Me shprehjen "*terram Cerauniorum*" (tokën e Keraunëve) Cezari na njeh me germinët, një fis ilir në gjirin e fisit të Kaonëve, duke na plotësuar më

mirë historinë e fiseve ilire. Ky emërtim, nëpër libra, padrejtësisht ka zëvendësuar shprehjen autentike të autorit: "*terram Germiniorum*", e cila gjendet dhe nëpër kodikë. Pra bëhet fjalë për "*tokën e Germinëve*" brenda territorit të të cilëve zbarkoi trupat.

Te emërtimi *Germinii*, studiuesit Hëze, Ceka, Mansaku shohin emrin "Dhërmi", me shndërrimin e grykores "g" në ndërthëmboren "dh", dukuri e hershme e shqipes.

Cezari bregëzoi në *Palaeste-n* e Epirit (Palasa e Himarës), që e përmend drejtpërsëdrejti me emër për rëndësinë e këtij çasti, sepse ky vend i zbarkimit të 20000 trupave mes flotës armike, vendosur në Korfuz dhe Orikum, qe zanafilla drejt fitores dhe vendosjes së sundimit të tij.

Shumë më vonë "kryqtarët, udhë hequr nga Rikard Zemërluani, pësuan humbje të rënda gjatë kalimit nga Italia në Epir, pikërisht në kepin e Gjuhëzës. Jul Cezari ishte më me fat.

Era e veriut e shpuri flotën e tij me shtatë legjionet shëndosh e mirë dhe në fshehtësi të plotë në Paleste, Palasën e sotme, në bregdetin "e tmerrshëm të Kerauneve". (Hammond 2004: 19).

Toponimi *Palaeste*, hyrë në histori nga Cezari, ruhet gati i njëjtë pas 2000 vjetësh dhe shërben si dëshmi e lashtësisë së trojeve të të njëjtit popull. Ky rryp bregdeti, rrethuar me male nga veriu dhe lindja, mbeti i paprekur nga dyndjet e shumta, prandaj emrat e lashtë janë ruajtur më mirë se në çdo krahinë.

Gjiri i Gramës

Pas zbarkimit, Cezari niset për Orikum përmes Qafës së Llogarasë, ku kemi emërtimin *Qafa e Cezarit*, që duhet të ketë mbetur nga koha kur nëpër të kaloi ushtria cezariane, në vitin 48 para e. s." (Ceka 2006: 145), dëshmi tjetër e së njëjtës popullsi që ka përçarur e lënë të ngulitur emërtimin në kujtim të asaj ngjarjeje të pazakontë nëpër ato male të rrepta.

Pas 15 orë marshimi kolona mbë rrin në Orikum. Cezari e përmend 13 herë këtë qytet bregdetar, i njohur nga shekulli VI para e. s., i lakmuar prej të gjithëve, si një pikë daljeje në det. Prej ku largësia detare është "18.000 hapa nga kepi i Salentit në

Itali" (Plini Secundi III: kreu 145). Zona e Gjirit të Vlorës, ku ndodhet Orikumi, ka qenë populluar qysh në lashtësi. Si bazë detare, qyteti ishte fuqizuar ekonomikisht edhe nga guroret, që janë shfrytëzuar shekujve për ndërtime e vepra arti të Apolonisë, Dyrrahut dhe qyteteve të tjera.

Pranë Orikumit gjenden tri gurore, më e madhja e të cilave në gjirin Grama (*shkronjë*), emërtuar kësisoj nga mbishkrimet e gdhendura në faqen e gurores nga marinarët. Gjurmët më të hershme të Gramës i takojnë shekullit VI para e. s.. Për herë të parë këto mbishkrime, cilësuar nga arkeologu Karl Paç, si kartvizita në faqet e një guroreje antike, i botoi italiani Çiriako d'Ankona, pas vizitës në dimrin e 1435-ës.

Në vitin 83 para e. s., ka kaluar aty Kornel Sula, që ka lënë emrin e tij të shënuar në një faqe shkëmbi. Gjithashtu, lexohet emri i Gnej Pompeut, i riu, që veproi e qëndroi në rrethinat e Orikumit, kur sulmoi kohortat dhe anijet e Cezarit. Ai e ka përdorur gjirin e Gramës si strehim të sigurt dhe si pikë vrojtimi. "Emra të tjerë janë shënuar pranë emrit të tij, si duket, të marinarëve të Pompeut. Gjiri i Gramës është nga trashëgimitë më interesante të së shkuarës." (Ceka 2006: 180). Cezari e shtiu në dorë Orikumin pa luftë, mirëpritur nga banorët dhe garnizoni me popullsi vendase.

Orikumi "limani pyjor i Akrokerauneve" (Patsch 1904: 22) ishte pushtuar nga Filipi V në 214-ën para e. s., kishte parë imbarkimin e ushtrisë së Paul Emililit në 167-ën para e. s., që, pasi kishte rrafshuar 168 qytete epirote, këtej ishte kthyer për Itali. Shprehjet e Cezarit "*duke u përpjekur të mbronte qytetin*", "*mbylli portat*", "*dha urdhër të ngjiten mbi mure*", "*komandën e fortesës*", "*u binte ledheve të qytetit*", "*pengonte të silleshin në fortesë ushqime nga Bylisi dhe Amantia*" (Caesar 2007: 143; 158; krerët 39, 40), flasin për një qytet në kuptimin e plotë të fjalës, që "lidhej përmes rrugësh me qytete në brendësi të vendit".

Për këtë rrugë flet në veprën e tij Pukëvili (1999: 80). Ai thotë se "zbulova rrugën romake që çonte nga Apollonia nëpërmjet Byllisit dhe Amantias për në Buthrotum. Në pikën më të lartë të kësaj

rruge ndaheshin drej timet që niseshin drejt Orikumit, Palasës dhe Panormos.

Edhe sot, pamja e Orikumit të Cezarit, identifikuar me mbeturinat e fshatit Paleokastër *“me molin natyror, duke e bërë qytetin thuajse një ujdhesë”, “me molin e brendshëm”, “me hyrjen e ngushtë të tij”,* me liqenin e vogël, paraqitet thuajse e njëjtë. Këtu u zhvillua e vetmja betejë detare mes forcave cezariane dhe atyre pompejane që sulmuan nga toka e deti, kryesuar nga i biri i Pompeut, që, sipas Dion Kasit, edhe është plagosur.

Orikumi, që krahas Apolonisë përbënte bazën kryesore detare të Cezarit, me historinë e veçantë, vjen nga lashtësia, duke treguar vazhdimësinë e këtij emri nga e njëjta popullsi dhe vepra e Cezarit është një dëshmi më shumë.

Apollonia

Pas Orikumit, Cezari synon Apoloninë. Vendbanimi është themeluar rreth vitit 600 para e.s. Është një “vendbanim i njohur i shkencës dhe i mençurisë, nga ku të gjithë merrnin mend” (Pukëvil 1999: 84).

Dy shekuj pas ngritjes, qyteti ishte formuar plotësisht, madje, ishte kthyer në një qendër të rëndësishme studimi në arkitekturë, skulpturë, retorikë, filozofi, ku vinin edhe djemtë e aristokracisë romake. Ndërtesat e monumentet, zgjidhur dhe harmonizuar nga ana arkitektonike, e bënë Apoloninë të dallohej nga të tjerat. Ky qytet i ofronte bollëk e rehati Pompeut.

Duke qenë pranë bregdetit, ai e ruante me fanatizëm, për të mos lejuar Cezarin të bregëzonte. Cezari e njihte mirë rëndësinë e Apolonisë: e madhe dhe e pasur. Prandaj nxitonte për ta pushtuar.

Gjithmonë Apollonia me rrethinat kishin qenë pika të rëndësishme strategjike, prej nga ushtritë e huaja kishin hyrë në trojet ilire, pos të tjerash, për të kaluar edhe në vendet fqinje. Dëshmitë e lashtësisë janë të shumta. Cezari nxiton drejt saj. Qyteti është i ngritur mbi dy kodra, me mure, faltore dhe port të lulëzuar. Me afrimin e Cezarit, komandanti pompejan çoi ujë në fortesë, e fortifikoi, mbylli portat e qytetit e dha shumë

urdhëra. Deri atë kohë fortesa, në pjesën më të madhe të saj “ishte e mbuluar nga vepra arti” (Veith 1942: 33).

Duke e gjetur miqësor edhe Apoloninë, Cezari marshoi për Dyrrah, depoja e Pompeut në armatime dhe nozullime. Mirëpo, nuk realizoi as mbërritjen para Pompeut, as pushtimin e qytetit. Cezari u rikthye në zonën e Apolonisë, *“për të lënë të plagosurit dhe për t’u shpërndarë rrogat ushtarëve”* (Caesar 2007: 178).

Cezari plotësoi nevojat e ushtrisë me çfarë i ofroi vendi i veprimeve.

Punishtja monetare në Apoloni

Po rrogat e ushtarëve? Sipas Ciceronit, në Apoloni në vitin 49 para e. s., vepronte një punishte monetare romake. Pompeu dhe Senati, larguar rrufeshëm nga Roma, pa mjete financiare për shpenzimet ushtarake, gjatë qëndrimit në Ilirinë e Jugut, duhet ta kenë ngritur këtë punishte. Argjendi sigurohej nga Iliria dhe nga Maqedonia e afërt. Punishten e Apolonisë, Cezari duhet ta ketë shfrytëzuar për të prerë monedha, të paktën, për të paguar mëditjet e ushtarëve. Kjo mbështetet edhe me faktin që, në rrethinat e Tiranës, janë gjetur dy thesare, me 63 dhe 119 monedha; gjysma e këtyre janë monedha romake të periudhës republikane me emrat Luc Kornel Lentuli dhe Kaj Klaud Marcelli, konsuj gjatë këtyre ngjarjeve, si e thotë edhe Cezari në librin I.

Sipas numismatëve, monedhat janë futur në tokë në vitet 49 apo 48 para e. s. Pa dyshim, në vitin 49 para e. s. punishtja e Apolonisë u vu në shërbim të thesarit romak dhe nxori në qarkullim denarë me emrat e konsujve të sipërpërmendur. Studiuesi Ceka lidh gruposjen e monedhave me gjendjen e pasigurisë që shkaktoi lufta civile romake në krahinat e Ilirisë, veçanërisht, plaçkitja e fisit të Parthinëve nga kalorësia e Pompeut, fillimisht dhe nga legjionet e Cezarit gjatë pushtimit të qytetit të tyre, më pas (Ceka 1972: 99).

Cezari Apoloninë e vlerësoi veçan nga qytetet e tjera me të njëjtin emër, rreth 20 në pellgun e Mesdheut, duke e zgjedhur për edukimin dhe formimin e trashëgimtarit të tij, Oktavian Augustit. “Kur luftërat civile përfunduan, me qëllim që të formonte shpirtin e këtij djaloshi të

veçantë në shkencat liberale, (Cezari) e dërgoi në shkollat e Apolonisë për studime” (Paterculus kreu 59). Duhet të jetë ky çast që ia rriti vlerën Apolonisë, të cilën Ciceroni e quan “qytet të madh e hijerëndë” (Ciceronis, kreu 26) “qytet me ligje të mrekullueshme”.

Kur Cezari vritej në Romë nga 23 goditjet e thikave të përбетuesve, Oktaviani ishte në Apoloni (Irmischer, 1974: 361). Duke përmendur leksikografin Samuel Christoph Schirlitz (1797 - 1875), Irmischer shkruan se leksikografi përfundon shkrimin për Ilirinë me konstatimin se “Vlera e kësaj Ilirie del nga rëndësia e shumë qyteteve, të cilët ishin ngritur po aty, si Dyrrachiumi, Apolonia, **një qytet ku shkencat kanë pasur selinë e tyre** dhe ku Oktaviani, që u bë më vonë perandori August, ka ndjekur studimet e veta”.

Dyrrahu

Cezari synonte Dyrrahun. Ky ka qenë qyteti më i rëndësishëm i luftërave civile, mes Cezarit e Pompeut e, më pas, mes Oktavianit dhe vrasësve të Cezarit.

Themeluar rreth vitit 650 para e. s., Dyrrahu ishte rritur e lulëzuar, duke u bërë deri me institucione qeverisëse që mbështeteshin në kushtetutë, kishte port të madh me kantier për ndërtim anijesh. Ciceroni e quan “qytet të admirueshëm, të njerëzishëm ndaj tij dhe shumë afër Italisë” (Ciceronis liber quartus decimus). Sipas Tit Livit (Livi libri XLII, kreu 48), në vitin 171 para e. s. në port ishin ankoruar 76 anije.

Pas 100 vjetësh, porti ishte rritur për nga madhësia e rëndësia. Për këtë na siguron edhe historia e ngjarjeve tona: vendosmëria e Pompeut për ta ruajtur dhe këmbëngulja e Cezarit për ta shtënë në dorë.

Sipas Pukëvil, epokat më të paharrueshme të historisë së Dyrrahut janë lufta mes Cezarit e Pompeut dhe e perandorit Aleks me normanët e Robert Guiskardit (Pukëvil 1999: 95). I mbrojtur nga natyra, Dyrrahu kishte pozicion me rëndësi të madhe ushtarake, që, bashkë me Apoloninë, i lejonin Pompeut të mbante nën vëzhgim gjithë bregun ilirik për bllokimin e Cezarit. Ky arriti ta shkëpuste Pompeun nga Dyrrahu, por jo t’ia me-

rrte. Duke ditur rëndësinë e qytetit, Pompeu, që ndodhej në Tesalonik atë çast, i njoftuar për mbërritjen e Cezarit, erdhi me ngut nga rruga që u quajt “Egnatia” disa vjet pas këtyre ngjarjeve. Për lëvizjet e Pompeut nëpër luginën e Shkumbinit drejt Durrësit, Cezari shkruan: “*ndodhej në Kandavi*”, “*arrinte përmes Kandavisë*” (Caesar 2007: 143, 179), duke dhënë dëshminë që kjo rrugë në vitin 48 para e. s. nuk kishte emrin Egnatia, por mbante emrin e lashtë ilir “Rruga e Kandavisë”.

I bllokuar nga toka, Pompeu ngriti kampin e vet nga ana e detit, në “*një pozicion të lartë të quajtur Petra*” (Caesar 2007: 160). Cezari e përmend drejtpërsëdrejti Petra-n, njëjtësuar me Shkëmbin e Kavajës apo Shkëmbin e Bardhë: “i vetmi shkëmb i krahinës, Petra-Bianca /.../ emri i lashtë i fushimit të Pompeut, ruajtur kështu ndër shekuj, me emrin *Shkam* të banorëve vendas, që i përgjigjet saktësisht kuptimit të fjalës *Petra*” (Heuzey 1886: 51), pozicion mjaft i rëndësishëm, një linjë katërfishe fortifikimi natyror, duke u shtrirë mes dy rrugëve kryesore që çojnë në Dyrrah.

“Rruga e bregut” futet midis detit dhe shkëmbit të Petra-s “duke formuar një pykë të ngushtë, të ngjashme me Termopilet e Greqisë Perëndimore” (Heuzey 1886: 55). Ngaqë kundërshtari nuk po ofronte betejë, Cezari pushtoi kreshtën e kodrave që i bënin kurorë pellgut ku kishte fushuar Pompeu, ngriti pika mbrojtjeje e vrojtimi, vuri garnizone, bllokoi burimet ujore në këtë zonë, pa ndërruar a bllokuar rrjedhën e lumenjve, Darçi e Leshniqe, sepse, si edhe tani, kishin ujë të kripur të papastër e nuk përdoreshin për t’u pirë.

Ledhat e Pompeut

25 km ishte gjatësia e vijës fortifikuese të Cezarit, nga Durrësi, deri në lumin Darçi. Me 22 km vijë fortifikuese e ndoqi Pompeu. Këto fortifikime, koha e njeriu i zhduku, por në jug të përroit të Agait, ende sot ruhen ledhe të pjesshme 2 m të larta, që vendasit i quajnë “ledhet e Pompeut” (Hoxha 2005: 75), dëshmi e atyre ngjarjeve. Cezari përmend hapësirat për kullotje, vendet e ulëta, diku-diku moçalore, livadhet, pyjet, kodrat me shpate të buta ose të thikta.

Bima chara

Gjatë veprimeve pranë Dyrrahut, cezarianëve u mungoi drithi, mirëpo në kreun 48, autori përmend një bimë me emrin *chara* që siguruan njerëzit e tij në atë zonë. Duke e përzierë me qumësht dhe pjekur, *chara* zëvendësoi bukën. Studiuesit, që gjetën shumë bimë të tilla në afërsi të Durrësit, mendojnë se është një lloj zhardhoku, si patatja, përdorur në kohë krize edhe nga vendasit. Sipas Hëzes-s, fjala ilire *chara* përdorur nga Cezari, nuk është veçse bima këlkazë e shqiptarëve. (Heuzey 1886: 80). Këtu, pikërisht përreth zonës në juglindje të Durrësit, në luginën e Erzenit dhe ultësirën e Kavajës, zhvillohet beteja për jetë a vdekje mes kryekomandantëve romakë.

Përfundim

Në përfundim mund të themi se:

1. Në mungesë të shkrimeve nga autorë vendas, nga vepra e Cezarit mund të nxjerrim të dhëna të vlefshme për historinë e Ilirisë.
 2. Vepra tërësore e Cezarit dëshmon se mjaft toponime kanë kaluar pa ndërprerje në gojën e së njëjtës popullsie që nga koha e vonë e lashtësisë.
 3. Dy njoftime të reja na jepen vetëm nga Cezari: Germinët, duke u plotësuar më mirë historia e fiseve ilire dhe toponimi Palaeste, Palasa e Himarës.
 4. Marshimet e forcave romake gjatë bregdetit, por edhe thellë në prapatokë, flasin për ekzistencën e një rrjeti rrugor të shpërndarë në gjithë vendin.
 5. Veç shtrirjes gjeografike, emrat e qyteteve janë dëshmi e pranisë së popullsisë shqipfolëse që banonte aty, bënte jetesë të përparuar qytetare dhe u dha formën gjuhësore shqipe emrave të këtyre qyteteve.
- Mendojmë se do të ishte mirë që këto të dhëna, të rëndësishme për shkencat albanologjike, por

që përbëjnë kuriozitet edhe për njeriun e thjeshtë, sepse tregojnë lashtësi e vazhdimësi trojesh të një populli, të gjenden edhe nëpër pikat arkeologjike e guidat turistike

Bibliografia

- CAESAR, Julius (2007), *Mbi luftën civile*, Bargjini. Tiranë.
- CEKA, Hasan (1972). Mbi disa çështje të historisë ilire në dritën e të dhënave numizmatike: *Kuvendi i studimeve ilire*. Botim i Akademisë së Shkencave, Institutit të Historisë, Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë, Institutit të Monumenteve të Kulturës. Tiranë.
- CEKA, Neritan (2006). *Udhëtim në kështjellat ilire*. Migjeni. Tiranë.
- CICERONIS, M. Tulli (). *Oratio Philippica undecima*.
- HAMMOND, Nichol G.H. (2004), *Epiri*. Qendra e Studimeve Ndërrshqiptare. Tiranë.
- HEUZEY, Léon (1886), *Les opérations militaires de Jules César*. Paris.
- HOXHA, Rifat (2005). *Kavaja, kur nuk ishte dhe si u bë*, Gutenberg. Kavajë.
- IRMSCHER, Johannes (1974). Vërejtje rreth konceptit gjerman të shek. XVII e XIX mbi ilirët: *Kuvendi i studimeve ilire*. Botim i Akademisë së Shkencave, Institutit të Historisë, Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë, Institutit të Monumenteve të Kulturës. Tiranë.
- LIVII, T. (), *Ab Urbe condita*, libri 31 – 52.
- PATERCULUS, Velleius (), *Historiae romanae*, liber posterior.
- PATSCH, Carl (1923). *Ilirët*, përk. Karl Gurakuqi. Shtypshkronja "Nikaj". Tiranë.
- PLINI SECUNDI (). *Naturalis Historiae*, libri 3, 4.
- PUKËVIL, F. (1999), *Në oborrin e Vezirit të Janinës*. Horizont. Tiranë.
- VEITH, Giorgio (1942). *La campagna di Durazzo fra Cesare e Pompeo*. Tradotto dal tedesco. Roma.
- ..

SHUMËSI I EMRAVE NË VEPRAT E ËNGJËLL RADOJES DHE PASHKO BABIT

THE PLURAL NAMES IN THE PLAYS OF ËNGJËLL RADOJA AND PASHKO BABI

ARJOLA HOTI

Universiteti "Luigj Gurakuqi", Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Departamenti i Gjuhësisë, Shkodër,
ALBANIA

E-mail: arjola_hoti@yahoo.com

AKTET VII, 4: 292 - 297, 2014

PËRMBLEDHJE

Kumtesa përqendrohet në trajtimin e një dukurie me karakter gjuhësor: rreth formimit të shumësit të emrave në veprat: "Doctrina e kerscten" (Shkodër 1876) me autor Ëngjëll Radoja dhe "Vakinat e t'ligs herscme dhe t'ligs ree" (Shkodër 1882) me autor Pashko Babin. Autorët e lartpërmendur dhe bashkohës të tjerë bënë një kthesë të madhe në traditën shkrimore të shqipes. Në këtë studim jemi përpjekur të bëjmë prezent veçanërisht raste të veçanta të formimit të shumësit të emrave në këto dy vepra. Do të trajtohen çështje të tilla si: cilët janë rastet më prezente të shumësit të emrave në këto vepra? A ka shmangie nga norma standarde? Si ruhen sot këto forma të veçanta të shumësit në dialektin gegë, si një fenomen i trashëguar? Cili është mendimi i gjuhëtarëve rreth këtij problemi gjuhësor? Ky studim ka si qëllim edhe të fokusojë e saktësojë ngjashmëri dhe ndryshime të kësaj dukurie gjuhësore të trajtuar në botimet e Ëngjëll Radojës dhe Pashko Babit. Metodologjia e shfrytëzuar mbështetet në vëzhgimin, hulumtimin dhe identifikimin e rasteve të formimit të shumësit të emrave në veprat e këtyre dy autorëve shkodranë të shekullit nëntëmbëdhjetë. Një studim i tillë ka si synim t'i shërbejë jo vetëm studiuesve të fushës së albanologjisë por edhe disiplinave të tjera gjuhësore.

Fjalët çelës: shumës, emër, normë standarde, fenomen gjuhësor.

SUMMARY

The paper will focus on the treatment of an occurrence of linguistic character : about the formation of plural names in the works: "Doctrina e kerscten" (Shkodër 1876) by author Ëngjëll Radoja and "Vakinat e t'ligs herscme dhe t'ligs ree" (Shkodër 1882) by author Pashko Babi. The over mentioned authors and other contemporaries did a great twist on the existing writing tradition. In this scientific study we have tried to show up specifically special cases of the formation of plural names. It will be treated such cases like: which are some of the cases of the plural names in the plays? Is any admission from the standard norms? How can such special forms at the plural in the geg dialect be preserved like an inherited phenomenon? Which is the thought of the linguists about this linguistic problem? The aim of scientific study is to focus and specify the similarities and differences of this linguistic phenomenon treated on the publications of Ëngjëll Radoja and Pashko Babi. The used methodology is based on observation on the noun plural formation in the works of both authors from Shkodra. Such a study is intended to serve not only to the albanology researchers but also to the other linguistic disciplines.

Key words: plural, name, standard norm, linguistic phenomenon.

Hyrje

Gjatë vëzhgimit të shkrimeve shqipe të botuara gjatë shekullit të nëntëmbëdhjetë, të bie në sy edhe përpjekja e shkrimtarëve shkodranë për lëvrimin e gjuhës shqipe. Mes tyre veçojmë dy

klerikët: Ëngjëll Radojën me veprën : "Doctrina e kerscten me msime e me scpjegime" (Shkodër 1876) dhe Pashko Babin me veprën "Vakinat e t'ligs herscme dhe t'ligs ree" (Shkodër 1882), të cilët u bënë pikë referimi për studimin tonë. Aty

do të paraqiten para studiuesve të gjuhës shqipe çështje me karakter morfologjik, konkretisht përdorimin e shumësit të emrave, të cilat i kemi qëmtuar në të dy veprat e cituara më lart.

Në këtë punim do të ndalemi veçanërisht në trajtimin e disa *rasteve të veçanta* të formimit të shumësit të emrit, të cilët në trajtën që dokumentohen i janë shmangur ligjërit të sotëm.

Shumësi i emrave në gjuhën shqipe paraqet interes të veçantë, sidomos për vetë karakterin e gjuhës shqipe. Gjuha shqipe, siç dihet është një gjuhë analitike-sintetike, e cila për dhënien e formave të reja përdor gjërësisht trajta gramatikore të veçanta. Mjeti me të cilin ndërtohet forma e shumësit specifikohet vetëm si tregues i kategorisë së numrit dhe jo i ndonjë kategorie tjetër. Është për tu theksuar se shumësi i emrave të gjinisë mashkullore në këto vepra paraqitet shumë më i pasur.

1. Shumësi i emrave të gjinisë mashkullore:

1.1. Shumësi me prapashtesën –a: Këta emra që e formojnë shumësin me këtë formë gramatikore kanë një përdorim më të dendur në veprat që kemi në shqyrtim. Veçoria e tyre është që emrat e tipit të tillë nuk e ndryshojnë gjininë në numrin shumës, pavarësisht se marrin prapashtesën –a dhe këtë e vërtetojnë edhe përcaktorët e gjinisë mashkullore që ata marrin p.sh.: lis-a t'gjat, grusht-a t'fort', kallam-a t'vozer, ghem-a t'gnoom etj. Psh.

Radoja: “t’jeen *kraila*, mretna /.../ e vec se *kryma t’vozer*” (Doctrina: 98); “*Kurbanat* qe baheshin n’lig t’mocme” (Doctrina: 161); “e u nnezim *ccirra t’qjat* e *kannila* perpara” (Doctrina: 104).

Babi: “se po kisc n’krye *tre zymyla* buket” (Vakinat: 39); “Moisiu nisi *dymdhet burra*” (Vakinat: 70); “me i ra c’heret mrapa *burrat e miir*” (Vakinat: 163); “tiert thescin *ghema t’gnoom* e i lsoiscin rrughs” (Vakinat: 247); “iscin n’at venn *giasct qiypa* ghurit” (Vakinat:).

1.1.1. Emra të tjerë që e formojnë shumësin me prapashtesën –a: Përveç këtyre emrave që e kanë formuar shumësin në përputhje me ligjërimin e sotëm, është me interes të vëmë në dukje se në veprën e Pashko Babit dhe Ëngjëll Radojës ndeshim edhe ata emra që në mënyrën e

formimit i kanë devijuar këto rregulla. Kështu kemi:

Emri *ishull-i* në pajtim me fenomenin fonetik shumësin duhet ta formojnë me palatalizimin e II – së në –j, ashtu siç formimin e shumësit e bëjnë një grup emrash të tjerë, si: shekull – shekuj; mashkull – mashkuj; grumbull – grumbuj etj.

Në veprën e Pashko Babit ky emër shumësin e formon me prapashtesën –a, tek shembujt: “*e ishuLat* atii kan per t’i ciue t’falunat e veta” (Vakinat: 97); “si ra mannei e i pa *iscuLat* e Lesbo e Kio” (Vakinat: 309).

Po kështu edhe emri *qiell* shumësin e formon me këtë prapashtesë, si: “N’at cias u cline *cielat*” (Vakinat: 182); “kur *cielat* nuk munnen me i paa” (Vakinat: 106).

Edhe shumësi i emrit *det-i* dëshmohej i formuar me prapashtesën –a, pra *det-a*, madje e ndeshim të shkruar me shkronjë të madhe si emër të përveçëm: “e t’mbledhunat e uinave i emnoi *Deeta*” (Vakinat: 8).

Emri *Zot-i* që klasifikohet zakonisht si emër i përveçëm e gjejmë në formën shumës me trajtën *Zot-a*

Radoja: “sceitnit nuk i bessoim, se jan *ëota* por micct e eotit” (Doctrina: 104); “o disa nierz t’dekun porsi *ëota*” (Doctrina: 102).

Babi: “me aso for dhunsc nneeroiscin *ëota*” (Vakinat: 19); “ciou e ghoditna *ëota* sikurse i kan” (Vakinat: 45).

Ndërsa përsa i përket emrit *nip-i* i cili shumësin e formon me prapashtesën –a, vëmë re se në vepër nuk gjendet asnjëherë në këtë trajtë. Përkundrazi autori Pashko Babi përdor format t’nipt \ nipniin, p.sh.: “Giakobbi i puthi t’*nip*t e vet” (Vakinat: 49); “e *nipniin* e vet” (Vakinat: 49).

1.2. Shumësi i emrave me prapashtesën –e: Edhe prapashtesa –e është shumë prodhimtare në të dy veprat e autorëve tanë. Me këtë prapashtesë e formojnë shumësin një grup emrash të gjinisë mashkullore. Disa prej këtyre emrave karakterizohen nga fakti që në numrin shumës kalojnë në emra të gjinisë femërore. Kjo dukuri morfologjike shfaqet shumë e vjetër te shkrimtarët e veriut. Sipas albanologut Shaban Demiraj “te autorët shkodranë, që nga Buzuku emrat mashkullorë që e formojnë shumësin me

prapashtesën –**e** i përdorin rregullisht si emra ambigjenë, dmth në shumës i shoqërojnë me mbiemra e fjalë përcaktonjëse të gjinisë femërore (Demiraj 1971: 203). Kjo dukuri morfologjike që ruhet edhe sot në gjuhën shqipe si një fenomen i trashëguar shfaqet edhe tek veprat e autorëve në shqyrtim. Kështu të gjinisë mashkullore dalin emra, si:

Radoja: “as s’kaa me gabue n’essape t’fees e t’scirtit” (Doctrina: 35); “kaa dheu dy pusctete fort t’nalta” (Doctrina: 37); “nnina nee fajet e mcatet tona” (Doctrina: 59); “prei sotit t’nniemit e mcatevet” (Doctrina: 88);

Babi: “tui maarr majet e maleve ma t’nelta.” (Vakinat: 16); “n’kisc t’zotit me fal kusctet e veta” (Vakinat: 110); “se aso heret kurbanet e baktiive kiscin per tu hieek” (Vakinat: 167); “e jo me i lakmue essapeve tiera” (Vakinat: 49).

Vëmë në dukje faktin se këtë prapashtesë e marrin edhe shumë emra prejfoljorë të formuar me prapashtesën –**im**, si: kujtim-e, urdhnim-e, discrim-e, meritim-e, spieghim-e.

Radoja: “me marr mrapa urdhnimet e tia” (Doctrina: 62); “tadhtiit, neerlikimet, dredhimet ci bahen tui scit e tui ble” (Doctrina: 141); “edhe gjith kuitimet e discrimet tona” (Doctrina: 136);

Babi: “kuur i knnon ankimet gi derton ghoja” (Vakinat: 140); “e si i bani kraitit urimet e veta” (Vakinat: 49).

1.3. Shumësi me prapashtesën -na. Me këtë prapashtesë zakonisht shumësin e formojnë emra të gjinisë asnjajëse, si: “faroj me uina t’mdha gith dheen maar” (Doctrina: 137); “t’githa vennet e uinave ciell e derdhi” (Vakinat: 16); disa emra mashkullore, si: “kuur baim kryq, nuk thona n’emna por n’emen” (Doctrina: 25); “per ciobant e scirtnavet tona” (Doctrina: 47); “kan per t’meet esctnat tueja” (Vakinat: 71).

Në veprat në shqyrtim gjejmë të dokumentuar edhe emrin **krye** që e formon shumësin me këtë mbaresë në trajtën **krena**: “për t’keen krenat e gñinahies” (Doctrina: 54).

1.4. Shumësi me metafoji: Dukuria morfologjike emërtuar si metafoji bën që zanorja **a** e temës së emrit në gjininë mashkullore në numrin njëjës të kthehet në **e** në numrin shumës, si p.sh. thes-thasë, rreth-rrathë, dash-desh. Emrat thes-thasë,

rreth-rrathë, sipas profesor E. Çabejt kanë forma të singularizuara që janë përfutur nëpërmjet metafonisë **a:e** (Çabej 1967).

Në veprat e autorëve tanë dokumentohet një numër i reduktuar shembujsh:

Babi: “kuur murne me scpraaz thast” (Vakinat: 43); “kerkoi n’gjth thast e zu fill n’thes ma t’madhin” (Vakinat: 46); “duul prei atyne retheve e cio zann” (Vakinat: 223).

Nga të dhënat rezulton se ky fenomen morfologjiko-fonetik del i stabilizuar që në periudhën paraliterale, pasi del e dokumentuar edhe në shkrimet e pararendësve tanë, si Buzuku, Budi e Bogdani dhe si i tillë dokumentohet edhe tek këta dy autorë shkodranë.

1.5. Shumësi me ndërrim tingujsh g, k përkatësisht në gj, q. Ekzistojnë në veprat e autorëve në shqyrtim mjaft emra që e formojnë shumësin me qiellzorizimin e bashkëtingëlloreve **k, g** në numrin njëjës në **q, gj**, në numrin shumës. Të këtillë listojmë shembujt:

k:q: “e per t’paa- fee per micc e per anmicc” (Doctrina: 58); “e si miqt e vet kiscite per ta hatrue” (Vakinat: 162); “asctu mir do t’i duen turci” (Doctrina: 92); “e lieu me zyft e pesckve basck” (Vakinat: 55); “deri sa gi ti vee une enmiqt tuu scotoi per kam tua” (Vakinat: 98); “ato dy pleqt cline goi” (Vakinat: 142); “e voit me gieet kokra figsc e nuk jan giet” (Vakinat: 236).

g:gj (dhe mbaresë): “e zoqt e ciells kan per t’lscin” (Vakinat: 40); “ghrehet vet para syvve zoqve n’flead” (Vakinat: 104); “gi ja vuite t’qitha scitigiet me i scitii n’dor” (Vakinat: 92).

1.6. Shumësi me palatalizimin e tingullit ll në j. Është një tjetër formim shumësi i emrave me palatalizimin e **ll** – së në **j**. Ky fenomen në këto dy vepra përfaqësohet në një numër të konsiderueshëm shembujsh, si: “ci adhroin idhuit n’venn Tenzot” (Doctrina: 62); “e kan per t’raa prei ciellet hyvit” (Vakinat: 252); “e gñehi per n’muisc hyvit” (Vakinat: 22); “Kriscin me gith discepui gi kiscite e thirrne” (Vakinat: 186).

Në këtë rast veçojmë emrin **qiell**, i cili, ashtu siç e theksuam edhe më lart nuk e formon shumësin me palatalizim, por del me prapashtesën –**a**, si: “kuur ciella, e ciellat nuk munnen” (Vakinat: 106); “n’at cias u cline ciellat” (Vakinat: 182).

1.7. Shumësi i emrave mashkullorë me prapashtesën -j. Patjetër që këta autorë do të përfaqësojnë të folurën e trevës së vendlindjes, gjë që vihet re edhe në formimin e shumësit të disa emrave me prapashtesën perkatëse: -j. Është karakteristikë se Ëngjëll Radoja dhe Pashko Babi e shënojnë këtë mbaresë me dyfishimin e zanores -i. P.sh.: “per kunnra per to cioi giarpji t’zeherlatisun” (Vakinat: 74); “me mleedh kallii mas korzaresh” (Vakinat: 82); “Fuscen e tyne e ciarti me mii gi giaa s’ju lan” (Vakinat: 85); “me krye t’mluem jug nit tui kiaa koders ullive” (Vakinat: 100); “Ku mahescin t’nnryym scat luai t’eger fort” (Vakinat: 148).

Ethem Likaj, në një punim të tij thekson: “sot ka një anomali për këtë shumës dhe për këtë janë botuar disa shkrime duke theksuar se prirja me sa duket shkon drejt menjanimit të prapashtesës -nj dhe përgjithësimi të -j – së (Likaj 2002: 84).

2. Dygjinisia

Gjatë studimit të fenomenit të shumësit në veprat e këtyre dy autorëve dalluam shumë emra mashkullorë që në shumës janë integruar në femërorë. Kjo bën që të klasifikohen si emra të dygjinishëm. Dimë se dygjinisia vepron te një grup emrash të gjinisë mashkullore që në shumës marrin prapashtesat -a, -ra.

Te veprat e autorëve në studim ndeshim shumësin e emrit petku /-a të formuar me prapashtesën trajtëformuese -a petka, p.sh.:

Radoja: “rrobet e kisc, petkat e mescs” (Doctrina: 102); “dy egnei petka t’bardha” (Doctrina: 225);

Babi: “ka dy paar petka t’mira” (Vakinat: 48); “zaptoi petkat e vuu në eëea vedin” (Vakinat: 37).

Po kështu dallojmë edhe emra jofrymorë me origjinë asnjajëse apo mashkullorë që e formojnë shumësin me prapashtesat e lartpëmendura -a, -ra, të cilët i listuam edhe më sipër, si: mallna t’lira, esctnat tueja, ujna t’mdha, scpitnave tona etj.

Kjo dukuri shihet e përhapur edhe tek emrat mashkullorë që e formojnë shumësin me prapashtesën -e, si: vise t’largta, kujtimet tona, fajet tona, mcate t’vsctira, maleve t’nelta.

3. Shumësi i emrave femërorë

3.1. Shumësi me prapashtesën -a

Jo më pak produktiv na shfaqet shumësi te një grup emrash të gjinisë femërore, por ne në këtë studim nuk do të ndalemi në të gjitha rastet e formimit. Përcaktimi më i qartë i gjinisë femërore të një emri është kur ky emër merr prapashtesën -a në trajtën e shquar të numrit njëjës. Por me këtë formant gramatikor shumësin e formojnë edhe disa emra të trajtave të tjera të gjinisë femërore, si p.sh.:

Radoja: “scka nuk diin prei letrasc mrrin me e marr” (Doctrina: 104); “o tui citt fial, e prrala permennim Zotin” (Doctrina: 106); “me i pas n’hatet rrenat e t’kciat” (Doctrina: 117); “nner ditt ci atii jan sciugurue e jan t’diilat e festat” (Doctrina: 116);

Babi: “iscin higher e bba si dyy vija” (Vakinat: 267); “e mrenna furrave tyne e sofrave tyne” (Vakinat: 58); “ato morii mizasc n’tars t’muscizave” (Vakinat: 58); “e ju bisedoi annrat e veta” (Vakinat: 40); “n’kto trii festa t’gith sa t’jen maskulli ner ju” (Vakinat: 163); “dy rrasa n’t cilat iscin zier fialt” (Vakinat: 65).

Përsa i përket emrit figurëla që në përputhje me normën drejtshkimore shumësin e formon me prapashtesën -a, tek Ëngjëll Radoja e ndeshim këtë shumës të ndërtuar me prapashtesën -e, si: “pse biim n’ghiui perpara fuqureve /.../ me i nneerue fuquret” (Doctrina: 104).

Edhe emrin roba-t e gjejmë të formuar me prapashtesën -e: “giaan e viedhun e rrobet e takam” (Doctrina: 146).

3.2. Shumësi i emrave me prapashtesën -e

Me këtë prapashtesë dalin një sërë emrash, si: “na praa per kto kater arsye kena bare” (Doctrina: 99); “me mledh dyy kranne me skue me i pieek /.../ ner syy gni ghrue e vei gi po mliidhte kranne” (Vakinat: 120); “e scughuroi me kagh e saze e daire” (Vakinat: 163); kiscte pass n’dor pijet e tii n’sofer” (Vakinat: 40).

Si emra të gjinisë femërore dalin edhe disa emra tema e të cilëve në trajtën e pashquar njëjës përfundojnë me -ër, -ull, -ur dhe në numrin shumës marrin prapashtesën -a. Listojmë shembuj si më poshtë:

letër-letra: “letrat e tenzot jan plot me k’so premtimesc” (Doctrina: 53);

thupër-thupra: “em aat ju ka rraah me thupra” (Vakinat: 100);

vepër-vepra: “Veprat e mira ci jan gith scka ua ban” (Doctrina: 11);

shpatull-shpatulla: “ci u zaan bess scpatullave ti” (Doctrina: 103).

Vlen të theksohet se në veprat e autorëve ndeshim të përdorur emrin erë\ a të cilin e gjejmë të shënuar me prapashtesën **-na**, ashtu sikurse përdoret në dialektin gegë. Kështu kemi: “e fryn ernat e ju vescu si kie maa mrapsct” (Vakinat: 200).

Po kështu edhe emri natë\ a i gjinisë femërore shumësin e formon me metaforë, si: “sikur se Giona tri dit e tri net nnei n’bark” (Vakinat: 121); “e un n’ata net kam per t’ra” (Vakinat: 60).

4. Shumësi i parregullt

Nuk mund të lëmë jashtë këtij studimi pa përmendur një element të rëndësishëm rreth shumësit të emrave në veprat e cituara. Krahas formave të lartpërmendura ndeshim në këto shkrime edhe disa emra të cilët e formojnë shumësin duke ndërruar temën e njëjësit dhe që Kristaq Cipo ndryshe e quan edhe shumësi i thyer (Cipo 1949: 76). Veçojmë mes tyre emrat kalë, dorë, dyer të cilët e formojnë shumësin me zbërthimin e zanoreve **-a**, **-o**, **-e** të temave të fjalëve në togun zanor: **ua**, **ue\ye**, si:

Shumësi i emrit kalë\i, tek këta dy autorë shkodranë formohet me zbërthimin e zanores **a** në togun **ua**, por pa palatalizimin e l-së në **j**, pra kemi formën **kuallt**, p.sh.: “kuallt e sckelne, egieit i haghne miscin” (Vakinat: 116). Shumësi në formën kuaj nuk ndeshet asnjëherë në vepra dhe me të drejtë Shaban Demiraj thekson se kjo mund të jetë një trajtë e re e përfutur në kohë më të vona të shqipes (Demiraj 1971: 203).

Emri der\ë e formon shumësin duke zbërthyer zanoren **e** në togun zanor **ye**, p.sh.: “dyvert e ferri, tha kriscti n’ungniill” (Doctrina: 37); “dyvert e tija jan ciaart” (Vakinat: 140).

Ndërsa emri dor\ë zanoren **o** në shumësi e zbërthen në togun zanor **ue**, p.sh.: “me i la duert e veta n’gjak t’tii” (Doctrina: 19); “nuk munn ju pscto duerve tuja” (Vakinat: 142).

Tek Ëngjëll Radoja gjejmë edhe rastin tjetër kur tek fjala dorë nuk kemi zbërthimin e zanores **o** në **ue**, por në **u**, si: “jan porsi dyy duur” (Doctrina: 54).

Mes të tjerave, na u duk e rastit këtu të veçojmë trajtën e shumësit të emrit grua që formohet me mbledhjen e togut zanor **ua** në **a**, formë si e mbarë shqipes, por që nga ana grafike shënohet me dyfishimin e zanores **a**: “parsia tieter si ghraat” (Vakinat: 145); “e ghraat e dielmve tuu” (Vakinat: 15).

Përfundime

Në këtë studim u përpoqëm të trajtojmë dhe të pasqyrojmë çështje të sistemit emëror, konkretisht të formimit të shumësit të emrave në veprat *Dotrina e kerscten* dhe *Vakinat e t’ligs herscme e t’ligs ree* të dy shkrimtarëve shkodranë të shekullit të nëntëmbëdhjetë Ëngjëll Radoja dhe Pashko Babi. Duke i shqyrtuar këta emra për nga formimi i shumësit të tyre del se:

1. Në këto dy vepra ndeshim një shumëllojshmëri përdorimi të formave të shumësive të emrave. Më prodhimtar listohet shumësi me prapashtesat **-a** dhe **-e**, por pa anashkaluar rastet e tjera të formimit të shumësit të këtyre emrave.
 2. dallohen raste kur autorët i janë shmangur ligjërit të sotëm të gjuhës shqipe.
 3. Dallojmë shumë emrave që nga përdorimi i tyre i kanë rezistuar kohës në ruajtjen e trajtave geqe.
 4. Një vëmendje iu kushtua në këtë punim edhe formave të parregullta të shumësit.
- Këto vepra përbëjnë pasurinë e çmuar të shkrimeve geqe. *Pa dyshim ky prodhim verior është më i rëndësishmi i prodhimeve të letratyrës shqipe, si nga pikëpamja e sasisë dhe gjërësisë si dhe nga pikëpamja e lëndës dhe mbrendësisë.* Këta autorë tregojnë pikëpamjet e tyre prej intelektualësh duke realizuar një komunikim me lexuesin e gjuhës shqipe e në veçanti në dialektin gegë.

Bibliografi

AGALLIU, Fatmir (1969), Emra që përdoren vetëm në shumësi në gjuhën shqipe: *Studime filologjike*, nr. 2, Tiranë, f.

AJETI, Idriz (1969), *Historia e gjuhës shqipe*, Prishtinë.

ÇABEJ, Eqrem (1967), *Shumësi i singularizuar në gjuhën shqipe*, Tiranë.

CIPO, Kostaq (1949), *Gramatika shqipe*, Tiranë.

DEMIRAJ, Shaban (1971), *Morfologjia historike e gjuhës shqipe*. Pjesa e I, Tiranë.

RESSULI, Namik (red. 1941), *Shkrimtarë shqiptarë 1*, Tiranë..

LINGUISTIC PERSPECTIVES IN THE PETRO MARKO'S PROSE

KËNDVËSHTRIME GJUHËSORE NË PROZËN E PETRO MARKOS

GRETA JANI

Universiteti "Aleksandër Mojsiu", Durrës, Shqipëri

greta_jani@yahoo.com

AKTET VII, 4: 298 - 302, 2014

PËRMBLEDHJE

Në këtë punim do të jenë në fokus disa dukuri gjuhësore që kemi vënë re në prozat e Petro Markos, "Nata e Ustikës", "Hasta la vista", "Qyteti i fundit" dhe "Retë dhe Gurët". Gjuha e këtij autori karakterizohet nga fjalë e shprehje që i përkasin të gjitha shtresave leksikore, ndaj na është dukur me interes të studiojmë atë shtresë leksikore me burim të kufizuar që duket se i jep edhe bukuri e hijeshi veprës. Dialektalizmat, krahinorizmat, arkaizmat, historizmat, neologjizmat janë disa dukuri gjuhësore që së bashku me shembujt e vjelë nga veprat konkrete përbejnë pjesën kryesore të punimit tonë.

Fjalët çelës: dialektalizmat, krahinorizmat, arkaizmat, historizmat, neologjizmat.

SUMMARY

Some linguistic phenomena seen at Petro Marko's work, "Nata e Ustikës", "Hasta la vista", "Qyteti i fundit" and "Retë dhe Gurët", will be on the focus in this work. The Language of this author is characterized by words and phrases which belong to all lexical classes, so it seems more interesting to study that lexical class with limited resource which appears to transmit elegance and beauty of the work. Colloquialism, slangs, archaizms, historizmat, neologisms are some linguistic phenomena, along with all collected examples by concrete actions constitute the main part of our work.

Key words: Colloquialism, slangs, archaizms, historizmat, neologisms.

Hyrje

Synimi i parë i madh i çdo shkrimtari kur shkruan një vepër letrare është bukuria e gjuhës, gjetja e fjalëve më të përshtatshme, e figurave më prekëse dhe më të vlefshme për përshkrimin e mjedisëve ose për karakterizimin e personazheve (Shkurtaaj 2008: 171).

Një synim të tillë duhet të ketë pasur edhe shkrimtari Petro Marko, kur shkruante prozat e tij, që bashkë me tematikën, përmes një gjuhe të bukur e të pasur, të na bënte të ndjenim dhe "erën" e krahinës së tij. Kurdoherë autori përpiqet që, nëpërmjet organizimit gjuhësor e stilistik, të japë një përshtypje, një atmosferë, një përjetim, të sugjestionojë një botë letrare dhe të arrijë një efekt (Lloshi 2005: 242).

Por, kur studion prozën e Petro Markos nuk mund të qëndrosh indiferent ndaj disa dukurive gjuhësore që hasen jo rrallë në veprat e tij, të cilat kemi menduar t'i bëjmë edhe objekt studimi të këtij punimi, pasi theksojmë se gjuha për autorin nuk ishte një mjet i gatshëm i marrëveshjes midis njerëzve, por një kod që ofron mundësi të mëdha shprehëse e krijuese, si dhe tregues i një aftësie për të përdorur mjeshtërisht të gjitha shtresat e leksikut, veçanërisht atë me burim të kufizuar.

Dialekti është gjuha e një krahine, rajoni apo qyteti në krahasim me gjuhën e përbashkët të mbarë kombit (Shkurtaaj 2003:38). Në veprat letrare të shkrimtarëve të letërsisë artistike jo rrallëherë përdoren dialektalizma për qëllime

stilistike. Burimet e leksikut dialektor për shkrimtarin janë të shumta; në radhë të parë ligjërimi i vet dialektor, pastaj hulumtimet vetjake në ligjërimet popullore, leximet e folklorit, fjalorët krahinorë e burime të tjera të bollshme (Thomai 1992:138).

Gjatë leximit të kujdesshëm të veprës së Petro Markos gjejmë lëndë të pasur gjuhësore popullore dialektore që, më së shumti e takojmë në gjuhën e autorit, p.sh.: *musëndër, tërkuzë, shoshë, cipal etj.*, por edhe në atë të personazheve, p.sh.: *në daç, paç uratën, kaur i qenit, derëbardhë etj.*

Shtresat e fjalëve dialektore e krahinore të Petro Markos

Raporti i përdorimit të dialektalizmave shkon drejt ligjërimin të autorit, por kjo nuk do të thotë aspak se ligjërimi i tij është dialektor. Në të dyja këto lloj ligjërimesh gjejmë dialektalizma dhe krahinorizma të njëjtë. Kjo me vetëdije i ka shërbyer Petro Markos të ofrojë ligjërimin e tij me atë të personazheve. E sigurisht, në këtë përpjekje për t'ia arritur këtij synimi futen në punë edhe dialektalizmat leksikore.

Shtresa e fjalëve dialektore dhe krahinore në gjuhën e veprës së Petro Markos dallon dy grupe të gjera:

a) fjalë dialektore e krahinore që kanë forcë tipizuese për personazhet a mjediset dhe që përdoren me këtë qëllim nga autori.

b) fjalë dialektore e krahinore që i kanë kapërcyer kufijtë dhe kanë hyrë në përdorim në gjuhën letrare, d.m.th. që sjellin nuanca kuptimore, emocionuese, stilistike plotësuese dhe kështu, e kanë humbur forcën tipizuese në letërsinë artistike (Islamaj 2000: 104).

Petro Marko ka marrë nga ligjërimi popullor dhe ka përdorur fjalë të parme dhe jo të parme, të panjohura ose pak të njohura. Në tërësinë e fjalëve të parme të huazuara prej ligjërimin popullor përmendim: *bretku, çorbë, tërkuzë, kolibe, pullaz, çanak, sebeb, qepshe, thile, ushkur, kotruve, gjurulldi etj.*

Në grupin e fjalëve jo të parme përmendim ato të formuara me mjete fjalëformuese me prejardhje dialektore dhe krahinore, që sot shfrytëzohen

nga gjuha letrare, p.sh. prapashtesat: -ës, -it, -th, -nik, -ar, -o, -is, -os etj. në fjalët *rrufit, vërsnik, gërnjar, brambullon, sikteris, kullandris etj.*

Marko shfrytëzon gjedhet fjalëformuese popullore, duke zgjeruar e rritur vargjet fjalëformuese të tipit: *bukëfije, vulëhumbur, fatzi, ogurzi, gjunjëprerë, sybardhë, syrrëmbushur, etj.*

Sinonimia si mjet i ligjërimin emocional

Sinonimia dialektore te autori është një nga burimet e tjera të pasurimit të leksikut të shqipes. Kemi parasysh këtu ato fjalë (dhe jo trajta e variante dialektore fjalësh), të cilat ruhen e përdoren ende nga folësit e një dialekti dhe që duke u përqsasur me fjalët e gjuhës letrare që shprehin të njëjtin nocion, krijojnë me to çifte sinonimike.

Në gjuhën e prozës së autorit gjen fjalë që kanë zënë vend në gjuhën e sotme letrare shqipe, si: *brambullinte (zjarri), mërdhija, shtrojë, sinor, marifet etj.*, por interes më të madh paraqesin ato fjalë dialektore të cilat pasurojnë gjuhën e sotme në planin kuptimor a të ngarkesave stilistike.

Në planin emocional ajo që i dallon disa fjalë dialektore a krahinore nga sinonimet e tyre në gjuhën letrare, është ngjyrimi i veçantë shprehës-emocional ose stilistik i tyre, si p.sh.: i **pataksur** në krahasim me *i trembur, qyfyre* në krahasim me *shaka, mërzej* në krahasim me *rri, honeps* në krahasim me *duroj, pëlqej etj.* Në këto raste fjala dialektore, krahas kuptimit të saj të mirëfilltë, i shtohet dhe ngjyrimi stilistik, shpesh nuancë tallëse, përbuzëse apo ndonjë nuancë kuptimi më e përpiktë.

Rrallë ndeshim edhe ndonjë fjalë dialektore me përhapje të kufizuar ose me burim të huaj (apo arkaizma), që nuk sjellin gjë të re në pasurimin dhe përsosjen e leksikut të gjuhës letrare, si: *xhelepe (taksa), sadaka (falas).*

Togfjalëshat në funksion të karakterizimit të personazheve

Prurje leksikore dialektore Marko ka sjellë edhe në fushën e togfjalëshave, p.sh: *shtëpi-kolibe,*

fliste kuturu, bënin dava, i rridhnin çurg, pllakë-shkëmb, dallgë-oshëtimë, tym-jetë, shtëpitë-burg, etj.

Në frazeologjitë e tij mbizotërojnë ato që vlerësojnë emocionalisht nocione, cilësi, veprime. Petro Marko nëpërmjet frazeologjisë do të na japë nuanca të mendimeve dhe ndjenjave, duke dhënë artistikisht personazhe dhe mjedise të realizuara, si: *lë kockat, do e hash si frëngu pulën, kaloi në satër, u bëmë kashtë e koqe, i ra bretku etj.*

Në tërësinë e frazeologjizmave të qëmtuara në veprën e tij gjejmë nga ato që nuk kanë tregues dialektorë, si: *na mbante shpirtin, shumë lart e vret, më merr në qafë, lë kockat, lexoj mendjen, si frëngu pulën etj.*, gjejmë gjithashtu njësi me burim dialektor a krahinor që janë bërë pronë e shqipes, si: *ecnin me një komb në fyt, ju shpëlaftë mortja, kaloi në satër, shqep në dru, kyç gojën etj.* Fjalë dialektore të përdorimit të përditshëm vijnë në veprat e Markos për të sjellë më pranë vendlindjen, si: *molloiste, ujdishur, kaptoni, kamarja, kurdis, perusti, vathi, pataksur, velencë, bukëfiqe, mëngjër (i) mb. – i majtë, tat/ë ~a – babai, , gjalm-i (fill i trashë), çoç (diçka) etj.*

E gjithë kjo lëndë dialektore është burim pasurimi për leksikun poetik të shqipes.

Arkaizmat shprehje atmosferës historike

Jeta mes njerëzve të bregut i ka ofruar shumë pasuri gjuhësore autorit, larmi e gërshetim të shtresave të ndryshme të ligjërimit: nga të folmet që bëjnë bazën e standartit gjuhësor e deri te ligjërimit me mjaft dialektalizma e arkaizma karakteristike për këtë zonë.

Arkaizmat zënë një vend me rëndësi në romanet e Petro Markos. Ato janë arkaizma të mirëfilltë, d.m.th. fjalë, kuptime fjalësh e ndërtime frazash të moçme, që kanë gjegjëset e tyre në gjuhën letrare, dhe një numër i caktuar arkaizmash që shënojnë nocione, sende e dukuri të së kaluarës, të rëndësishme për kohën e kaluar, që sot nuk përdoren por që njihen me emrin historizma ose arkaizma historikë.

Arkaizmat historikë janë më të shumtët në veprën e Markos. Meqë ngjarjet e romaneve dhe të tregimeve të tij janë ngjarje të një kohe të

kaluar, autori ka qenë i detyruar të përdorë shumë fjalë të lidhura ngushtë me historinë konkrete, me objektet, sendet, nocionet, dukuritë, shpesh të tejkaluara, por që emërtimet e tyre paraqesin një shtresë të rëndësishme leksikore me përdorim të caktuar artistik (Islamaj 2000: 127). Disa nga ato ende jetojnë në fjalorin veprues të gjuhës. Historizmat më të numërt që ndeshim këtu janë fjalë të leksikut të përgjithshëm, p.sh: *kryepiak, xhandar, nizam, bej etj.*

Dihet që efekti shprehës i arkaizmave varet nga filli i fjalëve të tjera në kontekst. Me arkaizmat Marko krijon përftesa të larmishme veçanërisht në dialogët dhe përshkrimin e mjedisit dhe atmosferës historike. P. sh.: *Të gjithë më dukeshin si pleq të fishkur, si pleq me oftikë. Po shyqyr që na erdhe gjallë!* Arkaizma të tjerë: *Xhebrail, rezil, syfetin, helbete, meazallah, (prej) ndrilloje, qepshe, pallavrat, tutkë etj.*

Të shumtë na dalin arkaizmat historikë që kanë të bëjnë me fenë. Autori njeh mirë këtë shtresë leksikore dhe ofron një numër të konsiderueshëm të këtij leksiku, që lidhet me veshjen, me pajisjet për detyrimet fetare, me ritet, p.sh: *prokopi, fqelon, psallte, dolloma, azreti etj.*

Me interes të veçantë janë historizmat që emërtojnë nocione, dukuri e sende nga fusha e etnografisë. Marko i bën një shërbim të mirë etnografisë shqiptare dhe leksikut të kësaj fushe. Disa nga etnografizma të Markos jetojnë edhe sot (emërtime gatesash, veshjesh, emërtimet e parave, mjeshtërive, zakoneve etj., p.sh: *napoleon, rixha, nanuris, qilar, veresie, hallexhi, tram, kërrellë, qereste, qylaf, tirqe, tespe, bandill, etj.*

Arkaizmat dhe historizmat e Markos përdoren me kuptim asnjëanës dhe me kuptim të prejardhur e me ngarkesa stilistike.

Neologjizmat kuptimorë stilistik

Edhe në fushën e krijimtarisë gjuhësore Marko ka dhënë një ndihmesë të madhe, më konkretisht në krijimin e neologjizmave kuptimorë, po sidomos të atyre stilistikë.

Natyrisht, krijimi i këtyre neologjizmave nuk mbështetet vetëm në mundësitë e favorshme që ofron shqipja në këtë rrafsh, po edhe në aftësinë krijuese të vetë Markos, në këmbënguljen e tij të vazhdueshme që ta bëjë këtë gjithësesi, gjë që dëshmohet më së miri në gjithë punën e tij, me gjuhën dhe stilin e tij. Duke qenë njohës i mirë i gjuhës së gjallë, i gjuhës popullore, i dialekteve, i ligjërimeve të saj e i stilit, ai zbulon vlera të plota e të gjithanshme të fjalës shqipe, duke mos i trajtuar të shkëputura, por gjithnjë në përdorimet e mundshme, në kontekstet e ngushta e të gjera, në leksematikën e saj e në lidhjet e shumta sintagmatike të njohura e të krijuara nga ai vetë ose të rigjallëruara. Me neologjizmat ai dëshmoi se një mirë të gjitha vlerat e fjalës.

Duke marrë për bazë vlerën fjalëformuese të njërive leksikore, ai krijoi një varg fjalësh të reja me të cilat, shtoi ndjeshëm fondin e fjalësit të shqipes duke zgjeruar edhe strukturën kuptimore të këtij leksiku.

Në këtë punë dobiprurëse të shumëfishtë ai ka ndjekur këto rrugë: ka krijuar fjalë e shprehje të reja me brumin e shqipes, duke marrë si mbështetje dhe si gjedhe ndërtimet ekzistuese e të qëndrueshme, që nuk dalin nga sistemi fjalëkrijues standard (me pak përjashtime të disa krijime rastësore për motive e qëllime artistike). Më të qëlluarat janë ato me dy tema fjalësh (fjalët e përbëra), por nuk janë as të pakta e as më pak pasuruese edhe formimet me parashtesa e me prapashtesa, që njihen më prodhimtaret edhe në shqipen e sotme.

Më poshtë po paraqesim një pjesë të neologjizmave që kemi vjelë në prozën e Markos.

a) Neologjizma me parashtesë:

anti-: antifashistë;; **mos-:** mosbesimi, mospërfilës, mosbesim;;

inter-: interbrigadist, internacionale;; **alla-:** allapartizance, allafashiste;

për-: përkundruall, përshkënditnin, përzemërsisht, përditë, përdridhej, përnjëherë;

rrë-: rrëmbush; **kundër:** kundërsulmonin, **vër-:** vërsulën.

sh-: shpalos, shfarosja; **z-:** zbytheshin; **zh-:** zhvidhosur; **s-:** sforcuar; **ç-:** çrregullt;;

b) Neologjizma me prapashtesë:

- **an:** zeshkan, llafazan; -**ac:** dorac; -**as:** barkas, bregas, dhërmijas, ballkanas;

- **arak:** shtazarak, qesharake; -**acak:** frikakakët; -**jat:** korfjat; -**jot:** korfjat, himarjot;

- **ëse:** prekëse; -**ese:** ngulmuese; -**im:** gagarelim, vëllazërim, profetizim;

- **(ë) z, - z(ë):** kullëzës, gjuhëz, pakëz, copëz, mëshqerëzë etj.; -**ërin:** bredhërin;

- **ian:** pirandelian, milician; -**ake:** hollake; -**aman:** leckamanësh;

- **inë:** kuesturinë; -**atare:** gjakatare, shakatare;

- **kë:** shejtankë, shqiptarkë; -**ist:** anarkist, tankist, frankist; -**nik:** thatanik;

- **lli:** mustaqelli; -**llëk:** bollëk njerëzillëk; -**çk(ë):** dashuriçkë; -**çi:** bataçki;

- **on:** shkëndijon, trumbeton, pulson; -**os:** gagarellos, përrallos, plumbos;

- **ore:** gërxhore, shkëmbore, mëngjesore;

- **osh, -oshe:** djaloshi, bukurosh, gjatoshi;

- **oz:** glorioz, -**o:** dimëro, -**t:** të rrumbullt etj.

- **reshë:** burrëreshë; -**thi:** mëmëdhethi; -**xhinj:** breshkaxhinj, hallexhinj,

- **uço, -ko:** Andreuço, Martinko etj.; -**ush, -ushe:** ëngjëllushin;

Duhet të theksohet se Marko parapëlqen formimet me prapashtesat zvogëluese e më të shpeshtat janë me -z, -zë, -th.

c) Neologjizma-kompozita

Këto janë fjalëkrijime origjinale të Markos që bëhen tipar dallues i stilit gjuhësor të autorit (Thomai 1992: 95).

Edhe pse përskrimet e Markos nuk janë shumë të gjata, ai e shikon me vend përdorimin e njëfjalëzimit që sipas tij e bën më të saktë, më të hollësishëm e më emocional, si: *syrrëmbushur, shkumëreja, kokërruar, llërëpërveshur, shpirtkatran, vijëzjarri etj.*

Disa prej këtyre neologjizmave-kompozita i takojnë shtresës abstrakte, sidomos nga bota shpirtërore dhe e marrëdhënieve të ndryshme. Ato janë njëfjalëshe që shënojnë tipare e veprime, nuanca të holla të mendimeve e ngjyimeve të ndryshme. Përdorimi i tyre bëhet me larmi të madhe semantike. Shumë nga ato lidhen me tiparet fizike e morale të njeriut dhe janë krijuar sipas gjedheve të njohura të krijimeve popullore, si: *sahanlëpirës, cipëplasuri,*

kokërruar, kokëvaisur, turiderr, syzi, vetullzi, flokëzi etj.

Këto krijime e zgjerojnë shumë këtë klasë semantiko-leksikore, gjë që dëshmon për pasurimin me njësi e gjedhe të gjuhës shqipe nga ana e Markos. Më të shpeshtat neologjizma të Markos janë:

- **emri i pjesës së trupit + mbiemri:** *kokërruar, kokëvajsur, dorargjend, flokëzi etj.*

- **emër i pjesës së trupit + emër i një sendi që ka një tipar dallues:** *shpirtkatran, sykau, kokë-shkëmb, zemërzjarr etj.*

- **emri i pjesës së trupit + mbiemër që shënon tipar të figurshëm të kësaj pjese të trupit:** *zemërtartë, zemërvrarë, zemërnxira, barkderr etj.*

- **emër nocioni, dukurie e objekti + mbiemër:** *këmishëçjerrë, këmishëzinj, derëbardhë, zemërnxirë etj.*

Shumica e këtyre neologjizmave kanë ngjyrimë emocionale të larmishme e të theksuara, si dhe shprehësi të lartë.

Përfundim

Si përfundim, theksojmë se Petro Marko solli prurje të reja në normën e njësuar letrare, duke

harmonizuar në të dialektoren dhe krahinoren. Ai tregoi se gjuha shqipe ka mundësi të mëdha shprehëse, se ajo mund të ofrojë trull të pasur për paraqitjen e gjithë asaj lënde me të cilën autori ishte mëkuar në vite. Shtresa e leksikut me burim të kufizuar, e qëmtuar dhe e lëvruar me shumë stil nga Petro Marko, i ka krijuar atij mundësi të pakufizuara për të përshkruar e sjellë para syve tanë tablo reale, sa rrënqethëse aq edhe shpresëdhënëse, për të përcjellë ndjesi që emocionojnë e befasojnë lexuesin e çdo kohe.

Bibliografi

ISLAMAJ, Shefkije (2000), *Gjuha e Jakov Xoxës*, Prishtinë.

LLOSHI, Xhevat (2005), *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Tiranë.

SHKURTAJ, Gjovalin (2008), *Si të shkruajmë shqip*, Tiranë.

SHKURTAJ, Gjovalin (2003), *Dialektologjia*, Tiranë.

THOMAI, Jani (1992), *Teksti dhe gjuha*, Tiranë.

THOMAI, Jani (1992), *Teksti dhe gjuha*, Tiranë.

THE STRUCTURE OF TAG QUESTIONS IN ENGLISH AND ALBANIAN LANGUAGE

STRUKTURA E FJALIVE PYETËSE TË PAGJYMTYRËZUESHME NË GJUHËN ANGLEZE E SHQIPE

ETLEVA KONI

Departamenti i Gjuhës Angleze, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës, Tiranë, SHQIPËRI
Email: eekondi@yahoo.com

AKTET VII, 4: 303-308, 2013

PËRMBLEDHJE

Në qendër të këtij punimi është analiza sintaksore e fjalive pyetëse të pagjymtyrëzueshme në gjuhën angleze e shqipe, duke e vënë theksin veçanërisht në strukturën sintaksore të këtyre fjalive, parë brenda kuadrit të qasjes 'parime dhe parametra', që do të thotë nxjerrjes në pah të elementëve përbërës të këtyre fjalive dhe lidhjes që ekziston midis tyre. Çështjet e parashtruara, lidhur me strukturën e fjalisë i ofrojnë lexuesit dhe atyre të cilët janë të interesuar, në këtë fushë njohuri mbi llojet më tipike strukturore të këtyre fjalive në të dyja gjuhët. Duke i pranëvënë dhe krahasuar këto njësi do të hidhet dritë mbi drejtimet kryesore të ngjashmërive, tipareve universale dhe dasive, të veçantat lidhur me tipet ndërtimore të këtyre fjalive pyetëse.

Fjalët çelës: pyetëse të pagjymtyrëzueshme, intonacioni, strukturë, flektive.

SUMMARY

This paper is a comparative study of the syntax of tag questions in English and Albanian language, focusing mainly on the word order of these questions within the Principles and Parameters framework. As a general theme, the paper is mostly concerned with the question of the composition of the clause, i.e. what kind of components the clause is made up of, and how these components are put together in the clause. The questions raised concerning the structure of the clause provide the reader and those who are interested in this field with good knowledge about the most typical structural types of tag questions in English and Albanian. In other words, by juxtaposing and comparing these units we aim at pointing out the common or universal features as well as the unique character of each language in the formation of the tag questions.

Key words: tag questions, inflective, intonation, structure.

Introduction

Being a further type of yes/no interrogative sentences in English, tag questions consist of an auxiliary verb + a pronoun (with or without a negative particle). Appended to a statement, they have the word order of a yes/no question and have a positive or negative orientation. While in Albanian language this kind of interrogative sentence comes with the phrase 'apo jo', which can be appended to a statement (in this case we obtain an incomplete interrogative sentence), or

it can be separated from the proceeding statement. In both languages, this kind of question elicits an answer, invites the hearer to decide the truth of proposition of the statement, and it can even express speaker's surprise, disbelief, disappointment or annoyance [4].

In contrast to the Albanian language, this kind of interrogative sentence in English has a specific structure, depending on the structure of the statement appended to. In Albanian language, it has the structure of an incomplete sentence called 'fjali e pagjymtyrëzueshme' implying a

sentence consisting of an inseparable word or a group of words which can neither be analyzed as syntactic elements nor be expanded ë4].

Public killings have an intoxicating horror about them, **don't they?**

Seç ka një farë dalldie të ethshme në ekzekutimet publike, **apo jo?**

You're serious, **aren't you?**

Nuk është se po bën shaka, **apo jo?**

("Angels and Demons")

Tag questions in English and Albanian are widely used in spoken language. They are mainly found in dialogues, in the answer, and monologues to ask for confirmation, negation or even to express disbelief toward speaker's proposition. In written language, we mainly find them in fiction ë4]. Based on the corpus used in this article, in English and Albanian language, we have:

Table 1. Use of tag questions

1. Written language		
Source	Corpus of the words	Number of the tag questions
Romani "Death in Holy Orders"	981045	66
Novel "Tess of the d'Uberville"	142100	13
Novel "Angels and Demons"	123800	22
4 scientific magazines in English	213920	1
Novel "Engjëj dhe djaj"	1634476	50
2 scientific magazines in Albanian	68088	0
Novel 'E penguara'	52824	6
2. Spoken language		
Source	Corpus of the words	Number of the tag questions
5 magazines "OK"	121500	14
film "Billy Elliot"	6490	8
film "East is East"	10285	3
film "West Wing"	9020	6
film "Romance on the Orient Express"	4730	9
Magazine 'Jeta'	19800	1
Magazine 'Shqip'	19760	1
Magazine "Klan"	8900	0

ANALYSIS OF THE STRUCTURE OF THE TAG QUESTIONS

The operator in tag questions in English is generally the same as the operator in the preceding statement, i.e. the operator we choose is determined by the structure of the verb phrase in the statement.

The trees have inquisitive eyes, *haven't they?*
Pemët kanë sy kureshtar, *apo jo?*

You will like going, *will you not?*
Do të të pëlqejë të shkosh, *apo jo?*
("Tess of the d'Ubervilles")

If the statement has no operator, the dummy auxiliary 'do' is used, as for yes-no questions in general ë12]:

You went to the races with John, *didn't you?*
Shkove me Xhonin për të parë garat, *apo jo?*
("OK")

The subject should definitely be a pronoun which either repeats, or is in coreference with the subject of the statement, agreeing with it in number, person, and gender ë12].

- ë1] Henry puzzles me, *doesn't he?*
ë2] Death seems to follow you about, *doesn't it?*
ë3] Other people's lives are so mysterious, *aren't they?*
("Death in Holy Orders")
ë4] She'll be here tomorrow, *won't she?*
("Romance on the Orient Express")

In the examples ë1] and ë4] the subject of the tag questions agrees with the subject of the statement in number, person and gender, while in the examples ë2] and ë3] they agree in number and person.

The tag question can be positive or negative. This is determined by the statement. If the statement is positive, the tag question is generally negative, and vice versa, if the statement is negative, the tag question is positive. The intonation of the tag question occurs on the auxiliary, and it is either rising or falling. Respectively, we have:

positive statement + negative tag (rising/falling intonation)

negative statement + positive tag (rising/falling intonation)

Whether it is a positive or negative tag in English, in Albanian the tag questions are given with the phrase '*apo jo*' which is not determined by the statement and it is the one on which the intonation occurs. In Albanian, the phrase has the illocutionary force of an inquiry. Very often it has an emphatic role. It emphasizes some proposition in the statement. Similar to English, this phrase can also have a rising or falling intonation.

In both languages, English and Albanian, the tag questions with a falling intonation ask for the confirmation of the proposition in the statement. In this aspect, they resemble exclamatory sentences rather than questions. Syntactically, they are interrogatives but semantically exclamations. They are exclamatory questions with a falling intonation ë4].

Exclamatory question

In English language

Wasn't she angry!
Wouldn't it be risky!

It'd be risky, wouldn't it?
("Death in Holy Orders")

Tag question

She was angry, *wasn't she?*

In Albanina language

Unë të di?!

Ngjitej dashuria si lëngata?! Ngjitej dashuria si lëngata,

hë?

E çuditshme?!
jo?
("E penguara")

E çuditshme, apo

The tone that occurs in an exclamatory question in Albanian is exclamatory and falling. These questions mostly describe the feelings or the emotional attitude of the speaker rather than merely expect an answer to the question. The tone of the tag question is similar to the one that characterizes the questions, falling or rising. They invite the hearer to decide the truth of the

proposition ë4]. Clearly these sentences have a positive and negative orientation.

The exclamatory tag questions in English or Albanian can be incomplete. They usually lack the verb phrase.

What a nerve-racking thing, isn't it?

Sa gjë acaruese!

A bit foolhardy, wouldn't it be?

Paksa budallallëk!

Bit of funny idea of Sir Alred's, isn't it?

Paksa ide qesharake, ideja e zotit Arled!

("Billy Eliot")

In English, there is a less common type of tag question. It consists of a positive statement and a positive tag.

That's the question, is it?

Kjo është pyetje, apo jo?

("Tess of the d'Ubervilles")

You were accused of being anorexic. Were you?

Akuzohesh se je anoreksike, apo jo?

("OK")

The tag has a rising intonation and the statement is mostly preceded by the interjection 'oh' or the particle 'so', indicating that the speaker has come to a conclusion. The tone may sometimes be one of the sarcastic suspicions ë12]:

Oh, that's the question, is it?

Ou, kjo na qenka pyetje?!

So you can go from your word like that, you young witch, can you?

Pra, ti shtrigë e vogël mund të na dalësh nga fjala kështu?!

("Tess of the d'Ubervilles")

We can use the interjections and the particles even in the Albanian language for the same reason and with same kind of intonation. Like for example, *hë, ashtu/ ashtu ë/ vërtet (really), çë (what) etc.*

Ou, kjo na qenka pyetje?!

In this case, the hearer makes use of the irony to indicate that the question directed by the speaker is not the one he expected.

A negative tag question in English or Albanian language can be used as an answer to some previous proposition expressing agreement. But, if we use rising intonation, we express surprise and contradict what has been previously said.

Their daughter is very clever.

Vajza e tyre është e zgjuar.

A. *(Yes) isn't she? ël agree.]*

(Po) a nuk është?

A. *Their daughter is very clever.*

Vajza e tyre është e zgjuar.

B. *Isn't she? ël thought she was.]*

Nuk është?

Tag questions in English can be also appended to imperative sentences where they invite the listener's consent. The auxiliary in the tag question is usually 'won't' for the negative and 'will' for the positive. The subject is usually 'you' ë12]:

Fuck off, will you?

Do ikësh, apo jo? ("Billy Eliot")

Walk normally, will you?

Do ecësh mirë ti, apo jo?

("Tess of the d'Ubervilles")

But, we can find these tag questions in English even with other auxiliary verbs or subjects.

Open the door, can't you?

Nuk mund ta hapësh derën?

Hand me a knife, won't somebody?

Nuk do të më japë dikush një thikë?

("A comprehensive grammar of the English language")

In Albanian language, this structure of the tag question expresses 'soft' order. This means that the tag question is used as a softener of the

imperative. Similar to English, they are mostly encountered in the spoken language.

First person plural imperatives may take 'shall we' as a tag question.

Let's play another game, shall we?

Le të bëjmë një lojë tjetër.

Let's not discuss it now, shall we?

Le të mos e diskutojmë tani.

In English the sentence structure beginning with the phrase 'let's' (*le të*) is an imperative, while in Albanian they are 'fjali nxitëse' (incentive sentences). They mostly express a request toward the hearer [5]. Regardless the way we call them in English or Albanian, these sentences serve to encourage the speaker to propose something or invite the hearer to do something. Thus, the verb can also be in the first person plural. These kinds of questions are not widely used in English and we mostly encounter them in the spoken language.

Some tag questions can be appended to statement or exclamation. Their form does not depend on the polarity of the statement. They have the same form and take a rising intonation.

You don't know what I'm talking about, **am I right?** / isn't **that so?** / **don't you think?**

Nue di se për çfarë po flas, nuk është kështu?

But you have your indoor fears – **eh?**

Ti ke frikë të rrish brenda, hə?

You've got my address. **Yeah?**

Ti e ke adresën time. Po?

("East is East")

We mostly encounter them in films, spoken language. They are often encountered even in Albanian language but as incomplete or expressed even by only one particle. In both languages they are used for the same purpose, to invite the hearer to decide for the truth of some proposition [5].

Ashtu?

A?

Mirë?

("E Penguara")

Conclusion

All the evidence we brought here concerning the structure of the tag questions, in both English and Albanian language, serve to prove that despite the differences they have in form they have striking similarities in discourse functions. Being a characteristic of spoken language in both, English and Albanian, tag questions cannot be analyzed in isolation. They usually follow one or some sentences made of syntactic elements and are associated to them through content. The missing elements are explained through the situation. Thus, we can say that tag questions are strongly related to the context.

Bibliography

1. Burton, N (1997), *Analysing sentences. An introduction to English Syntax*, Longman, p. 219-249.
2. Carter R, McCarthy M (1997), *Exploring spoken English*, Oxford University Press, p. 30-64.
3. Chomsky, N (1972), *Aspects of the theory of syntax*, Cambridge, Massachusetts
4. Çeliku M, Domi M, Floqi S, Mansaku S, Pernaska R, Prifti S, Totoni M (2002), *Gramatika e Gjuhës Shqipe*, vëllimi II, p. 136.
5. Çeliku M, Karapinjalli M, Stringa R (2007), *Gramatika praktike e gjuhës shqipe*, Ilar, p. 375-400.
6. Çeliku M (2012), *Sintaksë e gjuhës shqipe (Përbërësit sintaksorë)*, Ilar.
7. Embick D, Noyer R (2001), *Movement operations after Syntax*, Linguistic Inquiry 32, p. 555-595.
8. Haegman L (1997), *Elements of Grammar*, Kluwer Academic Publishers, Dordrecht/Boston/London.
9. Leech G, (1988), *An A- Z of English Grammar and Usage*, Nelson, p. 527-547.
10. Leech G, Deucher M, Hoogenraad R (1982), *English Grammar for today*, Macmillan, p. 3-182
11. Leech G, Starvik J (1991), *A communicative grammar of English*, Longman, p. 232-237.

12. Quirk, R., Greenbaum, S., Leech, G., Starvik, J., (1985), *A comprehensive grammar of the English language*, Longman, p. 806-827.
13. James, P.D. (2001), *Death in Holy Orders*, (novel), Faber and Faber.
14. Hardy Thomas, (2000), *Tess of d'Urbervilles*, (novel) Wordsworth Classics.
15. Hardy Tomas, (2002), *Tesi i D'Erbervilëve*, (novel), Pegi.
16. Brown Dan, (2000), *Angels and Demons*, (novel), Corgi Books.
17. Brown Dan, (2000), *Engjëj dhe Djaj*, Dudaj.
18. Kadare Ismail, (2009), *E Penguara*, (novel), Onufri.
19. *Architecture Today*, 159, June 2005 (magazine).
20. *BBC Wildlife*, vol. 23, No.7, July 2005 (magazine).
21. *Ecologist*, June 2005 (magazine).
22. *Management today*, July 2005 (magazine).
23. Worhtington Jan, *Romance on the Orient Express*, British version, May 1998 (film).
24. *Billy Eliot* (film), *East is East* (film), *West Wing* (film.)
25. "OK", No 463, 5 April, 2005; "OK", No 464, 12 April, 2005; "OK", No 459, 8 March, 2005; "OK", No 466, 26 April, 2005; "OK", No 467, 3 May, 2005.
26. *Monitor*, weekly magazine, 21 March 2011, No 11 (471).
27. *Shqip*, monthly magazine, July 2011, No. 107. *Klan* (magazine), 8 July 2011, No.723..

KOLONIZIMI OSMAN NË SHEKUJT XIV- XVI

THE OTTOMAN COLONIZATION IN XIV – XVI CENTURIES

KLODIAN GJONI

Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare, Sarandë, SHQIPËRI

e-mail: klogdjoni@yahoo.com

AKTET VII, 4: 309 - 313, 2014

PERMBLEDHJE

Objekti i këtij studimi është Kolonizimi osman në shekujt XIV- XVI. Është synuar të evidentohen fillesat otomane me islamizmin e tyre. Kjo është realizuar përmes njohjes së tyre nga vijnë, historinë e tyre dhe arsyet se pse ata në fillim u bënë të domosdoshëm për perandorinë bizantine kur kaluan ngushticat dhe iu vërsulën Evropës Juglindore. Në këtë studim janë pasqyruar fillimet e inkursioneve osmane që shtinë në dorë Bujtininë, Brusën (1326), Nikenë (1331), Nikomedinë (1336 - 1337), deri dhe Galipojën (1354) në bregun evropian të Dardaneleve. Kjo ishte shtënia në dorë e ngushticave. Duke siguruar kontrollin e tyre, ata i hapën vetes portën për depërtimin në Evropën juglindore. Për të vijuar më tej me zgjerimin turk në Evropë në 1451- 1566 dhe për t'i shtrirë kufijtë e Perandorisë Osmane deri aty. I është kushtuar rëndësi kolonizimit osman në Bullgari, në Serbi, Hungari. Dhe për t'u trajtuar më gjerësisht kolonializmi në Shqipëri.

Fjalët çelës: kolonizimi, Perandoria Osmane, Perandoria Bizantine, kufij, Evropa.

SUMMARY

The object of this study is the Ottoman Colonization in XIV - XVI centuries. It is intended to identify the origins of Ottomans with their Islam. This is accomplished through recognition of their origin, their history and the reasons why they first became necessary for the Byzantine Empire when was attacked crossed the straits and Eastern Europe. In this study reflect the beginnings of Ottoman incursions took possession Bujtina, Brusa(1326), Nikea(1331), Nikomedia(1336-1337), and Galipoja (1354) on the European side of the Dardanelles. It was shooting up the straits. Ensuring their control, they opened the gate for their infiltration in Southeast Europe. To continue with Turkish expansion in Europe in 1451 - 1566 and to extend the boundaries of the Ottoman Empire up there. A special place in this study has the Ottoman colonialism in the Byzantine Empire. The importance is paid to the Ottoman colonization in Bulgaria, Serbia, Hungary. And more broadly the ottoman colonialism in Albania.

Key words: colonization, the Ottoman Empire, the Byzantine Empire, borders, Europe.

Hyrje

Duke iu referuar fjalorit të gjuhës së sotme shqipe kolonizimi ka të bëjë me një vend të pushtuar me forcë nga një shtet i huaj më i fuqishëm, që humbet pavarësinë për një kohë të gjatë dhe shtypet e shfrytëzohet prej tij në mënyrë të egër e të pamëshirshme. Ndërsa kolonializëm ësh të politika e sundimit, e shtypjes dhe e shfrytëzimit të kolonive nga ana e një shteti

më të fuqishëm (ASHRPSSH 1980: 850). Jemi të detyruar t'i njohim turqit nga vijnë, historinë e tyre, pse ata në fillim u bënë të domosdoshëm për perandorinë bizantine kur kaluan ngushticat dhe iu vërsulën Evropës Juglindore.

Fillesat otomane me islamizimin e tyre

Shumë kohë para se të kalonin në Evropë, të vendoseshin në gadishullin e Hemit (të cilin do ta

quanin Ballkan) dhe do të pushtonin Konstandinopojën (që do ta quanin Stamboll), turqit kishin kaluar nëpër një proces të gjatë evoluimi. Së paku tri qytetërime historike perse, arabe dhe bizantine kontribuan me prurjet e veta për të përgatitur sundimin e tyre të ardhshëm. Në strukturën e popullsisë së Ballkanit, ata zenë një vend të rëndësishëm. Sipas studimeve, turqit erdhën në Antalian e sotme nga Azia Qendrore në fillim të shek. XIII. Ata erdhën si fise nomade që u konvertuan në myslimanë. Turqit të quajtur Osmanë me emrin e liderit të fiseve të tyre të para, patën suksese të mëdha në ngujimet e tyre rreth kordonit të civilizimit islam dhe dëshmuan aftësi të rrallë për t'u shtrirë si pushtues në të gjithë rajonin midis Ballkanit dhe Azisë. Fillimisht Perandoria Bizantine i mori turqit si ushtarë, por me kohë e humbi kontrollin mbi to dhe jo vetëm kaq, por së shpejti ra nën kontrollin e tyre.

Kur Frederik Barbaroza me gjermanët e tij, vihej në rrugë drejt Bizantit pa e fshehur planin për të shtënë në dorë kurorën e Komnenëve, ai hyri në negociata me Sulltanin, por u befasua kur mori vesh që Bizanti e kish bërë para tij. Në shek. XII kur Bizanti u detyrua t'u kërkonte ndihmë myslimanëve për t'u mbrojtur nga armiqët e përbashkët kryqëtarë, grekët dhe turqit u mblodhën në të njëjtin kamp (Beldiceanu 2004: 26).

Në dhjetëvjeçarin e tretë të shek. XIII kur Perandoria Bizantine ishte e rënë dhe territoret e saj qenë ndarë mes latinëve, selgjuët përfituan për të marrë marshim drejt detit Egje. Një tjetër fis afrohet nga Azia qendrore drejt perëndimit, futej në Azinë e Vogël për t'u vënë në shërbim të Sulltanit të Konjës. Si shpërblim për shërbimet Sulltani i caktoi këtij fisi një territor të vogël jo larg Konstandinopojës. Për historinë e ardhme të Evropës do të dukej si një zgjidhje fatale (Tata 2005: 27- 29).

Inkursione osmane në Ballkan

Ballkani u pushtua nga Perandoria Osmane në fund të shek. XIV. Kjo gjymtyrë e Evropës, iu shkëput asaj në një periudhë 500 vjeçare. Në këtë realitet, popujt e Ballkanit i bënë qëndresë Perandorisë, por po aq e vërtetë është se ata u bënë

pjesë e Perandorisë. Pra pjesëtar në trofetë, bëmat dhe në krimet e saj.

Po të shikohet me vëmendje ngritja dhe përparimi i osmanëve në Evropën juglindore, islama më së shumti u dha osmanëve pretekset për të cilët ata kishin nevojë që të niseshin për pushtimet e botës së krishterë. Otomanët u futën në Evropë në vitin 1352 duke kaluar në pjesën perëndimore të ngushticës së Dardaneleve. Sulmuan Bullgarinë dhe Trakenë, pushtuan Serbinë dhe Shqipërinë Veriore pas rezistencës heroike të aleancës serbo – shqiptare në Fushë Kosovë më 1389. Serbia dhe Bullgaria u bënë vasale të osmanëve, të cilat e shtrinë kufirin deri në Danub. Osmanët iu për gjigjën me rreptësi një kryqëzate ballkanike, të organizuar prej perëndimorëve (Vate 2004: 45). Më 1453 turqit pushtuan Konstandinopojën me anë të një goditjeje të fortë mbi shtetin Bizantin që e kishte shpërryer grupet e brendshme rivale. Vetëm pak vite më vonë, më 1478 turqit pushtojnë edhe pjesën tjetër të Shqipërisë. Mbas këtij pushtimi të përgjithshëm, rreth 1/3 e popullsisë së Ballkanit u konvertua në myslimanë të shtetit sunit. Perandoria Osmane u karakterizua nga eklektizmi etno – kulturor, po i dominuar fuqishëm nga orientizmi si filozofi e si besim.

Nga dyndjet e para osmane në Evropë deri afërsisht të pushtimi i Edrenesë (Adrianopolit) në vitin 1365 përveç presionit të shtimit të popullsisë, pati dhe disa faktorë të tjerë që e bënë të mundur vendosjen e gjerë të turqve në Evropë. Osmanët e kuptonin domosdoshmërinë për të pastruar kontrollin e fortë të Dardaneleve si për arsye ushtarake, ashtu dhe ekonomike. Ata donin të siguronin kalimin nga Anadolli në Ballkan dhe të vinin taksa tranziti për mallrat që transportoheshin përmes ngushticave. Kështu ata ishin të interesuar të krijonin një kufi të ri në Evropë, dhe për ga zitë (grekërit) dhe për qeverinë, ajo që duhej bërë ishte vendosja në këtë rajon e luftëtarëve kufitarë profesionistë.

Banorët vendas i kishin frikë inkursionet turke dhe në vitet e para kishte ende territore dhe shtete ku ata mund të largoheshin. Turkomanët merrnin gjithçka linte pas popullsia e krishterë pa si braktiste vendin dhe ngrinte vendbanime të

re- ja urbane e rurale. Në këtë mënyrë u bënë kryesisht turke tokat që përkojnë në vija të përgjithshme me provincat e sotme evropiane të Turqisë nën sundimin e Orhanit (1324- 1360) dhe veçanërisht nën sundimin e Muratit I(1360-1389). Ky transformim etnografik pati jehonë tepër serioze në shtetet e krishtera, të cilat patën vështirësi në përthithjen e popullsisë refugjate. Në periudhën e mëvonshme ardhja e madhe e turqve pushoi, por nuk ndaloi fare. Duke e parë të nevojshme që rrugët e rëndësishme ushtarake dhe pikat e forta ishin në duar të besuara, turqit vazhduan dhe më vonë të vendoseshin rreth këtyre territoreve, megjithëse në numër më të vogël (Sugar 2007: 30).

Interesimi i fuqive të mëdha për trashëgiminë e Perandorisë Osmane, mes të cilave është edhe Ballkani, fillon që në shek. XVI. Në fuqitë e mëdha të para, e interesuar për të hyrë në marrëdhënie politike me Perandorinë Osmane, ishte Franca e cila që në shek. XVI hyri në marrëdhënie me oborrin osman kundër Perandorisë Austro – Hungareze. Në sajë të këtij koalicioni, Francës iu dha e drejta e mbrojtjes së popullsisë katolike në territoret e Perandorisë dhe rikthimi i bazave tregtare në Mesdheun Lindor, tregëti që ishte lëkundur nga pushtimi osman.

Tri tiparet e ndërtimit të Perandorisë Osmane gjatë politikës kolonialiste

Tri ishin parimet themelore mbi të cilat u ndërtua gjithë Perandoria Osmane. Parimi militar, parimi i dinastisë dhe parimi islam. Parimi militar i Perandorisë, shpjegon faktin e fuqishmërisë së saj të lartë ushtarake dhe aftësinë për pushtime të shpejta, bazuar mbi fise mercenarësh nomadë dhe nga Azia Lindore. Parimi militar osman u tregua më i suksesshëm edhe se evropianët të cilët vuanin nga rivalitete feudale, nga ndarjet midis vendeve të ndryshme, madje edhe në çdo luftë të ndryshme nga problemet e sekteve fetare dhe nga intoleranca ndaj disa besimeve si: hebrenjtë dhe ortodoksët. Por ky parim militar pati edhe kufizimet e veta që e çuan drejt dështimit. Ai varej nga dimensionet pushtuese të Perandorisë. Kur di mensionet e kufizuan, armata dhe në

përgjithësi parimi militar e rëndoi ekonominë Perandorake me taksa e tatime dhe me degradim ekonomik. Gjithashtu pushteti i centralizuar ushtarak, bënte që ushtria e stërmadhe të lëvizte nga një anë e Perandorisë në anën tjetër duke humbur kohë e fi nanca të shumta. Gjithashtu dhe vetë prapambetja teknologjike dhe shkencore e Perandorisë u reflektua dhe në parimin militar duke sjellë degradimin gradual të tij.

Parimi i dinastisë ishte ndër më kryesorët. Ai rridhte nga përvoja mesjetare të Evropës dhe të Mesdheut Lindor. Sipas këtij parimi, vendi, shteti konsistonte në grumbullimin e fuqive kryesore pushtuese të Perandorisë rreth një familjeje sunduese otomane të quajtura më vonë osmanë dhe që e vijon këtë me familjen e tij. Për të krijuar një shtet efikas, osmanët krijuan institucione në të cilat adaptoheshin rregulla që buronin nga vetë shoqëritë e pushtuara. Perandoria pranoi kështu besimin mysliman institucionet edukuese dhe ligjore të tij. Shoqëria otomane trashëgoi pra një sistem të tërë xhamish, shkollash dhe gjykatash.

Otomanët ndërtuan një sistem burokratik të përafërt me atë të Perandorisë Bizantine, me taksa, me gjykata funksionale, praktika feudale dhe sisteme të ardhurash nga toka. Gjithë kjo strukturë kishte edhe kufizimet e vetë të mëdha duke u bazuar te pushteti qëndror i Sulltanit, kjo sillte si pasojë ndërvarjen absolute të Perandorisë nga ka paciteti qeverisës i Sulltanit për të qeverisur. Shu më rregulla të Sulltanit, me karakterin e tyre të ngurtë, e përkeqësuan dhe e dobësuan shtetin.

Parimi islam ishte gjithashtu një ndër ko lonat kryesore të shtetit otoman. Gjithë sistemi politik, kulturor dhe ligjor, buroi nga ligjet islamike që u quajtën “Sheriati”. Institucionet shoqërore dhe fetare i shërbenin shtetit. Parimi islam ndikoi mbi konvertimin masiv fetar në trevat e Perandorisë, por mjaft popuj ruajtën besimet e veta si çifu tët, katolikët dhe ortodoksët. Krahësuar me Evro pën e atëherëshme ku regjimi fetar ishte tepër konservator, parimi islam i Perandorisë, përmbante mjaft tolerancë bashkëjetese multi-fetare. Gjithashtu pozicioni kaq i rëndësishëm i parimit

islam në strukturën e shtetit thellonte hendekun me Evro- pën kristiane.

Parimet e lartpërmendura u reflektuan edhe në Perandorinë Osmane, e shtrirë midis dy kontinenteve të ndara nga ngushtica e Dardanele- ve, Perandoria Osmane do të kishte disa specifika të saj në politikën e saj. Ajo as nuk pretendonte të ishte vetë sistemi dhe të ndiqte parimin universal të ish – perandorive të vjetra, as nuk arriti të konceptonte e as të realizonte konceptet evropiane të “ekuilibrit të forcave”. Por shtrirja e saj gjeografike euro – aziatike solli ndikime relativisht balancuese në politikën dhe diplomacinë e perandorisë Osmane. Ky qëndrim balancues, prodhoi në momente të caktuara një politikë të jashtme neutrale me shumë dobi për fatet e të gjithë kontinentit.

Në momentin kur Perandoria Osmane filloi të hynte në relacione me sistemin e marrëdhënieve ndërkombëtare evropiane, ajo filloi trondit- jet e njëpasnjëshme që do të sillnin shkatërrimin e saj dhe shkatërrimin e sistemit universal të marrëdhënieve ndërkombëtare. Gjithashtu është për t’u vënë në dukje se tri parimet e lartpërmendura të Perandorisë Osmane: parimi militar, parimi dinastik dhe parimi islam lanë gjithashtu gjurmë të thella në fizionominë e popujve dhe vende ve të Ballkanit dhe ndikuan në raportet e tyre me Evropën.

Ndikimi i vendeve të kolonizuara mbi Perandorinë Osmane

Jo vetëm Perandoria Osmane pati ndikim mbi vendet që i kolonizoi, por edhe këto vende patën ndikim mbi të. Ky bashkëpunim deri me anë krushqish e martesash është një tregues më shumë për thellësinë që kishin depërtuar me njëra- tjetrën shoqëritë e ndryshme. Aq rëndësi i jepte këtij bashkëpunimi dinastia osmane, sa ajo qysh prej fillimeve të veta lejoi t’i dobësohej progresivisht trashëgimia “antropologjike” turke. Është bërë një llogaritje duke filluar prej sulltanit Orhan eksogama e praktikuar sistematikisht nga gji- thë pasardhësit, mund të thuhet se pati bërë që pas 20 sulltanësh, dinastia osmane të mos përm- bante më, veçse një të miliontën gjak turk.

Duke tërhequr renegatë të ndryshëm, du ke rrëmbyer dhe rekrutuar fëmijë të shumtë të kri- shterë për shërbime ushtarake, duke rrëmbyer va- jza greke, sllave, shqiptare të caktuar për t’u bërë nënat e brezave të rinj osmanë, trupat turke e shtynë në dorë Ballkanin.

Fakti më i shënueshëm i historisë së ma- rrëdhënieve osmane me vendet që kolonizoi në shek. XIV, është integrimi progresiv i elementeve të këtyre vendeve në ushtri, në administratë dhe në shoqërinë osmane. Menteshë për themelin e shtetit osman, ata shërbyen si trupa ndihmëse të ushtrisë osmane, së cilës i bënë shërbime të pa- çmueshme. Ata i ndihmuan sulltanët në mënyrë ko- nkrete për të ndërtuar shtetin e tyre dhe për ta administruar atë. Ky proces varej domosdosh- më risht edhe prej politikës liberale, toleruese të os- manëve të parë.

Toleranca fetare ishte një rregull dhe mun gesa e paragykimit racor ishte karakteristikë prej zanafillës legjendare të emiratit të osmanit, para se osmanët të merrnin sulltanatin dhe kur osma- nët u ngritën në fuqi ata nuk ngulmonin në dalli- me ndërmjet myslimanëve dhe të krishterëve. Kjo lidhej me situatën konkrete të përbërjes së popu- llsisë në territoret që shndërroheshin gjithnjë e më shumë në osmanë (Bake- Gramon 2004: 150).

Sulltanët nuk kishin kurrfarë kompleksi të mbanin në oborrin e tyre specialistë gjithfarësh, deri edhe mjekë që kujdeseshin për shëndetin e tyre vetjak, çfarë do të ishte e pakonceptueshme. Me ndërrimin e fesë, që do të merrte vull kohë pas kohe në periudhën e ardhshme osmane duhet pranuar se osmanët nuk patën asnjëherë një pro- gram të saktë përse i përket zhvillimeve fetare.

Përfundim

Osmanllitë kishin kaluar nëpër një proces të gjatë evoluimi. Së paku tri qytetërime historike perse, arabe dhe bizantine kontribuan me prurjet e veta për të përgatitur sundimin e tyre të ardhshëm. Kolonizimi osman në shek. XIV – XVI ka pa së një- shtrirje të madhe ku në fakt zor se mund të flasësh për një kufi në kuptimin e sotëm të kësaj fjale. Në Evropë ndër vendet e kolonizuara, për mendim: Hungaria, Rumania, Shqipëria, Bullgaria,

ish -Jugosllavia, Greqia, Ukraina, Krimea etj., duke pasur ndikimin e saj në këto vende, përmes kolonizimit. Megjithatë jo vetëm Perandoria Osmane pa ti ndikim mbi vendet që i kolonializoi, por edhe kë to vende patën ndikim mbi të

Bibliografia

ASHRPSSH, I GJ. (1980), *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*.

BELDIÇEANU, I. (2004), *Fillimet: Osmani dhe Orhani*.

TATA,V., L. (2005), *Identiteti himariot dhe ballkanik*.

VATE, N. (2004), *Ngritja e osmanëve*.

SUGAR, F., S. (2007), *Perandoria e parë Osmane dhe provincat e saj*.

BAKE- GRAMON, ZH. (2004), *Apogjeu i Perandorisë Osmane: Ngjarjet 1512 – 1606*.

TEKNICIZMAT NË PROZËN E PIRANDELOS

TECHNICALITIES IN PIRANDELLO'S PROSE

MIRELA PAPA

Departamenti i Gjuhës Italiane, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës, Tiranë, SHQIPËRI

Email: papamirela@yahoo.com

AKTET VII, 4: 314 - 321, 2014

PERMBLEDHJE

Teknicizmi është fjalë që ka një kuptim konkret dhe të përcaktuar brenda zhargonit të një zanati, arti, industrie apo shkence. Progresi i shkencave, filozofia, teknika profesionale ka bërë që çdo disiplinë të kërkojë sot leksikun e saj të veçantë. Teknicizmat i gjejmë jo vetëm në ligjërimin e specializuar, por edhe në atë letrar. Një ndër autorët që përdor teknicizma në veprat e tij është edhe Luixhi Pirandello. Përpjekja e vazhdueshme për ta bërë gjuhën gjithnjë e më të detajuar dhe për ta pasuruar atë e shtyn Pirandelon të përdorë fjalë të marra nga terminologjia e specializuar e arteve, profesioneve, shkencave. Në këtë kumtesë do të studiojmë leksikun e specializuar që Pirandello përdor rëndom në novelat e tij. Terma të gjuhës së mjekësisë, botanikës, zoologjisë, gjeografisë fizike e toponimisë do të jenë objekt i analizës. Gjithashtu do të shohim edhe se si janë dhënë këta terma në përkthimin në shqip.

Fjalët çelës: letërsi, gjuhë specialiteti, teknicizma, përkthim

SUMMARY

Technicality is a word that bears a real and well-defined meaning within the jargon of a profession, art, industry or science. The progress of sciences, philosophy, professional technique has made it possible for every discipline to have its own specialized lexicon. Technicalities are to be found not only in the specialized discourse, but in the literary one as well. One of the writers that makes use of technicalities in his works is Luigi Pirandello. In continuous efforts to make his language as much detailed and rich as possible, Pirandello has deliberately used words from the specialized terminology of arts, sciences, professions. In this paper, we will study the specialized lexicon that Pirandello uses in his short stories. The analysis will focus on the terms from the language of medicine, botany, zoology, physical geography, toponyms, etc. We will also see how these terms are rendered in the Albanian translation.

Key words: literature, specialized language, technicalities, translation

Hyrje

Teknicizmi është një fjalë që ka një kuptim konkret dhe të përcaktuar brenda zhargonit të një zanati, arti, industrie apo shkence. Progresi i shkencave, filozofisë, teknikës profesionale ka bërë që çdo disiplinë të kërkojë sot leksikun e saj të veçantë. Në formimin e fjalëve të reja, për të shprehur ide të reja, gjuhët disponojnë një leksik ndërkombëtar të formuar mbi bazën e huazimeve të marra nga greqishtja dhe latinishtja dhe të përshtatura sipas nevojave të tyre të veçanta.

Duket e çuditshme, por teknicizmat i gjejmë jo vetëm në ligjërimin e specializuar, por edhe në atë letrar. Një ndër autorët që përdor teknicizma në veprat e tij është edhe shkrimtari italian Luixhi Pirandello. Përpjekja e vazhdueshme për ta bërë gjuhën gjithnjë e më të detajuar dhe për ta pasuruar atë e shtyn Pirandelon të përdorë fjalë të marra nga terminologjia e specializuar e arteve, profesioneve, shkencave. "Pirandello nuk ngurron të sakrifikojë sferën e kuptimit të gjuhës kur e kërkon veçantia e objektit të shprehur apo

të paraqitur” (Vicentini 1970: 157), prandaj ndonjëherë teknikizmi kompromenton qartësinë dhe gjallërinë e rrëfimit.

Në këtë kumtesë do të studiojmë leksikun e specializuar që Pirandelo përdor rëndom në novelat e tij. Terma të gjuhës së mjekësisë, botanikës, zoologjisë, gjeografisë fizike e toponimisë etj. do të jenë në objekt të analizës. Gjithashtu do të shohim edhe se si janë dhënë këta terma në përkthimin në shqip.

1. Mjekësia

Teknicizmat më të shumtë janë të llojit mjekësor. Nuk është për t’u çuditur nëse mbajmë parasysh që shumë nga personazhet e tij janë viktimat të sëmundjeve të çuditshme dhe vdesin shpeshherë nga vdekje të menjëhershme. Tregimet e tij janë të mbushura me njerëz, veprime, gjeste anormale. Personazhet e tij kanë “shenja të veçanta që i dallojnë, janë të shënuar në trup (strabikë ose me tike dhe shenja të tjera) dhe të shënuar brenda, të shënuar nga hidhërimi i gatshëm për të shpërthyer” (Munafò 1974). Mjekësia është një nga shkencat që ka në zotërim numrin më të madh të kanaleve të përhapjes në publikun e gjerë (Cortelazzo 1990: 36). Kjo për vetë faktin se pacientët kanë të drejtën legjitime të informohen mbi shëndetin e tyre dhe për faktin se aktiviteti shëndetësor del përtej rrethit të specialistëve përmes komunikimeve shkencore që i drejtohen publikut të gjerë (udhëzues ilaçesh etj), si edhe përmes rubrikave të shëndetit që janë të pranishme në çdo gazetë apo revistë. Edhe pse zakonisht gjuhët e specialitetit e përdorin me kursim sinoniminë (Cortelazzo 1990: 10), gjuha e mjekësisë pikërisht për shkak të shtresëzimit të madh (Dardano 1994: 541) përdor mjaft sinonime. Kështu kemi sinonime që krijohen nga ekzistenca e termave që u përkasin niveleve të ndryshme të aktualizimit (Duro 1997: 77) dhe, më konkretisht, nivelit të mirë filltë shkencor (ose sektorial) dhe atij shkencor-popullor (ose përdorimi i zakonshëm). Por, duhet thënë se të dyja format janë të pranuar apo të ligjëruara.

Po paraqesim sëmundjet që prekin më së shumti personazhet e Pirandelos dhe të shikojmë kujt nivel aktualizimi i përkasin dhe si janë përkthyer në gjuhën shqipe.

- ...afflito da una cisti enorme alla nuca (Marsina stretta),
- që kishte një alamet bërdungulle në qafë (*Fraku i ngushtë*, 2008: 174),
- (...) orribilmente gonfio dall’idropisia (Filo d’aria)
- (...) ishte ënjtur tmerrësisht nga hidropizia (*Një fill ere*, 2008: 194),
- (...) finché un colpo d’apoplessia, due anni fa, non lo aveva fulminato, là su quella sedia, pur senza finirlo (Filo d’aria)
- (...) derisa dy vjet më parë i kishte rënë pika, aty në karrige, por kishte shpëtuar pa vdekur (*Një fill ere*, 2008: 195),
- (...) morto all’improvviso, di sincope, per troppo amore, dicevano (Notte)
- (...) kishte vdekur papritur e pa kujtuar, nga zemra. Thoshin nga dashuria e madhe ... (*Natë*, 2008: 146),
- (...) subito appena colpita da paralisi la vecchia principessa (La rallegrata)
- (...) pasi u paralizua princesha e vjetër (*Kërcim i hareshëm*, 1997: 138),
- (...) e un pajo di mezzi guanti di lana alle mani orribilmente deformate dall’artrite (Il fumo)
- (...) dhe një palë gjysma dorezash në duart e deformuara keq nga përdheu (*Tymi*, 1963: 84),
- (...) un colpo apoplettico, di quelli genuini, e in capo a tre ore, morto (Il tabernacolo)
- (...) i ra pika, një nga ato goditjet fare të zakonata dhe pas tri orëve vdiq (*Tabernakulli*, 2008: 85),
- “I medici, eh! subito, con la loro scienza, avevano compreso che non sarebbe cresciuta più. Linfatico, cacchessia, rachitide... (I tre pensieri della sbiobbina)
- Mjekët, me anë të shkencës së tyre, nuk mënuan të kuptojnë se nuk do të rritej më. Gjak i prishur, dobësi e përgjithshme, kocka të pazhvilluara, rakitizëm... (*Tre mendimet e gungaçes*, 1997: 46),

- (...) avevano dovuto amputare una gamba e poi l'altra, per un sarcoma che s'era rinnovato (I tre pensieri della sbiobbina)
- (...) i kishin prerë njëren këmbë dhe pastaj tjetrën, për shkak të një tumori të përtërirë (*Tre mendimet e gungaçes*, 1997: 51),
Vëmë re nga shembujt e marrë se Pirandelo përdorë terma të cilët i përkasin nivelit të mirëfilltë shkencor. Në tekstet e përkthyer me përjashtim të ndonjë rasti sporadik (*hidropizia*) përkthyesit i kanë përkthyer termat me terma, të cilët i përkasin nivelit shkencor-popullor të gjuhës së mjekësisë. Duhet thënë se edhe në gjuhën italiane kemi disa nivele të aktualizimit, prandaj për të respektuar zgjedhjen e bërë nga shkrimtari termat duhet të ishin përkthyer me terma të nivelit të mirëfilltë shkencor, ndonëse do të tingëllonin të pakuptueshëm për lexuesin shqiptar.
Në raste të tjera termat u referohen ilaçeve dhe mjekimeve:
- (...) intrise d'alcool con le essenze omeopatiche (Acqua e li)
- (...) të ngjyera me alkool me esenca homeopatike (*Ujë dhe pikë*, 2008: 183).
Disa shembuj venë në dukje shkallën e specializimit dhe, si rrjedhim, të vështirësive kuptimore, të gjuhës mjekësore:
- tu ridevi e dicevi: Insufficienza... è vero?... insufficienza delle valvole aortiche (Formalitet)
- ti qeshje e thoshje: Dobësia... a po jo?... dobësia e valvolavet aortike (*Formalitet*, Shkëndija N. 3, f. 50).
Në këto dyja rastet janë përdorur terma që i përkasin nivelit të mirëfilltë shkencor edhe në novelat e përkthyerat.

2. Botanika

Pirandelo ishte një vëzhgues i mirë i natyrës. Ky lloj leksiku duket themelor në "novelat e tij fshatare", domethënë ato të cilat kanë si skenar fushën, si kundërvënien me novelat qytetare apo urbane. Bëhet fjalë përgjithësisht për fjalor të punëve bujqësore, emra bimësh apo lulesh, pemësh. Disa nga tregimet kanë si titull emra të tillë që nxjerrin në pah shijen e Pirandelos për

natyrën (*La rosa, Alberi cittadini*), punët që lidhen me nxjerrjen e squfurit (*Il fumo*).

Disa shembuj:

- Tanto per la potatura; tanto per gli innesti; tanto per la concimazione... (Il fumo)
- Kaq për krasitjet; kaq për shartimet; kaq për plehrimin... (*Tymi*, 1963: 72),
- (...) smallare mandole, raccogliere ulive (Prima notte)
- (...) duke qëruar bajame, duke mbledhur ullinj (*Nata e parë*, 2008: 42),
- A chi attendeva a riempire di minerale grezzo i forni o i "calcheroni", a chi vigilava alla fusione dello zolfo, o s'affacciava sotto i forni stessi a ricevere dentro ai giornelli che servivano da forme lo zolfo bruciato che vi calava come una densa morchia nerastra (...) (Il fumo)
- Atij që priste të mbushë furrat me mineral të papunuar, atij që përgjonte gjer të shkrihej squfuri ose rropatej poshtë furrave duke pritur brenda koritave – që shërbenin si kallëpë – squfurin e djegur që rridhte ngadalë si murgë e trashë dhe e zezë... (*Tymi*, 1963: 52),
- gli alberi aspettano da una decina d'anni almeno, la rimonda; i frutici crescono senza innesti, coi polloni sparpagliati (Il fumo)
- pemët, të paktën prej dhjetë vjetësh, presin të krasiten; fidanët rriten në qejf të vet, të pashartuar, me gemat të hallakatur (*Tymi*, 1963: 69),
- pensò che ora tutta quella terra era sua; suoi quegli alberi: olivi, mandorli, carrubi, fichi, gelsi; sua quella vigna. (Scialle nero)
- mendoj se tani e tërë ajo tokë ish e tija; të tijt ishin pemët: ullinj, bajamet, bishtajat, fiqt, manat; e tij ish vreshta. (*Shalli i zi*, 1963: 28),
Sh.i.p. it. carrube = bishtajë: pemë e vendeve të ngrohta, frutat i ngjajnë bathëve, kanë ngjyrë të errët kafe e janë të ëmbla. Përdoren për ushqim kafshësh, sidomos të kuajve.
- I socialisti, capisci? mi rubano l'uva ancora acerba; i fichidindia, tutto! (Il tabernacolo)
- A e kupton? Socialistët po ma grabisin rrushin ende aguridhe, pastaj edhe fiqtë e Hindit, të gjitha! (*Tabernakulli*, 2008: 84).
Për sa i përket botanikës duhet thënë se Italia dhe Shqipëria kanë të njëjtën shtrirje gjeografike

dhe përgjithësisht llojet e ndryshme të bimëve, të drurëve ndodhen edhe në vendin tonë, kështu që nuk ka vështirësi shumë të mëdha për t'i dhënë këta terma me terma të cilat ekzistojnë edhe në gjuhën tonë. Me përjashtim të fjalës *carrube* për të cilën përkthyesi, për të zgjidhur nevojat kuptimore të lexuesit, përveç termit gjegjës në gjuhën shqipe i jep edhe shpjegimin me një glosë jashtëtekstuale, duke qenë se në gjuhën shqipe fjala “bishtajë” i referohet një bime që përdoret për ushqim të njerëzit.

3. Lundërtari, mjeshtëri e lundrimit

Ndikimi i detit bëhet i dukshëm në veprën e Pirandelos. Shumë nga personazhet e tij jetojnë përgjatë bregut sicilian apo në portet e gadishullit (*Nell'albergo è morto un tale ëNë hotel vdiq diku-sh, La maestrina Boccarmé /Mësuesja Bokarme/*). Pjesa dërrmuese e fjalorit të lidhur me këtë temë u referohet emrave të barkave, veglave apo pajisjeve të peshkatarëve, ashtu si edhe llojeve të peshqve të ngrënshëm:

- (...) si distraeva guardando con gli altri oziosi le navi ormeggiate: tre alberi e brigantini, tartane e golette, ciascuna col suo nome a poppa (La maestrina Boccarmé),
- (...) kalonte kohën, siç bënin edhe njerëz të tjerë të ngeshëm, duke kundruar anijet e lidhura në breg: tredirekëshe, peshkatore me vela, goleta, secila me emrin e vet të shkruar në qiç (*Mësuesja Bokarme*, 1999: 121),
- E ora, ecco, arrivavano le paranze, una dopo l'altra, con le vele che garrivano allegre (Idem)
- Dhe ja, ku vinin parancat, njëra mbas tjetrës, me velat që cijatnin gëzueshëm (*Mësuesja Bokarme*, 1999: 121),
- E sollevando con gli occhi tutta l'anima a guardare nell'ultima luce la punta degli alti alberi, i pennoni, il sartiame (Idem),
- Dhe duke vështuar në buzëmbremje fort e përqendruar majat e direkëve të lartë, shulicat, pallasartat (*Mësuesja Bokarme*, 1999: 122),
- ...seguitava a guardare i marinai che in qualche nave facevano il lavaggio della coperta, gettandosi allegramente l'acqua dei buglioli addosso, tra salti e corse pazze e gridi e risate (Idem),

- ...vazhdonte të vështonte detarët që lanin ku-vertën e ndonjë anijeje, duke i hedhur njëri-tjetrit për qyfir ujin e kovave, duke rendur, duke kërcyer dhe duke thirrur e duke qeshur me të madhe. (*Mësuesja Bokarme*, 1999: 123),

Në përkthimin e termave tipike të fushës së lundrimit, përkthyesit kanë zgjedhur fjalë të cilat bëjnë pjesë në gjuhën e specializuar të lundrimit në gjuhën shqipe, ndonëse ndonjë lexues mund edhe të mos kuptojë ndonjë nga termat. Zgjedhja e përkthyesve na duket e drejtë, sepse kështu respektohet edhe qëllimi i autorit.

4. Zoologjia

Prania e kafshëve në veprën e Pirandelos vihet re që në hapat e parë të studimit të saj. Janë të shumë titujt e tregimeve ku personazhe qendrore janë kafshët (*La rallegrata /Kërcim i hareshëm/; Il capretto nero /Keci i zi/; Il pipistrello /Lakuriqi i natës/ etj.*)

Nga të gjithë miza është insekti, i cili përdoret më shpesh, derisa prania e saj shndërrohet në obsesion dhe në disa raste simbolizon të keqen. Disa herë prania e saj do të shërbejë për të paraprirë skena, episode, në të cilat fshihet në mënyrë të vazhdueshme ndjenja e vdekjes:

- Ora, spesso, qualche mosca le si attaccava, vorace, a quegli occhi. (L'altro figlio)
 - Shpesh, u ngjitej tani ndonjë mizë nepsqare, atyre syve (*Djali tjetër*, 1963: 145).
- Emrat e zogjeve dhe të shpendëve janë të shumtë në novela. Per sa i përket përkthimit duhet thënë se edhe në këtë rast vlen i njëjti arsyetim që bëjmë edhe për botanikën.
- E di qua e di là, passeri, cince e beccafichi (...) accompagnavano con un coro di sfrenata ilarità quell'aspra rissa sottovoce (...) (Il bottone della palandrana)
 - Dhe në të dyja anët harabela, trishtila dhe bil-bila kopshti, (...) shoqëronin me një kor qesëndie të pafre atë zënkë të ashpër nën zë (...) (*Kopsa e setrës*, 1999: 112),
 - (...) si era insellato sul naso un payo di grossi occhiali cerchiati di osso, che gli davano l'aspetto d'un barbagianni (La patente)

- (...) kishte vënë një palë syza të mëdha me skelet kocke, që i jepnin pamjen e një torollaku (*Dëshmia*, 1999: 35).

Në këtë rast të fundit kemi të bëjmë me përkthim të gabuar të fjalës, sepse në rastin konkret “barbagianni” është përdorur me kuptimin e tij konkret (buf, kukuvajkë) dhe jo me kuptimin e figurshëm (buf, torollak).

- Non sbruffò, perché era un cavallo ben educato (*La rallegrata*)

- Nuk tërsëlliu, sepse ish kalë i edukuar mirë, (*Kërcim i hareshëm*, 1997: 139),

- (...) guardami là quel bel truttrù calabrese (Idem)

- (...) pa vështro atje atë vraptarin kalabrez (*Kërcim i hareshëm*, 1997: 139),

- Volevo domandarti, - disse, - se non ti occorreva la carrozza, perché il bajo oggi non si può attaccare alla mia (*Formalità*)

- Dëshironja të pyesja, - tha, - në se nuk të duhet karoca, pse sot nuk mund t’a mbërthej kalin. (*Formalitet*, Shkëndija, N. 3, f. 45)

Në ato raste kur kafshët luajnë një rol të rëndësishëm në vepër, personifikimi është i vazhdueshëm (*La rallegrata*, *La liberazione del re*). Lidhur me këtë kujtojmë se personifikimi (apo prozopopeja) konsiston në dhënien qenieve jo racionale (frymorë apo jo) cilësi njerëzore.

5. Gjeografia fizike dhe toponimia

Ngritjet dhe uljet e terrenit, grykat, burimet dhe lumenjtë etj. paraqesin një pasuri të leksikut të specializuar. Lidhur me toponiminë, Pirandelo tregon deri në detaje emrat e maleve, krahinave, kishave. Në çdo rast, vendndodhja e tregimeve është e vështirë të përcaktohet. Në lexim e sipër kuptojmë se ku zhvillohen ngjarjet, nëse në Itali apo jashtë, nëse në ishujt apo në gadishull, nëse në brendësi apo në bregdet; por vetëm në disa raste do ta përmendë qartë emrin konkret të vendit. Vetëm me një lexim të vëmendshëm mund të zbulohet, me aludime, vendi real i të rrëfyerit.

Hermans-i (1985), nga pikëpamja e studimeve përshkruese në fushën e përkthimit, dallon dy kategori të emrave të përveçëm (ku përfshihen edhe toponimet) sipas shkallës së

«semantizimit»: *conventional names* (konvencionalë) dhe *loaded names* (shprehës). Të parët përbëhen nga fjalë të cilave u mungon ngarkesa semantike, domethënë, në përbërjen e tyre nuk ka asnjë aluzion për natyrën e referentit, *shprehës* janë emrat e përveçëm të semantizuar, të pajisur me kuptim dhe/apo konotacione që tentojnë të përfshijnë në formimin e tyre fjalë që u përkasin kategorive me një ngarkesë të përcaktuar semantike.

Për sa i përket mënyrës së përkthimit të emrave të përveçëm Franco Aixelá-ja i ndan procedimet teknike në dy grupe të mëdha: ruajtje dhe zëvendësim, sipas faktit nëse përkthimi është i orientuar drejt polit të origjinës (përshtatje) apo drejt polit mbërritës (pranueshmëri). Strategjitë përkthimore që mëtojnë ruajtjen janë: *përsëritja*; *përshtatja ortografike*; *përkthimi gjuhësor*; *glosa jashhtëtekstuale*; *glosa brendatekstuale*. Përballë strategjive të ruajtjes, ato të zëvendësimit orientohen drejt polit mbërritës, dhe përmes tyre përkthyesi synon të zvogëlojë apo të neutralizojë ekzotizmin apo papranueshmërinë kulturore të referentit origjinal. Kësaj kategorie i përkasin këto procedime: *neutralizimi i kufizuar*; *neutralizimi absolut*; *natyralizimi*; *përshtatja ideologjike*; *heqja*; *krijimi autonom*.

Të shikojmë disa shembuj të qartë vendndodhjeje në novelat e Pirandelos dhe të kuptojmë strategjinë që kanë ndjekur përkthyesit për dhënien e këtyre toponimeve:

- Vi ricordate di Milocca, beato paese, dove non c’è pericolo che la civiltà debba un giorno o l’altro arrivare, guardato com’è dai suoi sapientissimi amministratori? (*Acqua e li*)

- A ju kujtohet Miloka, qyteza e lume ku s’ka rrezik të mbërrijë ndonjë ditë qytetërimi, sepse e ruajnë administratorët e saj fort të ditur? (*Ujë dhe pikë*, 2008: 182),

- Risolvette di allontanarsi per sempre da Roma. Si sarebbe ritirato nelle sue terre di Fabriano (*Come gemelle*)

- Vendosi të largohej një herë e përgjithnjë nga Roma. Bëri ndër mend të tërhiqej në tokat e tij në Fabriano. (*Si dy binjake*, 2008: 123),

- Un caso singolarissimo era accaduto, parecchi anni addietro, a Marco Saverio Bobbio, notajo a Richieri tra i più stimati (L'Avemaria di Bobbio)

- Marko Saverio Bobios, noter në Rikieri, një ndër më të shquarit, shumë vjet më parë i kishte bërë vaki një ngjarje tepër e veçantë. (*Urata e Bobios*, 2008: 125),

- Passata la stazione di Sulmona, Silvestro Noli rimase solo nella lercia vettura di seconda classe (...). Con questo gelo nel cuore ritornava ora in Abruzzo, spirata la licenza di quindici giorni concessagli dal direttore delle scuole normali di Città Sant'Angelo, ove da cinque anni insegnava disegno. (Notte)

- Pas stacionit të Sulmonas, Silvestro Noli mbeti vetëm në vagonin e papastër të klasës së dytë. (...) Me këtë thëllim po kthehej tani në Abruco, meqë i kishte mbaruar leja pesëmbëdhjetëditore, që i kishte dhënë drejtori i shkollë normale për djem i Città Sant'Anxhelos, ku kishte pesë vjet që jepte lëndën e vizatimit. (*Natë*, 2008: 143-44).

Il capretto nero zhvillohet në Girgenti (Agrixento aktual); *Difesa del Mèola* zhvillohet në Montelusa; *Amicissimi* në Romë (Lungo Tevere, Porta Pia, Via Pastrengo). Në Siçili zhvillohen tregime të famshme si: *Prima notte /Nata e parë/*, *Scialle nero /Shalli i zi/*, *Il fumo /Tymi/*, *Formalità /Formalitet/*, *L'altro figlio /Djali tjetër/* etj.

Shembuj të emrave të maleve, pyjeve, fushave etj.

- Sorge al posto di esse un bosco di mandorli e d'olivi saraceni, detto perciò il Bosco della Cívita (Il capretto nero)

- Në vend të tyre sot lartohet një pyll bajamesh e ullinjsh saraçenë, prandaj edhe e quajnë pylli i Cívitas. (*Keci i zi*, 2008: 149),

- (...) ogni giorno, sul tramonto, si reca a piedi, col suo passo elastico e misurato, dalla città alta sul colle alle rovine dei Tempii akragantini, aerei e maestosi su l'aspro ciglione che arresta il declivio della collina accanto, la collina akrea (idem)

- çdo ditë, në të perënduar të diellit, me atë hapin e tij të matur dhe elastik, shkon më këmbë nga qyteti lart në kodër deri në rrënojat e tempujve Akragantinë, plot ajër dhe madhështorë, përmbi buzinën e ashpër, e cila pengon

shkarjen e kodrës ngjat, të kodrës akree (*Keci i zi*, 2008: 148),

- Sotto il ciglione scorre, quando può, il fiume Akragos che Pindaro glorificò come ricco di greggi. (Ibidem)

- Atëherë, kur mundet, rrëzë greminës rrjedh lumi Akragas, luginën e të cilit Pindari e pati lavduar për grigjat e shumta. (*Keci i zi*, 2008: 149),

Kisha, rrugë apo monumente janë gjithashtu objekt vëmendjeje nga ana e Pirandelos:

- Avviene spesso che, o nel tempio della Concordia, o in quello più su di Hera Lacinia, o nell'altro detto volgarmente dei Giganti s'imbatta in comitive di suoi compatriotti, venute a visitare le rovine. (ibidem)

- Qëllon shpesh që zoti Çarls Trokli nganjëherë ndeshet me grupe bashkatdhetarësh të vet, të cilët vijnë për të vizituar rrënojat, qoftë të Tempullit të Harmonisë, qoftë edhe ato të Herës Lacinia apo edhe ato të atij që populli e quan Tempulli i Gjigandëve e që ndodhet pak më lart. (*Keci i zi*, 2008: 149),

- ...e ogni domenica si faceva la santa comunione nella chiesetta della Badiola al Carmine (L'Avemaria di Bobbio)

- ... dhe çdo të diel merrte kungimin e shenjtë në kishëzën e Badiolas. (*Urata e Bobios*, 2008: 125),

- Ogni volta, dopo la lezione, si faceva una giratina per sollievo giù per la piazza del Pantheon, poi su per quella della Minerva, attraversava Via dei Cestari e sboccava sul Corso Vittorio Emanuele. Giunto in prossimità di Piazza San Pantaleo, prendeva quell'aria astratta, perché di solito – prima di imboccare la Via del Governo Vecchio, ove abitava. (...) (L'eresia catara)

- Çdo herë, mbas mësimit, profesori, për t'u shlodhur, niste e shëtiste nëpër sheshin e Panteonit, pastaj ngjitej në sheshin e Minervës, kalonte nëpër Rrugën e Çezarëve dhe dilte në shëtitoren Vitorio Emanuele. Kur mbërrinte pranë Sheshit të Shën Pantaleos, merrte përsëri atë pamjen e mangët, sepse kishte zakon – para se t'i futej Rrugës së Qeverisë së Vjetër, ku banonte, futej në një ëmbëltore, (fshehurazi, të paktën siç synonte), prej së cilës dilte mbas pak me një kaush letre në dorë. (*Herezia katare*, 2010: 83).

Për të përfunduar këtë grup, pas analizës së bërë, mund të themi se strategjia kryesore që ndjekin përkthyesit për përkthimin e toponimeve është ajo e përshtatjes ortografike për toponimet konvencionale dhe kryesisht përkthim gjuhësor për toponimet shprehëse. Kjo strategji e fundit është edhe një hap përpara drejt polit mbërritës në krahasim me strategjitë e tjera.

6. Shkenca të tjera

Kemi një numër jo shumë të madh termash të cilët i përkasin shkencave të tjera. Më të shumtë janë terma fizike dhe kimie, elementë apo instrumenta karakteristikë:

- C'è caffèina, in casa? – No... io non so, - s'affrettò a rispondere Flavia. – Ho mandato a prendere l'etere (Formalità)

- A ka kafé në shtëpi? – Jo, më duket, nuk di, - shpejtoi të përgjegjë Flavia. – Kam marrë eter... (Formalitet, Shkëndija N. 3, f. 48),

- Poggìo lo stetoscopio sul petto del giacente e vi piegò l'orecchio per ascoltare (ibidem)

- Mbështeti stetoskopin mi gjoksin e të sëmurit dhe vuri veshin të dëgjonte. (Formalitet, Shkëndija N. 3, f. 48),

- Bisogna telegrafare d'urgenza perché dalla città vicina accorra a precipizio un medico munito del siero di Behring (...) (Acqua e lì)

- Duhet telegrafuar me urgjencë që të vijë rrëmbimthi nga qyteti një mjek me serumin e Behringut. (Ujë dhe pikë, 2008: 187).

Në rastin e parë kemi të bëjmë me një gabim në përkthim. "Kafeinë" është zëvendësuar me "kafe". Në rastet e tjera strategjia e përkthyesve është përkthimi i termit me një term i cili i përket nivelit shkencor të gjuhës mjekësore.

Përfundimet

Përpjekja e vazhdueshme për ta bërë gjuhën gjithnjë e më të detajuar dhe për ta pasuruar atë e shtyn Pirandelon të përdorë fjalë të marra nga terminologjia e specializuar e arteve, profesioneve, shkencave. Pirandelo nuk ngurron të sakrifikojë sferën e kuptimit të gjuhës kur e kërkon veçantia e objektit të shprehur apo të paraqitur, prandaj ndonjëherë teknikizmi kompromenton qartësinë dhe gjallërinë e rrëfimit. Në këtë

kumtesë pamë të përdorura nga Pirandelo terma të gjuhës së mjekësisë, botanikës, zoologjisë, gjeografisë fizike e toponimisë etj.

Për sa i përket gjuhës së mjekësisë duhet thënë se në tekstet e përkthyer me përjashtim të ndonjë rasti sporadik përkthyesit i kanë përkthyer termat mjekësorë italianë me terma të cilët i përkasin nivelit shkencor-popullor të gjuhës së mjekësisë shqiptare, pavarësisht nivelit shkencor të cilit i përkasin termat e gjuhës origjinale. Duhet thënë se edhe në italisht kemi po disa nivele të aktualizimit, prandaj për të respektuar zgjedhjen e bërë nga shkrimtari termat duhet të ishin përkthyer me terma të nivelit të mirëfilltë shkencor, ndonëse do të tingëllonte i pakuptueshëm për lexuesin shqiptar.

Për sa i përket botanikës dhe zoologjisë duhet thënë se Italia dhe Shqipëria kanë të njëjtën shtrirje gjeografike dhe përgjithësisht llojet e ndryshme të bimëve, të drurëve, kafshëve dhe shpendëve ndodhen edhe në vendin tonë, kështu që përkthyesit nuk kanë hasur vështirësi të mëdha për t'i dhënë ato me terma, të cilat ekzistojnë edhe në gjuhën tonë.

Në përkthimin e termave tipike të fushës së lundrimit, përkthyesit kanë zgjedhur fjalë të cilat bëjnë pjesë në gjuhën e specializuar të lundrimit në gjuhën shqipe, ndonëse ndonjë lexues mund edhe të mos kuptojë ndonjë nga termat. Zgjedhja e përkthyesve na duket e drejtë, sepse kështu respektohet edhe qëllimi i autorit.

Për sa i përket strategjisë kryesore që ndjekin përkthyesit për përkthimin e toponimeve është ajo e përshtatjes ortografike për toponimet konvencionale dhe kryesisht përkthim gjuhësor për toponime shprehëse. Kjo strategji e fundit është edhe një hap përpara drejt polit mbërritës në krahasim me strategjitë e tjera.

Bibliografi

VICENTINI, C. (1970), *L'estetica di Pirandello*, Milano: Mursia.

- MUNAFÒ G. (1974), *Conoscere Pirandello: Introduzione e guida allo studio dell' opera pirandelliana. Storia e antologia della critica*, Le Monnier.
- CALVINO, I. (1980), *Una pietra sopra, Discorsi di letteratura e società*, Turin: Einaudi.
- CORTELAZZO M.A. (1990), *Lingue speciali*, Padova: Unipress.
- DARDANO M. (1994), "I linguaggi scientifici", në *Storia della lingua italiana*, vëllimi II, *Scritto e parlato*, nën kujdesin e L. Serianni e P. Trifone, Torino: Einaudi.
- DURO A. (1997), "Terminologjia në ligjërimin e specializuar", në *Studime Filologjike*, Tiranë, Nr. 1-4.
- FRANCO AIXELÀ J. (1996), *Culture-specific items in Translation*, në Román Alvarez dhe M^a Carmen Africa Vidal, *Translation, Power, Subversion*, Multilingual Matters, Clevedon, 52-78.
- _____, (2000), *La traducción condicionada de los nombres propios (ingles-español)*, Salamanca: Ediciones Almar.
- HERMANS Th. (1985), *Translation Studies and a New Paradigm*, tek Theo Hermans (ed.) *The Manipulation of Literature: Studies in Literary Translation*, Croom Helm, Londër, f. 7-15.
- _____, (ed.) 1985, *The Manipulation of Literature: Studies in Literary Translation*, Croom Helm, Londër, f. 7-15.
- _____, (1993), *On modelling translation: Models, Norms and the Field of Translation*, Livius 4, 69-88.
- _____, (1999), *Translation in Systems: Descriptive and Systemic Approaches Explained*, Manchester: St. Jerome..

KRAHINA E SHPATIT (ELBASAN) DHE PËRPJEKJET E SAJ PËR PËRHAPJEN E ARSIMIT DHE RUAJTIEN E TRADITAVE FETARE NË PERIUdhËN E PUSHTIMIT OSMAN

THE REGION OF SHPAT (ELBASAN) AND ITS EFFORTS TO PROMOTE EDUCATION AND MAINTAINITS RELIGIOUS TRADITIONS DURING THE PERIOD OF OTTOMAN OCCUPATION

ELIANA IBRAHIMI
Email: eliana22al@yahoo.it

AKTET VII, 4: 322-326, 2014

PËRMBLEDHJE

Studimi synon të evidentojë përpjekjet e popullsisë së krahinës së Shpatit për përhapjen e arsimit e të shkollave në gjuhën shqipe. Analizohet mënyra se si kjo krahinë mundi t'i bëjë ballë presionit të administratës osmane, e cila përpqej të përhapte arsimin perandorak nga njëra anë dhe, nga ana tjetër elementit grek që synonte greqizimin me hapjen e shkollave greke. E reja që sjell ky studim është listimi i të dhënave që vërtetojnë se në periudhën e sundimit osman në krahinën e Shpatit, me gjithë kushtet e vështira u arrit të përhapej arsimi shqip dhe të ruheshin traditat kombëtare autoktone. Kjo qe rezultat i përpjekjeve dhe i vendosmërisë së popullit të kësaj krahine. Artikulli duke studiuar përpjekjet rajonale të arsimit në gjuhën shqipe, si një hallkë e pashkëputshme e zinxhirit arsimor kombëtar sjell ndihmesë në historinë e shkollave dhe të arsimit kombëtar shqiptar.

Fjalët çelës: pushtim, arsimim, tadita fetare, atdhedashuri

SUMMARY

Through the study of this topic I tried to highlight the efforts of the people of the region of Shpati trying to open upschools in Albanian language and maintain their religious traditions. To analyse how this region managed to face pressure that came both from the Ottoman administration which wanted to introduce their own schools and religion, and Greece. What I bring to this study, is the listing of data which proves that during the period of Ottoman rule despite the difficult conditions, the region of Shpat managed to preserve their indigenous religious traditions and Albanian schooling. This was a result of the efforts and determination of the people of this region, which has been characterized by a high spirit of patriotism. This is noted in the existence of a large number of churches prevalent in all the villages and in the long existence of the first Albanian school.

Key words: invasion, education, religious traditions, patriotism

Hyrje

Studimi synon të evidentojë përpjekjet e popullsisë së krahinës së Shpatit për përhapjen e arsimit e të shkollave në gjuhën shqipe, si dhe ruajtjen e traditave të tyre kombëtare. Analizohet mënyra se si kjo krahinë mundi t'i bëjë ballë presionit të administratës osmane, e cila përpqej të përhapte arsimin perandorak dhe t'i islamizojë

ata, nga njëra anë dhe, nga ana tjetër elementit grek që synonte greqizimin me hapjen e shkollave greke. E reja që sjell ky studim është listimi i të dhënave që vërtetojnë se në periudhën e sundimit osman në krahinën e Shpatit, me gjithë kushtet e vështira u arrit të përhapej arsimi shqip dhe të ruheshin traditat kombëtare autoktone. Kjo qe rezultat i përpjekjeve dhe i vendosmërisë

së popullit të kësaj krahine, që karakterizohet nga një frymë e lartë atdhedashurie. Kjo vihet re në hershmërinë e hapjes së shkollave të para shqipe. Artikulli duke studiuar përpjekjet rajonale të arsimit në gjuhën shqipe, si një hallkë e pashkëputshme e zinxhirit arsimor kombëtar sjell ndihmesë në historinë e shkollave dhe të arsimit kombëtar shqiptar.

Pushtimi i gjatë osman që vazhdoi për rreth pesë shekuj me radhë i solli popullit shqiptar vuajtje e fatkeqësi të panumërta. Ky pushtim shkaktoi një gjendje tepër të rëndë e të padurueshme dhe e zhyti Shqipërinë në prapambetje të thellë ekonomike, shoqërore e kulturore. Vetë sistemi feudal – ushtarak i Perandorisë Osmane nuk nxiste zhvillimin kulturor, ai përqëndrohej në shfrytëzimin e fshatarësisë, në veprimtarinë luftarake dhe në përhapjen e fesë islame. Me pak fjalë ky pushtim ndërpreu zhvillimin normal të vendit në të gjitha fushat e jetës. Veprimtaria arsimore e kulturore zhvillohej kryesisht nga komunitetet fetare myslimane, ortodokse e katolike dhe vetëm në gjuhët arabe, osmane, greke e latine (Myzyri 1987).

Shekulli XIX shënoi një kthesë të rëndësishme në historinë e popujve të shtypur të Ballkanit. Në gjirin e këtyre popujve filluan të merrnin hov lëvizjet për pavarësi. Në këto lëvizje u përfshi edhe Shqipëria e cila megjithëse e prapambetur filloi të përjetojë ndryshime të rëndësishme në strukturën ekonomike dhe shoqërore. Shturja e mardhënieve feudale dhe zgjerimi i mardhënieve tregtare çoi në forcimin e lidhjeve ekonomike e shoqërore ndërmjet krahinave duke nxjerrë kështu në pah interesin e tyre të përbashkët dëbimin e sundimit të huaj. Të gjitha këto ndryshime që ndodhën në jetën ekonomike e shoqërore të Shqipërisë u pasqyruan edhe në jetën politike, kulturore e arsimore të popullit shqiptar.

Këto ndryshime marrin hov sidomos në vitet 30–40 të shekullit XIX të inkuadruara në lëvizjen e madhe të njohur në histori me emrin Rilindja Kombëtare Shqiptare. Si detyrë e parë e rëndësishme e rilindasve tanë dilte lëvrimi i gjuhës shqipe, i përhapjes së shkrimit dhe shkollave shqipe. Gjuha shqipe ishte një hallkë shumë e

rëndësishme me anë të të cilës rilindasit tanë mund të bashkonin popullin shqiptar në luftë për çlirimin kombëtar (Histori II, 2002). Por përhapja e arsimit, kulturës kombëtare dhe çelja e shkollave shqipe përbënte një punë të vështirë e cila haste në pengesa të mëdha të brendshme e të jashtme.

Një nga pengesat më të mëdha që duhej kapërcyer ishte qëndrimi i portës së lartë e cila gjithmonë ishte përpjekur ti mbante shqiptarët në errësirë e padituri me qëllim që të shuante çdo shkëndijë në fushën e arsimit dhe kulturës. Pengesa për çeljen e shkollës shqipe sollën edhe shtetet fqinje e fuqitë e mëdha (Myzyri 1973). Proçesit të përpjekjeve dhe dëshirës për përhapjen e arsimit shqip krahas qendrave të rëndësishme të vendit si Korça, Voskopoja, Elbasani iu bashkangjitën edhe njësi më të vogla krahinore të vendit të cilat patën peshën e tyre dhe u bënë pjesë e pashkëputur e zinxhirit të arritjeve në fushën e arsimit dhe të kulturës sonë kombëtare.

Si e tillë përmendet edhe krahina e Shpatit të Elbasanit. Kjo krahinë në gjysmën e dytë të shekullit XIX dhe në fillim të shek. XX ishte mjaft aktive në lëvizjen kombëtare të popullit tonë. Përmendim këtu ndeshjet e zhvilluara nga çetat të cilat drejtoheshin nga Ymer Dervishi nga Valëshi e Isuf Qosja nga Zavalina. Në tetor të vitit 1907 u bë një tjetër ekspedite turke e cila kishte për qëllim të ndërtonte qoftë edhe me pahir një shkollë turke dhe një xhami (Mark Tirta).

Lëvizja kombëtare e Shpatit tërhoqi në mënyrë të veçantë vëmendjen e disa shteteve të huaja. Ato u munduan ta shfrytëzonin këtë lëvizje për interesat e tyre, duke e lidhur atë me traditën e kriptokristianizmit. Një rol të veçantë antishqiptar luante diplomacia greke, e cila i cilësonte shpatarakët si grekë albanofonë, si krahinë me kulturë greke, me psikologji e me zakone greke. Kjo politikë kishte të bënte me pretendimet greke për shtrirjen e territorit të tyre deri në lumin Shkumbin. Por lëvizja antiturke e shpatarakëve nuk kishte të bënte aspak me interesat greke apo të ndonjë shteti tjetër por me interesa thjesht kombëtare shqiptare. Në kushte të tilla shpatarakët arritën të kultivojnë më tej traditat,

gjuhën, kulturën e trashëguar nga të parët e tyre (Nikolaidou 1979).

Në Krahinën e shpatit popullsia dallohej për një frymë të lartë atdhedashurie. Arrijmë në këtë përfundim nisur nga të dhënat e dokumentuara. Kështu qysh herët në Shpat kanë filluar përpjekjet për lëvrimin e gjuhës dhe hapjen e shkollave shqipe. Gjithashtu në krahinën e Shpatit gjëjmë të paprekura dhe të ruajtura me fanatizëm elemente të kulturës fetare vendase. Vendosmëria e tyre për ti ruajtur këto elemente duket në shfaqjen e dukurisë së kriptokristianizmit si dhe në praninë e një numri të madh kishash në këtë krahinë.

Përpjekjet për arsim dhe hapjen e shkollave shqipe

Në Shpat të Elbasanit përhapja e arsimit shqip në shkolla, me mësues shëtitës dhe në forma individuale mori përmasa të tilla sa në një korespondencë nga Elbasani thuhej se Shpati i gjithë ka nis të mësojë shqipen (Myzyri 2004). Kështu në shk. XVII përmendet Anonimi i Elbasanit, Theodor Bogomili i cili krijoi një alfabet origjinal shqip, ku përdoret e folura e Shpatit. Ndërsa në vitin 1872 në statusin e Sillogut të Madh të Stambollit vihet në dukje se edhe në viset e largëta malore siç është Krahina e Shpatit të Elbasanit ka filluar të mësohet fshehurazi gjuha shqipe. Në këtë krahinë kanë dal disa vetë të cilët i nxisin njerëzit e thjeshtë të mësojnë shqip. Megjithëse kjo krahinë ishte më e prapambetur nga pik[pamja e zhvillimit ekonomik – shoqëror krahasuar me qendrat kryesore të vendit, me përhapjen e ideve kombëtare dhe duke e ndier më pak peshën e sundimit osman (favorizuar kjo nga kushtet e relievit), u bë vatër e rëndësishme ku u përhapën shkrimi e shkollat e fshehta shqipe.

Gjuha shqipe në këtë krahinë mësohej me abetaren e Kostandin Kristoforidhit. Kjo gjë shqetësonte si patrikanën e Stambollit ashtu edhe qarqet shoviniste greke (Myzyri 1973). Ndërsa në vitin 1896 banorë të krahinës së Shpatit i dërgojnë një kërkesë fuqive të mëdha në të cilën thuhej: “Ne banorët e krahinës së Shpatit ju drejtohem juve duke ju lutur që të bëni një

demarsh pranë portës së lartë me qëllim që ajo të na akordojë edhe ne një leje për tu arsimuar edhe neve në gjuhën tonë kombëtare si të gjitha kombet e tjera të nënshtruara të Perandorisë Osmane. Duke qënë shqiptar dhe në qendër të Shqipërisë ne nuk kuptojmë as greqishten as bullgarishten e asnjë gjuhë tjetër, dhe nuk mund të shkollohem veçse në gjuhën tonë shqipe.”

Një kërkesë e tillë u përkrah dhe u vlerësua nga vëllezërit Frashëri në Stamboll dhe nga patrioti Murat Toptani. Ata theksonin se kërkesa të tilla duhet të bëjnë edhe krahinat e tjera sepse vetëm kështu theksonin ata do të mund ta detyrojmë portën e lartë të jap leje për hapjen e shkollave shqipe. Por qeveria turke hodhi poshtë çdo kërkesë për hapje shkollash shqipe. Një refuzim i tillë nuk i ndali përpjekjet e shpatarakëve për mësimin e gjuhës shqipe. Në një situatë të tillë mënyra më e mirë për momentin ishte mësimi klandestin i shqipes (Myzyri 1973).

Pasi kërkesa e shpatarakëve nuk u pranua nga porta e lartë dhe shkolla shqipe nuk u hap, ata filluan bisedimet me patriotët korçarë për dërgimin e disa djemëve nga Shpati për tu arsimuar në shkollën e djemve në Korçë me qëllim që të shërbenin si mësues për të arsimuar pjesën tjetër të popullsisë e për rrjedhim ndikojnë kështu në përhapjen e arsimit shqip në të gjithë krahinën. Aq e zjarrtë ishte dëshira e shpatarakëve për të hapur shkolla shqipe sa që pranonin ta kthenin besimin e tyre fetar nga ortodoks, të cilin e kishin ruajtur me fanatizëm si kriptokristianë për rreth dy shekuj, në katolikë duke i drejtuar një kërkesë Papës së Romës vërtet që t’u jepej mundësia të hapnin shkolla shqipe (*Kalendari* 1900).

Patrioti i shquar elbasanas Hysen Ceka ka dhënë ndihmesë të madhe për përhapjen e arsimit shqip në këtë krahinë. Kështu ai i veshur me kostum shpatarakësh, në mënyrë që të mos njihet nga Porta e Lartë, shëtiste nëpër Krahinën e Shpatit, mbledhte nëpër hijet e lisave fshatarë, u shpërndante abetare dhe u mësonte gjuhën shqipe. Hysen Ceka që i gatshëm të shërbente si mësues në Shpat kur në vitin 1897 po flitej për të hapur një shkollë në fshatin Nezhani, megjithëse kjo shkollë nuk u arrit të çelej.

Në vitin 1899 ai jepte të dhëna të rëndësishme për ngjarjet në Shpat, për gjendjen arsimore, për vendosmërinë e shpatarakëve për të mësuar në gjuhën amtare. Përhapjen e arsimit e të shkollave shqipe ai e shihte si mundësinë më të mirë për ti prerë rrugën synimeve dashakeqe greke e turke. Sipas tij të gjitha të këqiat që ne heqim sot nga armiqtë tanë vijnë nga që s'kemi shkolla në gjuhën tonë. Shkollat theksonte ai janë një fuqi e madhe për ti bashkuar shqiptarët dhe për ti bërë njerëz të qytetëruar (Myzyri 2004).

Pas vitit 1900 lëvizja për arsim dhe shkolla shqipe merr përmasa edhe më të mëdha. Kjo gjë dëshmohej edhe nga konsulli rus i Manastirit A. Rostkovskij i cili shprehet se: "Jam duke dëgjuar gjithnjë e më tepër se në të gjitha fshatrat janë duke u hapur shkolla të fshehta ku mësohet alfabeti shqip. Vetë popullsia e dëshmon diçka të tillë vazhdon konsulli. Të gjitha librat dhe gazetatat në përmbajtjen e tyre manifestojnë urrejtje si ndaj Portës së Lartë ashtu edhe ndaj klerit grek" (Myzyri 1973).

Në vitin 1900 me përpjekjet e Isuf Qoses i cili pasi u mor vesh me krerët e fshatit Valësh dhe me ndërmjetësinë e konsullit grek të Manastirit mori leje nga autoritetet turke për të hapur një shkollë gjoja për të mësuar greqisht. Mësuese ishte Amina Bibaja. Kjo shkollë realisht shërbeu si vatër për mësimin e gjuhës shqipe pasi ditën në të mësohej greqishtja dhe natën në fshehtësi të madhe, të mbikëqyrur me roje mësohej gjuha shqipe. Kështu në mënyrë të fshehtë mësimi i shqipes vazhdonte të përhapej në të gjitha fshatrat e Shpatit derisa në 1908 hapen shkollat e para shqipe në Shpat (Elbasani Enciklopedi, 2004).

Mbas fitores së revolucionit Xhonturk të 23 korrikut 1908, u krijuan kushte të reja të favorshme për hapjen e shkollave shqipe në Shqipëri. Sipas kujtimeve të njërit prej mësuesve të parë të Shpatit, Kodhel Dedes nga Nezhari, një delegacion prej njëzetë vetash shkoi në Elbasan për tu takuar me përfaqësues të shoqërisë "Bashkimi", për të uruar siç thotë Isuf Qosja "Shyqyr që ia arritëm kësaj dite" dhe për të biseduar për hapjen e shkollave shqipe në Shpat

(Kujtime të Kodhel Dedes, *Arkivi i Muzeut, Elbasan*).

Gjatë bisedës Isuf Qosja i drejtohet Aqif Pashës: "Na duhen katër mësues për Shpatin". Aqif Pasha i përgjigjet: "Na batë me turp o shpatarakë se s'kemi mësues. Ata që patëm i qitëm nga Gryka e Zaranikës, nga Krraba dhe Cermenika". Isufi i përgjigjet prap: "Kemi nja katër a pesë djem shpatarakë këtu, t'u bajmë provim dhe t'i nxjerrim mësues". U ngarkua Alush Efendi Saraçi i që t'i provonte a ishin në gjendje për tu bërë mësues. U futën në provim Kodhel Dedja (Nezhar), Sulë Panxhi (Valësh), Dylë Dervishi (Valësh) dhe Cane Sharra (Pashtresh), të cilët fituan dhe u caktuan mësues për krahinën e Shpatit.

Shkollat shqipe në Shpat filluan në vjeshtën e dytë allaturka të vitit 1908. Në vitin 1909 të gjithë nxënësit e krahinës së Shpatit vinë në Elbasan, në Klubin "Bashkimi", për të dhënë provim. Provimet dolën me sukses, nxënësve iu shpërndanë edhe dhurata. Të hollat e materialet do të siguroheshin nga klubi (Kujtime të Kodhel Dedes, *Arkivi i Muzeut, Elbasan*). Në qershor 1909 një grekoman shqiptar thotë se: "Sa për Shpatin e kemi thanë në tjetër herë që ka katër mësonjës në gjuhët shqipe e në greqisht asnjë. Shpati sot i gjithë ka zënë të mësojë shqipen, ene nuk asht çudi të thom se, në kërkofshim trakaçet e barinjve, ene atje kemi me gjetur libra shqipe gjithfarësh, me një ksi vendi ç'duhet mësonjtorja greqisht" (Liria, nr. 49, 1909).

Me këtë përhapje masive që kishte marrë mësimi i gjuhës shqipe problem tashmë dilte përdorimi i një alfabeti të njësuar që u vendos në kongresin e Manastirit më 1908. U deshën vite që të vendosej alfabeti më i përdorshëm.

Edhe për këtë problem shpatarkët iu përmbajtën vendimeve të kongresit dhe prerazi u shprehën se: "Kena dhanë besën për këto shkronja shqipe, kto kena me majt, kto kena me xanë dhe për kto kena me luftue me ata që duan me zor me na fut shkronja arabçe (Bashkimi i Kombit, nr. 22, 1910).

Ruajtja e traditave fetare

Periodha e pushtimit osman e ndërlikoi shumë tablonë fetare jo vetëm në krahinën e Shpatit por në të gjithë vendin. Tipike e kësaj periudhenë kra-

hinën e Shpatit është shfaqja e dukurisë së kriptokristianizmit ose të dybesimit. Për të ruajtur traditat e tyre fetare kristianët e Shpatit të favorizuar nga terreni malor dhe nga mungesa e kontrollit të vijueshëm administrativ vazhduan të praktikonin në fshehtësi ritet e fesë ortodokse dhe në sytë e administratës osmane shtreshin sikur ishin konvertuar në myslimanë (Duka 2007). Kjo lëvizje nuk nisej nga motive thjesht fetare, as nga ato ekonomike, por nga interesa të mirëfillta kombëtare. Këtë e vërteton fakti që ky fenomen pushon së ekzistuari fill pas shpalljes së pavarësisë. Duke u arsimuar në gjuhën e tyre kombëtare, duke ruajtur me fanatizëm traditat e tyre fetare ata do të mund ti bënin ballë politikës shkombëtarizuese, asimiluese, greqizuese të kishës ortodokse e cila përpigjej tu impononte liturgji në gjuhën greke dhe të hapte sa më shumë shkolla greke.

Nga ana tjetër administrata osmane nuk i lejonte ata të arsimoheshin në gjuhën e tyre amtare. Duhet theksuar se ky fenomen nuk u bë burim përçarje në mes të banorëve pasi mbi gjithçka qëndronte çështja kombëtare (Skëndi 1980). Përveç dukurisë së kriptokristianizmit të dhëna të tjera të rëndësishme që vërtetojnë se shpatarakët i kanë ruajtur me fanatizëm traditat e tyre fetare janë edhe të dhënat materiale, ekzistenca e një numri të madh kishash një pjesë e të cilave ruhen deri sot.

Është interesant fakti që në të gjitha fshatrat e Shpatit gjenden, përveç kishave ekzistuese dhe një numër i konsiderueshëm rrënoja kishash të madhësive të ndryshme, mesatarisht pesë kisha në çdo fshat. Mendohet se disa nga këto kisha janë ndërtuar që në fillimet e krishtërit.

Përfundim

Një rol të rëndësishëm në ruajtjen e vlerave artistike e kulturore në Shpat, sidomos pas shekullit XIII ka luajtur Kisha ortodokse. Për rëndësinë e Shpatit dhe për zhvillimin e tij ekonomiko - kulturor flasin edhe pikturat murale të kishave të Shelcanit e të Valëshit.

Në këto kisha ushtruan dhe shpalosën talentin e tyre piktorët e mëdhenj si Onufri më të birin e tij Nikollën të shek. XVI. Më pas anonimë të tjerë kanë vazhduar punën pa na e lënë emrin e tyre derisa vijmë në shek. XVIII tek piktori i shquar ikonograf Kostandini (Popa 1955).

Bibliografi

- ARKIVI i Muzeut Elbasan, Kujtime të Kodhel Dedes.
- BASHKIMI i Kombit (1910), nr. 22, Manastir.
- DUKA, F (2007), *Shekuj osmanë në hapsirën shqiptare*, Tiranë.
- ELBASANI Enciklopedi (2004).
- HISTORI e popullit shqiptarë II, (2002), Tiranë.
- KALENDARI Kombiar, Ngjarjet e Shpatit (1900), Sofie.
- LIRIA (1909), nr. 49, Selanik.
- MYZYRI, H (1973), *Shkollat e para kombëtare shqipe*, Tiranë.
- MYZYRI, H (1987), *Mësonjëtorja e parë shqipe e Korçës*, Tiranë.
- MYZYRI, H (2004), *Shkolla Normale e Elbasanit*, Tiranë.
- NIKOLAIDHU, E (1979), *Kriptokristianët e Shpatit*, Janinë.
- POPA, Th (1955), Piktor Kostandini prej Shpati: *Buletini për shkencat shoqërore*, nr. 4, Tiranë.
- SKËNDI, S (1980), *Studime kulturore ballkanike*, Tiranë.
- TIRTA, M, Shpati në vështrim historik etnokulturor, *Shpati i Sipërm..*

KRIJIMTARIA POETIKE E NAIM FRASHERIT PËRMES TEKSTEVE TË LETËRSISË SË SHKOLLËS SË MESME

THE POETIC CREATIVITY OF NAIM FRASHERI THROUGH HIGH SCHOOL LITERATURE TEXTBOOKS IN ALBANIA

IRMA BILALI SOKOLI
Email: siisokoli@gmail.com

AKTET VII, 4: 327 - 332, 2014

PERMBLEDHJE

Qëllimi i këtij punimi është të nxjerrë në pah mënyrat në të cilat është trajtuar figura e poetit kombëtar në librat e letërsisë të shkollës së mesme. Probleme të ndryshme janë vërejtur në interpretimin e veprave poetike të përzgjedhura për studim. Qasja ndaj poezisë së Naimit, është thelbësore për objektivat e të mësuarit të lëndës së letërsisë sidomos në tekstet e shkollave të mesme. Është e rëndësishme që të paraqesin një plan krahasues diakronik dhe bashkë-tekstual mbi diversitetin e shkrimeve të mundshme. Në analizat kushtuar figurës së Naimit dëshmohet vlerësimi i poetikës naimjane si një aspekt teorik-orientues për nxënësit e shkollës së mesme. Krijimtaria poetike e Naimit është përshkruar në mënyra të ndryshme, shpesh si modele të ngurta dhe stereotipe të cilat nuk marrin parasysh identitetin dhe diversitetin e vlerave estetike. Sugjeroj se është vendimtare të shqyrtohet rrjedha e analizës shkencore tekstuale ndaj kësaj krijimtarie.

Fjalët çelës: analizë, shkollë, tekste, identitet, objektiva, historiografi letrare.

SUMMARY

The purpose of this paper is to highlight ways in which the figure of our national poet in literature books Albanian school is handled. Various problems are observed in the interpretation of the poetic works. Naim's approach to poetry is essential to the learning objectives of the subject of literature in high school textbooks. It is important to present a comparative view in a diachronic and co-textual plan on the diversity of possible writing. In the analysis devoted to Naim Frasheri, the embodiment and evaluation of the ideas, language and structure of his poetry are proved as an aspect of theoretical orientation for the students. Naim's poetic creativity is often described in solid models and stereotypes which does not take into account the comprehensive identity and diversity of aesthetic values. I suggest that is decisive to be reviewed the course of scientific textual analysis of this poetry.

Key words: analysis, school, text, identity, objectifs, literature historiography.

HYRJE

Trashëgimia kulturore e një kombi është tregues i rëndësishëm identitetit dhe autenticitetit të tij, ajo i përket memories sonë të përbashkët dhe më shumë se kujtdo i përket së ardhmes e në këtë kontekst brezit të ri, i cili rritet dhe edukohet në shkollë. Tradita e studimit të letërsisë lidhet ngushtë me shkollën dhe shoqërinë shqiptare. Nëse ne sot kërkojmë rritjen në nivelin e

erudicionit letrar e gjuhësor të nxënësit në shkollën e mesme duhet të jemi të qartë në konceptet dhe problematikat që shtrohen përta i përket aftësive që nxënësit dëshmojnë. Për të arritur këtë lind nevoja të bëjmë një analizë për programet dhe tekstet e kësaj lënde nga disa këndvështrime të caktuara.

Disa nga problemet e programeve dhe teksteve të letërsisë e të gjuhës shqipe që kohët e fundit

del e integruar me letërsinë janë identifikuar në diskutime, analiza e studime të niveleve mediatike e në qarqe akademike. Duke konsideruar materialin letrar dhe aparatën didaktik një element bazik për kulturën letrare e më gjerë, përzgjedhim një nga emrat kryesorë të gjithë historisë së kombit si figura më e trajtuar në tekstet shkollore të letërsisë.

Përse Naimi dhe përse tekstet shkollore?

Përse Naimi dhe përse tekstet shkollore? Sepse tekstet shkollore janë pjesë e historiografisë letrare shqipe dhe si e tillë trajtesa bëhet pjesë e një kërkimi më të gjerë brenda kësaj disipline.

Vetë Naimi më 1886 shkruan *‘Istori e Shqipërisë për shkollat e para’* brenda tekstit *“Istori e përgjithshme”* shtypur në Bukuresht prej shoqërisë Drita. E po ashtu *“Vjersha për mësonjëtorët e para”* të shtypura gjithashtu prej shoqërisë Drita (Vozga 2010: 306). Arsyeja tjetër ka të bëjë me faktin se tekstet shkollore janë një burim i përbashkët dijes që rrjedh në shkollë dhe që shpërndahet gjithandej duke gjeneruar një bashkëjetesë solide mes të gjithëve ne. Së fundmi në gjykimin tim si mësimdhënëse në boshitin aksiologjik mbi të cilin shtrihet historia e letërsisë shqipe personaliteti i Naim Frashërit është një gur kilometrik me një rëndësi esenciale. Në një raport përpjestimor të vendit që autorët zënë në historinë e letërsisë shqipe, është e vërtetë fakti se N. Frashëri zë një vend të madh në programin e lëndës së letërsisë.

Sa herë kemi dëgjuar e kemi recituar vetë vargjet naimjane *“Ti Shqipëri më jep nder, Gjuha jonë sa e mirë”* apo ka jehuar vargu *“O malet Shqipërisë”* jemi ndjerë me të vërtetë krenarë që mund të përcjellim me ndjenjë dhe emocion frymën shqiptare të parardhësve. Poezia naimjane bëhet kështu një varg kult që na transmeton një mesazh të rëndësishëm. Në mënyrën më të zakonshme këto vargje mësohen në shkolle e janë pjesë pothuaj e të gjitha teksteve shkollore të leximit letrar e të letërsisë (pavarësisht alternativave sipas shtëpive të ndryshme botuese) në gjithë arsimin parauniversitar. Megjithatë përngulitjes në mendjen dhe zemrën e pothuaj

çdo shqiptari të vargjeve më të ndjera nga bota poetike e N. Frashërit falë kjo kryesisht përgjithësimi të tyre në orët e mësimi në shkollë, besoj se ka akoma për të shqyrtuar dhe për të nxjerrë në dritë nga vlera e krijimtarisë së këtij autori. Përmundur në një artikull të vetëm të bëjmë pjesë të shqyrtimit të gjitha tekstet e dala në qarkullim ndër vite do të bazohemi për trajtesën tonë tek ato më të përdorurat.

Kërkesat e programit lëndor

Në kurrikulën lëndore nga viti në vit vërehen pikëvështrime të ndryshme në lidhje me krijimtarinë naimjane. Kryesisht artikulli është ndalur në trajtimin e figurës së Naimit në disa pak tekste të viteve ‘30, në ato të pas ‘44, tekstet e viteve ‘90 dhe ato që mësohen sot nga nxënësit tanë. Në tërësi, objektivat në lëndën e letërsisë kanë të bëjnë me:

- Njohjen e vlerave ideore dhe artistike të letërsisë shqipe dhe vështrimin e saj në kuadrin e kulturës kombëtare dhe botërore.
- Aftësimin teorik e praktik për zotëri mbi koncepte letrare e shkencore.
- Pajisjen me informacione në fushën e arteve dhe të shkencës

Që nga viti 1936 kur E. Çabej shkruan ndër të parët tekste (tekst mirëfilli pragmatist e quan autorja e parathënies së ribotimit Ledi Shkreli) me pjesë të zgjedhura nga literatura letrare për shkollat e mesme, njihet gjithashtu si i tillë edhe teksti i hartuar nga Justin Rrota apo ai i Namik Resulit *“Shkrimtarë shqiptarë”* në dy vëllime i iniciuar nga Instituti i Studimeve Shqiptare, e deri në botimet e vitit më të fundit shkollor emri dhe vepra e Naim Frashërit nuk kanë munguar asnjëherë në kurrikulën lëndore të letërsisë në arsimin e mesëm në shkollën shqiptare.

Në të gjithë këta libra vlerësohet lart figura e Naimit duke u quajtur si apostull i idesë nacionale (Çabej: 2009), poeti kombëtar i shqiptarëve, figura qendrore e Rilindjes. Në përfundim të analizës së tij mbi N. Frashërin Çabej e quan atë patriot pan shqiptar, bir i vonë i roman tizmit, të ndikuar nga shkrimtarët frëng. Këtë influencë studiuesi e sheh të përzierë me ndikimin e poezisë perse, e cila shfaqet me ngjyra mi stike

islamike në vargjet e Naimit. Gjithashtu autori i tekstit i njeh Naimit veçorinë e të jetuarit brenda në histori dhe, si pasojë trajton lëndën historike në veprat e tij (Çabej: 2009).

Emri dhe vargjet e Naimit përpara se të vinin tek ne kanë kaluar nga dora e prindërve tanë, gjenden në biblioteka, pothuaj të çdo shtëpie, si vëllim më vete ose brenda teksteve mësi more të koleksionuar ndër vite, duke kontribuar të ndërtojmë njohjen tonë kolektive. Sigurisht që nga Çabej deri tek autorët e librave të fundit shumë gjëra kanë ndryshuar, ashtu siç ka ndryshuar dukshëm edhe shoqëria jonë e sistemi ynë arsimor.

Tekstet e letërsisë deri në vitet '90

Tekstet shkollore të letërsisë të hartuara dhe të botuara në proceset e ndryshme refor muese, kanë bërë kthesa të dukshme në periudha e situata të ndryshme të historisë gati 100-vjeçare të shkollës shqipe.

Në rrjedhë të viteve konceptimi i teksteve për lëndën e letërsisë ka ndryshuar i ndikuar nga faktori letrar dhe jashtëletrar. Politikat arsimore në kohë të ndryshme kanë bërë që të botohen një shumëllojshmëri tekstesh qoftë nga aspekti historik, qoftë nga aspekti strukturor i trajtimit të letërsisë. Kryesisht në tekstet e letërsisë është paraqitur një formë panoramike e për shkrimin historik të epokës letrare, është trajtuar gjerësisht biografia e shkrimtarit dhe është lënë më pak vend për kritikën interpretuese dhe teorinë e recepsionit nga vetë lexuesi (nxënësi). Përgjithësisht gjatë dekadave të kaluara është synuar që të emetohet një model i cakutuar i njohjes dhe interpretimit të letërsisë. Përgjithësisht është konceptuar historia e letërsisë si një formë mësimi për letërsinë shqipe. Madje dhe vetë tekstet janë titulluar si histori letërsie (*Hist. e let.* Grup autorësh: 1985). Në kuadër të këtij konceptimi janë trajtuar edhe periudha të rrara e veprat e shkrimtarëve të lidhura ngushtë me historinë e kombit. Një formë e tillë studimi është ndjekur edhe në shumë tekste të tilla të këtij lloji, duke qenë se është edhe më e njohura dhe më e përdorura nga historicienët e letërsisë

në shumë vende të botës. Teoricienët e huaj pohojnë se ndarja e historisë së letërsisë sipas shekujve është një ndarje komode.

Gjatë viteve të izolimit totalitar sistemi arsimor drejtohej nga ideologjia komuniste dhe letërsia, si të gjitha artet dhe shkencat e tjera ishte nën kontroll të rreptë. Në librat e historisë dhe të letërsisë dënohej dhe demaskohej klasa e bejlerëve dhe kulakëve prej nga vinte dhe vetë Naimi. Megjithatë e gjithë Rilindja është meri të e kësaj klase. Ata e bënë Shqipërinë të pavarur. Studiuesi R. Qosja shprehet për disa probleme në lidhje me aspektin studimor të letërsisë e respektivisht edhe mbi veprën në fjalë. Edhe në *Historinë e letërsisë shqipe* (1955) për shkollën të mesme të prof. Dhimitër Shuteriqit janë shprehur qëndrime të njëanshme për shkak të shikimeve ideologjike e politike të lëndës letrare (Qosja 2000).

Pas viteve të '90-ta

Në programin e pas viteve '90 përkatësisht në vitet 91-95 në kohën kur unë personalisht ndiqja shkollën e mesme lënda e letërsisë zhvillohej në pjesën më të madhe me shënime të diktuar pasi librat që kishin ekzistuar nuk mund të përdroreshin më. Studimi i letërsisë strukturohej në këto nivele. Njohja e parë me lëndën përqendrohej tek teoria e letërsisë e cila studiohej në fillim duke u ndjekur më pas nga letërsitë sipas ndarjes kronologjike; dhe shqiptare apo e huaj e vjetër, e Rilindjes dhe Bashkëkohore.

Më pas dalin botimet e reja të letërsisë për shkollat e mesme. Gjatë viteve 1996-1998 u hartuan tekste mjaft të arrira të letërsisë shqiptare dhe botërore, në krahasim me ato që ishin botuar deri atëherë sipas vlerësimit të autores së mjaft teksteve shkollore Rita Petro.

Vepra e Naimit sigurisht nuk mund të shihet e ndarë nga periudha letrare e Romantizmit apo në emërtimin tonë Rilindja Kombëtare Shqiptare. Dy emërtime që prej disa studiuesve shihen edhe si paradoksale, përkatësisht S. Çapaliku, duke bërë një krahasim me zhvillimin e historisë së letërsisë europiane (Çapaliku: 1995: 30). Edhe këtu

ndoshta duhet të ndalen studiue sit për të rishikuar proceset letrare shqipe.

Në këto botime, Naim Frashëri si personalitet studiohet në *Letërsia Shqiptare 2*, ku traj tohet Rilindja Kombëtare dhe Romantizmi Shqiptar me veçoritë dhe autorët përkatës, pas Letë rsisë së Vjetër shqipe.

Një ndryshim në vlerësimin ndaj figurës së Naimit vë re F. Dado në *Sfida të historiografi së shqiptare* kur pohon se “përjetimet estetike dhe vështirimet interpretuese të studiuesve kanë ndryshuar nga koha në kohë në vlerësimin ndaj figurës së Naimit” (Dado: 2009: 311).

Si është prezantuar Naimi në librat aktualë?

Në botimin shkollor të sipërpërmendur trajtohet gjerësisht biografia dhe bota poetike e Naimit duke e ndarë atë sipas motiveve që përbëjnë poezinë e tij. Në fund përmblihet edhe mendimi kritik i disa prej studiuesve dhe mendimtarëve shqiptarë (Letërsia shqiptare 2: 2001: 181-249). Në gjithë këtë paraqitje Naimi vlerëso- het krye- sisht si poet lirik dhe analizohet më gjerësisht poezia me motiv meditativ-filozofik. Lirikat e Naimit analizohen me hollësi duke konsta- tuar që në fillim se ato zënë vendin kryesor në krijimtarinë e poetit. Nga ato me motiv meditativ-filozofik, si “Fjalët e qiririt” dhe “Fyelli”, “Në bregdet” kalohet në analizën e poetikës me mo tiv erotik ku gjenden si të pandara e trajtohen në vargje si shkak-pasojë “Dashuria” dhe “Bukuria”. Shqyrtohet tema patriotike, e cila gjen përhapje të gjerë në poezitë naimjane nëpërmes ilu - strimeve të vargjeve e komenteve të studiuesit. I kushtohet një vend i rëndësishëm interpretimit tematik dhe motiveve të veprës “*Bagëti e bujqësi*”.

Një risi vihet re në vëmendjen që i ku sh tohet studimit stilistik të tekstit, fragmentit, duke iu larguar pak tematikës apo historizmit të te pruar. Në përvojën time dhe nga bashkëbisedimet me kolegë do ta vlerësoja këtë model libri si më të arriturin profesionalisht të botuar deri më tani.

Në vitin 1999-2000, me një vendim të me- njëhershëm, u hodh nga MASH-i projekti për pro- filizimin e shkollave. Në këta modele librash ve- pra e Naimit trajtohet në klasën e 11 të shkollës

së mesme ku analizohet vëllimi “*Lulet e verës*” në mënyrë të përgjithshme, duke prekur nga pak të gjitha aspektet e poezisë naimjane, por duke u shmangur nga detajet dhe analizat e hollësishme stilistike (*Gjuha shqipe dhe letërsia 11: 2007: 208*).

Çka nuk duhet të studoihet sipas programeve

Vitet e fundit, ndryshimi i sistemit të arsimit të mesëm nga 4 vjeçar në 3 shoqërohet me ndryshime në tekstin mësimor të shkollës së me- sme, i cili na del i integruar me gjuhën shqipe dhe orët mësimore, në të cilat kjo lëndë zhvillohet janë më të reduktuara. Si rrjedhojë letërsia në vetvete si lëndë vjen e tkurret dukshëm, dhe au- torët trajtohen shumë më përciptazi e jo në më- nyrë të thelluar. Në shkallën e nivelit arsimor të shkollës së mesme programi i mësimi të letërsisë parashikon zgjerimin dhe thellimin e kom- petencave dhe njohurive të përfutuara në arsimin 9-vjeçar, trajton objektin e studimit që nga klasa e parë e gjimnazit, duke u vendosur progresivisht deri në provimin përfundimtar.

Gjatë studimeve të nivelit të mesëm tek nxënësit shtrohet nevoja e aftësimit me njohuritë përkatëse të formimit të përgjithshëm që duhet të zotërojë në përfundim të këtij cikli shkollor. Në këtë koncept lënda e letërsisë është ndo shta lënda më e domosdoshme për formimin in telektual dhe kulturor të të rinjve.

Në strukturën aktuale të kurrikulës së le tërsisë në shkollën e mesme përveç *Letërsisë dhe gjuhës shqipe*, si lëndë e detyruar zhvillohet dhe *Lënda e letërsisë me zgjedhje*, e cila parashi kon një studim më të thelluar rreth disa autorë ve dhe veprave të tyre. Programi i lëndës së letë rsisë si lëndë me zgjedhje është konceptuar në një modul të ndërtuar në bazë teme. Kjo ju jep mundësi nxënësve për të folur, dëgjuar, lexuar, shkruar, sidomos për të debatuar dhe gjykuar rreth problematikave dhe çështjeve të veçanta.

Edhe më tej vepra e Naimit nuk është trajtuar e plotë në librat shkollorë

Në librat e gjimnazit përzgjedhja e mate rialit letrar ruan raportin 40% letërsi e huaj dhe 60% letërsi shqipe me përzgjedhje të përshtat shme

për grupmoshat e caktuara. Ky është një kriter i detyrueshëm për hartuesit e teksteve, por dhe për mësuesit që punën e tyre e bazojnë mbi këto tekste. Sigurisht në kushtet e sotme një nxënës brenda një viti shkollor për objekti vat dhe programin mësimor punon më shumë se me një tekst shkollor, por gjithsesi baza kryesore mbetet tek teksti edhe në rastin kur ai është udhërrëfyes drejt hapësirave të tjera informu ese jashtë mureve të ngurta të shkollës. Faktori kulturor është një element i rëndësishëm iden ti fikues për shoqërinë dhe krejt kombin.

Politikat botuese në lidhje me reformimin e teksteve letrare, prurjet alternativë, përbëjnë sot risi, por edhe shfaqin problematika në lidhje me konceptimin e analizës studimore. Nevoja për të komunikuar në mënyrën më të qartë, të saktë dhe ekonomike me marrësin (nxënë sin) prodhon edhe vetë stilin. Letërsia shqipe është një letërsi me tipare kryesisht nacionale dhe veçanërisht periudha e Rilindjes Kombëtare ushquu tek njerëzit më shumë se në çdo periudhë tjetër dashurinë për kombin e gjuhën shqipe. Në këtë këndvështrim poezia naimjane është ndoshta kulmi më i lartësuar i kësaj periudhe. Kjo vepër sigurisht përfaqëson pjesën më të avancuar, më të përparuar inteligjencës patriotike demokratike shqiptare. Mirëpo, brenda tërësisë së teksteve mësimore mund të dallohet se vepra e Naimit nuk është trajtuar në mënyrë të plotë, përkatësisht në pajtim me nevojat dhe mundësitë e pranimit nga nxënësit e kësaj moshe, as brenda ideve të theksuara kombëtare e njerëzo-re e as si vlerë estetike e realizuar me anë të një gjuhe të fuqishme figurative, që ka shtrirje dhe rrezatim të fuqishëm në krejt periudhën pasuese deri në fillimet e letërsisë moderne shqipe.

Autorët romantikë dhe veçanërisht Naimi i dhanë emocionit një nivel të ri vlerash, por gjithashtu ripërcaktoi cilësinë e veçantë të tyre. Ata gjithashtu ripërcaktuan rolin e emocionit në kuptimin e realitetit. Ndoshta kjo duhet të jetë një pikë e cila mund të zgjerohet nga institucionet e mendimit kritik dhe hartuesit e teksteve, pasi nxit mendimin krijues dhe drejton për interpretime të shumanshme nxënësit. Në programin lëndor të gjimnazit parashikohet që vepra e Naim Frashërit

të punohet në klasën e 10-të dhe të 11-të, përkatësisht analiza përqendrohet në poemthin *Bukuria* dhe poezia "*Fjalët e qiririt*" (*Gjuha Shqipe dhe letërsia* 10, 11: 2010). Analiza e kësaj të fundit ndjek pothuaj të njëjtën linjë me studimet parardhëse (por krejt në mënyrë të përmblodhur) duke e quajtur poezi e filozofisë aktive e cila pasqyron bindjet e autorit, i cili ndërton ura lidhëse mes literaturës feta re dhe asaj shkencore. Kam parasysh këtu librat e shtëpisë botuese Albas, të cilat duket të kenë gjetur përdorim më të gjerë vitet e fundit.

Tekstet e letërsisë vazhdimisht kanë gje neruar informacione, konceptime dhe analiza të shumëllojshme mbi shkrimtarët dhe periudhat. Procesi i të mësuarit të lëndës së letërsisë si një qëllim pedagogjik në vetvete nuk mund të arrihet pa këto struktura. Aparati pedagogjiko-shke ncor i teksteve të letërsisë është i modeleve të ndryshme duke synuar që nga pyetjet me nivel riprodhues e deri tek ato sintezë. Mendimi kritik dhe proceset e përfshira në të janë elementë thelbësorë të programit mësimor parauniversitar dhe veçanërisht atij të letërsisë në gjimnaz.

Të japësh mësim lëndën e letërsisë do të thotë të tregosh një rrëfim të themeluar mbi një letërsi-identitet kombëtar-histori. Çdo po pull gjen identitetin e tij të vërtetë në një farë tregimi mitik.

Përfundim

Cilësia sigurisht përbën shenjëzimin e kahlmotshëm dhe të derisotshëm të arsimit (Shamata 2010). Ky nocion kompleks lidhet sigurisht edhe me një mjet kaq të rëndësishëm siç është teksti. Duke mbajtur parasysh, objektivat kryesore të arritjes, që kanë të bëjnë me aftësimin e nxënësit për të analizuar, gjykuar dhe mbajtur qëndrim ndaj veprës letrare, ideve dhe mesazheve që ajo përcjell, procesi mësimor do të mbështetet në përdorimin e një larmie aktiviteteash nxënieje, nga diskutimet në grup, tek ushtrimi sistematik i nxënësit në punimet me shkrim dhe prezantimet gojore. Në kërkim edhe të motiveve të reja burimi kryesor për arritjen e këtyre synimeve mbetet pa asnjë dyshim libri i letë-

rsisë, duke i shtuar pastaj gjithë arsenalin e nevojshëm në shërbim të nxënësit. Nëpërmjet, interpretimit të saktë dhe analizës së kujdesshme e të detajuar poezia e Naimit do të jetë në gjendje të prodhojë procese transformuese. Duke rigjeneruar relacionet ndërpersonale dhe të përbashkëta, zgjon forma të reja të reja të vetëdijes dhe energji projektuese që hapin horizonte të reja drejt avanguardës.

Bibliografia

BULO, Jorgo, XHIKU Ali etj. (1985), *Historia e letërsisë shqiptare 1* (për shkollat e mesme), ShBLSH, Tiranë.
 ÇABEJ, E. (2009), *Elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe*, excipere, Çabej, Tiranë.

ÇAPALIKU, Stefan (1995), Paradokse historiko-estetike: *Historia e letërsisë si grindje metodike*, Tiranë.

DADO, Floresha (2009), *Sfida të historiografisë letrare*, Bota Shqiptare, Tiranë.

KODRA, Klara, FILIPI, Rita, ÇAPALIKU, Stefan (2001), *Letërsia Shqiptare 2*, Shblsh, Tiranë.

MARASHI, Ardian; HAMITI, Sabri; MËNIKU, Linda; SHEHRI, Dhurata (2007), *Letërsia dhe Gjuha Shqipe 11*, Albas, Tiranë.

PETRO, Rita, MËNIKU, Linda, MARASHI, Ardian (2010), *Gjuha Shqipe dhe Letërsia*, Albas, Tiranë.

SHAMATA, Halit (2010), *Mësuesi*, nr. 3, qershor.

VOZGA, Ramazan (2010), *Libri shqip 1555-1912*, Biblioteka Kombëtare, Tiranë..

ALBANIAN CRITICISM OF DIASPORA

KRITIKA SHQIPTARE E DIASPORËS

LEKA NDOJA

Universiteti Shtetëror i Tiranës, Fakulteti i Histori Filologjisë, Tiranë, SHQIPËRI

Email: vretheeln@yahoo.co.uk

AKTET VII, 4: 333 - 337, 2014

PERMBLEDHJE

Funksioni kritikës si nënsistem letrar i diasporës (1944-1990) shmanget nga qendra sisteme: si rirreceptim në Historinë e Letërsisë. Identifikimi kritikës letrare shqiptare: Gradilone, Camaj, Shllaku, Sini shta. Revistat, Shëjzat, Koha Jonë, BKS. Rrëzimi normave letrare Tiranë-Prishtinë: dikotomi sisteme vlerash autorë/vepra të qendrës letrare. Kritikën e diasporës si *tamisdate*: rimarrja koncepteve të kritikës si bazë etike. Funksioni i teorisë shkencore si metodë ndërkulturore në Diasporë, model qasjeje mes vëllimeve: kritika jashtë dhe qendra sisteme. Ndërkulturore dhe komparative për kritikën Perëndimore ndaj agregateve kulturore të qendrës. Qasja faktorëve jashtëletrarë përcaktues *tehuajsimi* gjuhësor. Përzgjedhja, nga teoria e suksesit të qendrës ndjekur nga kritika. Kritika diasporës ofron konceptet e sta-tusit të letërsisë si normë etike. Bartja e funksionit të traditës: dallueshmëri ndaj retorikës qendrore për "të rene ideologjike", rivendos normën universale si historiografi letrare në kohë dhe vëllim: plotësim dhe jo rishkrim i historiografisë.

Fjalët çelës: Kritika, Shëjzat, tëhuajsimi, norma, vëllimi.

SUMMARY

The function of Albanian criticism as Diaspora literary under-system developed in 1944-1990 pe riod, uncharted from the center of system: as new receptivity in Literary History. Identification of Albanian literary critic from Gradilone, Camaj, Shllaku, Sinishta in the Shëjzat, Koha e Jonë, Albanian Catholics Bulletin reviews. The falling of the literary norms at Tirana-Prishtina centers from these critic: as dichotomy of value system for authors and works of literary center. The reception of exile critics as *tamis-date*: the reactions of conceptual critics as ethics base. The scientific theories function as application of intercultural methods at Literary Circles as a model for comparative approaching between exterior and inside critic volumes in Systemic Literary Center. Intercultural and comparative for the Western critic for center cultural aggregates. Approaching extra literary factors determinate the linguistic alienation. Selection, from theory of success of center followed from critics. The Diaspora criticism offer the literary status concepts as ethic norms. The transfer of traditional function: discerning from rhetoric center of "the Ideological new", replace the norm for the Universal norm of Literary Historiography in temps and volumes: as completion nor as rewriting of Historiography process".

Key-words: Criticism, Shëjzat, alienation, norm, volume.

Hyrje

Krahas zhvillimit të një letërsie shqiptare në Diasporë në vitet 1944-1990 me autorët më të njohur, si Koliqi, Camaj e Pipa jemi ndalur në identifikimin dhe shqyrtimin e tipologjisë së kritikës dhe të funksionit të saj në kohë dhe si premisë për plotësimin e tablosë kritike në sistemin le

trar kombëtar. Duke qenë se historiografia zyrtare dhe në opuset kritike të autorëve qendër-sisteme janë privuar subjektet e prodhimit kritik të diasporës, qëllimi i kërkimit ka synuar: rileximin e kritikës shqipe brenda nënsistemit letrar kombëtar të diasporës zhvilluar në katër dekada; argumentimin e autonomisë kritike konceptuar

përmes dallimit të funksioneve të kësaj kritike, si *tipare bazë të kritikës* së diasporës.

Përcaktuese në vëllimin e kritikës së zhvilluar në diasporë, kanë qenë revistat letrare-kulturore më të rëndësishme, si kohëzgjatje dhe pra ktika kritike shkencore njëjshëm me studimet universitare të shkollave që u përkisnin në Romë, Palermo, Napoli, Mynih, Columbia Un. etj.: *Shëjzat* 1957-1978, *Koha e Jonë* 1962-1992, *BKSH* 1981-1994. Për përcaktimin e funksioneve të kritikës kemi parashtruar një skemë me 3 komponentë të kritikës së diasporës:

1) Komponenti i funksionit inherent të kritikës së diasporës: e cila përcaktoi metodat dhe teoritë e përshtatshme të brendshme në për zgjedhjen dhe analizimin e veçorive artistike, por edhe koncepteve të veprës, grupi veprash apo të objekteve studimore të Sistemit Letrar Qendror krahas atyre (më të pakta) të Nën sistemit Letrar të Diasporës;

2) Komponenti i funksionit të kritikës nisur nga modeli i ndërkulturalizmit: atij estetik dhe ndikimit të "të huajës si gjuhë" dhe derivateve të saj kulturore të Perëndimit, në ndërkëmbimin deri të huajsimin e kanalit lingistik të prodhimit studimor kritik, duke ofruar modelin estetik të shijes dhe të qasjes lidhur me objektet e marra në shqyrtim me monumentet klasike, apo moderne letrare-kulturore të Perëndimit;

3) Komponenti i funksionit etik dhe metakritik i kritikës shqiptare në diasporë të demostruar krahas studimeve në një agregat veprimtarish kulturore në Perëndim: simpoziume, konfere nca, qendra studimore universitare, kremtime etj.

Materialet dhe metodat

Kritikat dhe studimet e botuara nga auto rët në revistat letrare: *Shejzat* (Romë), *Koha e Jonë* (Paris), *Buletini Katolik Shqiptar* (Santa Clara, Kaliforni) si bazë e rrjetit të aktiviteteve letrare dhe procesit të ndërkommunikimit të botimeve, si kusht për ekzistencën e nën sistemit letrar kombëtar. Përcjellja e mendimit kritik me anë të botimeve studimore (në gjuhë të huaj) në Perëndim lidhur me prodhimin letrar Shqipëri / Diasporë. Metoda komparative, interkulturore dhe analitike për përcaktimin e tipologjisë dhe të koncepteve

të kritikës si degë e shkencës letrare mbi veprat letrare dhe historiografike. Deideologjizimi i metodave studimore si tipar bazë i materialeve të përzgjedhura në këtë kërkim si asimetri e metodës që përfshiu funksionet në kritikën e Qendrës Letrare Sistimore në Tiranë e deri diku në Prishtinë.

Funksioni i kritikës së Diasporës

Gjatë rrahjes së mendimeve për rishkrimin e historiografisë letrare të gjysmës së dytë të shekullit XX nuk është përmendur fakti i ekzistencës së kritikës dhe të studimeve të autorëve të diasporës për prodhimin letrar të sistemit letrar kombëtar në Tiranë-Prishtinë, por edhe të dikotomisë së vlerave nga përfaqësuesit e kritikës në qendër dhe në diasporë. Diaspora autor qendër-sistimore ruajti Fishtë, Konicën, Koliqin e pas tij autorët "Hermetikë" e "ekzistencialistë" Pashku, Arapi, Haliti, Zeqo dhe në vitet '80 Camaj; Sistemi Qendror Letrar Migjenin, Shuteriqin, Agollin, Kondin, Kadarenë. Duke parë se rezultatet e këtyre studimeve dhe aktiviteteve ishin të ndryshme në qendër (Tiranë-Prishtinë) dhe diasporë (Romë-Paris-Munich), por edhe të kundërta duhen dalluar faktorët ndërveprues për arritjen e rezultateve të ndryshme të kritikës në diasporë:

Së pari: faktori i *funksionit inherent të kritikës* në diasporë, ai i përcaktimit të filozofisë së artit dhe ligjëritit artistik si primare në përcaktimin e vlerës së krijimtarisë nga subjektet kritike. Konstatimi i përvijimit të metodave dhe teknikave lidhur me misionin e studimit si pjesë e shkencës letrare të ndikuar nga zhvillimet e aplikimet e teorive të reja të shfaqura në Perëndim, si bashkohësi e kritikës kombëtare.

Në diasporë dallohet vijimi i një kritike historike-filologjike (De Sanctis) te autorë si Karl Gurakuqi dhe Namik Resuli, të kritikës intuitiviste (Benedeto Croce) dhe të interpretimit psikanalitik të tekstit tek Ernest Koliqi dhe Giuseppe Gradi lone; të zbatimit të metodës së letërsisë së komparative tek Arshi Pipa dhe Martin Camaj, por edhe të interpretimit të tekstit dhe të zbatimit të teorive të strukturalizmit. Kështu dalja në mërgim e autorëve-qendër të viteve '30 '40 Koliqi dhe kritikëve Namik Resuli e Arshi Pipa siguroi vi

jueshmërinë e traditës së kritikës moderne të Krist Malokit dhe Mitrush Kutelit aplikimet e të cilave iu drejtuan teorive të "ndaluara" në qendrën sistemore si interpretimi semiotik, psikanalitik dhe sidomos formalizmi¹ apo strukturalizmi (Roland Barthes etj.), duke u mjaftuar me tekstologjinë e autorëve të vjetër dhe të një kritike të interpretimit sociologjik, por veçanërisht mbivlerësimi i ideologjisë si normë bazë e krijimtarisë e kritikës, kundrejt formës artistike.

Metodën komparative e inicioi Martin Camaj në kritikën mbi përkthimet i njohur me teorinë e formalizmit përmes terminologjisë kritike të avancuar në këtë drejtim. Ky autor në analizën e përkthimit të pjesës së parë të *Komedisë hyjnore*, Ferri të Dante Alighierit në përkthimin e Pashko Gjeçit në një akribi të kompetencës i jep shprehje dukurisë së interpretimit ndërkulturor përmes kalimit nga gjuha në gjuhë, ku rezultatet mbi të arriturat nuk shpallen në pozitive e negative si në kritikën Shqiptare, por vetëm përimitohen faktet e arritjes së formës danteske në shqipe krahasimisht me përkthimet e pjesëve të zgjedhura të *Komedisë Hyjnore* nga Ernest Koliqi.

Së dyti: faktori i funksionit të kritikës nisur nga ndërkulturalizmi, dhe niveli shkencor në revistën *Shêjzat* (Koliqi, Camaj e Gradilone) kishin vënë kritere të njohjes në nivel shkrimtarie fi llimisht të gjuhës shqipe: *Çdo shqiptar qi ká nji mendim frytdhanës për të shfaqun dhe din t'a shfaqí në shqipe të paster, çdo intelektual qi lakmon të rráhi nji çashtje ditunore ase don të paraqesi prodhimet e veta letrare, ka me gjetun vend në këto fletë t'ona,...*

Ky qëndrim që u ndryshua më vonë me kriterin e njohjes së "një gjuhe" (të huaj), që është një kriter ndërkulturor. Ky kriter ndërkulturor, i vendosur nga Koliqi-Camaj-Valentini u provua se funksionoi në jetëgjatësinë e revistës kulturore letrare: me kohëzgjatje 17 vjet. Kulmoi në *numrin komemorativ*, të vitit 1978, e përvijoi deri në fund të prodhimit të kritikës së letërsisë shqipe, duke i botuar si autorë bilingualë, Valentini-Koliqi-Gradilone-Camaj në revistën *Shêjzat*, Arshi Pipa dhe Anest Andrea në anglisht (revistat *Koha e Jonë*, *BKSH*). Aplikimi i teorive moderne letrare në praktikën kritike të arbëreshit Giuseppe Gradi-

lone me *Studi di letteratura albanese* dhe të Arshi Pipës në kryeveprën e letërsisë komparative të kritikës *Dante and Montale* (Minesota 1978), ndo nëse janë botuar në gjuhët italisht dhe anglisht nuk mund të receptohen pa kontributin e metodës ndërkulturore.

Përpunimi i teorive dhe i termave të kriti kës së diasporës ka gjetur deri shprehjen artistike te motivi kërkimor i poemës *Palimpsest* të Martin Camajt. Rrjeti i kritikës shqiptare si aktivitet ndërkulturor, duke krijuar kanalin e gjuhës tjetër jo për t'u tëhuajësuar, por për shtrirje të vëllimit të komunikimit në atë global i parapriu rrugës së prodhimit letrar në biling, sikundër Camaj (me *Gedichte* (1991), ndërsa kritika në diasporë ruajti funksionin e saj të ekzistencës në *melting pot*-in ndërkulturor.

Së treti: faktori i funksionit etik në prakti kën kritikë të diasporës ndaj prodhimit letrar në qendrën sistemore Tiranë-Prishtinë, përfaqësuar kryesisht nga editorët: Ernest Koliqi, Lec Shllaku, Gjon Sinishta, Bilal Xhaferri, por edhe nga Martin Camaj, Giuseppe Gradilone dhe Arshi Pipa. Paraqitja e kësaj etike është shfaqur si tipar kryesor që herët në kritikën e diasporës, duke u bërë *alter ego* për mërgimtarin. Kritika i drejtohej kryesisht shkrimtarit dhe teksteve bazë të realizmit socialist. Këto kritika, pas vitit 1957 me themelimin e revistës *Shêjzat*, kanë hyrë në formën e *tamisdave* në Tiranë e Prishtinë apo kanaleve të tjera gjuhësore të transferuara nga nënsistemi i letërsisë së diasporës në qendrën sistemore kom-bëtare.

Etika e kritikës së diasporës

Etika e kritikës së diasporës ndahet në dy tipare: (a) ndërkulturore; dhe (b) tradicionale.

(a) Kritika si etikë ndërkulturore: ndërsa në kritikën e poezisë moderne, Giuseppe Gradilone për arritjen e aplikimit të filologjizmit ndërkulturor, duke e krahasuar në studimin e tij "*Poezia Eterodokse e Fatos Arapit*" shmangien nga norma, por nga ana tjetër duke qëmtuar figurat e poezisë së madhe hermetike të Quasimodos, Ungarettit, Montales si ndikime (intertekste), apo duke nxjerrë në pah etikën shumëkuptimore të tekstit ku definohet repertori i mjeteve letrare të pa-

njehshme për kritikën e regjimit që e kapluan nga idologjizmi ishte në zotërim të mjeteve të kufizua ra repertuale për të përkapur simbolikën dhe analogjinë kuptimore të interpretueshme në një lexim ekuivok të lexuesit të ardhëm duke iu shmanhur barrierës ideologjike.

Ndërsa poeti Faslli Haliti përmes aktualitetit dhe lojës së intonimit si ironi e bartur në sim bolikën e pakriter apo të banalizuar ideologjike, si te poema *Dielli dhe rrëkerat* është vlerësuar nga kritika e Lec Shllakut. Interceptimi parodik si dobësim i ideologjisë mbizotëruese, arritur përmes tejkalimit të shprehjes ideologjike e bën të panevojshme interpretimin politik të tekstit poetik, por edhe të mjeteve formale për të përcaktuar rrymën hermetike të parapëlqyer të këtij po eti. Këtë sensibilitet kishte përkapur edhe kritika zyrtare në Tiranë lidhur me "rrymën". Sterilizimi i skajshën i figuracionit duke e lidhur fjalën me kuptimet ideologjike, u quajt nga Shllaku si mision etik i Halitit të cilin kritika në Shqipëri krijimtarinë e tij quajti "banale", pasi me heqjen e atributit autonom të fjalës, asgjësohej konteksti, duke krijuar kontekstin e mungesës intonative, si tipar paradoksal i receptimit ironik të retorikës së kohës.

Gjatë pleniumit IV (26-28 qershor 1973) dhe konferencës së Lidhjes së shkrimtarëve pas një muaji (Korrik 1973), 40 vjet më parë dënuan poetët e shekullit XX Fatos Arapi, Faslli Haliti, Moikom Zeqo e Xhevahir Spahiu për hermetizëm. Akuzat e kritikëve si Dritëro Agolli, Razi Brahimi, Andrea Varfi në revistën e Lec Shllakut, ku citohej (Artan Iliri, pseudonim) Sollzhenicini se "sistemi komunist mund të luftohet përmes letër sisë komuniste". Qasja e Shllakut në këtë lëvizje të "hermetizmit" mori rol parësor etik në gjithë kritikën e diasporës, duke sjellë metodën ndër kulturore të marrë në mbrojtje poezitë e Faslli Halitit "Dielli e rrëketë", "Koburja" etj.

Edhe në revistën *Shëjzat* u ndoqën zhvillimet "kundra poezisë hermetike" në Shqipëri. Si ti par etik kritika e diasporës është shfaqur edhe në kontestin ndaj tematologjisë politike në prozën e zhvilluar në Shqipëri dhe Kosovë. Kritika e diasporës disa herë ka tejkaluar rolin e kritikës, duke propozuar norma për zhvillimin e letërsisë jashtë

dogmave, duke stigmatizuar luhatjet etike të shkrimtarëve në Shqipëri.

(b) Etika tradicionale në kritikë: kritika e diasporës pasi u kujdes për krijimtarinë e jo vetëm, të Halitit, Fatos Arapit, Adem Demaçit si autor i vëllimit *Gjarpijt e gjakut* në revistat: *Koha e jonë*, *Buletini katolik shqiptar* i Gjon Sinishtës në Kaliforni. Kjo kritikë tradicionale ndiqte moritë e veprimtarive letrare. Ndërsa u zhvilluan elementë të kritikës socio-antropologjike, të strukturalizmit për formën e riparaqitjes së miteve kombëta re në letërsinë "e re" nga shkrimtarët e qendrës sistemore duke interpretuar me relativizimin e tyre, mënjanimin e traditës letrare bashkë me mito logjinë si pjesë e "normës".

Martin Camaj e dekonstruktua romanin *Hasta la Vista* të Markos dhe gjuhën e përdorur të tij, gjithashtu edhe deformimet psikike veshur personazheve me mikrotopos tradicional, te romani *Dasma*. Ndërsa Arshi Pipa sheh në kritikën e tij ndaj Kadaresë në romanin autobiografik *Kronikë në Gur* një tipar të disidencës në letërsi, atë të zbërthimit të strukturave polivalente si etikë kundër-ideologjisë diktatoriale, duke evidentuar analogjitë politike dhe sarkastikën e autorit, duke i dhënë jetë një leximi alegorik të subjektit dhe personazheve-aktantë në roman, por duke evidentuar kurbaturën e rënies së disidencës në periudhën e fundit krijuese të viteve '80.

Etika tradicionale është paraqitur në revistën *Koha e Jonë*. Këtu Lec Shllaku ndiqte me kujdes bihevorizmin e pushtetit ndaj artit, por edhe ndaj jetës së artistit, duke dhënë një zë në errësirë. Revista ndonëse botohej në Firence, si organ i PBD për çështje sigurie, nënshkruhej vendi i botimit: Paris, ku bashkëpunëtorët i drejtoheshin një kutie postale.

Tipari i etikës tradicionale në kritikë, është përvijuar në ruajtjen e funksionit të mitit perëndimor si virtut i prodhimit letrar kombëtar.

Konkluzione

Në këto tri tipare të kritikës së diasporës bartur nga studiuesit-autorë: Ernest Koliqi, Arshi Pipa e Martin Camaj duke shtuar edhe kritikën editoriale të Lec Shllakut mund të shohim se janë plotësuar kërkesat e një kritike bashkëkohore të kërkuar

nga institucioni i kritikës dhe historiografisë. Kështu kritika e diasporës është afruar në qe ndër mënyra më të përpjekshme si përplotësim i praktikës kritike, si bashkëkohësi e mendimit kritik me metodikën e praktikës së saj sipas normave të paktinuar nga normat e qendrës së dikurshme të sistemit letrar kombëtar dhe historiografisë si produkt sistemor. Funksionalizimi i kritikës së diasporës kërkon, një lexim të ri si proces të "faktizmit".

Bibliografi

BYRON, Janet (1981), *Albanian Nationalism and Socialism in the Fiction of Ismail Kadare: BKSH*, 2, 87-89.

CAMAJ, Martin (1962), "Ferri" e para kantikë e *Komedis Hyjnore* në gjuhën shqipe: *Shêjzat*, 5-6, 148-158.

CAMAJ, Martin (1965), Romani i "Eshtnave", *Shêjzat*, 7-8, 258-261.

CAMAJ, Martin (1991), *Gedichte*, Kyrill & Verlag, Munich, New York.

CUDDON, J. A. (1977, 1998), *Literary terms & Literary theory*, Penguin, London.

EICHENBAUM, Boris (1965), *Russian Formalist Criticism*, University of Nebraska, Lincoln & London.

GRADILONE, Giuseppe, DE GENTI, A. (1972), Anton Pashku, tregimtar i shquem: *Shejzat*, 4-8, 143-146.

KOLIQI, Ernest (1965), Vjerrsha të Dantes, përkth. Ernest Koliqi, *Shejzat*: 7-8, 299-305.

KOLIQI, Ernest (1957), Kroje të reja në Parnaz shqiptar: *Shejzat*, 1, 3-9.

KOLIQI, Ernest (1957), Mbas udhëhjekjes së Shêjzave: *Shêjzat*, 1, 1-2.

MALI, Ujk [SHLLAKU, Lec] (1974), Koha e Jonë: *Shêjzat*, 7-8-9, 9-14.

PIPA, Arshi (1999), Fenomeni Kadare: *Plejad*, Tiranë..

KULTI I KALIT NË DISA AREALE MITIKE

THE CULT OF THE HORSE IN SOME MYTHICAL AREAL

IRENA GJONI

Universiteti "Aleksandër Moisiu", Fakulteti i Edukimit, Letërsi shqipe, Durrës, SHQIPËRIA

E-mail: gjoniirena@yahoo.com

AKTET VII, 4: 338-343, 2014

PERMBLEDHJE

Studimi i kultit të kalit në traditën kulturore mitike të Bregdetit të Jonit, kontekstualisht edhe kombëtar shqiptar i shtrirë në drejtim të hetimit të elementëve përbërës, e bëjnë mitin e tij të qëndrueshëm si në aspektin kombëtar, ashtu edhe në aspektin ndërkombëtar. Për këtë arsye, artefakti mitik përqaset në dy aspekte: (a) brendakombëtare – me krahinat e tjera të truallit kombëtar shqiptar; dhe (b) jashtëkombëtare – me traditat mitike të popujve fqinjë, ku vendin kryesor e zë tradita e lashtë helene e romake, mandej e popujve të tjerë të Lindjes e të Perëndimit. Në këtë kontekst studiohet (a) bashkëjetesa e tij me heronjtë e eposit heroik; (b) viktimizimi i kalit të bardhë te ilirët; (c) mbrojtja nga fatkeqësitë detare; (ç) origjina ktonike ujore; (d) përmbushja e nevojave praktike; dhe (dh) parashikimi i ardhmërisë. Disa prej këtyretributeve të kalit njihen edhe nga popujt e tjerë.

Fjalët çelës: kulti i kalit, areale mitike, funksion, totem, besime e legjenda.

SUMMARY

Studying the horse cult in mythological cultural tradition of the Ionian Coast, and the Albanian national same context lying in investigating the constituent elements, make his myth in terms of sustainable national and in international terms. For this reason, approaching mythical artifacts in two aspects: (a) insidenational - with other provinces Albanian national land and (b) outnational - the mythological traditions of neighboring nations, where the main voice of the ancient Hellenic and Roman tradition then the other peoples of the East and West. In this context studied (a) cohabitation with the heroes of the heroic epos, (b) victimization of white horse at Illyrians (c) protection of maritime disasters, (d) the ctonic origin from water, (d) the fulfillment of practical needs, and (f) a forecast of the future. Some of these attributes of horse are known and from other people.

Key words: the cult of the horse, mythical realm, function, totem, beliefs and legends.

Hyrje

Objekti i këtij studimi është kulti i kalit në disa areale mitike. Është përqendruar më tepër në Bregdetin e Jonit duke e parë përballë arealeve tjera mitike. Zoomorfizmi është një dukuri e njohur në Bregdetin e Jonit. Një kafshë e shenjtë, e shndërruar në kult në këtë trevë, është edhe kali. I konsideruar si njëra prej figurave më të rëndësishme të botës shtazore, ai është shumë i pranishëm në folklorin e të gjithë popujve. Sipas tipareve të tij kali i përket sistemit solar dhe lunar

mitik (Kuper) dhe, si i tillë edhe simbol i jetës dhe vdekjes.

Studimi i kultit të kalit në traditën kulturore mitike të Bregdetit të Jonit, kontekstualisht edhe kombëtar shqiptar i shtrirë në drejtim të hetimit të elementëve përbërës, e bëjnë mitin e tij të qëndrueshëm si në aspektin kombëtar, ashtu edhe në aspektin ndërkombëtar. Për këtë arsye, artefakti mitik përqaset në dy aspekte: (a) brendakombëtare – me krahinat e tjera të truallit kombëtar shqiptar; dhe (b) jashtëkombëtare –

me traditat mitike të popujve fqinjë, ku vendin kryesor e zë tradita e lashtë helene e romake, mandej e popujve të tjerë të Lindjes e të Perëndimit.

Përfaqësimi i tij në këtë traditë në këngë, besime e legjenda, në funksion të totemit, ndërlidhja me mitet e popujve të tjerë e prejardhjes ujore, e bëjnë kultin e kalit të interpretohet në kontekst të bashkudhëtarit të njeriut për t'i kapërcyer hapësirat gjeografike. Në këtë kontekst studiohet (a) bashkëjetesa e tij me heronjtë e eposit heroik (konsiderohet arma kryesore, bisedon, i ndihmon në dyluftim, ha, pi, jeton, vuan dhe vdes bashkë me ta); (b) viktimizimi i kalit të bardhë te ilirët; (c) mbrojtja nga fatkeqësitë detare – pulenat e anijeve kanë kokën e kalit; (ç) origjina ktonike ujore (ka dalë nga deti); (d) përmbushja e nevojave praktike (për punët në shtëpi e në fushë); dhe (dh) parashikimi i ardhmërisë. Disa prej këtyretributeve të kalit njihen edhe nga popujt e tjerë.

Fillesa e kultit të kalit

Në mitologji kali është qenie fisnike me instinkte të mira, me energji dhe fuqi të pashtershme dhe para së gjithash me shpejtësi. Kali është e vetmja kafshë që i ka mundur njeriut me shpejtësi të kalojë hapësira të mëdha gjeografike. Në kohën kur me anë të kalit mundësohej ndërlidhja e botëve të ndryshme, atij i përshkruheshin tipare të ndryshme, të cilat kishin karakter mitik. Kali shfaqet edhe me cilësi ktonike. Origjina e kalit lidhet me lindjen e tij në ujë, sepse uji është element përbërës i botës nëntokësore, ndaj edhe udhëhiqet nga perënditë e kësaj bote. Sipas mitologjisë, sovran i detit i fali njeriut kalin e parë. Thuhet:

*“Zoti Posejdon, nga ju na vjen kjo krenari,
Kujt e fuqishëm, mëzat*

si dhe perandoria e thellësive” (Hamilton 1962: 35).

Posejdoni – perëndia e Detit, në formën e hamshorit i servilet Gjesë, Nënës Tokë. Në mitologjinë helene, po ashtu i ka atributet e qënies ktonike, kur na shfaqet si kafshë e dashur e Hadit, perëndisë së nëntokës. I njohur në mitologji është edhe Pegasi, djali i Meduzës dhe Posejdonit. Kali me flatra më parë është i Perseut (që të lironte

Adromedën) dhe më pas i Belerefonit që e kapi teksa pinte ujë në burimin e Pirenës. Sipas një varianti tjetër iu dhuroa nga Posejdoni Belerofonit dhe Athina i dhuroi një fre të artë, që të drejtonte kalin e shenjtë të luftonte kundër Kimerës. Ishte Pegaso që me një goditje me thundrën e tij bëri të shpërthente burimi Ipokren (“burimi i kalit”), i shenjtë për Muzat, mbi malin Elikona. Pas vdekjes së Belerofonit, ai kishte hedhur tutje shalën, sepse donte të arrinte Olimpin. Pegasi fluturoi pranë Zeusit dhe më vonë u shndërrua në yjësi (Kolonna 2005: 279-280).

Ndërlidhja e kalit me botën ktonike është e pranishme edhe në ritet e iniciacionit, ku kali e mëson iniciantin të bëjë vepra heroike dhe t'i tejkalojë të gjitha provat. Lule Frangu me kalin e tij brenda ditës e kalon rrugën Shkodër Vlorë dhe e fiton bastin të martohet me të dashurën. Kështu, kali na del si simbol, i cili njeriut ia hap dyert e jetës. Kali me fuqinë e vet magjike, në besime popullore të popujve të ndryshëm të botës, na paraqitet edhe si element ndërlidhës midis botës së të vdekurve dhe të gjallëve, si është paraqitur në eposin kirg *Er-Töshtük*.

Në *Apokalipsë*, Vdekja kalëron në kalë të zbehtë, si edhe te Eskili. Në folklorin gjerman dhe anglosakson ruhet besimi se ta ëndërrosh kalin, është shenjë e vdekjes së afërme (Durand 1991: 70). Në Bregdet mendohet se, nëse të del në ëndërr një kalë i bardhë, një fund i palavdishëm të pret, në mos një vdekje e lahtarshme.

Shumë kultura i japin atij tipare hipomorfe dylojëshe të demonëve dhe e ndërlidhin me Të Mirën dhe Të Keqen. Sipas kësaj, duket se kali i përket errësirës së botës ktonike, lind nga barku i tokës ose nga thellësitë e detit, duke kalëruar si gjaku në venë. Kjo tregon tiparet e kalit natën. Ndërkaq ditën ai i largohet botës së origjinës, që të ngrihet në botën e dritës, të qiellit. Tani ky kalë nuk është lunar e htonik, por solar dhe uranik, sepse i përket botës së perëndive të së mirës. Në këtë kontekst kali i bardhë qiellor pasqyron instinktin e kontrolluar, të zbutur e sublim (Chevarlier – Gheerbrant 1983: 270).

Në shumë kultura besohet se kali ka lindur nga furtuna. Ai njëkohësisht është edhe shërbyes i qiellit dhe i perëndive të fenomeneve kohore. Në

mitologjinë greke Heliosi çdo ditë bartte diellin nëpër qiell, me karron që e tërhiqnin katër kuaj. Rënia ritmike e thundrave të tyre dhe karroja që shkaktonte zhurmë ishin bubullimat, ndërkaq vetëtimat ishin kamxhiku që i grahte kuajve.

Bukuria dhe energjia e lëvizjes së kalit, po ashtu edhe shakullima ka tërhequr edhe vëmendjen e poetëve. Hektori i grah karros që e tërhiqnin pelat.

Në eposin heroik dhe në këngët e trimërisë dialektika e lidhshmërisë së heroit me kalin ka qenë shumë e ngushtë dhe tepër intime. Ai është heroi më i ngushtë dhe bashkudhëtar i heroit të eposit heroik (flet me heronjtë, i ndihmon në dy-luftime, në shmangien e rreziqeve dhe në gjetjen e udhëve të shpëtimit). Origjina e kalit tek shumë popuj lidhet me botën kozmike. Në eposin *Rigveda* qielli krahasohet me kalin e zbukuruar me diamante (Prop 1990: 275).

Kulti i kalit në trevën ilire

Sipas Aleksandër Stipčevićit, kali ka qenë element esencial i kompleksit religjioz, i cili është formuar si shprehje e marrëdhënieve shoqërore dhe ekonomike të shoqërisë patriarkale në dallim nga gjedhi, i cili është simbol tipik i shoqërisë së matriarkatit. Në kohën e hekurit këto dy komplekse religjioze gërshetohen dhe kështu krijohen shumë kombinime të reja, në të cilat shpesh është vështirë të dallohen e të njihen elementet e përparshme të këtyre dy komplekseve (Stipčević 1990: 340).

Stipčevići thekson se rol vendimtar në përhapjen e kultit të kalit në trevën ilire kanë luajtur depërtimet e popujve kalorës nomadë nga stepat e Evropës Lindore, megjithatë ky fakt nuk guxon të na shpjegojë drejt përfundimit që ilirët nuk e kanë njohur kultin e kalit. Mungesa e paraqitjeve figurative të simbolit të kalit nuk do të thotë se ai nuk ka ekzistuar edhe para se të shfaqen paraqitjet e tilla. Kemi arsye të besojmë se kali, së paku në disa periudha kohore, është kafshë shumë e lashtë kulti. Që dokumentacioni arkeologjik nuk është e vetmja dëshmi e ekzistimit të kultit të një kafshe, më së miri shihet në rastin e kalit. Në disa vise ku dokumentacioni arkeologjik është shumë i varfër, ndoshta edhe kurrfare, është dëshmuar

kulti i kalit në burime të shkruara nga koha antike, për fat të keq shumë të rralla, por tejet të vlefshme (Stipčević 1990: 335).

Dijetari i shekullit II p. I. K., Festusi, ka shkruar se Neptuni më parë quhej Hippius, për shkak se Saturni ka fituar që të hajë mazin në vend të Neptunit, përkatësisht për arsye se Neptuni, me një goditje me sfurkun e vet nga toka ka nxjerrë kalin. Hippiusin, shumë filologë e nxjerrin në lidhje me fjalën shqipe “me hipë, me kalërue”. Në përfytyrimet më të vjetra mitologjike, hyu i detrave jepet dhe në formën e kalit. Festusi shënon se për këtë arsye, në çdo nëntë vjet i flirtojnë detit katër kuaj. Në disa monumente janë vizatuar edhe anijet ilire që kanë te pulenat kokën e kalit (Stipčević 1990: 335-336).

Për cilësitë e mira të kalit, ai është konsideruar kafshë e shenjtë, ndaj edhe kali i bardhë ka qenë i destinuar për viktimizim ose fljirim. Sigurisht ai në këtë rol është paraqitur atëherë kur nuk janë viktimizuar më njerëzit. Viktimizimi i kalit ka prejardhje indo-evropiane, sepse këtë rit e kanë njohur të gjithë popujt indoevropianë (Eliade 1991: 188), si dhe ilirët. Virgjili nënvizon se ilirët çdo të të vjet kanë bërë kurban një kalë tërheqës. Mendohet se ky lloj viktimizimi është bërë në Durrahium (Nikolic 1959: 278).

Kulti i kalit në Bregdetin e Jonit

Mendohet se riti i mësipërm ka ekzistuar dhe në Bregdetin e Jonit. Në këtë krahinë ekzistencën e mbijetësive të kultit të kalit e gjejmë edhe te “Burimi i kalit”. Është një burim i rëndësishëm në Borshin e vjetër, i lidhur me kultin e kalit. Pasi del, uji futet në atë që quhet “Përroi i kalit” dhe duke rrjedhur vrullshëm tatëpjetë, ngjan si një trok kali në vrapim e derdhet në lumin e Borshit. Ka vlera kurative (Kabo-Krutaj-Bërzholi 2002: 40). Ajo që vëmë re është se kulti i kalit është i lidhur me kultin e ujërave. Nuk mund të përcaktojmë raportet mes tyre, nëse kanë ose jo hierarki, por evidentojmë bashkëjetesën mes tyre.

Po kështu hyu i luftës Medauri është hy kalorës, i hipur në kalë, i paraqitur me shtizën në dorën e majtë dhe pas shpine me gjarpërin dragua, gjarpër monstër detare.

Edhe kulti i Dioskurëve paraqitet ikonografisht si kalorës (Zeqo 1995: 23). Ata ushtronin fuqi në det. Dioskurëve (djemve të Zeusit), pra Kastorit dhe Polluksit, për hir të të atit, iu lejua që të ndajnë të njëjtin fat pas vdekjes, ashtu siç ndodhte dhe në jetë: secilit prej tyre do t'i duhej t'i kalonte ditët herë në Olimp dhe herë në Botën e Poshtme. Me këtë detyrë të pazakontë të pasvdekjes mund t'i thërrisnin marinarët në orën e rrezikut. Në qoftë se dëgjohej lutja e tyre (e marinarëve), binjakët do të dilnin për shpëtimin e tyre me kuajt e tyre të bardhë simbolikë, ose në formën e shkarkesës elektrike, që mund të vërtitet në bashin e anijeve në kohën e stuhisë (Houtzager 2004: 192). Që në shek. III–I p. l. K. në faqet shkëmbore të gjirit të Gramatës (stacion i detyruar), detarët gdhendën rreth 500 mbishkrime, midis të tjerash, lutje kushtuar Dioskurëve, perëndive mbrojtëse të tyre.

Edhe te Dioskurët, me kuajt e tyre të bardhë, sërish shfaqet karakteri sinkretik i kultit të ujërave dhe të kalit në Bregdetin e Jonit. Këto tregime, kuptimi i mirëfilltë i të cilëve s'është e mundshme të rindërtohet, pasi i takojnë kompleksit religjioz mediteran, mbase mund të vihen në lidhje me rolin e kalit si mbrojtës të detarëve. Ky rol është dëshmuar me faktin që anijet kanë pasur pulenin në formë të kokës së kalit dhe dihet që kafshët e paraqitura në pulenët kanë pasur për detyrë që t'i mbrojnë detarët prej fatkeqësive. Për këtë arsye është përdorur edhe faltorja e vogël, kushtuar kultit të dyfishtë të Dioskurëve ose Kastorëve, një faltore e gjendur në Butrint, brenda një prej banesave më të rëndësishme, Banesës me Atrium (Ceka 2002: 51).

Në Bregdetin e Jonit kulti i kalit është i lidhur dhe me atë të bujqësisë. Këtë e dëshmojnë një sërë këngësh të mbledhura, sidomos në fshatin Lukovë. Sipas tyre, ai përdoret kryesisht për nevoja praktike, për të shirë grurin në lëmë. Ja si jepet te kënga e mëposhtme:

*"Ajs Kuqo,/ ajs Kuqal,
bëne bik¹, / Mos ki frikë,*

*Bëne kashtë,/ nxirre jashtë,
bëne mirë,/ mos bën firë!"*

Apo:

*"Hajt Kuqo, hajd Dori,
Shije grurin për zili,
Shij grurë e ndaj kashtë,
Bukën veç e kashtën bashkë,
Hajt Kuqo, hajd Dori,/ Me shëndet grurin e ri,
Hajt- hajt- hajt, Kuqo." (Arkivi 1972)*

Ndërsa në fshatin Shën Vasil këndohet në variantin e mëposhtëm:

*"Kuqua në strumbullar,/ gruri në hambar,
Kuqua në lëmë,/ kashta nëpër këmbë,
Kuqua vërdallë,/ Gruri në pinadhë,
Grurët bashkë,/ Kashta jashtë." (Arkivi 1978).*

Kulti i kalit te Eposi i Kreshnikëve

Kultin e kalit e gjejmë edhe në eposin heroik shqiptar. Aty flitet për zgjedhjen e kalit cilësor të heroit (Mujit dhe bashkluftëtarëve të tij). Shumë ndeshje me kundërshtarët nxiten nga grabitja e kuajve, sepse kali është konsideruar njëra prej armëve kryesore dhe më të rëndësishme për ta mundur kundërshtarin. Në këso rastesh ai është testuar nga heroi. Kujtojmë këtu kalin e Gjergj Elez Alisë:

*"Gjergj Elezi në shtall-o a' shkue
edhe bishtin tanve jau ka kapë
edhe jashtë të tanë për bishti i qet
edhe t'vetin për bishti e ki' kapë;
as pej vendi s'mundet për m'e l'kundë" (Çetta-Syla-Mustafa-Berisha 1993: 7).*

Për cilësitë ktonike të kalit flet edhe një këngë e eposit heroik shqiptar, e cila origjinën e kalit e lidh me lindjen e tij në ujë, sepse uji është element përbërës i botës nëntokësore, ndaj edhe udhëhiqet nga perënditë e kësaj bote. Ja një shebull nga eposi heroik shqiptar:

*"Nuk po tutna n'deti për me ra,
se në deti Ali unë kam le/
hem qit trup, djalë, n'deti e kam rritë" (Çetta-Syla-Mustafa-Berisha 1993: 314).*

Në ndonjë këngë kali lufton bashkë me heroin:

*"Luftë të madhe nërmjet veti bajnë;
ma shum gjoku n'shkelma qi po myt" (Çetta-Syla-Mustafa-Berisha 1993: 312).*

Ai i ndihmon heroit të plagosur:

¹ Kashtë e imët dhe e copëtuar që del nga shirja e të lashtave

*"E, oh, m'e pa: -e a:t xhogun e ti:
E, n't' dy gjuj, he, tu Muji-e po bje,
Eje, e me dha:p, ehe, Mujin-e p'e ka:p,
Ani, po i dimo, more, n'sha:l, he, me hi:p,
Ehe, oj, n'shpi:d-e, besa, e ka çit:t,
Ani-e n'ka:m, he, xhogu-e kjeka çua"* (Neziri 1997: 47).

Bashkëvuan me heroin:

*"Gjoku i Mujës për skej po m'i rrin,
tanë me lot-o gjoku qi p'e kan"* (Çetta, 1974: 146).
Parashikon ardhmërinë:

*"Por mbas shejesh qi gjoku m' ka,
- T' dy çetët shndosh s' kem me u bashkue!"*
(Palaj-Kurti 1996: 55).

dhe fatin e heroit:

*"Gjoku Mujës tagjin s'e ka ngronë;
Se në dy syt, tha, i shkreti po loton,
Të dy vesht te poshtë i ka vjerë,
Me komë të djathtë, ç'mun, e ka, vorr bon"*
(Dançetoviç 1952: 145).

Siç shihet, kali shpesh herë identifikohet me njeriun. Ai jeton si edhe njeriu: ha oriz, pi verë si edhe heroit:

*"Si n'e paçi baftin për me pështue,
në vend t'elbit oriz kam me të dhanë;
në vend t'ujit, venë kam me të qitë"* (Instituti 1966: 428).

Varroset njësoj si edhe njeriu:

*"Vrap të mirë, more, gjogu po shkon.
N' aksham, besa, në Judbinë po bjen
edhe shkjanë, tha, Muja p'i fiton,
porse gjogu Mujës i ka plasë.
Shumë shaqninë, bre, Muja po ma mleth
edhe vorrin gjogut po ja bajnë,
porsi njeri gjogun e vendojnë"* (Çetta-Syla-Mustafa-Berisha 1993: 409).

Varrimi i kalit si rit i lashtë është i pranishëm te të gjithë popujt indoevropianë. Për mbijetoja të këtij riti sjell të dhëna edhe studiuesi anglez M. A. Walker në librin *Eastern Life and Scenery* (botuar më 1886 në Londër), ku në mënyrë impulsive përshkruan varrimin e një kali në Shkodër. Sigurisht varrimi i kalit lidhet me besimin se ai i përket botës demonike, ndaj sa më shumë që respektohet prej njeriut, aq më shumë do të fitohet mëshira dhe bekimi i forcave demonike.

Meqë njeriu është i natyrës solare, atëherë edhe kali i heroit, përveç tipareve ktonike, fiton edhe karakteristika të sistemit solar.

Përfundim

Si përfundim mund të shtohet se studimi i kultit të kalit në disa areale mitike, i shtrirë në drejtim të hetimit të elementëve përbërës, e bëjnë mitin e tij të qëndrueshëm si në aspektin kombëtar, ashtu edhe në aspektin ndërkombëtar. Përfaqësimi i tij në këtë traditë në këngë, besime e legjenda, në funksion të totemit, ndërlidhja me mitet e popujve të tjerë e prejardhjes ujore, flijimi në periudhën ilire, vendosja e kokës në pulenat e anijeve, bashkëjetesa me heronjtë e eposit heroik, shfrytëzimi për nevoja praktike dhe besimi në aftësinë parashikuese, flasin për kujdesin dhe respektin e madh për këtë kafshë që ka treguar njeriu shqiptar i të gjitha periudhave historike, nga ajo parailire e deri në ditët tona për këtë kafshë.

Bibliografi

- ÇETTA, A., 1974 (Përgatitur nga), *Këngë kreshnike I*, IAP, Prishtinë.
- ÇETTA, A., SYLA, F., MUSTAFA, M., BERISHA, A., (Përgatitur nga), 1993, *Këngë kreshnike III*, IAP, Prishtinë.
- STIPÇEVIQ, A., 1990, *Ilirët*, Rilindja, Prishtinë.
- ARKIVI VETJAK I FAMILJES GJONI. Mblodhi Minella Gjoni nga Gita Dhimërtika 84 vjeçe, Shën Vasil 1978.
- ARKIVI VETJAK I FAMILJES GJONI. Mblodhi Minella Gjoni nga Lilo Vlasi 76 vjeçe, Lukovë 1972.
- AT PALAJ, B., DHE AT KURTI, D., 1996, (Mbledhë e e redaktuëm nga), *Visaret e kombit. Vëllimi i dytë*.
- KOLONNA, B., 2005, *Fjalor mitologjik*, Toena, Tiranë.
- NIKOLIC, D., 1959, Konj u verovanjima naseg naroda: *Ziva antika*, , g. 9, sv. 1-2, Skopje.
- HAMILTON, E., 1962, *La Mythologie*, Verviers.
- DURAND, G., 1991, *Antropoloske strukture imaginarnog. Uvod u opcu arhetipologiju*, Zagreb.
- HOUTZAGER, G., 2004, *Ελληνική Μυθολογία*, Athinë.

INSTITUTI I FOLKLORIT, *Folklor shqiptar II. Epika legjendare (Cikli i kreshnikëve)*. Vëllimi i parë. Tiranë 1966.

CHEVARLIER J., – Gheerbrant, 1983, *Rjecnik simbola, Mitovi, sni, obicaji, geste, oblici, likovi, boje, brojevi*, Matica Hrvatska, Zagreb.

KABO, M., KRUTAJ, F., BËRXHOLI, A, 2002, *Borshi*, Tiranë 2002.

ELIJADE, M., 1991, *Istorija verovanja i religijskih ideja*, Prosveta, Beograd.

ZEQO, M. 1995, *Aspekte të mitologjisë ilire*, Toena, Tiranë.

CEKA, N., 2002, *Butrinti* Tiranë.

DANÇETOVIC, V. S. (Redaktue prej), 1952, *Kangë popullore shqiptare të Kosovë-Metohis (Legjenda dhe kangë breshnike)*. Bleni i I-rë, Mustafa Bakija, Prishtinë.

NEZIRI, U. Z., 1997 (Përgatitur nga), *Epika legjendare e Rugovës V*, IAP, Prishtinë.

NIKOLIC, D., 1959, Konj u verovanjima naseg naroda: *Ziva antika*, g. 9, sv. 1-2, Skopje.

PROP, V., 1990, *Historijski korijeni bajke*, Svjetlost, Sarajevo. ..

LEXICAL MEANING AND CONNOTATIVE ELEMENTS IN VERBAL PHRASEOLOGICAL UNITS IN ALBANIAN AND ENGLISH LANGUAGE

KUPTIMI LEKSİKOR DHE ELEMENTET SHPREHËSE TEK NJËSITË FRAZELOGJIKE FOLJORE NË SHQIPE DHE ANGLISHTE

ROVENA VORA

University of Tirana, Foreign Languages Faculty, English Language Department, Tirana, ALBANIA
Email: rovena.vora@gmail.com

AKTET VII, 4: 344-348, 2014

PËRMBLEDHJE

Në këtë studim synojmë të përqendrohemi tek disa elemente që janë të rëndësishme për të kuptuar anën semantike të njësive frazeologjike, por gjithnjë pa e shpëputur këtë anë nga ajo formale. Kjo pikënisje teorike synon të nxjerrë në pah faktin që njësitë frazeologjike karakterizohen nga një realizim mjaft i veçantë leksikor i cili ka vlerësim të theksuar konotativ. Realizimi i kuptimit leksikor dhe i kuptimit të figurshëm të njësive frazeologjike foljore është studiuar në plan përqasës ndërgjuhësor, në shqipe dhe anglishte për të parë funksionimin e njësive ekuivalente në korpusin e mbledhur për këtë qëllim. Elementet shprehëse të njësitë frazeologjike foljore lidhen jo vetëm me kuptimin leksikor të tyre por edhe me anën strukturore. Shpeshherë njësitë frazeologjike pësojnë ndryshime në formë për t'ju përshtatur kontekstit apo stilit të autorit duke u përdorur në gjini dhe në ligjërimi të ndryshme.

Fjalët çelës: kuptim leksikor, njësi frazeologjike, formë, ngjyrim emocional.

SUMMARY

In this paper, we aim at focusing on some elements which are important in dealing with lexical meaning in verbal phraseological units, relating their meaning to their form as an inherent part of phraseology. This comparative study also aims at pointing out that verbal phraseological units are characterised by a special lexical meaning which has peculiar connotation. This is a comparative study of the lexical and figurative meaning in verbal phraseological units in Albanian and English language to see how certain equivalent lexical units function in both languages illustrated by the linguistic corpus. Connotative elements in verbal phraseological units are related not only to their lexical meaning but also to their form in order to adjust to a certain context and to the writer's style which make it possible that they be used in different genres and speech.

Key words: lexical meaning, phraseological unit, form, connotation.

Introduction

This paper deals with the lexical meaning and connotative elements present in verbal phraseological units in Albanian and English language. Idiomatic expressions can be found in every sphere of human life and communication. Indeed what makes their use so fascinating is the way they involve the imagination, make abstract

meaning more concrete, add a wealth of meaning to simple concepts, and finally, make the commonplace conversation more interesting. Phraseological units express in few words what would require many more words to express in literal terms.

Idioms are usually defined by their property of semantic eccentricity; they are meaningful strings

whose meaning is not a direct function of the meanings of their components. In linguistics and psycholinguistics, the main problem posed by idioms is the necessity of treating the string as a unit rather than decomposing it into parts. Not all idioms have a literal counterpart, and sometimes for semantic or syntactic reasons, a literal interpretation may be completely ruled out. We have to turn not only to their denotational meaning but we also have to consider its connotation, as one of the most pervasive categories of literary and non-literary discourse. Phraseological units, or idioms, like words or ordinary expressions have a meaning. As such, two classes of models have been proposed for idiom comprehension by researchers in the field of phraseology. Reflecting the characteristics of such idioms as *i bën bisht*, *e lëshoi gojën*, *by and large* and *kick the bucket*, one class treats idioms as expressions that have meanings that are stipulated arbitrarily. According to this class of models, idioms are understood simply by retrieving the meaning of an idiom as a whole. Glucksberg [3] refers to this type of model as a *direct look-up* model. The second class of models reflects the characteristics of such idioms as *i hedh hi syve*, *e nxori nga balta* or *carrying coals to Newcastle*. The meanings of these kinds of idioms are not arbitrary. The relation of coals to Newcastle is a matter of historical fact, and the literal act of carrying coals to the coal mining center of Newcastle is a stereotypical instance of uselessly bringing something to some place. According to this second class of models, idioms are understood by ordinary linguistic processing combined with a pragmatic interpretation of the use of the expression in discourse contexts. Mostly an idiom has been defined as a multilexemic expression whose meaning cannot be deduced by the general rules of the language in question from the meanings of the constituent lexemes of the expression, their semantically loaded morphological characteristics (if any) and their syntactic configuration. Unlike a free phrase which is usually composed of two lexemes A and B in which its signified 'X' = 'A + B', thus, making it 100% compositional and replaceable by any

other sufficiently synonymous phrase, an idiom is a semantic phraseme such that its signified 'X' does not include either of the signified 'A' and 'B' [6]. This can be made clear by the following example in Albanian in which the idiom 'bëj bisht' is made up of two lexemes 'bëj' and 'bisht' where its signified 'X' does not include the signifieds 'A' and 'B' of the two constituent lexemes.

-Vëri nuset në punë, mos i kurse.

-Nuset i vënca atje ku të mos dalin. Unë t'i kursej ato? Jo mbesë xhane, kursehen vetë, i bëjnë bisht punës, kanë frikë mos u hahen duart. Tri nuse, tri sprija në shtëpi! [5]

Materials and methods

The corpus taken into consideration for the analysis is composed of verbal phraseological units in Albanian and English language. The examples have been extracted from various novels by Albanian and English writers and in some cases for specific research purposes we have used examples taken from English-Albanian, Albanian-Albanian and English-English phraseological dictionaries.

The data has been used to illustrate many theoretical points we came across during our study about lexical meaning and connotative elements in verbal phraseological units in Albanian and English language. Phraseological units are considered within their context to better define their meaning and show the differences in their form which reflect differences in their lexical meaning.

Results and discussions

Nowadays, we can speak of two main groups of phraseological units or idioms. The first group is represented by idioms composed of constituents for which the semantic interpretation is not a compositional function of the formatives of which it is composed. These have no literal counterparts, thus, have no literal meaning like 'iu bë gjaku ujë', 'm'u bë ferrë' etc. and are intuitively nontransparent whose meaning is hard to guess without a special context or previous exposure. This is closely related to their

paradigmatic fixity according to which substitution of a synonym for an idiomatic part does not preserve the idiomatic meaning of the expression. The second group of phraseological units have a literal meaning and a figurative one, thus, they are compositional as the following examples:

Po të bësh kështu, mbyllin sytë e të lënë të vjedhësh, të rrëmbesh, të fitosh, siç thua zotrote. [4]

S'më duket që, paratë e dhëna me dorën tënde, ta shpjenë punën gjere atje tek thua... dhe mbloodhi buzët. – Si zor, o dyqanxhi! More paratë e mia s'ia lë, unë, se kam marrë dorë për to... po nuk di do a s'do zotrote ta hedh në burg? [8]

There is a great number of compositional phraseological units in both Albanian and English language. However, many researchers conclude that compositional idioms are not necessarily transparent, and idiomatic parts do not usually have their literal meaning. As suggested by van der Linden, analyzability should be distinguished from compositionality, and the possible distribution of meaning over its parts is better viewed as a property of the idiom itself (as a whole) and not as a property of its parts [1]. As pointed out by many scholars in the field of phraseology in both languages is that the major difficulty with idioms is that unlike most lexical items, (most) idioms have considerable internal structure which seems to interact with the usual productive syntactic and semantic mechanisms of a language. Thus, in order to make sense of both groups of phraseological units one must take into account the connotative penumbra of their words.

Thus, there is a number of idiomatic expressions to express anger in Albanian and English language:

i hipi gjaku në kokë (në tru); i hipi gjaku (në fytyrë); i ra gjaku në sy; i hipin xhindet; in Albanian and *blow your stack; hit the ceiling; blow off steam* in English language.

Kur dëgjoi fjalën që i kish dërguar Malush Agai, beut i hypi gjaku në kokë e mënt i ra pika. S'e nxinte më as lëkura, as konaku, as tërë vendi. [4]

Thanë me vete: "Ç'po bëhet kështu? A mos po përmbysët bota? A mos i kanë hypur xhindet Asllanit?" Vërtet ashtu ish: Asllanit i kishin hypur xhindet, se i kish vajtur thika gjer në eshtër, pra e kish bërë fora. [4]

Father hit the ceiling when I damaged the car. [7]

Phraseological units are used to replace borrowed words, especially in Albanian language. 'Ngul këmbë' replaces 'insisto':

Sepse zonja e madhe ngulte këmbë e nuk donte të ndahej nga kjo botë para se ta ngopte shpirtin: [4]

'ka gisht' replaces 'është i implikuar':

Këtu ka gisht armiku ynë dhe pikë. Ai ktheu kokën dhe s'dihet përse zuri të vështronte andej nga perëndimi, përtej kënetës së Hoxharës, drejt detit. [9]

'e bën mizën buall/e bën qimen tra' instead of 'ekzagjeron:

... argatët vazhdonin të vështrojnë shoshokun në sy, sikur të mos u besonin fjalëve të Perit, i cili, shpeshherë, siç thoshte Këmbëçikriku, e bënte 'mizën buall'. [10]

Idioms are also used to give a different shade of meaning through figurative devices, such as: *hedh sytë; hedh një sy; ngul sytë; qep sytë* for *shikoj*.

Dhe ia qepi sytë të vdekurit, për të dalluar ndonjë dhembje. [9]

mori dhenë – instead of – *u përhap*:

Edhe breshkat, o qahaja-bash, morën dhenë e s'gjen një për hajmali, po për 'to, shyqyr, s'thotë gjëkafshë beu. [8]

Nevertheless, connotation is text-bound and culture-bound which means that the phraseological unit 'mori dhenë' and its equivalent cannot be used in the same context. Phraseological units are usually used in informal conversations and few of them can be used in other contexts. Different from other linguistic devices, the verbal phraseological unit 'e solli kokën' conveys the same meaning as the verb 'erdhi' but the former expresses a different shade

of meaning and a different attitude of the speaker, as in the example below:

Sapo e pa këtë njeri, Artanës iu prenë këmbët dhe u mbështet më shumë pas Etlevës. "Ç'është vallë ky gojëzënë? Që nga e ka sjellë kokën? Ç'kërkon?"[5]

Idiomatic expressions have a wider scope of use than being used in informal speech. They are also used in different literary genres including poetry. The famous Albanian writer Dritëro Agolli uses lots of idioms in his poems:

*Mua peshqit më lënë pa mend, më çudisin
Me buzët e tyre përçmuese, përqeshëse;
Pastaj kur më kthejnë kurrizin,
Më flakin fytyrës indiferencën rrëqethëse! [2]*

Despite having the same meaning with the synonymic verbs, phraseological unit may be stylistically different as in:

fut hundët – ndërhy
*Beu i zemëruar, sikur t'i paskish prerë udhën
ndonjë lepur ugursëz, qëndroi kalin: -Jeziti! Vjen
nga prapa diellit dhe fut hundët në çifligun tim,
sikur të jetë pa zot... [8]*

In some idiomatic expressions of verb + noun type, mainly in greetings, cursing etc. the verb form and the order of their constituents changes, leading to a different form from its literary equivalent due to emphasis and relating to style and genre they are used in making the second expression more common than the first:

*Për motin e pestë, e shkreta gjyshe ndjesë pastë,
nuk e priti dot gjersa të vinte puna te krasitja pa
të zemërohej. Ajo ia plasi që në pyetjen e parë
kumbares. [8]*

Ellipsis is also common in some phraseological units having the same meaning as the full idiomatic expression. So, 's'ia vlen' and 's'ia vlen barra qirasë' or 'ia mblodhi' and 'ia mblodhi rripin':

*Mos ki qeder. Do të ngrihet ajo dhe do të shohim
se kujt do t'ja mbledhë më parë. [9]*

Considering that idiomatic expressions are used in a wide range of situations means that the same verb can have different phraseological units as its equivalent in different levels of the language. For instance, 'vdiq' (die) in Albanian can be replaced by different idiomatic expressions in different styles and genres - *e ndjeu perëndia; ndërroi jetë; dha shpirt; mbylli sytë; ndeu këmbët; i ktheu patkonjtë nga dielli; na e mori të keqen; e la fryma; harroi të merrte frymë, i bëri këmbët bigë; shkoi për të bërë vegsha.*

In English language there is a number of expressions for the same verb 'die' - *kick the bucket; the golden bowl is broken; turn up one's toes; slip one's cable; slip through one's fingers; tip over the perch; give up the ghost.* These idiomatic expressions are marked by semantic and stylistic differences. For instance, 'the golden is broken' is of biblical origin, a euphemism for death which nowadays is used by different writers. Quite often, idioms are used in puns or to express humour where they have both the literal and figurative meaning:

"Isn't our Kate a marvel! I wish you could have seen her at the Harrisons' party yesterday. If I'd collected the bricks she dropped all over the place, I could build a villa".

In conclusion, phraseological units cannot be understood and translated based on their first original meanings. Idioms cannot be separated from their colourful origins which reflect differences in language systems, geographical environment, diverse custom habits, religion and culture. Moreover, phraseological units are one of the most remarkable parts between languages. Therefore, we can get lots of knowledge about culture through studying idioms and in turn get better understanding of idioms by learning the connotation meaning and the cultural background behind them.

References

1. Abeillé, Anne (1995): "The flexibility of French idioms: A representation with lexicalized tree adjoining grammar", Hillsdale, NJ: Lawrence Erlbaum Associates, 15-43.

2. Agolli, Dritëro (1995): *Lypësi i kohës*. (Poezi). Tiranë: Shtëpia botuese "Enciklopedike".
3. Glucksberg, Sam (1993): "Idiom meaning and allusional content", Hillsdale, NJ: Lawrence Erlbaum, 3-26.
4. Kuteli, Mitrush (1972): *Tregime të zgjedhura*. Tiranë: Shtëpia botuese "Naim Frashëri".
5. Kuteli, Mitrush (1964): *Vepra letrare 3/Novela*. Tiranë: Shtëpia botuese "Naim Frashëri".
6. Mel'čuk, Igor A. (1995): "Phrasemes in language and phraseology in linguistics", Hillsdale, NJ: Lawrence Erlbaum Associates, 167-232
7. Шнтова Л. Ф., Брускина Т. Л. (2005): English idioms and phrasal verbs, Антология.
8. Xoxa, Jakov (1965): *Lumi i vdekur*. Vëllimi I. Tiranë: Shtëpia Botuese "Naim Frashëri".
9. Xoxa, Jakov (1980): *Juga e bardhë*. Vëllimi I. Tiranë: Shtëpia Botuese "Naim Frashëri".
10. Xoxa, Jakov (1980): *Lulja e kripës së butë*. Vëllimi I. Tiranë: Shtëpia Botuese "Naim Frashëri"...

LIDHJET SISTEMORO-STRUKTURE NË RRAFSHIN E FORMËS DHE TË PËRMBAJTJES NË TERMINOLOGJINË E SË DREJTËS

THE SYSTEM-STRUCTURE CONNECTIONS IN FORM AND CONTENT LEVEL OF THE LANGUAGE TERMINOLOGY OF LAW

EDA SHEHU

Departamenti i Gjuhëve Slave dhe Ballkanike, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës, Tiranë,
Shqipëri

Email: edashehu_2006@yahoo.com

AKTET VII, 4: 349-357, 2014

PËRMBLEDHJE

Koncepti i sistemit gjenë zbatim të plotë në rrafshin paradigmatic të lidhjes së njësive si nga ana e formës, ashtu edhe nga ajo e përmbajtjes, sikurse në çdo terminologji edhe në terminologjinë e së drejtës. Lidhjet ndërmjet njësive në këtë terminologji të stilit juridiko-administrativ në rrafshin sistemor paradigmatic, duke u mbështetur në kuptime (koncepte), të shkarkuara nga ngjyresa emocionuese e shprehëse shfaqen më të drejtpërdrejta, më të rregullta. Në të takohen forma, struktura e mjete gjuhësore të lidhura me përmbajtje semantike pak a shumë të përcaktuara. Lidhjet e njësive në rrafshin paradigmatic mund të ndahen në një varg grupesh, si në rrafshin e formës, ashtu edhe të përmbajtjes, si: a) lidhje kuptimore konceptore, si p.sh.: *e drejta₁ + e drejta₂ + e drejta₃*; b) lidhjet termformuese njëfjalësore, si p.sh.: *ligjor-e / statutor-e / kuvendor-e*; c) lidhjet termformuese togfjalëshore, si: *akt administrativ / akt i gjendjes civile / akt ligjvënës*.

Fjalë çelës: sistem, lidhje, njësi, term, form, përmbajtje, rrafsh paradigmatic.

SUMMARY

The law language terminology, like other kinds of terminology, is the result of the application of the concept of the system in the paradigmatic level of connection of units, both in form and content. At paradigmatic system level of juridical-administrative style of terminology, the connections among units are more direct and more regular, since they are free from emotional shades of expression. These connections are characterised by forms, structures and language means, with more or less, designated systematic contents. The connections of the units, at paradigmatic level can be divided into a number of groups, at both form and content level, such as: a) Symantic, conceptual connections, such as: *law₁ + law₂ + law₃*

b) One word term forming connections such as: *legal – statutory – assembly*, c) Word group term-forming connections, such as: *administrative act / civil status akt / law-making act* ect.

Key words: system, connection, unit, term, form, content, paradigmatic level.

Hyrje

Koncepti i sistemit gjenë zbatim më të plotë në rrafshin paradigmatic të lidhjes së njësive si nga ana e formës, ashtu edhe nga ajo e përmbajtjes.

Siç është nënvizuar me të drejtë, në lidhjet kuptimore midis njësive të gjuhës, zbatimi i idesë së sistemit del në forma më të ndërlikuara, sidomos kur kuptimet e tyre janë të ngarkuara

me ngjyresa subjektive emocionuese-shprehëse. Kjo do të thotë se lidhjet ndërmjet njësive të stilit juridiko-administrativ në rrafshin sistemor paradigmatic, duke u mbështetur në kuptime (koncepte), të shkarkuara nga ngjyresa emocionuese e shprehëse, shfaqen më të drejtpërdrejta, më të rregullta. Lidhjet asociative ndërmjet njësive gjuhësore, në kuptimin sosyrian të fjalës në këtë stil janë më të rregullta e më sistimore. Në të takohen kryesisht forma, struktura e mjete gjuhësore, të lidhura me përmbajtje semantike pak a shumë të përcaktuara:

a) me përputhje barasvlerësish: ***në fuqi*** (*hyn*), ***në ligj***, ***në pritje***, ***për shkak*** (të detyrës)

b) me mospërputhje barasvlerësish: ***me burgim***, ***me thyerje*** (grabitje), ***me mosveprim***

c) me elemente përbërës të diferencuar dhe me kufij pak a shumë të prerë ndërmjet tyre, çka bën që edhe ndërmjet njësive speciale të shumëkuptimshme të krijohen lidhje asociative të drejtpërdrejta, simetrike dhe të përshkallëzuara. Kjo çon në rritjen e karakterit të diferencueshëm si të kuptimeve, ashtu edhe të njësive gjuhësore, në të cilat ato pasqyrohen brenda një përmbajtjeje të caktuar semantike. Në mënyrë të veçantë kjo vërehet edhe në ata terma që janë ngritur mbi bazën e fjalëve të zakonshme, siç mund të vërehet në lidhjet në sistem te çiftet *fjalë / term*: *e drejta*₁ (fjalë), *e drejta*₂ (term) dhe *kallëzim*₁, *kallëzim*₂, *veprim*_{1,2}, *paraqitje*_{1,2} (në gjyq), *ndalim*_{1,2}, *vepër*_{1,2} etj.

Vështuar nga pikëpamja e mësipërme, lidhjet e njësive në rrafshin paradigmatic mund të ndahen në një varg grupesh, si në rrafshin e formës, ashtu edhe të përmbajtjes. Këto lidhje, sigurisht, në konceptimin sosyrian, janë lidhje asociative të sistemit (të gjuhës) dhe jo të ligjërimit dhe si të tilla përbëjnë fondin e kompetencës së ligjëruesit, d.m.th. shprehin raportin ndërmjet njësisë reale në gjuhë (në performancë) dhe asaj të asociuar në vetëdijen gjuhësore të tij. Si të tilla ato nxirren si nga tekstet e stilit përkatës, ashtu edhe nga veprat leksikografike, nga fjalorë, nga të cilët njësitë vendosen të sistemuara, si në rrafshin e formës (në fjalorët shpjegues), ashtu edhe të përmbajtjes (në fjalorët shpjegues, të gjuhës së

përgjithshme apo nga ata terminologjikë). Meqë, në përgjithësi, të gjitha njësitë dhe format gjuhësore në këtë stil dalin të njëkuptimshme (si fjalët, ashtu edhe termat), atëherë të dyja këto lloje njësish, si dhe elementet përbërëse të tyre do të vështrohen si lidhje në grupet sistimore-strukturore.

1) Lidhje kuptimore konceptore

Sistemet kuptimore – konceptore nxirren kryesisht nga lidhjet paradigmatiche (asociative) të çdo njësie të marë në vetvete, si, psh. *e drejta*₁ + *e drejta*₂ + *e drejta*₃ kur ato paraqiten si fjalë me një ose disa kuptime të dhëna dhe si terma me një përmbajtje konceptore të caktuar, të përbëra nga një ose disa koncepte, të shprehura po nga e njëjta njësi, siç u përmend më sipër *e drejta*_{1,2,3}.

Në këtë rast kemi dy lloje lidhjesh të përmbajtjeve të njësisë: 1. lidhjet kuptim (kuptime) + koncept, ku lidhen në sistem kuptimi i njësisë si fjalë dhe koncepti po i asaj si term, d.m.th. *e drejta*₁ (fjalë) dhe *e drejta*₂ (term), *ndalim* (si fjalë) dhe *ndalim* (si term); 2. lidhjet *koncept*₁ + *koncept*₁, ku *koncept*₂ (= *e drejta* (si fushë veprimtarie) është zhvillim i mëtejshëm i konceptit₁ (= *e drejta* e votës), si edhe më tej *e drejta*₃ (si shkencë). Po kështu mund të thuhet për lidhjet kuptimore e sistimore paradigmatiche: *ndalim*₁ (si fjalë) + *ndalim*₂ (si term) + *ndalim*₃ (po si term) (= “mbajtje nën arrest për një kohë të shkurtër”).

Si bazë analize, për të zbuluar lidhjen ndërmjet kuptimeve dhe koncepteve të njësisë, mund të shërbejnë dy burime, sipas të cilave mund të hetohet mekanizmi i formimit të termave mbi bazën e fjalëve të zakonshme, por edhe i zhvillimit të mëtejshëm të termave për emërtimin e koncepteve të reja, sipas të njëjtës njësi, si shfaqje të polisemisë (homonimisë). Si burim i parë mund të shërbejnë fjalorët shpjegues, përfaqësues të gjuhëve përkatëse (si shqipe ashtu edhe ruse), ku pasqyrohen në strukturën semantike të fjalëve lidhjet e kuptimeve dhe të termave, siç mund të jenë

"Fjalori i gjuhës së sotme shqipe" (1980), kurse si burim i dytë, mund të, shërbejë studimi i valencave të termave, të nxjerra nga rrethi i përdorimit të tyre në lidhjet sintagmatike. Kjo është e rëndësishme të ndiqet si procedurë, sepse fjalorët shpjegues të gjuhës nuk mund të pasqyrojnë të gjitha ato kuptime të specializuara (koncepte), të cilat mund të nxirren nga hetimi i përdorimit të termave në tekstet speciale të fushës, në rastin tonë të stilit juridiko-administrativ. Si modele të paraqitjes të lidhjeve kuptimore e konceptore, të nxjerra nga fjalorët shpjegues do të marrim si terma përfaqësues njësinë *e drejta*, kurse për lidhjet kuptimore-konceptore, të nxjerra nga lidhjet sintagmatike të teksteve, do të sjellim një varg shembujsh, të cilët plotësojnë tablonë e mësipërme.

Rasti a) **"Fj. gj.1980"**:

e drejta 1. *tërësia e normave* që rregullojnë marrëdhëniet shoqërore



e drejta 2. *"shkenca që merret me studimin e këtyre normave..."*



e drejta 2.1 *degë e kësaj shkence* për një anë të veçantë të saj ...



e drejta 3. *"lëndë mësimore..."*



e drejta 3.1 *"teksti i lëndës mësimore"*



e drejta 4. *mundësi që sigurohet me ligj ...*



4.1 *mundësi që jepet sipas ligjit ...*

4.2

4.3

4.4

e drejta 5. *"arsye a shkak që për ligj një veprim..."*



e drejta 5.1 *"diçka që mendohet si e drejtë, e lejuar..."*

Duke u mbështetur në lidhjet kuptimore-konceptore të njësisë *e drejta* (si fjalë dhe si term), mund të shihet se në fjalorë lidhja e fjalës me termin pasqyrohet nga e kundërta, ku si bazë nuk merret fjala (*e drejta*), mbi të cilën ngrihet

termi *e drejta*, por në fillim jepet termi *e drejta* dhe pastaj fjala, kurse realisht termi del nga fjala dhe jo anasjelltas. Kjo na bën të rindërtojmë lidhjet kuptimore-konceptore, sikurse mund të nxirreshin nga rrethi i përdorimit të tyre në tekst. Kështu, fillimisht duhet nisur nga fundi, nga kuptimi (5.1: *"diçka që mendohet si e drejtë, e lejueshme"*), i cili paraqitet realisht si kuptim primitiv, fillestar i vetë fjalës *e drejta*. Nxjerrja në pah e këtij kuptimi të fjalës, e plotësuar nga nuanca tjetër (shih 5: *"diçka që quhet a mendohet se është drejtë dhe e lejueshme"*), shërben si bazë për të trajtuar raportet e termit (*e drejta*) me fjalën, mbi të cilën ngritet (*e drejta*), ashtu edhe mekanizmin e formimit të termit vetë, i cili realisht fillon si formim prej 5.1 e jo nga kuptimi 1 i dhënë në Fjalorin përkatës, d.m.th. nga 1.

Pra, kështu mund të rindërtojmë edhe njëherë strukturën semantike të fjalës, brenda së cilës jepen edhe kuptimet e specializuara (konceptet) e fjalës term – *e drejta* (në rastin tonë të fushës së stilit juridiko-administrativ).

*e drejta*₁ *"diçka që mendohet si e drejtë e lejuar"* (si *fjalë*)



*e drejta*_{1.1} *"diçka që quhet a mendohet si e drejtë e lejueshme"* (si *term*)



*e drejta*₂ *"mundësi që sigurohet me ligj..."* (si *term*)



*e drejta*_{2.1} *"mundësi që jepet sipas ligjit"* (si *term*)



*e drejta*₃ *tërësi normash* (si *term*)



*e drejta*₄ *degë e kësaj fushe* (si *term*)



*e drejta*₅ *shkenca për fushën* (si *term*)



*e drejta*₆ *lëndë mësimore* (si *term*)



*e drejta*₇ *teksti lëndës mësimore* (si *term*)

Në mënyrë të veçantë, në bazë të lidhjeve sistimore paradigmatiche të njësisë si term mund të qëndrojnë kuptime të përgjithësuara që shprehin raporte të caktuara, si p.sh. marrëdhënie ndërmjet kuptimit “të procesit”: *vërtetim*₁ (= vërtetim i aktit) dhe “rezultatit të veprimit”: *vërtetim*₂ (= “tekst i shkruar”), si dhe ndërmjet këtij të fundit dhe objektit të përftuar, *vërtetim*₃ (= si “dokument i shkruar”) (teksti + letra që përmban tekstin). Kuptime të tilla të përgjithësuara, në të cilat pasqyrohen lidhjet logjike ndërmjet koncepteve, të shprehura nga e njëjta shenjë (njësi), mund të hetohen në mjaft terma të fushës në fjalë. Më poshtë po japim një varg shembujsh të lidhjeve sistimore kuptimore-konceptore të një varg termash nga fusha e stilit juridiko-administrativ:

*aplikim*₁ (“proces”) – *aplikim*₂ (“rezultat”) – *aplikim*₃ (“dokument”);

*avokat*₁ (“fushë e praktikës juridike”) – *avokat*₂ (“vend”) – *avokat*₃ (“tërësi e avokatëve”);

*dhurim*₁ (“proces”) – *dhurim*₂ (“rezultat”);

*goditje*₁ (“proces”) – *goditje*₂ (“rezultat”);

*kërkesë*₁ (“proces”) – *kërkesë*₂ (“rezultat”) – *kërkesë*₃ (“dokument”);

*korrigjim*₁ (“proces”) – *korrigjim*₂ (“rezultat”) – *korrigjim*₃ (“pjesë e korrigjuar”);

*lutje*₁ (“proces”) – *lutje*₂ (“rezultat”) – *lutje*₃ (“dokument”);

*ndalim*₁ (proces) – *ndalim*₂ (“rezultat”);

*paraqitje*₁ (“proces”) – *paraqitje*₂ (“tekst i paraqitur”);

*përmbarrim*₁ (“proces”) – *përmbarrim*₂ (“vendi ku kryhet procesi”: *Po shkoj në përmbarrim*);

*shfrytëzim*₁ (i njeriut) – *shfrytëzim*₂ (“i postit”);

*shkurorëzim*₁ (“proces”) – *shkurorëzim*₂ (“rezultat”);

*vërtetim*₁ (“proces”) – *vërtetim*₂ (“shkresë”).

Një grup më vete me interes të veçantë stilistikor përbëjnë një varg fjalësh kryesisht librorë të cilat qëndrojnë në bazë të termave togfjalësh. Në përbërje të termave togfjalësh, duke u përdorur kryesisht si elemente të

përcaktuara, ato fitojnë status të veçantë në strukturën ndërtimore të termit dhe si të tilla, në fjalorët terminologjikë, dalin edhe si njësi të pavarura, siç janë p.sh. *afat*, *afatësi*, *përdorim*, *ndryshim*, *ndreqje*, *nevojë*, *ngatërrim*. Nga *Fjalori të drejtës* (Tiranë 1986) me *afat* ka 22 togfjalësha (*afati i hetimit*, *afat i parashkrimit*) dhe *afat* / jepet edhe si njësi e veçantë (si të thuash e pranuar si term i fushës). Këto njësi që mund të cilësohen në vetvete më shumë si fjalë të zakonshme, kanë strukturën e tyre kuptimore, të dhënë në *Fjalorët shpjegues të gjuhës*, me lidhjet e tyre të ndryshme kuptimore, si p.sh. *ndryshim*, *përdorim* (2 kuptime) etj.

Vetëkuptohet se mbi bazën e kuptimit themelor të secilës prej tyre merr vlerë koncepti rezultat i shprehur nga termi togfjalësh, si p.sh. me *përdorim* ka 7 togfjalësha terminologjikë (*përdorim vetjak*, *përdorim pa shpërblim*, por njësia *përdorim* nuk jepet si njësi e pavarur, meqë është cilësuar nga hartuesi i fjalorit si fjalë e zakonshme, çka është e kundërt me njësinë *afat*, të përmendur më sipër. Siç u theksua më lart lidhjet e tyre kuptimore si njësi të veçuara në rrafshin paradigmatic mund të nxirren nga fjalorët e gjuhës së përgjithshme, kurse lidhjet konceptore mund të analizohen në rrafshin sintagmatik, siç mund të paraqiten në shembujt e mëposhtëm:

Përdorim (sipas FSh) në lidhjet kuptimore paradigmatiche e të korrelatuara me foljen *përdor* ka 7 kuptime: 1. “*shtie në punë*” ... 2. “*shfrytëzoj*” ... 3. “*hipi me mjet transporti*” 4.5.6.7. “*vë në jetë*” ...

Përdorim / në lidhjet sintagmatike, si bazë e formimit të termave togfjalësh në *Fj. i së drejtës*, siç u përmend më sipër, ka 7 togfjalësha në secilën gjuhë: *përdorim dokumentash të rreme*, *përdorim i pakujdesshëm i makinave*, *përdorim i pakujdesshëm i pajisjeve teknike*, *përdorim i paligjshëm i vartësit*, *përdorim pa shpërblim*, *përdorim shoqëror*, *përdorim vetjak*.

Siç del nga shembujt e mësipërm marrëdhëniet sintagmatike, në të cilat hyn njësia *përdorim* në togfjalëshat terminologjikë mund të lidhen me kuptime primitive (bazë) të saj ose edhe, sipas rastit, me kuptime të ndryshme që ajo ka. Këto

raste kërkojnë analiza të veçanta e të holla, të cilat s'mund t'i bëjmë objekt të këtij studimi.

2) Lidhjet termformuese njëfjalësore

Këto lidhje paradigmatiche krijohen mbi bazën e marrëdhënieve të termave sipas një elementi të përbashkët, i cili mund të jetë nga forma që nga një mjet ndajshesor (parashtesë, prapashtesë) e deri një fjalë e pavarur (fjalë ose term). Studimi i tyre ka vlerë të veçantë si teorike për të hedhur dritë mbi mekanizmin e formimit dhe funksionimit të termave, ashtu edhe praktike në punën për hartimin e fjalorëve terminologjikë. Duke i vështruar hierarkisht mjetet termformuese, nga të thjeshta tek ato të përbërat, mund të dallonim këto grupe, të cilat duhen vështruar secili më vete.


1. Me mjete ndajshesore:

a) parashtesim: **mos:** *mosveprim* / *mosparaqitje*, *mosekzekutim* / *mosdhënie*;

b) prapashtesim: **or:** *ligjor-e* / *statutor-e* / *kuvendor-e*.

Lidhjet e mësipërme nga ana e brendshme mund të vështrohen edhe në rrafshin sintagmatik: *mos* + *veprim* → *mosveprim*, *ligj* + *or* → *ligjor*

2. Me fjalën ose me pjesën e termit si *temë prodhuese*: *ligj:* *ligjor* / *i ligjshëm* / *ligjshmëri* / *ligjvënës* / *ligjvënës-e* / *ligjbërës-i* / *ligjbërës-e* / *ligjbërje* / *ligjzbatues-i* / *ligjzbatues-e* ...



Për fjalën, si fjalë e zakonshme ose si term që shërben si bazë për formimin e termave togfjalësh, si temë termformuese do të merret jo

vetëm elementi i përcaktuar, që shërben si pjesë kryesore, meqë mbart ngarkesën konceptore parësore të termit, por edhe elementi përcaktues, i cili, ndonëse mbart peshën dytësore të informacionit të specializuar, bën pjesë në strukturën formuese të termit. Kjo do të thotë se të dy elementet e togfjalëshit terminologjik plotësojnë njëri – tjetrin dhe kushtëzojnë ndërsjellësisht përmbajtjen e konceptit rezultat të termit. Ashtu sikurse elementi i përcaktuar shërben si bazë për përmbajtjen e konceptit rezultat si, p.sh. *kod*, tek *kod ligjor*, ashtu dhe elementi përcaktues *ligjor* specifikon konceptin, duke e diferencuar nga të tjerët. Kështu, p.sh. tek *kod rrugor* elementi përcaktues specifikon elementin e përcaktuar *kod*, duke e diferencuar nga *kod* në togfjalëshin *kod ligjor*. Kjo do të thotë se *kod* në të dyja rastet nën veprimin e elementeve përcaktuese *ligjor* dhe *rrugor* fiton dy ngjyresa kuptimore (konceptore) të ndryshme. Përveç kësaj, termat togfjalësh i përkasin dy fushave (sferave) të ndryshme: *kod ligjor* (drejt.) dhe *kodi rrugor* (ek.transp.).

Nga ana tjetër duhet nënvizuar, se në specifikimin e kuptimit të elementit përcaktues kanë peshën e vet edhe lidhjet sintagmatike të pjesëve fjalëformuese, të cilat specifikojnë njëra – tjetrën sidomos brenda të tërës, por në bashkëvajtje edhe me elementin e përcaktuar. Kështu, p.sh. tek *ligjor* mund të veçojmë lidhjen sintagmatike *ligj* + *or*, ku *–or* kuptimisht diferencohet në marrëdhënie me *ligj*, kur krahasohet me një element tjetër përcaktues me të njëjtën prapashtesë *–or*, si, p.sh. tek *statutor*, *statut* + *or*, tek *kuvendor* *kuvend* + *or*. Mund të shihet se *–or* vihet në raport me elementin tjetër të sintagmës fjalëformuese, d.m.th. me *statut*, *kuvend*, *ligj*, *rrugë* dhe në vartësi të tyre modifikohen ngjyresat kuptimore të saj, si: a) “sipas ligjit” në: *rrugë ligjore*; b) “i kuvendit”, “që i përket kuvendit” tek *Komisioni Kuvendor*; c) “i ligjeve” tek *kod ligjor*. Kjo do të thotë se prapashtesat në vartësi të pjesës temore dhe të elementit të përcaktuar të togfjalëshit terminologjik diferencohen kuptimisht, ndonëse kjo mund të zbulohet edhe në strukturën fjalëformuese të termit të marrë veças, çka del

edhe nga konteksti si: 1) **Vërtetimi i faktit bëhet lehtë** (=kuptimi i “veprimit”) dhe 2) **vërtetimi u dorëzua në kohën e duhur** (=kuptimi “i objektit”), pra: *-im* në rastin e parë ka kuptimin e rezultatit të veprimit, kurse *-im* në rastin e dytë ka kuptimin e objektit. Kjo mund të zbulohet edhe në *përmbarrim* (si veprim₁ dhe si vend₂ (= *shkoi e dorëzoi dokumentin në përmbarrim*), po kështu mund të thuhet për *vendim, deklaram*.

3) Lidhjet termformuese togfjalëshore

Siç dihet ka katër modele bazë të formimit të togfjalëshave, sipas të cilëve funksionon mekanizmi i krijimit të togfjalëshave: 1) *fjalë + term*; 2) *term + fjalë*; 3) *fjalë + fjalë* dhe 4) *term + term*. Do të nënvijëzojmë se modelet 2 dhe 4 janë më të rëndësishëm. Po sjellim disa shembuj që i ilustrjnë ato.

- Në rastin e modelit *term + fjalë*, kuptimi i fjalës modifikohet nga kuptimi (përmbajtja konceptore) i termit, si: ***i lartë*** / tek *gjykata e lartë*, ***i rëndë*** / tek *dënim i rëndë*, ***i lehtë*** / tek *dënim i lehtë*, ***i huaj*** / tek *ligj i huaj*. Në këtë rast kuptimi (kuptimet) i fjalës tek termi mund të nxirret nga struktura semantike e saj dhe në tërësinë e vet gjithë struktura e tij mund të shihet si një sistem kuptimor me lidhje të brendshme, brenda të cilit zbulohet edhe kuptimi që ka fjala në togfjalëshin terminologjik si ***i lehtë*** tek *dënim i lehtë*.

- Në rastin e modelit *term + term*, kuptimi i termit si element përcaktues mund të modifikohet nga elementi i përcaktuar, por ky modifikim mund të jetë i patheksuar, meqë si rregull termi është kryesisht i njëkuptimshëm si *kushtetues-e* tek *gjykata kushtetuese* dhe *kushtetues-e* tek *drejta kushtetuese*.

Një problem më vete mund të përbëjnë lidhjet kuptimore të elementeve të vargut (vargjeve) termformuese, sidomos në çiftet folje/emër foljor, si p.sh. *dënoj* dhe *dënim*, *vërtetoj* dhe *vërtetim*. Në këto raste thelbin e kuptimit e përbën kuptimi i foljes që trashëgohet nga emri që lidhet nga ana e fjalëformimit (termformimit) me të, por, megjithatë kuptimi i emrit foljor mund të jetë më i gjerë se kuptimi i foljes, sepse ai fiton kuptime të tjera, si p.sh. tek *vërtetoj*,

vërtetim. Elementi *vërtetim* ka kuptimin e veprimit, të huazuar nga folja, por edhe të “objektit të veprimit” që fitohet si kuptim i ri. Kjo do të thotë se sistemet terminologjike organizohen në mënyrë më të plotë, duke pasqyruar sistemet konceptore të fushës përkatëse, përmes termave emra (sidomos nga emrat prejfoljorë). Si rregull emrat prejfoljorë jo vetëm mbushin plotësisht strukturën konceptore, meqë e japin më të plotë strukturën konceptore të fushës, por ata kanë edhe dënduri më të lartë përdorimi sesa termat folje. Ky konstatim mund të vlejë jo vetëm për termat emra të prejardhur nga foljet (ose më mirë që kanë korresponduese foljen si *dekretim* nga *dekretoj*), por edhe për emrat si leksik i përgjithshëm që kanë korrespondime me foljet përkatëse. Kështu, p.sh. mund të vihet re përparësia *lexim i pretencës* sesa *lexoj pretencën*, *përfundim i seancës* sesa *përfundoj seancën*. Në këtë rast lidhjet logjike nëpërmjet veprimeve të sendësuar jashtë marrëdhënieve kohore i shkojnë për shtat kërkesave të përmbajtjes së stilit, siç janë karakteri objektiv i paraqitjes së lëndës, depersonalizimi dhe pasivizimi i përmbajtjes së tekstit.

Duke rivështruar sistemet e krijuara mbi bazën e fjalëve si elemente formuese të termave togfjalësh, mund të arrihet në përfundimin se shkalla më e lartë e sistemësisë në lidhjet termformuese vërehet tek termat togfjalësh, të cilët në disa raste përbëhen në maksimum prej 5-6 gjymtyrësh. Kjo bën që të krijohen një rrjet lidhjesh sistmore me hierarki të plotë dhe simetri të brendshme, ku si faktor i qëndrueshmërisë së tyre dhe i identitetit si term, mund të shërbejë uniteti i gjymtyrëve për shprehjen e një koncepti rezultat, d.m.th. ku zotëron uniteti i së tërës mbi pjesët. Si njësi të hapura nga forma e jashtme, por të mbyllura nga përmbajtja e vetme konceptore që shprehin, ato mund të quhen edhe sisteme sintaksoro-konceptore, prandaj do të shihen si rast i veçantë lidhjesh sistmore. Megjithatë, ato mund të shihen në dy rrafshë: (a) në tërësinë e lidhjeve të brendshme brenda çdo togfjalëshi me bazë

fjalën; dhe (b) në raport me njësitë e tjera, me të cilat lidhen nga ana termformuese.

Si qendër organizimi të lidhjeve brenda togfjalëshit shërbejnë ato njësi të përcaktuara, të cilat shquhen për një përmbajtje konceptore ose kuptimore të gjerë, si të tilla ato përbëhen nga tri kategori leksikore: (a) *nga fjalë të përgjithshme*; (b) *nga njësi*, si leksik i përbashkët terminologjik, d.m.th. nga njësi që u përkasin disa fushave terminologjike; dhe (c) nga terma *me përmbajtje të gjerë konceptore*. Për t'i konkretizuar më drejtpërdrejt rastet e mësipërme, mund t'i referohemi Fjalorëve terminologjikë të fushës.

(a) Fjalët e përgjithshme, siç e kemi përmendur më sipër mund të qëndrojnë si njësi më vete ose mund të futen si elemente përcaktuese të togfjalëshave terminologjikë. Duke marrë për bazë të dhënat statistikore të nxjerrë nga fjalorët terminologjikë, këto njësi mund t'i paraqesim të shprehura numerikisht nga ana sasiore duke i dhënë në disa shembuj të veçantë: ***bashkim*** (6): *bashkim çështjesh*, *bashkim dënimesh*, *bashkim sendesh*; ***dëm*** (13), ***dëmtim*** (18), ***dërgim*** (6), ***dhënie*** (6), ***dhomë*** (3), ***fëmijë*** (6), ***fillim*** (4) ***fshehje*** (5);

(b) Njësi të sistemeve të ndryshme terminologjike, si leksik i përbashkët terminologjik: ***gjendje*** (7): *gjendje civile*, *gjendje juridike*, *gjendje lufte*; si *formë*, *përmbajtje*; si strukturë sistem, fuqi, *forcë*, *gjendje*, *bazë*;

(c) Terma të mirëfilltë: akt (7): *akt administartiv*, *akt i gjendjes civile*, *akt ligjvënës...*, ***çështje***, ***detyrim***, ***dënim***, ***e drejta***, ***ekzekutim***, ***gjykim***.

4) Lidhjet leksiko-kuptimore

Termat në nivel fjalësh lidhen me njëri – tjetrin në bazë të kuptimeve si koncepte speciale të përafërta dhe të përbashkëta të fushës në fjalë, duke shërbyer kështu si bazë për të studiuar mekanizmin e funksionimit të të gjitha njësive të këtij leksiku në ligjërim, në mënyrë të veçantë në lidhjet sintagmatike. Në këtë rast këto të fundit zbulojnë qartazi lidhjet paradigmatiche në sistem. Mund të vërehet lehtëzi se njësitë leksikore futen në lidhje leksiko-semanticore si kategori të njëjta leksiko-gramatikore në bazë të kuptimeve të

niveleve të ndryshme: (a) *të përbashkëta*, si të përfshira në një kuptim të përbashkët; (b) *të përafërta*; (c) *që kryqëzohen njëra me tjetrën*; (d) *që renditen sipas një shkallëzimi*.

Vështruar nga pikëpamja e marrëdhënieve term-koncept, d.m.th. barazisë së secilit me konceptin që shprehin, vlera e këtyre lidhjeve paradoksalisht ka të bëjë më tepër me zbulimin e diferencave të njërës njësi nga tjetra, pra më tepër nga ajo që i ndan sesa i bashkon. Kjo përbën edhe thelbin e rëndësisë së evidentimit të këtyre lidhjeve, të ngritura në sisteme (mikrosisteme) leksiko-kuptimore (konceptore).

Deri diku mund të thuhet se këto lidhje mund të përngjashmohen me lidhjet sinonimike relative, siç vërehen në leksikon e përgjithshëm, por, megjithatë, në këtë leksik me natyrë speciale, mbizotërojnë vlerat diferencuese të njësive dhe jo ato variuese. Pra, ndryshe nga leksiku i përgjithshëm ato nuk variojnë mendimin, por, përkundrazi e diferencojnë atë.

Për t'u mos shpërndarë në këtë temë, e cila lidhet më tepër me marrëdhëniet e sinonimisë ndërmjet termave do të përqendrohemi këtu vetëm në atë pjesë që na intereson më tepër dhe që lidhet me natyrën e kuptimeve (koncepteve) që shërbejnë si premisë për futjen e njësive të specializuara (të termave) në llojin e lidhjeve të mësipërme leksiko-kuptimore (konceptore).

(a) Njësi të lidhura në bazë të një kuptimi (koncepti) përfshirës:

jurist: *avokat* – *avokat mbrojtës* – *gjykatës* – *përmbaarues* – *noter* – *prokuror*

shikoj: *vërej* – *vrojtoj* – *vëzhgoj* – *këqyr* – *mbikqyr* – *hetoj* – *gjurmoj* – *ndjek*.

(b) Kuptime të përafërta:

avokat – *avokat mbrojtës* – *gjykatës*; *hetues* – *kriminalist* – *penalist*;

hartoj – *formuloj*; *vrojtoj* – *vëzhgoj* – *ndjek* – *gjurmoj* – *këqyr* – *mbikqyr* – *hetoj*

(c) Kuptime (koncepte) që kryqëzohen:

ligj – *e drejta* – *drejtësi* (*jurisprudencë*), *gjurmoj* – *hetoj*, *avokat* – *avokat*

(d) Kuptime (koncepte) të shkallëzuara:

vjedhje – *grabitje*; *vërej* – *vrojtoj* – *vëzhgoj*; *godit* – *lëndoj* – *plagos* – *vras*.

5) Lidhjet tematiko-leksikore

Në bazë të këtyre lidhjeve qëndron (vihet) një koncept, që shënohet nga një term i caktuar, si përfaqësues i një fushe (mikrofushe) tematike dhe rreth tij grumbullohen të gjitha njësitë që bashkohen konceptualisht me të. Kjo shërben për të studiuar leksikun special të fushës në mënyrë të detajuar, në të gjitha lidhjet e imta, përmes së cilave vështrohet se si mbulohet gjithë mikrofusha e dijes (një pjesë e mikrostrukturës së saj), nga gjithë sistemi terminologjik përkatës. Çdo mikrofushë ndahet në pjesë të veçanta sipas temës bazë.

Një shembull mund të jepet me mikrofushën "gjyq":

gjyq – *gjykoj* – *gjykim* – *gjykatës* – *e* – *gjyqtar* – *avokat* – *avokatin mbrojtës*

thirrur – *i ftuar* – *i pandehur* – *akuzues*
– *i akuzuar*
denoncoj – *akuzoj*

ndëshkoj – *dënoj* – *burgos* / *наказывать* – *осуждать* – *арестовать*

6) Lidhjet terminologjiko-konceptore

Në bazë të lidhjeve të termave qëndrojnë (vendosen) marrëdhëniet që ekzistojnë ndërmjet termave. Sipas studimeve të bëra janë përcaktuar katër lloj marrëdhëniesh konceptore themelore, mbi bazën e të cilave lidhen termat njëri me tjetrin:

- 1- Marrëdhënie gjini/lloj ose lloj/gjini;
- 2- Marrëdhënie e tëra/pjesa;
- 3- Marrëdhënie shkallëzore;
- 4- Marrëdhënie kundërvënëse;
- 5- Marrëdhënie funksionale;

Marrëdhëniet vështrohen si ndërmjet termave fjalë dhe termave togfjalësh si njësi të veçuara, ashtu edhe ndërmjet elementeve përbërëse të togfjalëshave. Këtu do të vështrohen marrëdhëniet ndërmjet termave fjalë dhe termave togfjalësh, por jo ndërmjet elementeve të termave togfjalësh. Megjithatë mund të

vërehet se një pjesë prej tyre, si lidhje të natyrës paradigmatiske (asociative), mund të takohen edhe në sistemet e përshkruara më sipër.

1. Marrëdhëniet gjini/lloj:

avokat → *avokat mbrojtës*.

2. Marrëdhënie e tëra/pjesa:

bashki › *minibashki* / › *komunë*;

shtet › *qark* / › *rreth* › *qytet* / › *lagje* / › *bllok*.

3. Marrëdhënie shkallëzore:

bashki → *minibashki* → *komunë*;

përvetësim → *rrëmbim* → *vjedhje* → *grabitje*;

kapje → *ndalim* → *arrestim* → *burgim*.

4. Marrëdhënie kundërvënëse:

fajësi ≠ *pafajësi*;

veprim ≠ *mosveprim*.

5. Marrëdhënie funksionale:

a. vend / veprim : *gjykatës* → *gjykim*

b. person / veprim : *gjykatës* → *gjykoj* (*gjykim*) – *dënoj* (*dënim*);

kriminel → *vret*, *kundërvajtës* → *shkel*.

c. veprim / person : *shkelje* → *kundërvajtës*, *gjykim* → *gjykatës*, *hetim* → *hetues*

Përfundim

Studimi i lidhjeve sistemoro-strukture në rrafshin e formës dhe të përmbajtjes në terminologjinë e së drejtës ka vlerë të veçantë si teorike për të hedhur dritë mbi mekanizmin e formimit dhe të funksionimit të termave, ashtu edhe praktike në punën për hartimin e fjalorëve terminologjikë. Kjo shërben për të studiuar leksikun special të fushës në mënyrë të detajuar, në të gjitha lidhjet e imta, përmes së cilave vështrohet se si mbulohet gjithë mikrofusha e dijes (një pjesë e mikrostrukturës së saj), nga gjithë sistemi terminologjik përkatës.

Bibliografi

(1980), Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë.

(1986), Fjalor i termave të së drejtës, Tiranë.

CHOMSKI N, (1957), Syntactic structures, The Hague Mouton.

DURO A, (2001), Terminologjia si sistem, Tiranë.

LEKA F, (1983), Udhëzues për përpunimin e terminologjisë teknike-shkencore, Tiranë.

MEMUSHAJ R, (1989), Morfologji e eptimit të gjuhës së sotme shqipe, Tiranë.

PASHO H, (2005), Terminologjia e ekonomisë në gjuhën shqipe, Tiranë.

SAMARA M, (2008), Rreth leksikut politik e shoqëror në gjuhën shqipe, Tiranë.

THOMAI J, (2009), Prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe, Tiranë...

UNDER THE SHADOW OR ON THE TOP OF JOURNALISM OF THE YEAR '30

PETRO MARKO NË KRYE APO NË HIJE TË PUBLICISTIKËS SË VITEVE TRIDHJETË

Edlira CERKEZI¹, Benita AHMETAJ²

¹University "Ismail Qemali", Department of Albanian Language & Literature

²Regional Department of Education

Vlora, Albania

e-mail: edlira_cerkezi@yahoo.com; haxhiraj.benita@gmail.com

AKTET VII, 4: 358-361, 2014

PËRMBLEDHJE

Punimi ynë do të fokusohet te kritika letrare, e cila bëhet fushë e njerëzve me profile dhe orientime të ndryshme. Petro Marko djaloshi më me talent e kulturë të gjerë do të nisë hapat e parë në rrugën e letërsisë si gazetar. Spikati jo vetëm me tematikën e gjerë që ai perfshiu në shkrimet e veta, por edhe me qëndrimin e një kriku të shkujdesur që i thotë hapur mendimet e tij pavarësisht se në ç'kohë jetoi dhe për ç'kohë flitej. Dihet se po në vitet '20-'30 mendimi kritik ishte gjallëruar përmes shënimeve, artikujve, recensioneve të cilat u dukën në disa të përkohshme apo fletore letrare. Pavarësisht nga strukturat primitive politike që mbisundonin ende në Shqipëri, shtypi u zhvillua në një mënyrë çuditërisht liberale. Censura kishte si në çdo diktaturë dhe disa periodikë u mbyllën, por ajo nuk arriti kurrë ato përmasa të frikshme kontrolli si në periudhën mbas çlirimit.

Fjalët çelës: fenomen inovativ, publicistike, raporte, publikime, strukturë politike.

SUMMARY

Our paper will focus on literary criticism, made of people with different backgrounds and different orientations. Petro Marko talented boy with a wide culture will begin the first steps on the path of literature as a journalist. Attracting so the attention not only of broad mass-media that he included in his writings but also with an attitude of casual Creek that I say openly despite his thoughts that we lived and naturally the question comes "what time did he lived? And what time are we talking too?". It is known that between '20-'30s was revitalize critical thinking through notes, articles, reviews of which appear in several literary temporary or notebook. Despite primitive political structures still prevailed in Albania, the press took place in a manner surprisingly liberal. Censorship was as in any dictatorship and some periodical was closed but it never failed the control of those scary proportions as in the period after release.

Key words: Innovation phenomena, journalism, propotion, publication, political structure.

Hyrje

Klima krijuese apo jeta mendore në vitet tridhjetë karakterizohej nga një shterpësi letrare, por njëkohësisht edhe vitet ku u konstituan dhe u konsolidua shtypi shqiptar në vend. Përpyekja për t'u kapërcyer kjo ishte manifesti i "*Botës së re*", e cila hidhte një hap të madh, por në mënyrë më të matur diçka të tillë e kërkonte edhe "*Përpyekja*

shqiptare". Në kritikën publicistike ishin të pranishëm Stefan Shundi dhe Kudret Kokoshi. Pjesë e opinionit u bë dhe mendimi i shkrimtarëve si Petro Marko, Nonda Bulka. Duket se kritika letrare bëhet fushë e njerëzve me profile dhe orientime të ndryshme.

Petro Marko djaloshi më me talent e kulturë të gjerë do të nisë hapat e parë në rrugën e letërsisë

si gazetar. Spikati jo vetëm me tematikën e gjerë që ai përfshiu në shkrimet e veta, por edhe me qëndrimin e një kritiku të shkujdesur që i thotë hapur mendimet e tij pavarësisht se në çfarë kohe jetoi dhe për ç’kohë flitej. Marko do të derdhë gjithë shpirtin e tij në shkrimet e veta. Do të përmendim shkrime të përditshme tek gazeta *“Shtypi”* 1937, *“Koha e Re”* 1935, *“Arbënia”* (1935-1936), apo shkrimet tek *“ABC”* e *“Vatra”* (1936). pikasin shkrimet e tij tek *“Përpyjekja shqiptare”*, revista më serioze e cila shtroi çështje të të gjitha fushave të kulturës.

Krijimtaria publicistike e Markos e parë në rrafshin kronologjik

Tri janë periudhat në rrafshin kronologjik tek krijimtaria publicistike:

1. Periudha e parë (1930-1938).-përpyjekjet e para serioze;
2. Periudha e dytë (vitet 1938-1944) – heshtje e detyruar: burg-Tiranë, Itali, vullnetar i lirisë Spanjë, internime Ustikë-Itali, partizan Itali-Shqipëri;
3. Periudha e tretë (vitet 1947-1958) – dënim me heshtje: burg mizor-Tiranë, burgim i lirisë dhe penës-Tiranë vitet ‘74-’90.

1. Periudha e parë (1930-1938)

Fakti që Petro Marko ka shkruar në shtypin e përditshëm të kohës gjithnjë në kërkim të një gazetarie të vërtetë, me një gjuhë të thjeshtë, shkruar me një humor të hollë e fin dhe një patos të theksuar patriotik. Zëri i Petro Markos u bë zëri më artikullues i Shqipërisë i viteve ‘30-’40. Tematika e larmishme e publicistikës së Markos e bën gjithnjë e më të pranishëm kontributin e tij në publicistikën shqiptare. Ai vetë shkruan në një shkrim të kohës (*“Koha e re”- nëntor 1935*): *“Jam apo s’jam njeri me kalem?! Këtë nuk e dija. Nuk është kollaj që njeriu të shkruajë doemos për një qëllim të lartë pa qenë vetë i përgatitur, i ndritur”*. Vetë Marko beson në shërbimin që i bën kombit të vet përmes shkrimeve të tij. Vetëdija e një shkrimtari që parathotë atë që ndien është e gjithëpranishme në shkrimet e tij. *“Me pak fjalë sa qindra të rinj përgatit dhe i bën që të kenë etje për këndime dhe shkrime... Shqipëria ka nevojë*

për dritë, për dritë shqiptare, rrezet e së cilës të ngrohin zemrat e këtij populli që lindi në errësi dhe që kërkon me këmbëngulje të jetojë në dritë?” (Marko 2004: 117).

Jemi në fillim të viteve dyzet kur procesi letrar ka dëshmuar që para viteve tridhjetë hope artistike të cilat ndonëse përvijohen në disa personalitete të spikatur mbeten si pulsime jo masive në atë çka letërsia pritej të rishfaqej më tej. Dihet se po në vitet ‘20-’30 mendimi kritik ishte gjallëruar përmes shënimeve, artikujve, recensioneve të cilat u dukën në disa të përkohshme apo fletore letrare.

Natyrshëm lind pyetja: ç’raport na paraqet publicistika e Markos me mendimin kritik të kohës? Nëse flitet për dukuri të risive letrare, këto nuk duhen identifikuar patjetër me fenomenin e avangardës letrare, e cila përfaqëson një mohim të asaj që ekziston më parë. Në këtë pikëvështrim Petro Marko është më shumë shqiptari që përmes shkrimeve të tij u bë tribunë e shqetësimit me zërin më përparimtar të kohës në gazetari, sesa një përfaqësues i denjë i mendimit kritik të kohës.

Edhe pse shohim disa përpyekje në shkrimet e tij me tituj *“Në prag të drejtimeve letrare”*, *“Kultura popullore”* autori thekson: *“Nuk është kollaj që njeriu të shkruajë dhe pastaj shkrimet e tij të kenë dohen dhe të lënë gjurmën e dëshiruar* (Marko 2004: 115). Pavarësisht nga strukturat primitive politike që mbisundonin ende në Shqipëri, shtypi u zhvillua në një mënyrë çuditërisht liberale. Censura kishte si në çdo diktaturë dhe disa periudikë u mbyllën, por ajo nuk arriti kurrë ato përmasa të frikshme kontrolli si në periudhën mbas çlirimit.

Botimet e vlershme ku autori vendos në tehun e kritikës gjendjen e shtypit të kohës fletore, listat dhe drejtimet e tyre, shqetësimi i Petro Markos është i ligjshëm kur bën pyetjen shqetësuese: *“Po Shkodra? Po veriu? Pasi Shkodra ka nevojë për një gazetë shkodrane, për një fletore që të përfaqësojë tërë Shkodrën. Ashtu siç “Jeta e re” e Vlorës përpiqej që në çdo numër të ndriçonte opinionin e Vlorës apo “Gazeta e Korçës”, “Demokratia e Gjirokastrës”, e cila gjendej në dorë të disa*

gazetarëve të mirë, duke plotësuar pak a shumë misionin e vetë” (Marko 2004: 125).

Edhe në këta rreshta Petro Marko na shfaq më shumë se një qëndrim kritik sesa një mendim mirëfilli kritik. Kjo patjetër lidhet me përpjekjet tij për të gjallëruar disi kritikën letrare të kohës, por edhe duke qenë i pozicionuar në shkrimet e tij gati, si refleksione të jetës së përditshme sesa një formësim të një mendimi të bazuar në një teori kritike të përcaktuar qartë. Mos ndoshta ky qëndrim refleksiv e ka mbajtur paksa në hije emrin e Petro Markos ku dëshira për të qenë në llogore të luftes e largon pak nga kjo rrugë e nisur rishtaz, kontributi i tij i sadopak të edhe pse i pandrituar në fushën e publicistikës (nënvizoj që gazetaria po luante rol themelor në afirmimin e kulturës kombëtare në Shqipëri që nga epoka e Rilindjes përparoi aq shpejt sa edhe vetë letërsia), ishte një lulëzim i shkurtër nën hijen e apokalipsit që do të vinte dhe do të shuante gjithë punën e tij të deriatëhershme.

2. Periudha e dytë ('47-'58) – heshtje e detyruar

Autori do të shkruajë me pseudonimin Demo Kote në gazetën *“Bashkimi”* janar-qershor 1945. Skicat letrare të botuara në këtë periudhë vijnë në formën e përshkrimeve letrare, si përshembull *“Dy pesëmbëdhjetë dhjetorë të Tiranës”*, apo të një vizatimi letrar si *“Drita e duarve”*, *“Panteoni i shqiponjave”*, ku na paraqitet një mënyrë mjaft interesante për nga mënyra e organizimit të lëndës. Me të është i pranishëm dialogu, i cili është shumë impenjativ përderisa merr përsipër të rrëfejë përmes pyetje-përgjigjeve mes poetit, mësonjësit, arkitektit, skulptorit, një punëtori dhe një nxënësi.

Një interes të veçantë paraqesin dy përshkrime për Migjenin ose siç e quan Petro Marko *“Millosi-shoku ynë”*, poetin e dhimbjes dhe të krenarisë, poetin e revoltës dhe të ngadhnjimit. Me të u nda fizikisht atë ditë që i tha: *“Unë do të nisem në Spanjë”*, por nuk u nda shpirtërisht prej tij për asnjë çast. Në gazetën *“Mesuesi”*, të 13 tetorit 1961 autori do të botojë shkrimin me temë *“Në klasë me Migjenin”* (Marko, P *“Diten që rojta une”*). Refleksionet janë të fuqishme dhe të unifikuara me vetë Petro Markon, ku revolta e

heshtur dhe dhimbja e tij në këtë periudhë të krijimtarisë e gjenë atë të krenuar në kremtimin e 150-vjetorit të lindjes së tij, por të dëshpëruar për misionin ende të pambaruar.

3. Periudha e tretë (vitet 1947-1958) – dënim me heshtje

Në periudhën e fundit '74-'90 do ta gjejmë Markon në burgimin e lirisë dhe penës. Tribunë e shkrimeve të tij do të bëhet gazeta *“Republika”*, viti 1991, ku fatet e vendit të tij nuk kishin si të mos e tronditnin mendjen dhe zemrën e Petro Markos. Një formë tipike e lidhjes shpirtërore me traditën letrare, por edhe me atë evropiane si dhe nevojën për t'u mbështetur në të është shtruarja herë pas here e çështjes së drejtimeve letrare të kohës në përshtatje me kërkesat e sistemit letrar shqiptar, duke kërkuar modele letrare kombëtare.

Çështja e evropianizimit të letërsisë dhe të kulturës shqiptare në përgjithësi vendoset dhe në vëmendjen e Markos në shkrimin e tij *“Në pragun e drejtimeve letrare”* tek *“Bota e re”* (1936: 7-9), *“Prapë mbi drejtimet e reja letrare”* tek *“Bota e re”* (1936: 3-11, nr. 6; 10-11, nr. 7 dhe 9-11, nr. 8 (Marko 2004).

Duke qenë një zë i vetmuar, por gjithnjë në pararojë të mendimit letrar të kohës Petro Marko është padyshim shkrimtari që as veten e vetë nuk e stolisë me fjalë të bukura edhe atëherë kur ato janë të meritueshme para mendimit që ai vetë shpreh në lidhje me profesionin e gazetarit.

Duke ngelur besnik i një marrëdhënie të patjetërsueshme që krijon çdo autor edhe me lexuesin më të thjeshtë e jo më me një që pretendon ta njohë më nga afër, do ta quaja zërin më të vullshëm, më rigoroz, shumëdimensional, ku e tashmja, e djeshmja, e ardhmja qëndrojnë të patjetërsueshme në dorën e një publicisti që shumë e më shumë do të dëshironte që të pararendte, por që heshtja më së shumti i detyroi, më shumë suspansa në krijimtarinë e tij do të mbyste edhe zërin më të lartë.

Përfundime

Duke dashur që përmes këtij studimi të shohim një Petro Marko ndryshe, jo në dritëhijet letrare,

ku formatet kallpe të asaj kohe nuk guxonin të shkruanin për krijuesin dhe njeriun më të guximshëm të atyre viteve, duke dëshiruar që kontributi i tij të mos mbetet në hije, por aspak duke e vendosur në krye me pa të drejtë, do të theksoja tri tipare që qenësisht janë të pranishme në krijimtarinë e tij publicistike, e cila si e tillë:

- a. Mbetet e shumëllojshme për nga lënda përmbajtësore.
- b. Refleksive ndaj fenomeneve të ndryshme të kohës.
- c. Në kufijtë e një kritike të mirëfilltë letrare.
- d. Një përpjekje për të qenë në krah të mendimit më përparimtar të kohës.
- e. Një zëdhënëse e vërtetë e fjalës së lirë, mishëruese e vet liberalizimit të mendimit teoriko-letrar të periudhës në fjalë (vitet '30).

Në këtë pikëpamje vepra e Petro Markos në vitet '30, kryesisht publicistika, ka një shkëlqim vetjak shqiptar e evropian njekohësisht. Duke qenë përherë jokomformist dhe madje edhe opozitar, kuptohet aq sa ishte e mundur në kushtet e sistemit stalinist shqiptar, Petro Marko është një nga desidentët e parë dhe më konsekuentë në radhët e shkrimtarëve më aktive në Shqipëri.

Kur karriera e tij gazetareske u ndërpre dhunshëm, më vonë, pas daljes nga burgu Petro Marko iu përkushtua krijimtarisë letrare e veçanërisht prozës së gjatë, romanit. Por edhe pse i përjashtuar nga radhët e gazetarisë, me qetësi e dinjitet të rrallë ai i përballoi padrejtësitë e shumta që iu bënë vite me radhë, ndërkohë kur sa e sa mediokër nderoheshin me çmime, grada e presidiume.

Edhe pse i përndjekur e i persekutuar, kur më pak e kur më shumë, ai nuk mohoi asgjë, nuk u tremb dhe nuk u step, por qëndroi krenar e i papërkulur; shkroi e punoi papushim. Si i tillë ai hyn në radhën e shkrimtarëve të rrallë, të cilët, siç ka thënë Ostrovski dëshirojnë t'i mësojnë njerëzit jo vetëm me veprën, por edhe me jetën e vet.

Bibliografi

- ALIU, Ali (1990), *Kërkime*, Tiranë.
- MARKO, Petro (2004), *Ditën që rrojta unë*, Tiranë.
- MUHAMETAJ, Enver (2008), *Mendimi letrar në vitet '39-44*, vol. 7, Tiranë.
- RESSULI, Namik (red. 1941), *Shkrimtarët shqiptarë, pjesa II*, Tiranë.
- SHERIFI, Isak (1990), *Poetika e letërsisë sociale e viteve '30*, Prishtinë.
- XHIKU, Ali (red. 1983), *Historia e letërsisë shqiptare*, Tiranë..

PETRO MARKO, VIKTIMË E CENSURËS SË SOCREALIZMIT SHQIPTAR

PETRO MARKO VICTIM OF ALBANIAN CENSORSHIP SOC-REALISM

FATJONA MEMI

E-mail: fatjonamemi@gmail.com

AKTET VII, 4: 362-366, 2014

PËRMBLEDHJE

Në dorëshkrimin tim jam përpjekur të trajtoj një çështje jo të panjohur në letërsinë shqipe, problemin e censurës, viktimë e së cilës ka qenë dhe Petro Marko, vepra e të cilit është censuruar në tri forma: i plotë, i pjesshëm dhe në elemente të caktuara të saj. Petro Marko është viktimë e censurës së socrealizmit shqiptar në veprën e botuar dy herë “Nata e Ustikës” (1989) dhe “Një natë dhe dy agime” (2002), si dhe në veprën tjetër “Një emër në katër rrugë” (2002), e cila shënon ndëshkimin më të madh nga këndvështrimi ideologjik. Në veprën e parë u hoqën pjesë ku shfaqej mbijetesa në rrethana të skajshme, përshkrimi i gjendjeve psikologjike, monologu si mënyrë e të rrëfyerit, etj. Në veprën e dytë censurimi i plotë erdhi si pasojë e ndërtimit të veprës përmes analogjisë me dukuritë e kohës, personazheve jashtë skemave të kohës, elementeve moderne.

Fjalët çelës: Petro Marko, socrealizëm, censurë, roman, modern.

SUMMARY

In my manuscript I am trying to address an issue not unknown in Albanian literature, the problem of censorship, which the victim was and Petro Marko, whose work is censored in three forms: full, partial and certain elements her. Petro Marko is a victim of Albanian socio-realism censorship in the novel published twice "Ustika Night", 1989 and "One night and two daysprings", 2002, and in other novel "One in four street name", 2002, which marks the punishment greater work from the ideologic perspective. In the first novel the removed part where survival appeared in extreme circumstances, the description of psychological conditions, monologue as a way of telling, second offense etc. To the second novel the complete censorship came as a result of building work by analogy with the phenomena of time, characters out of time schemes, modern elements.

Key words: Petro Marko, censorship, censored, novel, modern

Hyrje

Në vitet '60-'80, në Shqipëri, pati ndikim të madh romani i realizmit socialist, i cili i kufizonte romanit shqiptar burimin estetik, filozofik, letrar dhe shfrytëzimin e shkollave letrare – estetike të letërsisë së shek. XX-të. Por pavarësisht nga ajo që u botua një pjesë ishin mbështetës të skemës dhe të tjerë shfrytëzuan përvojën europiane të romanit realist për të sjellë për lexuesin shqiptar vepra me karakter letrar dhe kundër skemave.

Për letërsinë dhe gjithë fushat e tjera të dijes, problemi i censurës ishte po aq vdekjeprurës për

krijimtarinë letrare, për zhvillimin e saj, sa edhe vetë dënimi, burgosja e persekutimi i krijuesve. Viktimë e censurës ishin me dhjetra njerëz të dijes, mes të cilëve mendojmë se një ndër më të dëmtuarit ka qenë dhe Petro Marko, vepra e të cilit është censuruar në tri forma: e plotë, e pjesshme dhe në elemente të caktuara të saj.

Ky studim ka për qëllim ta paraqesë Petro Markon si viktimë të socrealizmit shqiptar mbështetur në veprën e botuar dy herë “Nata e Ustikës” (1989) dhe “Një natë dhe dy agime” (2002), si dhe në veprën tjetër “Një emër në

katër rrugë” pak të studiuar dhe që shënon ndëshkimin më të madh nga këndvështrimi ideologjik.

Petro Marko viktimë e censurës së realizmit socialist shqiptar

Të krijojnë idenë e një simbolike të çuditshme dy kufinj të kohorë (data e lindjes dhe e vdekjes), që përcaktojnë intervalin jetësor të shkrimtarit Petro Marko. Një betëjë për lirinë mund ta quajmë jetën e tij: e paracaktuar që në lindje e deri në vdekje. Lindi 1 vit pasi Shqipëria kishte shpallur pavarësinë, më 1913, jetoi në kohërat e kthesave të mëdha dhe vdiq 1 vit pasi ajo fitoi edhe një përmasë tjetër të lirisë: të fjalës e mendimit të lirë.

Lindi në fshatin Dhërmi të Himarës, kreu e studimet më 1924 në Shkollën Tregtare të Vlorës dhe në moshë të re, mori pjesë në Luftën Antifashiste të Spanjës, në rradhët e brigatave Internacionale. Ai udhëtoi si pjesëmarrës i organizatave antifashiste në Francë, Itali, Greqi, Spanjë, por fatkeqësisht pas vitit 1945 do të përjetonte një nga regjimet më të egra, siç ishte ai diktatorial i vendosur në Shqipëri. Shpirti i tij i lirë do të gjente shtegun për të dalë në rrugën e idealeve. Vepra e tij letrare do të bëhej arma e tij në luftën me diktaturën.

1. Censurimi i pjesshëm në romanin “Nata e Ustikës”

Romanin *“Një natë dhe dy agime”* shkruar që në vitin 1963, pas shumë peripecish redaktuese – ndaluese në zyrat e redaksive, autori mundi ta botonte nën një titull tjetër metaforik *“Nata e Ustikës”*, me kuptim krejt të kundërt nga i pari, duke shmangur titullin e dyshimtë . *“Agimi vetëm një herë mund të ndodhte si rezultat i një drejtimi politik të udhëhequr nga Partia....Agimi i parë dhe i dytë. Dy agime. E pamundur. Kush mund ta sillte të dytin?”* (*“Një natë dhe dy agime”*, f. 513).

Sepse agimi për njerëzit nën diktaturën shqiptare duhet të ishte vetëm partia dhe kursesi një dashuri ndaj një vaje aq më tepër të huaj.

Kemi një reduktim kapitujsh në botimin me titull *“Nata e Ustikës”*. Kapitujt: i pari *“Agim’* dhe i

fundit *“Agimi i dytë”* janë fshirë nga teksti në botimin e vitit 1989 dhe romani hapet me kapitullin me titull *“Nata”* (katulli 2 në botimin e plotë 2002). Kështu romani shfaq shmangie nga realizmi socialist duke pasur më shumë ndikime nga realizmi bashkëkohor evropian. Kështu fjala - simbol ‘agim’ zëvendësohet me fjalën ‘natë’. Nata, gjumi, ëndrra, nata e një të burgosuri dhe nata e njeriut të lirë, kanë ngarkesë kuptimore të thellë për njeriun në kushte krize ekzistenciale dhe nata kthehet në një përpjekje për t’u ndjerë i lirë, por për autorin nuk është ky kuptimi i lirisë së vërtetë, është nevoja për të kujtuar dhe jo për të harruar, prandaj heroji ndihet i lirë vetëm kur kalon nga shtegu i dashurisë.

Titulli lidhet me anë të fjalës agim me përmbajtjen, brenda së cilës zbulohet simbolika e tij: *“Agimi nuk është vetëm një dukuri kohore, por është jeta është simboli që shënon fillimin e ri, lirinë”*. Prandaj Andrea thotë: *“Hapa krahët. Bëra ca lëvizje të krahëve përpara- anash dhe ndjeva si më mbusheshin mushkëritë me erën e grykës së Matit. Agim. Agim i mrekullueshëm i malësisë”* (*“Një natë dhe dy agime”*, f. 10). Kjo është një parapërgatitje për lexuesin ,për ndërgjegjësimin e personazhit se fillimi i ri lind nga e thjeshta, njerëzorja, dhe ai mendon: *“Agim i egër dhe i ashpër si këto gryka të ashpra, pa erë parfumi, pa brisqe “xhillet”, pa të kuq buzësh, pa derdhje pizhamash të mëndafshita ose najloni në fund të shtretërve më të rehatshëm, me bukë me gjizë...edhe me çifteli, me këngë....I pari agim që e sodisja ndryshe.”* (po aty f. 13). Pranë këtyre njerëzve dhe në këto mjedise thithej ajër i vërtetë, njiheshin vlerat njerëzore më të larta. Por malësia, e heshtur, e largët ku njerëzit dhe natyra i ngjanin njëri – tjetrit është jashtë pasqyrit të jetës në zhvillimin revolucionar sic shpesh ndodhte në romanet e realizmit socialist. Madje marrëdhëniet njerëzore shihen nën një këndvështrim ironizues mbi jetën e njerëzve në diktaturë, ku krijohej një lidhje shpirtërore false, mes njeriut dhe partisë, të tipit: një nga punëtorët i vendosë emrin djalit Hidrocentral, një tjetër mahnitet nga vizita e parë në Tiranë, kafeneja e Mirditës është një tablo e përditshmërisë së malësorve, mes rutinës,

rrëmujës e mbylljes dhe punës së përditshme me vullnet pa bujë.

Personazhi kryesor, Andrea Bora, i emëruar prej 12 vjetësh në këtë vend verior transferohet në qytet dhe pasi kishte përjetuar agimin e paqhtë të malësisë ditën që mbërrin në qytet jeton “agimin e dytë”, dashurinë e tij, që ishte Sonja, vajza, me të cilën u dashurua 12 vjet më parë, në burgjet fashiste, kur të dy luftonin në brigadat internacionaliste. Kështu Petro Marko përmes fatit të heronjve na përcjell filozofinë e ekzistencializmit të individit në kushte ekstreme dhe besimin se mbijetesa e ka forcën tek ‘e nesërmja’, tek ‘një ditë e re’.

Ajo që vihet re është copëtimi i çdo fjale simbol nga përbërësit e tjerë kontekstualë. P.sh. fjala simbol ‘agimi’, zhvendoset brenda fjalisë duke i zbehur kuptimin kryesor: “*Sonja hapi sytë. Për mua ky ishte vetë agimi*” (“Nata e Uastikës”, f. 334) dhe “*..kur u çelën sytë e Sonjës, mu duk sikur u çelën dyert e agimit*” (“*Një natë dhe dy agime*”, f. 513).

Këto censurime që fillonin në strukturë vazhdonin në subjekt duke e drejtuar idenë e veprës drejt një linje tjetër. Forca artistike me të cilën ndërtohen veprat, në botimin e vitit 1989, zbehet nga mungesa, ose redaktimi i shumë përshkrimeve tronditëse mbi mjedisin ku personazhet lëvizin të tilla si: biruca ishulli, ku rraskapitja arrinte kulmin me ndërtesa të vogla ‘të mbledhura si në një lugë’, si dhe një sërë pjesësh që pasurojnë përshkrimin realist të situatave, ngjarjeve, karaktereve, si: ndjenjat e miqësisë dhe xhelozisë midis shokëve, trimërisë, paralelizma pozitivë midis partizanëve shqiptarë dhe atyre të huaj, sllovenë, kroatë, malazezë, triumfi i fitores dhe paragrafë plot me pashtrima kundër diktatorit Musolini.

Në botimin e paplotë të vitit 1989 edhe fjali që mbartin një ngarkesë kuptimore politike dhe hapësirë interpretimi të cilat mund të interpretoheshin politikisht në analogji me sistemin totalitar të kohës u hoqën si p.sh.: “*Po more bir, politika i ngjan Ustikës.*” (“*Një natë dhe dy agime*”, f. 216). “*Një regjim që s’ka asgjë të përbashkët me popullin e me kombin, s’mund të*

mbahet me gjak, me hu e me litar, por patjetër që do t’i vijë fundi” (“*Një natë dhe dy agime*”, f. 500). Janë reduktuar në një masë të madhe paragrafë, në të cilët në vend të veprimit e ngjarjes mbizotëron, monologu i brendshëm, pa dëgjues tjetër përveç vetes, i ndërtuar kryesisht me pyetje retorike. Gati 30 raste, ku personazhi kryesor, Andrea Bora del sentimental përballë ndjenjës së dashurisë, e cila e jetuar në intimitet larg syrit kolektiv nuk ishte e pranueshme për skemën e romanit socrealist. Përshkrimet intime, lojrat midis të dashuruarve të cilat faktikisht zënë një pjesë të vogël në vepër janë fshirë pothuajse të gjitha. P.sh.: “*Përsëri e mori gurin e saj. E hodhi në anën tjetër....dhe vija re se si kërcente gjiri i fryrë, që siç dukej nuk kishte mbajtëse.*” (“*Një natë dhe dy agime*”, f. 320).

Gjuha që përdorin personazhet shpesh me fjalë të rëndomta, shumë funksionale për karakterin e përshkrimit, është redaktuar duke paraqitur një leksik më të kontrolluar.

Në letërsi siç dihet është shumë e rëndësishme edhe koha, përfytyrja e saj, sepse ajo përcakton mënyrën e leximit. Mënyra e përdorimit të kohës në veprën letrare prej shkrimtarit, është një faktor që dallon llojet e romaneve nga njëri-tjetri. Koha e paraqitur në romanin “*Një natë dhe dy agime*” është ajo objektive e dhënë prej shkrimtarit subjektivisht në ngjashmëri me kohën historike. Pra është krijuar një shembëllim i kohës së viteve të luftës antifashiste, por nga ndikimi i censurës, që ka hequr dy kapituj me rëndësi në vepër (të parin dhe të fundit), rrëfimi është sipas një kohe lineare të vazhdueshme dhe jo si retrospektivë, siç ai është shkruar prej autorit në botimin e plotë.

Censura vepronte dhe me teknikën e transformimit të fjalive duke iu ndryshuar kështu kuptimin dhe vlerën artistike. Apo transformime që ndryshojnë idenë: detyra është para ndjenjës dhe jo e kundërta. “*Unë kisha nevojë të takohesha sa më parë me Sonjën.*” (“*Një natë dhe dy agime*”, f. 456) është ndryshuar: “*Unë kisha nevojë të takohesha sa më parë me shokët*” (“*Nata e Ustikës*”, f. 298).

Vihet re dhe një tendencë për të shmangur pjesët që pëmbajnë elemente autobiografikë në vepër

dhe kjo e dëmton veprën në aspektin artistik, pasi ato vijnë të ndërputhura natyrshëm në funksion të zbulimit të personazhit në nivel psikologjik, pra jo thjesht si dëshmi e fakteve jetësore.

Linja e dashurisë, si linjë kryesore, paralele me atë të luftës, ka marrë ndëshkime të shumta në aspektin përmbajtësor dhe ideor. Nëse do ta vendosnim veten në vend të një lexuesi që e lexon për herë të parë duket sikur shtrohen pyetjet: A mund të realizohet një dashuri në kushte të jashtëzakonshme, kur nuk ekziston mjedisi i duhur që ajo të marrë jetë? Apo është pikërisht efekti që krijon ekzistenca e kësaj ndjenje, në kohë thellësisht të pafavorshme, aspak ideale, që lexuesit t'i transmetohet një ide optimiste për jetën. A është dashuria e vetmja forcë në kushtet kur njerëzit vetëm mbijetojnë? Përballë këtyre pyetjeve autori gjatë veprës vë herë paralele e herë përballë njëra-tjetrës: dashurinë dhe idealin. Në kohë të tilla dramatike fatet individuale janë të ngjashme me fatet e popujve. Dhe popujt bashkohen përballë një të keqeje të përbashkët dhe njerëzit bashkohen në ideale e në ndjenja dhe nga bashkimi i dy gjendjeve të kundërta: luftë dhe dashuri autori na jep një tablo të jetës në dy dimensionet të ndryshme. Dhe me fundin e lumtur, bashkimin e dy luftëtarëve internacionalistë, Andrea Bora (shqiptar) dhe Sonja Martinović (slovene), ai i jep një përgjigje pozitive gjithë pyetjeve të mësipërme.

Drama qëndron në faktin se censurimi i romanit në elemente të subjektivitetit, e ka shndërruar atë në një fund tragjik duke dhënë një ide diametralisht të kundërt dhe duke i mohuar autorit lirinë e fjalës artistike dhe lexuesit lirinë e marrjes së mesazheve universale. Prandaj lexuesit i serviet një fund me kah absolutisht të kundërt nga ai i shkruar nga autori. Linja e dashurisë e cila e tërheq lexuesin drejt përfytyrimeve romantike, idealiste, shpesh ëndërrimtare, në romanin *"Një natë dhe dy agime"*, ka një fund të lumtur. Realizimi i dashurisë jep mesazhin se ajo mund të kapërcejë pengesat.

Në botimin me titull *"Nata e Ustikës"* fundi është tragjik. Censura e ka vendosur autorin të gjejë një

zgjidhje tjetër. Një heroinë me kombësi jo shqiptare që vdes, në vend të një heroine të huaj, që martohet me një shqiptar. Kështu vepra humbet mundësinë për të transmetuar mesazhet e saj, të triumfit të dashurisë, pa dallime kombësie, pa dallime politike të dashurisë si ndjenjë njerëzore para së gjithash. Lexuesit i imponohet një lloj katarsisi sa për sy e faqe dhe që nuk vjen sipas një linje emocionale-logjike e artistike. Ndëshkimi është i trefishtë: autor-vepër-lexues.

2. Shkaqet e censurimit të plotë të romanit *"Një emër në katër rrugë"*

"Një emër në katër rrugë" u ndalua të qarkullojë dhe për të u mor vendimi që të kthehej në karton. Shkrimtari u akuzua se romani i referohej kohës aktuale, socializmit, të cilin e paraqiste me nota negative. Madje u dënua dhe të paguante dëmin financiar nga hedhja në karton e romanit. Sic dihet lexuesi e ndërton leximin qoftë si ndërtim ose si "prishje e ndërtimit" (*"Poetika e prozës"* f. 173). Përmes teksteve të tilla ne bëjmë një lexim të ndryshëm, sepse teksti megjithëse referencial përsëri ndërtimi nuk kryhet pasi është i papërcaktueshëm, p.sh. në rastin tonë identiteti i katër heronjve nuk mbështetet tek identiteti, por tek shumëkuptimësia e emrit.

Thelbi është i njëjtë: të katër personazhet quhen Gjikë dhe simbolizojnë përkatësisht: *Gjikë Bua*: idealisti që beson në ndërtimin e një shoqërie të drejtë. *Gjikë Nina*: atdhetari. *Gjikë Mërtiri*: intelektual i idealist që tragjikisht shkon në vetëvrasje. *Gjikë Argjiri*: njeriu që i shet karakterin çdo sistemi që ndryshohet. Pra, janë jo vetëm karaktere shqiptare, por janë katër mishërime të karaktereve tipike njerëzore të vendosura në një udhëkryq "në katër rrugë".

Ngjarjet janë vendosur në kohën e mbretërisë shqiptare duke përshkruar një sistem qeverisës të dhunshëm, kriminal, amoral. Romani u ndërtua duke përdorur analogjinë me sistemin totalitar të kohës. Rrëfimi i përdorur prej autorit nuk i përmbahet një linje, por kemi një ndërthurje të rrëfimit në vetën e parë nga heroi dhe rrëfimit në vetën e tretë që japin përshkrimin e jetës së heroit rrëfimtari, ngjarjet në mjediset ku veprojnë

personazhet etj. Censurimi i veprës ishte i plotë, sepse elementët modernë me të cilët ishte ndërtuar ajo, projektonin tek lexuesi një skemë të re jashtë skemës së realizmit socialist.

Konkluzione

Censurimi i veprës *“Nata e Ustikës”*, është i pjesshëm dhe ka prekur, kompozicionin, llojin e rrëfimit, kohën letrare, duke përdorur transformimin, heqjen e faqeve e paragrafëve që kanë elemente biografikë, përshkrime intime, ngarkesë kuptimore politike.

Censurimi i veprës *“Një emër në katër rrugë”* ishte i plotë, sepse përmban elementë modern në kompozicion, në mënyrën e rrëfimit, në përdorimin e analogjisë si përftesë letrare.

Një fat të ngjashëm patën pjesa më e madhe e veprave të autorit, por romanet që ne morëm në studim përfaqësojnë më së miri nivelin më të lartë të veprimit të censurës dhe efektet negative të saj në aspektin artistik.

Bibliografi

ALIU, A. (1975), *“Koha dhe krijuesi”*, Rilindja, Prishtinë.

MARKO, P. (2002), *“Një natë dhe dy agime” / “Nata e Ustikës”*, OMSCA-1, Tiranë.

MARKO, P. (1989), *“Nata e Ustikës”*, shb. Naim Frashëri, Tiranë.

TODOROV, Tz. (2000), *“ Poetika e prozës”*, Panteon, Tiranë..

PRIRJE DHE KAHE TË ZHVILLIMIT TË LEKSİKUT TË SË FOLMES SË MATIT

TREND AND DIRECTION OF VOCABULARY DEVELOPMENT OF MATI DIALECT

MERITA HAS-HYSAJ

Email: ritahysa1@gmail.com)

AKTET VII, 4: 367-372, 2014

PERMBLEDHJE

Qëllimi i punimit është të paraqesë një tablo të gjendjes së të folmes së Matit në rrafshin leksikor, duke kundruar problematikën që servir. Zhvillimi i sotëm i të folmes, nuk mund të shihet i shkëputur nga rrjedhat e zhvillimit dhe progresi i përgjithshëm kulturor, mendor, shoqëror, i gjithë shoqërisë shqiptare. Në mënyrë specifike në këtë zhvillim, ka luajtur rol: arsimimi masiv, shtimi i mjeteve të informimit/komunikimit, gjuha standarde. Lëkundjet më të mëdha i pëson varianti tradicional në gojën e brezit të ri. Pyetjet: cila është gjendja e sotme e leksikut të së folmes, nëpër cilat rrugë ka evoluar, sa ushtron presion standardi mbi të, cila është prirja që përvijohet sot për zhvillimin e të folmes, çfarë do të birret dhe çka mbetet e pandryshueshme - marrin përgjigjen këtu. Nënvizojmë se përdorimi gjuhësor - jetësor i varianteve, do të vendosë zhvillimin e tyre.

Fjalët çelës: leksik, inovativ, komunikim, dialekt, Mati, standardi, faktorë.

SUMMARY

The purpose of this work is to present an overview of the current state of the Mati Dialect in lexical level, looking for problematic it has. The current development of the Mati Dialect, can not be seen in isolation from the mainstream of development and overall progress; cultural, mental, social and life in general throughout the society. Specifically, a significant role in this development has played: mass education, proliferation of media / communications and standard language. The largest fluctuations of traditional dialectal variant are being experienced at the mouth of the young generation. So, there are some questions waiting to be answered in this work. However, at the end of this issue we emphasize that the life and linguistic use of the variants, will decide who will be the "winner" and what will remain as necessary, indispensable in the dialect, and what elements will perish along the way.

Key words: lexical, innovative, communication, Mati, dialect, language, factors.

Hyrje

Është e mirëpranuar përgjithësisht nëpër trajtesa e studime të plota, se njësia apo sistemi më i luhatshëm i gjuhës, është ai leksikor. Duke qe në kështu, themi se nuk mund të shmanget kjo aksiomë edhe për të folmen e Matit, si një e fol me qendrore në gegërishte.

Në këtë punim synojmë të paraqesim një panoramë të përmbledhur të gjendjes aktuale dhe prirjes së ndryshimit të së folmes së Matit përgji thësisht, në rrafshin e leksikut: shtresëzimet leksi- kore brenda saj, presionin dhe ndiki-

met që ushtro hen nga standardi, variantet dialektore të disa fja lëve, sferat e ndryshme të vepri- mtarisë jetësore ku gjallojnë fjalë tipike.

Krahas kësaj sipërmarrje, detyrë e lakmue shme është njohja dhe formulimi i një ideje për te- ndencën e zhvillimit, si dhe rrugën që mund të ndjekë në të ardhmen e saj kjo e folme në lëmin e leksikut. Vëzhgimi i drejtpërdrejtë në terren, njoh- ja dhe zotërimi i vet të folmes, hulumtimi dhe ba llafaqimi i materialeve të botuara më he- rët, përshkrimi i të dhënave përmes metodës dia- lektologjike kanë qenë udhërrëfyesi i punës sonë.

Siç dihet, marrëdhëniet leksikore realizohen kryesisht brenda raporteve gjuhë-gjuhë, por ato shtrihen dhe në dimensione të tjera, si ato gjuhë-dialekt, dialekt-dialekt.

Marrëdhëniet gjuhësore gjuhë-gjuhë

Përsa i përket raportit të parë, gjatë shekuj ve, shqiptarët kanë pasur marrëdhënie me fqinjë e jo fqinjë, të njohura si marrëdhënie miqësie dhe armiqësie, e këto kanë sjellë si rezultat reflektime dhe gjurmë në leksik. Kështu, nga historia e gjuhës na vijnë dëshmi të ndikimit, grek, latin, sllav e turk, mbi gjuhën shqipe në për gjithësi. Në këtë li- një, lidhja mes gjendjes diakronike dhe asaj të sot me të së folmes së Matit, duhet kundruar në ra- dhe të parë si një lloj marrëdhënie e shqipes me variantet gjuhësore push tuese. Për të folmen to- në do veçojmë ndikimet e dy gjuhëve: *sllave* (si gjuhë fqinje, e njëherësh pushtuese) dhe *turqishtes* (si pushtuese).

(1) Leksiku me origjinë sllave

Dihet nga Historia e Shqipërisë, që sllavët erdhën dhe u vendosën në Ballkan (përmes dynd- jeve) nga shek. 5-6 e.s deri shek. 8 e.s. Ndikimet sllave në gjuhën shqipe lidhen me periudha më të vonshme (përkatësisht shek. 9-12). Me studimin e marrëdhënieve (historiko-gjuhësore) të sllavëve me shqiptarët janë marrë shumë stu- diues: Jeri çek, Shuflaj, Miklosiç, Majeri, Jokli, Skok, Pepoviç, Çabej, Ajeti etj.

Pranohet prej tyre, se disa nga fushat, ku është shtrirë huazimi sllav në shqipe janë:

- (a) bujqësia: *lopatë, pleh, prashit, vadit, kastravec, rrepë*;
- (b) kafshët shtëpiake (*kokosh, mace, hara bel, karkalec, grazhd*);
- (c) zejtaria (*çekan, çekic, gozhdë*);
- (ç) ekonomia shtëpiake (*strehë, prag, oborr, kotec, patku, koshare, stol*);
- (d) jeta shoqërore-administrative (*grabit, pa dis, gjobë, gosti, vazhdë, bisedë, gadit, rob, i dobët, i vobektë*);
- (dh) veshmbathje (*rize, opingë*).

Gjendja e sotme e elementit sllav në këtë të folme, si rezultat i faktit që nuk ka pasur kontakt të gjatë e marrëdhënie të vazhdueshme me slla-

vi- shten, na flet për praninë e tij, por jo në atë masë sa të dallojë nga të folmet e tjera rreth e qark Ma- tit. Pra, në këtë krahinë ndeshen fjalë të origjinës sllave, të cilat mund t'i grupojmë në:

(a) Fjalë të cilat kanë një përdorim edhe më të madh në të folme të tjera të shqipes se sa këtu p.sh.: *çakiç, kotec, kosh, gjözhd, brên, zabel, prashis, plehën, lopatë, patku, kosher, çerep, zabel, kos*.

(b) Fjalë të cilat janë relativisht të kufizua- ra në të folmet e tjera, e më të përdorshme në Mat p.sh.: *apet, gracul, grad, nevøj, pöd, rizë, plaç kadit, røb, fkat*.

(2) Leksiku me origjinë turke

Pushtimi i gjatë osman, që siç dihet u instalua në Shqipëri për afro 5 shekuj, dhe pse pa mundur ta asimilojë dot gjuhën tonë la gjurmë edhe në mënyrën e jetesës, praktika e zakone, fjalë dhe veshje. Këtu do të shohim pikërisht di sa raste të takimit të shqipes me turqishten në këtë të folme, përsa i takon sistemit më të pre kur, atij leksikor.

Ndër fushat e tij, fjalët më të shumta i ta kojmë:

(a) jetës shtëpiake: *ahër, axhë, bardak, bu nar, çekel, çepek, dajak, dallap, demiroxhak, bak- llav, penxhere, aksham, tybe, hala, tamam, hasër, havlli, kallaje, kanak, legen, lal, mixh, saç*;

(b) fjalë të përgjithshme: *bidad, bastan, bajrak, bamje, hajn, hasëm, hebe, henek, me u hazdru, istifat, nafak, jeshil, sebet, haram, llafe, jaran, sevda, lezet, sabah, sahan, sabër, halis, avash, avllaj, zarar, haber, pazar, sofër, millet, dallavere, kallaballajk, daulle, sahat, fukara, ibret, xhenaze, katil, selvi, sehir, tepsi, bajram, aga, budrum, birek, divan hajde, hajër, kafe, pa re, raki, sixhade, zor, melaçe, shejtan, zaif, za llum etj.*;

(c) fjalë të lidhura me emërtime veshjesh, objektësh të ndryshme, të cilat po zëvendësohen gradualisht: *bishtuk, kandil, bokshe, pashtamolle, nrra:jz, grosha:r, tina:r, she:gjë, parallaikët, tlita, kollçajk, brekushe, çemer sarraik, kajuke, spa:ikë, dallama, nemte, mita, gjetan, xhoke, rrethore, ushku:r, xhurdi, kallaçe, sapllak, cule, dokërr etj.*

Një shtresë tjetër fjalësh, të cilat do t'i quaj më thjeshtë dialektore, përbëjnë një grup më vete në këtë të folme dhe tërheqin vëmendje për nga

forma dhe kuptimi. Të fjalë të tilla të lidhura me praktika të caktuara ose me fusha të ndryshme të veprimtarisë, si: blegtoria, bujqësia, punët shtëpiake, të praktikave kanunore, të veshjeve tradicionale, nuk dalin më aq shpesh, ose kanë pësuar ndryshime semantike duke iu larguar kuptimit fillestar: *përkëtem* (lodhem), *pë rçapmi* (i mbahet goja), *pjellak* (cjapi që thërpen së pari), *shpesak* (pjesëtar i familjes), *kutejz* (pas qyrë), *dimnej* (mallkoj), *çëdig* (tirq), *gërzhillaj* (sa raje), *çekma* (dritare e vogël), *hashëll* (ushqim i bagëtive), *manore* (këmishë me mëngë të gjera), *mixull* (prush), *mazatur* (viç motak), *mnat* (ndih- më), *njekës* (dashi i këmborës), *prushi* (thekët e sixhades), *veks* (vorbë), *derdh* (shpërndaj lajm), *zbardh* (zhvesh misrin nga lëvozhga) etj.

Krahas këtyre, në këtë të folme bien në sy edhe një grup fjalësh të njëjta, që emërtojnë se- nde të ndryshme, apo edhe disa fjalë të ndryshme që emërtojnë të njëjtin send, të cilat ndonëse në numër të pakët, tërheqin vëmendjen:

(a) *Bostan* – *shalqin dhe pjepër*; *trap* – *rrip toke* i papunuar, *kos* i bërë mirë, *rrip toke* kufi ndarës mes arave; *almese* – *vegla bujqësore*, *parmenda*, *veglat e rrojës për meshkujt*; *koshare* – *hambar misri*, *kotec pulash*, (ofezë) *njeri shumë i shëndoshë*; *gjastare* – *gotë uji*, *enë për të mbajtur turshi ose raki*; *hut* – *lloj arme*, *shpend grabitqar*, *njeri budalla*; *bojë* – *ngjyrë*, *masë gjatësie*, *nderi i njeriut*; *pajë* – *anë*, *krah*, *pajtohem*, *paja e nuses* etj.

(b) *Vendi ku mbahen bagëtia* – *ahër*, *vath*, *burgj*; *proces* i vrasjes së kafshës – *me met*, *me cof*, *me gorth*, *me pre*, *me ther*; *pjella e gomaricës* – *parrç*, *vajsk*, *krriç*; *dashi që u prin bagëtive* – *njeks*, *shtuks*, *prijs*, *skuç*; *proces* i mbushjes me dhe të misrit – *me mef*, *me shaptu*, *me capu*; *vend i hapur në tokë ku mbahet ujë* – *pus*, *bunar*, *hurdhë*; *peshqir e havli*; *skile e dhelpën*, *bish tkuçe*, *rrensja*; *shpull e shplakë*; *çegel e vargjur*; *ksul e çylaf* etj.

Marrëdhëniet gjuhësore gjuhë dialekt

Ne po veçojmë dhe një numër të pakët fja lësh, të cilat sot kanë humbur krejtësisht në këtë të folme. Këtë e themi pasi krahasuam materialin gjuhësor që kishim në dorë, me atë të studiuesve

të parë të kësaj të folmeje në vitet '60: *aft*, *akran*, *bulletër*, *dala*, *gjajkë*, *katëku*, *krazë*, *llashkë*, *lakaç*, *nërtase*, *pulaci*, *rrubis*, *sis*, *spuri*, *srreku*, *shutroj*, *shogen*, *zdraj*.

Në sistemin leksikor sot, dy kahet a anët e procesit të zhvillimit gjuhësor, në këtë mjedis janë: *ruajtja* (përfaqësuar me brezin e moshuar) dhe *risimi* (që mishërohet në brezin e ri); të dyja këto nën drejtimin e rrafshimeve standardizuese dhe globalizuese.

(1) Zëvendësimi i fjalëve 'të vjetra' me të reja

Ndërkohë, dukuria më e spikatur, është ajo e zëvendësimit të fjalëve "të vjetra" a të huaja, me fjalë të përgjithshme të shqipes, apo të variantit standard. Nënvizojmë se, në gjuhë nuk ka fjalë të bukur apo të shëmtuar, pasi parimi bazë veprues në të është ai i "konkurencës" mes funksioneve të fjalëve dhe jo ndonjë gjë tjetër. Ajo që i përmbush më mirë nevojat komunikuese të bashkësisë gjuhë sore përdoruese në një situatë të dhënë, bëhet mbizotëruese.

Po sjellim këtu disa shembuj: *gjastare* > *go të*, *jatak* > *dyshek*, *brekushe* > *pantallona*, *apet* > *prapë*, *bardak* > *bidonuji*, *bunar* > *pus*, *dina* > *bi njak*, *flokje* > *tapet*, *grish* > *ftoj*, *havli* > *peshqir*, *ha zdru* > *bëhem gati*, *karjoll* > *krevat*, *ka tek* > *gjellë*, *mashtap* > *enë uji një kilogramëshe*, *mëxhevi* > *fë mijë*, *naheje* > *krahinë*, *nëgj* > *kyç*, *oda* > *dhome* etj.

(2) Tre brezat dhe tri mënyrat e transformimit të të folmes dialektore

Domosdo që, zhvillimi i sotëm i të folmes së Matit apo përgjithësisht i të gjitha varianteve dialektore, nuk mund të shihet i shkëputur nga rrjedhat e zhvillimit dhe progresi i përgjithshëm kulturor, mendor, shoqëror, pra i jetës në tërësi i gjithë shoqërinë shqiptare, së paku që pas çlirimit. Në mënyrë specifike në këtë zhvillim, ka lua jtur rol: **arsimimi masiv**; **shtimi masiv i mjeteve të informimit / komunikimit**; **gjuha standarde**. Mirëpo, për të qenë sa më afër realitetit leksikor të së folmes dhe masës **SA** e mënyrës **SI** të ndiki mit që kanë këto faktorë, është e nevojshme, që të dallohen aty, tre breza përdoruesish: brezi i moshuar, brezi i mesëm dhe brezi i ri. Kështu duke pasur pa rasysh këta faktorë mund të thuhet,

se brenda të folmes dallohen lehtë tiparet e të dy llojeve të të folurit, ashtu siç ka përcaktuar prof. Gj. Shkurtaj: *“varianti apo të folurit tradicional, në të cilin ruhen elemente të qëndrueshme të sistemit të vje tër, dhe varianti i ri, në të cilin gjejnë vend ndryshimet që i bëhen variantit të parë nën trysinë e faktorëve”*.

Të dy këto variante, japin e marrin me njëri-tjetrin në të gjitha fushat (veçanërisht në leksik), por shkalla e ruajtjes së variantit tradicional ose e kundërta, shfaqja në të e variantit ose e varianteve të reja në përgjithësi, varet nga ndryshorët sociolinguistikë. Nga kjo rezulton se kundrimi i gjuhësorës duhet bërë në lidhje të ngushtë me jashtë gjuhësoren. Pra, në një anë kemi pasurimin e variantit me fjalë, shprehje, to gjuhësore e gjedhe strukturore të reja, e nga ana tjetër kemi bjerren e fjalëve, shprehjeve, sendeve e praktikave të vjetëruara tashmë, të cilat kalojnë shkallë-shkallë nga më të moshuarit që ruajnë më shumë, tek brezi i mesëm më pak dhe krejt të pakta në brezin e ri. Me kalimin e kohës, nën veprimin e faktorëve jash gjuhësorë, por edhe të evolucionit të brendshëm e të raporteve gjuhë e shkruar-dialekt, ngushtohet rrezja e përdorimit ngushtësisht dialektore. Më i ekspozuar ndaj ndryshimit gjuhësor është brezi i ri.

Por ndërsa në strukturën fonetike dhe morfologjike nuk ndodh ndryshimi i inventarit të formave apo trajtave morfologjike të së folmes, në sistemin leksikor zhvillimi është i ndryshëm, sepse folësit nuk kanë të njëjtin njëfjalës, ndikuar nga shumë faktorë e ndaj nuk mund të bëhet i shteru eshëm inventari i së folmes. Megjithatë, një krahasim i sotëm i të folmes me gjuhën standarde, sjell disa të dhëna me vlera dalluese të gjendjes leksikore të kësaj të folmjeje, e cila ka pothuajse karakter homogjen, të njëjtra jthshëm në përbërjen e popullsisë.

Së pari, dallohen fjalë të përbashkëta me ato të gjuhës standarde, që nuk kanë dallime lek-sikore e kuptimore, por që kanë pësuar evolucione fonetike tipike të së folmes. Ndryshe këto fjalë quhen dhe **dialektalizma fonetike**: *‘âdërr’* në krahasim me *‘ëndërr’*; *‘çep’* në krahasim me *‘qep’*; *‘dhmall’* në krahasim me *‘dhëmballë’* etj.

Në përgjithësi, nga varianti standard ushtrohet trysni e madhe, në tërësi në sistemin gjuhësor, por më e dukshme është në trajtat fonetike që janë më afër atyre të standardit. Këto trajta synojnë të përdoren nga bartësit në ato situata kudo mundohen ta *“krehin”* të folurit e tyre nga varianti thjesht dialektor. Kështu, synohet *‘miq’* dhe jo *‘miç’*, *‘fiq’* dhe jo *‘fiç’*, *‘gjiz’* dhe jo *‘xhiz’*, *‘pleq’* dhe jo *‘pleç’*, *‘tjetër’* dhe jo *‘qetër’* etj. Por, kur themi këtë, kemi parasysh se sistemi fonetik i të folmes nuk ndryshon.

Kemi tentime për t’ia përshtatur atë sistemit të gjuhës standarde dhe shpesh dalin variante të reja as dialektore, as standarde plotësisht: *‘mirmxhes’* për *‘mermxhes’*; *‘mirsetxheta’* për *‘mersetxheta’*; *‘telefon’* për *‘telefon’*; *‘polic’* për *‘polic’*; *‘mshive’* për *‘fshij’* etj.

Së dyti, dallohen një grup fjalësh që janë të njëjta me ato të gjuhës standarde, por që paraqesin dallime në eptim. Ndryshe këto fjalë quhen dhe **dialektalizma morfologjike**. Këtu kemi parasysh paradigmat e zgjedhimit dhe të lakimit të disa emrave, foljeve, përemrave. Mirëpo, në këtë rast, vihet re zhvillimi i përkundërt me rrafshin fonetik, sepse shquhet kryesisht asimilimi nga sistemi dialektor i trajtave që vijnë nga sistemi letrar. Pra, më shumë sundon prirja e përshtatjes së gjuhës letrare në paradigmen e sistemit të së folmes dialektale. Në shumë raste ka dhe përzjerje të tyre, ku herë del njëra trajtë në krye dhe herë trajta tjetër (kemi parasysh trajtën standarde dhe atë dialektore) p.sh. lakimi i përemrit *cili*, nga brezi i vjetër del me formën *calli* ose *celli*, me paradigmen e vet në këtë formë, por tek brezi aktiv kemi një *‘dyzim’* të tij dhe herë del *calli* e herë del *cili* me paradigmat e tyre. Në të pakryerën del: *hasha, lasha, punosha*; ose me formën e vetës së dytë e të tretë me *–she, –te*.

Së treti, kemi ato fjalë e nocione të reja të hyra drejtpërdrejt nga gjuha standarde në këtë të folme që u takojnë fushave të ndryshme të jetës, si: shkencës, teknologjisë, administratës, politikës, kulturës, artit etj. Në një vështrim të shkurtër do të grumbullonim këtu trajtat më të përdorura e më të hasura në të folurin e përditshëm:

Fjalë dhe terma që kanë hyrë nga fusha të shkencës dhe teknologjisë pas viteve '90: *kompu ter, celular, internet, astronaut, frigorifer, video, kamera, lavatrice, aspirator, dush, duralumin, stuko, abazhur, mikrovalë, fritezë, ta pet, moket, foto kopje, tortë, globalizim, integ rim, asociim etj.*

Fjalë nga administrata politike dhe shoqërore: *deputet, parlament, komunë, prefekturë, BE, OKB, NATO, superfuqi, klane, pakt, draft, këshill si gurimi, paqeruajtës, buxhet, inflacion, infrastrukturë, suplement, OJQ, komision, konsultë, shef, bos, kontrabandë, korrupsion, drogë, doganë, pros titucion.*

Fjalë të hyra nga kultura dhe arti: *balet, soprano, tenor, estetikë, estradë, komedi, solist, piano, pianist, kompozitor, maestro, disko, poster, reklamë, spot, kozmetikë, parfum, lice, universitet, specializim, diplomë, kurrikul etj.*

Pra, nga ky sondim i shkurtër na rezulton se e folmja e Matit, në sistemin e saj leksikor, e parë në plan krahasues me gjuhën standarde ndahet në disa njësi më të dallueshme:

1. Kemi leksikon e përbashkët me gjuhën stan darde, me dallimet fonetiko-morfologjike të së folmes.
2. Kemi leksikon e hyrë drejtpërdrejt nga gjuha standarde.
3. Kemi leksikon *“thjeshtdialektor”*.

Perspektiva

Por, lind pyetja: po më tej cila është a mund të jetë prirja e zhvillimit të leksikut të të folmes? A ka ndryshuar vërtetë rrënjësisht marrëdhënia midis kohës dhe fjalës?! Çfarë duhet të ruhet e paprekur në gjuhë?

E ardhmja e kësaj të folmeje, mendojmë se do të ecë sipas ligjësisë të zhvillimit të përgjithshëm gjuhësor, që parakupton se, ajo do t'i nënshtrohet rrjedhave të natyrshme që do të pësojë shqipja në tërësi, aq më tepër po të kemi parasysh që kjo do të jetë e kushtëzuar nga vetë uzusi dhe përdorimi që do t'i bëhet variantit nga folësit e saj. Po të shtojmë këtu edhe kushtëzime të tjera, ndërlikime, transformime që do të sjellë koha me gjithë zhvillimet e vrullshme në shumë dimensionet e jetës tonë, atëherë na mbetet të

jemi gjithë sy e veshë për të kapur ditë pas dite të rene që lind e rrjedh nëpër gjuhë.

Besoj biem dakord, që ka lindur një botë e re komunikimi (me një gjuhë po aq të re dhe të ndërlikuar), e ndihmuar kryesisht nga teknologjia. Të përpiqesh të vlerësosh sot, ndikimin e këtij fenomeni në gjuhën e shkruar, atë të folur dhe raportet ndërpersonale, është ndoshta herët, por realiteti flet se kjo botë e re komunikimi, ka lindur dhe po zhvillohet. Të bëhesh pjesë e saj, apo ta refuzosh, mbetet gjithmonë një çështje zgjedhjeje.

Është vërtetë sfidë intriguese shoqërore: gjuha simbolizon mjetin më të bukur të qënies njerëzore dhe produktin më të mirë të pronësisë shpirtërore të një populli. Dhe këto ndryshime nuk dalin vetiu.

I duhet kushtuar vëmendje veçmas, elementit tradicional, pasi ai është guri i themelit: **Urimet, përshëndetjet, emrat e njerëzve, strukturat morfologjike e sintaksore, format gjuhësore të shprehjes së respektit e të mirësjelljes**, duhet të jenë në plan të parë për t'u ruajtur dhe trashëguar të tilla.

Përfundime:

- E folmja e Matit, është një e folme qendrore në gegërishte, e cila që nga periudha e dokumentimit të shqipes, është karakterizuar nga inovacioni.
- Ajo dallohet për praninë e disa shtresave leksikore: të ndikuara, të mbetura, të huazuara, si dhe të burimit të vet.
- Elementi sllav dhe ai turk, në këtë të folme zënë një pjesë jo të rëndësishme të leksikut. Ato, gjallojnë kryesisht në të folurit e më të moshuarve.
- Ajo ka marrëdhënie të afërta me sistemin standard dhe ndikohet pandarazi prej saj.
- Dallohen në të dy variante të të folurit: ai tradicional dhe ai i ri, me specifikat e tyre dhe përdoruesit përkatës.
- Lëkundjet më të mëdha varianti dialektor tradicional po i pëson në gojën e brezit të ri, ku rol të madh luajnë dhe faktorët jashtëgjuhësorë dhe ndryshorët sociolinguistikë.

- Zhvillimi i gjithanshëm i shoqërisë, veçan pas viteve '99, ka prekur edhe këtë të folme në sistemin e saj leksikor. Por, në këtë hov zhvillimi, mbetet prapëseprapë diçka identifikuese e krahinës, zonës a të folmes.

Pra, si përfundim pohojmë edhe njëherë atë fakt të dëshmuar prej gjuhëtarëve, se ndryshimet më të mëdha në sistemin gjuhësor të një të folmeje, nisin më së pari në fushën leksikore. Me sa duket dialekti është tharm i fortë, që s'ka për të 'vdekur' lehtë. Aq më shumë kur njerëzit ta kuptojnë dalëngadalë, se përdorimi i një dialekti nuk tregon prapambetje as injorancë, por mbart jetë, ngrohtësi njerëzore si shumëpak tjetër gjë e kësaj bote.

Bibliografi

- BECI B. (1962, 1963), "Hulumtime gjuhësore në Mat", BUSH, SSHSH, Tiranë, 2, 3
 ÇEFA A. (1957), "Një vështrim mbi të folmen e krahinës së Prellit", BINP, Shkodër, 1.

HAS'HYSAJ M. (2011), "*Vështrim dialektologjik dhe socio-etnolinguistik në të folmen e Përtejues (Mat)*", (Mikrotezë për gradën "Master"), Tiranë.
 GJINARI J., SHKURTAJ Gj. (2000), "*Dialektologjia*", Tiranë.

RROKAJ Sh. (2010), "*Të gjithë shqiptarët duhet të flasin shqipen standard*", në gazeta "Panorama", Tiranë, 15. 12.

SHKURTAJ Gj. (2000), "*Sociolinguistika*", SHBLU, Tiranë.

SHKURTAJ Gj. (2001), "*Onomastikë dhe etnolinguistikë*", SHBLU, Tiranë.

SHKURTAJ Gj. (2009), "*Sociolinguistikë e shqipes. Nga dialektologjia te etnografia e të folurit*", Tiranë.

TROPLINI E. (2012), "*E folmja e Çamërisë dje dhe sot*", Disertacion doktore, Tiranë.

ULQINI K. (1961), "*Gjurmime etnografike në troje të Skanderbegut*", BUSH, SSHSH 2. Tiranë...